



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
NJËSIA E INSPEKTORËVE

Nr. 3063 prot.

Tiranë, më 02.11 .2022

RAPORT

**I INSPEKTIMIT MBI RESPEKTIMIN E KUSHTEVE DHE KRITEREVE PËR
CAKTIMIN E MASAVE TË SIGURIMIT PERSONAL PËR VEPRËN PENALE TË
“MBAJTJES PA LEJE DHE PRODHIMIT TË ARMËVE, ARMËVE SHPËRTHYESE
DHE MUNICIONIT”**

Sipas

VENDIMIT NR. 47 DATË 15.07.2021 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Tiranë, 02.11.2022

Informata të përgjithshme

Titulli

Raport i inspektimit mbi respektimin e kushteve dhe kriterëve për caktimin e masave të sigurimit personal për veprën penale të "Mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit"

Data e përgatitjes

02.11.2022

Përgatitur nga

Znj. Elena Pelushi,
z. Julian Zonja,
znj. Alma Tafani,
znj. Lindita Ziguri,
z. Besnik Maho,
Inspektorë pranë Zyres së ILD



Për shqyrtim nga

z. Artur Metani,
Inspektori i Lartë i Drejtësisë



Miratoi Ktheu Ndryshoi

Data _____

1. Hyrje

- 1.1. Arsyet e inicimit të inspektimit
- 1.2. Qëllimi i inspektimit
- 1.3. Objekti i inspektimit
- 1.4. Subjekti i inspektimit
- 1.5. Objektivat e inspektimit
- 1.6. Rëndësia e inspektimit
- 1.7. Metodologjia e inspektimit
 - 1.7.1. Inspektorët e ngarkuar
 - 1.7.2. Mënyra e kryerjes së inspektimit.
- 1.8. Periudha e mbulimit të inspektimit.
- 1.9. Drejtimit e inspektimit
- 1.10. Kriteret (standartet) e vlerësimit.

2. Përshkrimi i të dhënave të administruara

- 2.1. Të dhënat e marra nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë
- 2.2. Të dhënat e marra nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier
- 2.3. Të dhënat e marra nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër

3. Gjetjet

- 3.1. Baza e vlerësimit
- 3.2. Proporcionaliteti i masave të propozuara
- 3.3. Veprimet procedurale të kryera nga ana e prokurorit për të identifikuar dyshimin e arsyeshëm të bazuar në prova
- 3.4. Niveli i arsytimit të bërë nga ana e prokurorit për t'i siguruar gjykatës se ekzistojnë së bashku ose veçmas kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit me karakter personal
- 3.5. Aspekte të tjera të evidentuara gjatë inspektimit tematik

4. Konkluzione

5. Rekomandime

1. Hyrje

1.1. Arsyet e inicimit të inspektimit

Në mbështetje të nenit 194, pika 4 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryen inspektime institucionale e tematike mbi çdo aspekt të punës së gjykatave, administratës gjyqësore, zyrave të prokurorive dhe administratës së prokurorisë.

Në këtë kuadër, nisur nga ushtrimi i kompetencave të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për sa i përket kontrollit të veprimtarisë së magistratëve, është planifikuar zhvillimi i një inspektimi tematik me objekt: "Respektimi i kushteve dhe kriterëve për caktimin e masave të sigurimit personal për veprën penale të "Mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit", parashikuar nga neni 278 i K.penal" pranë prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm si: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

1.2. Qëllimi i inspektimit

Qëllimi i këtij inspektimi është:

- Njohja e praktikave të tre zyrave të prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm lidhur me vlerësimin e kushteve dhe kriterëve ligjore për caktimin e masave të sigurimit, për të zgjedhur dhe kërkuar në gjykatë masa të përshtatshme të sigurimit personal, për veprën penale të "Mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit", të parashikuar nga neni 278 i K. Penal.
- Evidentimi i veprimeve procedurale të prokurorit në identifikimin e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova.
- Evidentimi i problematikave të mundshme në raport me zbatimin e ligjit në kuadër të respektimit të kushteve dhe kriterëve për caktimin e masave të sigurimit, dhe propozime të mundshme në drejtim të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë, të unifikimit të praktikave, të trajnimit vazhdues e ndryshimeve ligjore.

1.3. Objekti i inspektimit

Në këtë inspektim është vlerësuar veprimtaria e tre prokurorive pranë gjykatave të rretheve gjyqësore me juridiksion të përgjithshëm në respektimin e kushteve dhe kriterëve për caktimin e masës së sigurimit personal për veprën penale të "Mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit", parashikuar nga neni 278 i K.Penal.

1.4. Subjekti i inspektimit

Inspektimi tematik është zhvilluar pranë prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm si: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

1.5. Objektivat e inspektimit

Objektivat që synon t'i arrijë ky inspektim janë:

- Njohja dhe konstatimi i efektivitetit të veprimtarisë së prokurorive pranë gjykatave të rretheve gjyqësore subjekt inspektimi;
- Dhënien e rekomandimeve të karakterit legjislativ, administrativ, organizativ apo funksional lidhur me kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit me karakter personal.
- Identifikimin e veprimeve/mosveprimeve apo sjelljeve të magjistratëve, të cilat në bazë të një dyshimi të arsyeshëm justifikojnë fillimin e hetimit disiplinor sipas procedurave dhe rregullave të parashikuara në ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

1.6. Rëndësia e inspektimit

Inspektimi tematik paraqet rëndësi në:

- Rritjen e standarteve në veprimtarinë e magjistratëve në zbatimin e kushteve dhe kriterëve për caktimin e masave të sigurimit me karakter personal, të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale, Kushtetutë dhe Konventën Evropiane të të Drejtave të njeriut, lidhur me veprën penale të parashikuar nga neni 278 të K.Penal në veçanti.

1.7. Metodologjia e inspektimit

1.7.1. Inspektorët e ngarkuar:

Për kryerjen e inspektimit, sipas vendimit me nr. 47 datë 29.12.2021, u angazhuan fillimisht inspektorët për të punuar në grupe, sipas ndarjes së mëposhtme:

- a) Znj. Lindita Ziguri dhe Z. Besnik Maho, për Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër;
- b) Z. Daniela Sulaj dhe Znj. Alma Tafani, për Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier;

- c) Znj. Elena Pelushi dhe Z. Julian Zonja, për Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Me vendimin nr. 47/I datë 16.09.2021, për shkak të largimit nga detyra të një inspektori, është ndryshuar grupi i inspektorëve lidhur me inspektimin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, si më poshtë:

- a) Z. Julian Zonja dhe Znj. Alma Tafani.

Me qëllim rritjen e efikasitetit të grupit të inspektimit dhe mirëadministrimit të procesit, është caktuar si kryetar grupi Znj. Elena Pelushi.

1.7.2. Mënyra e kryerjes së inspektimit:

Kryerja e inspektimit është bazuar sipas vendimit të inspektimit, për realizimin e tij në 4 faza:

- 1) Faza e parë: "Përgatitja e planit të punës, hartimi i kërkesave për informacion dhe akte, si dhe zhvillimin e verifikimeve apo vizitave pranë prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm". Kjo fazë ka përfshirë hapat si më poshtë:
 - a) Është hartuar plani i punës, i dakortësuar nga të gjithë inspektorët.
 - b) Janë hartuar shkresat drejtuar zyrave të prokurorisë dhe gjykatave të rretheve gjyqësore Vlorë, Shkodër e Fier, sipas një modeli të dakortësuar nga të gjithë inspektorët.
 - c) Administruar informacioni dhe dokumentacioni sipas zyrës së prokurorisë dhe gjykatës përkatëse, dhe përpunimi i tyre paraprak.
- 2) Faza e dytë: "Përpunimi i të dhënave dhe informacionit të mbledhur". Kjo fazë ka përfshirë hapat si më poshtë:
 - a) Përpunimi i të dhënave dhe informacionit të mbledhur dhe studimi i tyre.
 - d) Vlerësuar se duhet të merren të dhëna të tjera, informacioni dhe dokumentacion plotësues, të vlerësuar sipas grupeve të inspektorëve, nëpërmjet dërgimit të shkresës, komunikimit me anë të telefonit dhe vizitës në terren.
- 3) Faza e tretë: "Hartimi i raportit të Inspektimit", që ka përfshirë këto hapa:
 - a) Hartimi i raporteve të veçanta nga secili prej grupeve të inspektimit për prokuroritë që janë ngarkuar për inspektim, sipas një modeli/strukture të njëjtë, të dërguar.
 - b) Hartimi i projekt raportit në fjalë, në përfundim të të cilit do t'i dërgohet për shqyrtim

pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Pas shqyrtimit dhe daljes së raportit nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do të kalohet në fazën e fundit:

4) Faza e katërt: "Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve dhe rezultateve të inspektimit".

1.8. Periudha e mbulimit të inspektimit.

Inspektimi tematik përfshiu veprimtarinë e zyrave të prokurorive subjekt të këtij inspektimi, për periudhën 01.01.2021 – 01.07.2021.

1.9. Drejtimet e inspektimit:

Fokusi i inspektimit tematik u përqëndrua kryesisht në tre drejtime kryesore:

- (i) Proporcionalitetin e masave të propozuara;
- (ii) Veprimet procedurale të kryera nga ana e prokurorit për të identifikuar dyshimin e arsyeshëm të bazuar në prova;
- (iii) Nivelin e arsytimit të bërë nga ana e prokurorit për t'i siguruar gjykatës se ekzistojnë së bashku ose veçmas kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit me karakter personal.

1.10. Kriteret (standartet) e vlerësimit.

Dokumentet vijuese janë baza kryesore, në të cilën është mbështetur puna e inspektorëve, gjatë vlerësimit të kryerjes së veprimtarisë së prokurorëve lidhur me objektin e inspektimit:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ;
- Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë ;
- Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur;
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë;
- Praktika e Gjykatës së Lartë;
- Praktika e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ)
- Ligji për Organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë;
- Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm mbi Gjendjen e Kriminalitetit në Shqipëri për vitet 2020 e 2021.

2. Përshkrimi i të dhënave të administruara

Nga ana e inspektorëve, në funksion të realizimit të inspektimit, janë administruar të dhëna nga: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë sipas shkresave me nr. 9104/1 prot datë 09.09.2021¹, nr. 11334/1 prot., datë 07.10.2021² dhe me nr. 12375/1 datë 03.11.2021³; Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër sipas shkresave nr.6551 prot., datë 09.09.2021, me nr. 6842 prot., datë 21.09.2021⁴; Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier sipas shkresës me nr.6850/1 prot., datë 09.09.2021⁵, nr. 9387/1 prot., datë 26.10.2021⁶; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë sipas shkresës me nr. 1383 prot., datë 07.09.2021, nr. 2967 datë 06.05.2022⁷; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër sipas shkresës me nr. 867/1 prot., datë 09.09.2021, nr.569/2 datë 05.05.2022⁸; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier sipas shkresës me nr. 4468/1 prot., datë 02.08.2021⁹; Gjykata e Apelit Vlorë, me shkresën me nr. 729 prot., datë 05.10.2021¹⁰.

Të dhënat e marra nga prokuroritë dhe gjykatat sa më sipër lidhen me:

- i) Praktikën shkresore që përfshihet në fashikullin e masës së sigurimit personal që ndodhet në Gjykatë, lidhur me kërkesat për vlefësim arrestimi ose ndalimi dhe caktim mase sigurimi personal; kërkesat për masë sigurimi personal; kërkesat për revokim, zëvendësim ose bashkim i masave të sigurimit personal.
- ii) Informacion shoqëruar me të dhëna statistikore, të ndara për çdo prokurori lidhur me numrin e materialeve hetimore me arrest që janë rregjistruar në çdo prokurori, emrin e prokurorit të caktuar me short manual/elektronik për ndjekjen e materialeve hetimore në fjalë; kërkesat për vlefësim arrestimi ose ndalimi dhe masë sigurimi personal; kërkesat për masë sigurimi personal; kërkesat për revokim, zëvendësim ose bashkim i masave të sigurimit personal. Gjithashtu, informacioni është kërkuar të shoqërohet edhe me kopje të regjistrit të protokollit të regjistrimit të hyrjeve të materialeve hetimore me arrest dhe të dërgimit të kërkesave përkatëse në gjykatë.

¹të regjistruar në ILD me nr. 3284/1 prot., datë 13.09.2021

²të regjistruar në ILD me nr. 3284/prot., datë 11.10.2021.

³të regjistruar në ILD me nr. 3284/5 prot., datë 04.11.2021.

⁴të regjistruar në ILD me nr. 3286/3 datë 23.09.2021

⁵të regjistruar në ILD me nr.3288/1 prot., datë 13.09.2021.

⁶të regjistruar në ILD me nr.ska, datë 26.10.2021.

⁷të regjistruar në ILD me nr. 3285/1 datë 10.09.2021/regjistruar në ILD me nr. 1179 datë 06.05.2022

⁸të regjistruar në ILD me nr. 3287/1 prot., datë 15.09.2021/regjistruar në ILD me nr. 1131/1 datë 09.05.2022. email i datës 28.04.2022.

⁹të regjistruar në ILD me nr.3289/1 prot., datë 05.08.2021.

¹⁰të regjistruar në ILD me nr. 3285/3 prot., datë 07.10.2021.

iii) Informacion pranë zyrave të prokurorisë, lidhur me rastet e lirimit të menjëhershëm të të arrestuarit ose të ndaluarit, shoqëruar me dokumentacionin e praktikës përkatëse të mbajtur për këto raste.

iv) Kopje të listave të gadishmërisë për periudhën e inspektimit.

2.1. Nga të dhënat e marra nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, rezultuan 10 çështje për të cilat është kërkuar nga prokurori masë e sigurimit personal shtrëngues ndaj 11 personave nën hetim për veprën penale objekt inspektimi si më vete dhe të shoqëruar edhe me vepra të tjera penale. Këto kërkesa kanë qenë të shoqëruar me kërkesën e prokurorit për vleftësimin e arrestimit/ndalimit të personit për të cilën është kërkuar masa e sigurimit, dhe për 1 çështje, kërkesa e prokurorit ndaj 1 personi nën hetim ka qenë edhe pas përfundimit të masës së sigurimit "arrest me burg" me afat, referuar parashikimit të nenit 245/1 shkronja "d" e K.Pr.Penale. Gjithashtu për 3 çështje nga 10 çështjet e sipërpërmendura, janë evidentuar kërkesë e personit nën hetim për zëvendësimin e masës së sigurimit sipas parashikimeve të nenit 260/2 të K.Pr.Penale.

Për periudhën e inspektimit nuk kanë rezultuar raste të urdhërimit nga ana e prokurorit, të lirimit të menjëhershëm të personave të arrestuar/ndaluar sipas parashikimeve të nenit 257 të K.Pr.Penale dhe të kërkesave për revokim/shuarje të masës së sigurimit nga ana e prokurorit/personit nën hetim sipas parashikimeve të neneve 260, 261 të K.Pr.Penale.

Lidhur me çështjet penale për të cilat nga ana e prokurorit është kërkuar masa e sigurimit me rastin e kërkesës për vleftësim arrestimi/ndalimi, rezulton në 4 prej tyre masa e sigurimit ndaj 4 personave nën hetim, është kërkuar për shkak se secili prej tyre dyshohej për kryerjen e veprës penale objekt inspektimi dhe në 6 çështje masa e sigurimit ndaj 7 personave nën hetim është kërkuar për shkak se dyshoheshin për kryerjen e veprës penale objekt inspektimi dhe për vepra penale të tjera.

Për 4 çështjet për të cilat masa e sigurimit është kërkuar vetëm për veprën penale "objekt inspektimi", fakti penal lidhej me mbajtjen pa leje të armës luftarake të llojit pistoletë në ambjent publik/automjet, sipas parashikimeve të nenit 278/1 i K.Penal dhe nga ana e prokurorit në përputhje edhe me nevojat e sigurimit, është vlerësuar si më të përshtatshme në 2 raste masa e sigurimit "arrest në burg", në 1 rast "arrest në shtëpi" dhe 1 rast me person të mitur "detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore". Nga ana e gjykatës janë pranuar këto qëndrime të prokurorit, por duke vlerësuar për 1 rast se ndodheshim para zbatimit të kërkesave të nenit 236 të k.pr.penale dhe duke caktuar për rrjedhojë caktimin e masës së sigurimit "garanci pasurore". Lidhur me këtë të fundit, nga ana e prokurorit është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit, e cila ka vendosur ndryshimin e masës së sigurimit "Garanci pasurore" më atë "arrest në burg", e cila nuk rezulton të jetë ekzekutuar për shkak të ikjes së personit nën hetim. Gjithashtu rezulton se për 1 çështje për të

cilën nga ana e gjykatës është vendosur "arrest në burg", është bërë ankim nga personi nën hetim dhe nga Gjykata e Apelit është lënë në fuqi vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor.

Për 6 çështjet e tjera, masa e sigurimit është kërkuar/dhënë për fakte penale ku personit i është atribuar vepra penale objekt inspektimi e shoqëruar me vepra penale të tjera.

- Për 3 nga këto çështje, ka rezultuar se masa e sigurimit është bazuar në faktin penal të përdorimit të armës luftarake, si vrasje, vrasje në tentativë, kanosje e prishjes të qetësisë publike dhe plagosjes, duke u kualifikuar sipas nenit 278/1 ndaj 2 personave, 278/4 i K.Penal ndaj 1 personi dhe e papërcaktuar sipas paragrafit të nenit 278 ndaj 1 personi. Lloji i armës i përdorur, është evidentuar pistoletë në 3 raste dhe automatik në 1 rast.
 - o Për 2 nga këto raste, nga ana e prokurorit, në përputhje edhe me nevojat e sigurimit, është vlerësuar si më e përshtatshme masa e sigurimit "arrest në burg" dhe nga ana e gjykatës është pranuar kërkesa në 1 rast, dhe për rastin tjetër është caktuar masa e sigurimit "arrest në burg" me afat. Vendimi për caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg" është ankimuar nga personi nën hetim, por është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit. Vendimi tjetër lidhur me masën e sigurimit "arrest në burg" me afat nuk është ankimuar dhe në përfundim të këtij afati, nga ana e prokurorit është kërkuar një masë e re sigurimi, "detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" e cila është pranuar si e tillë nga ana e gjykatës, referuar parashikimeve të nenit 244/3 të K.Pr.Penale.
 - o Për 1 rast, ku personat nën hetim kanë qenë të mitur dhe ngjarja ka qenë e lidhur me përdorimin e armës me anë të të cilës është kanosur e prishur qetësia publike, nga ana e prokurorit është vlerësuar "arrest në shtëpi" për përdoruesin e armës dhe për tjetrin si mbajtës i armës është kërkuar masa e sigurimit "detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore". Nga ana e gjykatës, është vlerësuar si masë e përshtatshme për të dy personat, "detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore". Vendimi ka marrë formë të prerë për shkak se nuk është ankimuar.
- Për 3 çështjet e tjera, rezulton se masa e sigurimit është kërkuar ndaj personit i cili rezulton të jetë konstatuar si mbajtës i armëve, municioneve luftarake në banesë dhe njëkohësisht edhe për mbajtje lëndë narkotike në dy raste, dhe për 1 rast këto dy vepra të shoqëruar edhe me vepra të tjera jo të lidhur me armë luftarake. Në këto raste, rezulton se lidhur me veprën penale të "Mbajtjes pa leje të armëve luftarake, municionit luftarak", kualifikimi është bërë sipas nenit 278/1, 278/3, 278/3,4 i K.Penal. Për të 3 këto çështje prokurori në përputhje edhe me nevojat e sigurimit, ka vlerësuar si më të përshtatshme caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg". Nga ana e gjykatës janë pranuar këto qëndrime të prokurorit, por duke vlerësuar për 1 rast se ndodheshin para zbatimit të nenit 236 të K.Pr.Penale dhe

për rrjedhojë caktimin e masës së sigurimit "garanci pasurore". Vendimet gjyqësore lidhur me këto masa kanë marrë formë të prerë, për shkak se nuk janë ankimuar.

Lidhur me 3 çështjet ku janë evidentuar kërkesë e personit nën hetim për zëvendësimin e masës së sigurimit sipas parashikimeve të nenit 260/2 të K.Pr.Penale, për periudhën e inspektimit, rezulton se prokuroria është përfaqësuar nga i njëjti prokuror që është ai i çështjes, i cili ka qenë si i tillë edhe gjatë paraqitjes së kërkesës për caktimin e masës së sigurimit, dhe se është vendosur zëvendësim vetëm për 1 çështje.

- Për çështjen e fundit, ku nga ana e kërkuarit ka qenë për zëvendësimin e masës së sigurimit "arrest në burg" në një më të lehtë, rezulton se nga ana e prokurorit nuk ka patur një qëndrim konkret lidhur me llojin e masës së sigurimit që duhet të vazhdonte për personin nën hetim dhe se referuar argumenteve të paraqitur prej tij, konstatohet vënia në dyshim e ekzistencës së kushtit të parashikuar nga neni 228/1 të K.Pr.Penale e cila passjell edhe revokim të masës së sigurimit. Nga ana e gjykatës, është vendosur zëvendësimi i masës së sigurimit në atë të "detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" ndaj personit të dyshuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 278/1, 300 dhe 305/b i Kodit Penal.
- Për 2 çështjet e tjera me objekt "kërkesë për zëvendësimin e masës së sigurimit "arrest në burg" nga ana e personit nën hetim, rezulton se:
 - o për 1 rast është paraqitur kërkesë për heqje dorë nga vetë kërkuari i dyshuar për kryerjen e veprave penale të parashikuar nga nenet 238/1 dhe 278/1 i Kodit Penal, dhe për rrjedhojë është pushuar çështja nga ana e gjykatës;
 - o për rastin tjetër nga ana e prokurorit është mbajtur qëndrimi për rrëzimin e kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit "arrest në burg" në atë të "arrestit në shtëpi". Kërkuari ka qenë person nën hetim për veprën penale të parashikuar nga nenet 78, 25 dhe 278/1 i Kodit Penal. Lidhur me këtë të fundit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Vendimi i gjykatës rezulton të jetë jashtë periudhës së inspektimit.

2.2. Nga të dhënat e marra nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, për periudhën e inspektimit referuar parashikimeve të nenit 244 të K.Pr.Penale, rezultuan 9 çështje për të cilat është kërkuar nga prokurori masë e sigurimit personal shtrëngues ndaj 9 personave nën hetim për veprën penale objekt inspektimi si më vete dhe të shoqëruar edhe me vepra të tjera penale. Në 6 çështje, këto kërkesa kanë qenë të shoqëruar me kërkesën e prokurorit për vlefësimin e arrestimit në flagrancë të personit për të cilën është kërkuar masa e sigurimit, në 2 çështje personi/at ndaj të cilëve është kërkuar masa e sigurimit nga ana e prokurorit, nuk kanë qenë të të arrestuar/ndaluar dhe në 1 çështje kërkesa e prokurorit ka qenë me rastin e përfundimit të masës së sigurimit "arrest në burg" me afat të vendosur nga gjykata sipas parashikimeve të nenit 245/1 shkronja "d" të K.pr.penale.

Për periudhën e inspektimit në kuadër të veprimtarisë së prokurorit lidhur me masat e sigurimit, janë konstatuar: 2 çështje në të cilat nga ana e prokurorit është shprehur qëndrimi i tij për vazhdimin e masës së sigurimit referuar nenit 248 të K.Pr.Penale, për verifikimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit; për 2 çështje prokurori ka shprehur qëndrimin lidhur me masën e sigurimit në kuadër të kërkesës së personit nën hetim për zëvendësimin e masës së sigurimit.

Për periudhën e inspektimit nuk kanë rezultuar raste të urdhërimit nga ana e prokurorit, të lirit të menjëhershëm të personave të arrestuar/ndaluar sipas parashikimeve të nenit 257 të K.Pr.Penale dhe të kërkesave për revokim/shuarje të masës së sigurimit nga ana e prokurorit/personit nën hetim sipas parashikimeve të neneve 260, 261 të K.Pr.Penale.

Lidhur me çështjet penale për të cilat nga ana e prokurorit është kërkuar masa e sigurimit me rastin e kërkesës për vlefësim arrestimi, rezulton në 4 prej tyre masa e sigurimit ndaj 4 personave nën hetim, është kërkuar për shkak se secili prej tyre dyshohej për kryerjen e veprës penale objekt inspektimi dhe në 2 çështje të tjera masa e sigurimit ndaj 2 personave nën hetim është kërkuar për shkak se dyshoheshin për kryerjen e veprës penale objekt inspektimi dhe për vepra penale të tjera.

- Për 4 çështjet për të cilat masa e sigurimit është kërkuar vetëm për veprën penale "objekt inspektimi", fakti penal lidhet me mbajtjen pa leje të armës luftarake në ambjent publik/automjet, sipas parashikimeve të nenit 278/1 i K.Penal dhe nga ana e prokurorit në përputhje edhe me nevojat e sigurimit, është vlerësuar si më të përshtatshme në 2 raste masa e sigurimit "arrest në burg", në 1 rast "arrest në shtëpi" dhe 1 rast ku personi ndaj të cilit caktohet masa e sigurimit "vendosja nën mbikqyrje" sipas parashikimeve të nenit 83 të KDPM. Nga ana e gjykatës janë pranuar këto qëndrime të prokurorit, por duke vlerësuar për rastin e "arrestit në shtëpi" si një kërkesë e prokurorit referuar përcaktimeve të nenit 244/3 të K.Pr.Penale. Për këto raste, lloji i armës luftarake ka qenë pistoletë në 2 raste, automatik për 1 rast dhe pushkë karabinë për rastin me të mitur.
- Për 2 çështjet e tjera, masa e sigurimit është bazuar në faktin penal të përdorimit të armës luftarake, si hedhje lënde shpërthyesë e gjuajtje me armë duke prishur qetësinë publike, kundërshtim i punonjësit të policisë, duke u kualifikuar sipas nenit 278/1, 278/1, 3 të K.Penal. Për këto raste, nga ana e prokurorit, në përputhje edhe me nevojat e sigurimit, është vlerësuar si më të përshtatshme masa e sigurimit "arrest me burg". Gjithashtu për këto raste lloji i armës luftarake të përdorur ka qenë lëndë shpërthyesë në 1 rast dhe automatik në 1 rast shoqëruar edhe me gjetjen në banesë të sasive të fishekëve.

Lidhur me 2 çështjet për të cilat nga ana e prokurorit është kërkuar masa e sigurimit ndaj dy personave nën hetim të cilët nuk kanë qenë të arrestuar/ndaluar, rezulton se në të dy rastet veprat penale për të cilët dyshoheshin secili prej këtyre personave lidheshin me përdorimin e armës së

zjarrit të kualifikuar si 278/1 i K.Penal. Dhe konkretisht vrasjes me paramendim në bashkëpunim në 1 rast ku është përcaktuar vepra penale e parashikuar nga neni 278/1 i K.Penal për 1 person nën hetim dhe të vrasjes me paramendim në tentativë. Masa e sigurimit e kërkuar në këto dy raste, ka qenë ajo e arrestit në burg, e cila është pranuar edhe gjykata.

Lidhur me çështjen për të cilën nga ana e prokurorit është proceduar me kërkesë për "arrest në burg", me rastin e përfundimit të afatit të masës së sigurimit "arrest me burg" të dhënë nga ana e gjykatës sipas parashikimeve të nenit 245/1, shkronja "d" i K.Pr.Penale, rezulton se kërkesa bazohet në dyshimin e arsyeshëm se personi nën hetim ka kryer veprën penale të "Prodhimit dhe mbajtjes së lëndës narkotike" të parashikuar nga neni 283/2 i K.Penal dhe "Mbajtjes së municioneve" të parashikuar nga neni 278/3 i K.Penal. Për këtë rast, nga ana e gjykatës është vendosur shuarja e masës së sigurimit dhe caktimi i masës së sigurimit "arrest në shtëpi", parashikuar nga neni 237 i K. Pr. Penale dhe ky vendim është lënë në fuqi edhe nga gjykata e apelit.

Lidhur me 2 çështjet për të cilat nga ana e prokurorit është proceduar me kërkesë për verifikimin e kushteve dhe zbatimit të masës së sigurimit "arrest në burg", sipas parashikimeve të nenit 248 të K.Pr.Penale ndaj 2 personave, rezulton se vazhdimi i masës së sigurimit është kërkuar nga ana e prokurorit lidhur me faktin penal të përdorimit të armës luftarake dhe konkretisht për plagosje, dhe vrasje me paramendim në tentativë dhe në bashkëpunim sipas parashikimeve të neneve 278/1 i K.Penal, dhe përkatësisht për secilin rast të shoqëruar me veprat penale 89, 25 dhe 78, 22, 25 i K.Penal. Për këto 2 raste, gjykata ka pranuar qëndrimin e prokurorit.

Lidhur me 2 çështjet për të cilat nga ana e prokurorit është mbajtur qëndrimi i tij për vazhdimin e masës së sigurimit "arrest në burg" ndaj 2 personave, me rastin e kërkesës së këtyre dy të fundit për zëvendësimin e masës së sigurimit sipas parashikimeve të nenit 260/2 të K.Penal, konstatohet se:

- për 1 çështje konstatohet përdorimi i armës së zjarrit në kryerjen e veprës penale të vrasjes me paramendim si dhe konstatimit të gjetjes së armës së ftohtë, duke u kualifikuar veprat penale në 78/1, 278/1 dhe 279/1 i K.Penal. Për këtë kërkesë, nga ana e gjykatës së rrethit gjyqësor nuk është pranuar kërkesa për zëvendësimin e masës së sigurimit. Ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit, e cila ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor.
- Dhe për çështjen tjetër ndaj personit nën hetim ekzistonte dyshimi për kryerjen e veprave penale të parashikuar nga neni 278/2,3 i K.Penal e lidhur me gjetjen në banesë të një arme automatik dhe sasi municionesh të armëve luftarake, neni 283/1 e lidhur me gjetjen në banesë së lëndës narkotike, e nenit 284/1 i K.Penal e lidhur me kultivimin e bimëve narkotike. Për këtë kërkesë, nga ana e gjykatës së rrethit gjyqësor është pranuar kërkesa për zëvendësimin e masës me garanci pasurore. Mbi ankimin e prokurorit, Gjykata e Apelit

ka ndryshuar vendimin duke zëvendësuar "arrest në burg" me atë "të arrestit në shtëpi", dhe kthimin e shumës së garancisë pronarit.

2.3. Nga të dhënat e marra nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, për periudhën e inspektimit referuar parashikimeve të nenit 244 të K.Pr.Penale, rezultuan 16 çështje për të cilat është kërkuar nga prokurori masë e sigurimit personal shtrëngues ndaj 18 personave nën hetim për veprën penale objekt inspektimi si më vete dhe të shoqëruar edhe me vepra të tjera penale. Në 15 çështje, këto kërkesa kanë qenë të shoqëruar me kërkesën e prokurorit për vlefhtësimin e arrestimit në flagrancë/ndalimit të personit për të cilën është kërkuar masa e sigurimit, dhe në 2 nga këto çështje gjithashtu rezultojnë të jenë edhe 3 kërkesa të prokurorit me rastin e përfundimit të masës së sigurimit "arrest në burg" me afat të vendosur nga gjykata sipas parashikimeve të nenit 245/1 shkronja "d" të K.pr.penale.

Për periudhën e inspektimit në kuadër të veprimtarisë së prokurorit lidhur me masat e sigurimit, janë konstatuar: 2 çështje në të cilat nga ana e prokurorit është shprehur qëndrimi i tij për vazhdimin e masës së sigurimi në referim të nenit 248 të K.Pr.Penale, për verifikimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit; për 5 çështje prokurori ka shprehur qëndrimin lidhur me masën e sigurimit në kuadër të kërkesës së personit nën hetim për zëvendësimin e masës së sigurimit; për 1 çështje prokurori ka kërkuar në 1 rast revokimin e masës së sigurimit sipas parashikimit të nenit 260/1 të K.Pr.Penale dhe në 1 rast tjetër shuarje mase sigurimi sipas parashikimeve të nenit 261 të K.Pr.Penale.

Për periudhën e inspektimit nuk kanë rezultuar raste të urdhërimit nga ana e prokurorit, të lirit të menjëhershëm të personave të arrestuar/ndaluar sipas parashikimeve të nenit 257 të K.Pr.Penale.

Lidhur me çështjet penale për të cilat nga ana e prokurorit është kërkuar masa e sigurimit me rastin e kërkesës për vlefhtësim arrestimi/ndalimi, rezulton në 4 prej tyre masa e sigurimit ndaj 5 personave nën hetim, është kërkuar për shkak se secili prej tyre dyshohej për kryerjen e veprës penale objekt inspektimi dhe në 11 çështje të tjera masa e sigurimit ndaj 13 personave nën hetim është kërkuar për shkak se dyshoheshin për kryerjen e veprës penale objekt inspektimi dhe për vepra penale të tjera.

Për 4 çështjet për të cilat masa e sigurimit është kërkuar vetëm për veprën penale "objekt inspektimi", fakti penal lidhej me mbajtjen pa leje të armës luftarake të llojit pistoletë në ambient publik/lokal/automjet, sipas parashikimeve të nenit 278/1 i K.Penal dhe nga ana e prokurorit i cili ka qenë i ndryshëm, në përputhje edhe me nevojat e sigurimit është vlerësuar si më e përshtatshme në 3 raste masa e sigurimit "arrest në burg", në 1 rast "arrest në shtëpi" dhe "garanci pasurore". Nga ana e gjykatës janë pranuar këto qëndrime të prokurorit dhe këto vendime kanë marrë formë të prerë për shkak mosankimimi në tre prej tyre dhe në një prej tyre si rrjedhojë e vendimit të Gjykatës së Apelit.

Për 8 çështje ndaj 9 personave nën hetim, masa e sigurimit është bazuar në faktin penal të përdorimit të armës luftarake, si vrasje, vrasje në tentativë, plagosje, gjuajtje me armë duke prishur qetësinë publike, duke u kualifikuar sipas nenit 278/1, 278/1, 25, 278/4 të K.Penal. Për këto raste, nga ana e prokurorit, në përputhje edhe me nevojat e sigurimit, është vlerësuar si më e përshtatshme për 5 raste masa e sigurimit "arrest me burg"- ku njëri prej personave nën hetim edhe i mitur, në 1 çështje "arrest në burg" me afat, në 1 çështje "ndalim për të dalë jashtë shtetit" dhe "detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore", 1 çështje ndaj të miturit "arrest në shtëpi". Për këto raste lloji i armës luftarake të përdorur ka qenë në automatik, pushkë, pistoletë.

- për 4 çështjet për të cilat është kërkuar masa e sigurimit "arrest në burg", gjykata i ka pranuar këto kërkesa dhe për shkak mosankimi ndaj 3 vendimeve, ato kanë marrë formë të prerë. Për 1 vendim rezulton të jetë ushtruar ankim në gjykatën e Apelit e cila ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës për caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg".
- për çështjen ndaj të miturit, për të cilën është kërkuar masa e sigurimit "arrest në burg", gjykata e rrethit gjyqësor e ka pranuar këtë kërkesë. Mbi bazë ankimi, Gjykata e Apelit ka vendosur ndryshimin e masës, duke caktuar masën e sigurimit "vendosje e të miturit në mbikqyrje" të parashikuar nga neni 82/1/a të KPDM.
- për çështjen ndaj të miturit, për të cilën është kërkuar masa e sigurimit "arrest në shtëpi", gjykata e rrethit gjyqësor e ka pranuar këtë kërkesë. Vendimi gjyqësor për shkak mosankimimi ka marrë formë të prerë.
- për çështjen për të cilën është kërkuar masa e sigurimit "arrest në burg" me afat, nga ana e gjykatës është pranuar kjo kërkesë. Në përfundim të afatit, përsëri prokurori ka proceduar me kërkesë për caktim mase sigurimi me afat dhe përsëri është pranuar nga ana e gjykatës. Më pas prokurori, pa përfunduar afati i caktuar, ka paraqitur kërkesë për revokimin e masës së sigurimit e cila është rrëzuar nga ana e gjykatës së rrethit gjyqësor, dhe në vijim, prokurori ka paraqitur kërkesë për shuarjen e masës së sigurimit e cila është pranuar nga gjykata, me gjyqtar të ndryshëm nga ai që ka caktuar masat e sigurimit dhe rrëzuar kërkesën për revokim mase sigurimi.
- në 1 çështje për të cilën është kërkuar "ndalim për të dalë jashtë shtetit" dhe "detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore", edhe gjykata e ka pranuar atë, dhe nuk rezulton të ketë ankim, duke marrë kështu vendimi formë të prerë.

Për 4 çështje të tjera, masa e sigurimit e kërkuar nga prokurori bazohet në dyshimin e arsyeshëm se personat nën hetim kanë kryer veprën penale objekt inspektimi të shoqëruar edhe me vepra të tjera penale, si "Prodhim dhe shitje lëndësh narkotike", "Kultivim i bimëve narkotike",

“Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit”, “Mbajtje pa leje të armëve të flohta”, “Shpërthim i lëndëve me eksploziv”. Fakti penal lidhur me veprën penale objekt inspektimi, ka të bëjë me gjetjen në banesë të fishekëve në 1 rast, si dhe në 3 raste të mbajtjes në ambjente publike si pistoletë, armë automatik të cilat janë kualifikuar sipas neneve 278/1, 278/2, 278/3, 278/1, 25 i K.Penal.

Lidhur me këto çështje rezulton se nga ana e prokurorit është vlerësuar si masë sigurimi “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” në 1 rast për nenin 278/2, 283/1, 279/2 K.Penal, e cila është pranuar edhe nga ana e gjykatës; për 2 çështje është vlerësuar masa e sigurimit “arrest në burg” dhe gjykata ka pranuar këtë kërkesë; për 1 çështje është kërkuar “arrest në burg” dhe gjykata ka vendosur caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” me afat. Për këto vendime, rezulton të jetë ushtruar ankim vetëm për 1 vendim që ka caktuar masën e sigurimit “arrest në burg” dhe gjykata e Apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor.

- Me përfundimin e masës së sigurimit me afat, nga ana e prokurorit është kërkuar sërish masa e sigurimit “arrest në burg”, dhe nga ana e gjykatës sërish është vendosur masa e sigurimit “arrest në burg” me afat. Në vijim prokurori, në respektim të afatit ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, e cila pranohet nga gjykata. Vendimi nuk është ankimuar, duke marrë formë të prerë.

Lidhur me 2 nga çështjet ku pas caktimit të masës me vlefshësimin e arrestimit në flagrancë, është proceduar me kërkesa të prokurorit me rastin e përfundimit të masës së sigurimit “arrest në burg” me afat të vendosur nga gjykata sipas parashikimeve të nenit 245/1 shkronja “d” të K.pr.penale, rezultojnë se masat janë kërkuar dhe vendosur për shkak se personat dyshohen për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 278/1 (armë pistoletë në automjet) dhe 236/1 i K.Penale për 1 çështje dhe për tjetrën 278/1 (pistoletë ambjent publik) dhe përdorim duke konsumuar edhe elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 89 të K.Penal.

Lidhur me 2 çështjet për të cilat nga ana e prokurorit është proceduar me kërkesë për verifikimin e kushteve dhe zbatimit të masës së sigurimit “arrest në burg” ndaj 2 personave, sipas parashikimeve të nenit 248 të K.Pr.Penale, rezulton se vazhdimi i masës së sigurimit është kërkuar nga ana e prokurorit lidhur me faktin penal të përdorimit të armës luftarake pistoletë dhe konkretisht për vrasje në rrethana cilësuese në tentativë në 1 rast dhe vrasje me paramendim, sipas parashikimeve të nenit 278/1 i K.Penal, dhe të shoqëruar me veprat penale 79/dh, 22 apo 78, 25 i K.Penal. Për këto raste, gjykata ka pranuar qëndrimin e prokurorit për vijimin e masës së sigurimit “arrest në burg”.

Lidhur me 5 çështjet për të cilat nga ana e prokurorit është mbajtur qëndrimi i tij për vazhdimin e masës së sigurimit “arrest në burg” ndaj personave, me rastin e kërkesës së këtyre dy të fundit për zëvendësimin e masës së sigurimit sipas parashikimeve të nenit 260/2 të K.Penal, konstatohet se:

- për 2 çështje konstatohet përdorimi i armës së zjarrit në kryerjen e veprës penale të vrasjes në rrethana cilësuese në tentativë me paramendim duke u kualifikuar veprat penale në 79/dh, 22, 278/1 i K.Penal. Për 1 çështje për shkak të heqjes dorë të kërkuesit gjykata ka vendosur mospranim dhe 1 çështje gjykata e rrethit gjyqësor ka rrëzuar kërkesën. Për çështjen e fundit rezultoi se ndaj vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor është ushtruar ankimi dhe gjykata e apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor.
- për çështjen tjetër ndaj personit nën hetim ekziston dyshimi për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga neni 130/a, 278, 280 i K.Penal e lidhur me gjejtjen në banesë të një arme automatik dhe sasi municionesh armëve luftarake, dhunë në familje dhe armë gjahu. Prokurori ka mbajtur qëndrimin për rrëzimin herën e parë, duke mos u paraqitur në seancë dhe gjykata e rrethit gjyqësor e ka rrëzuar kërkesën e personit nën hetim. Mbi bazën e ankimit të këtij të fundit, Gjykata e apelit ka vendosur prishjen dhe kthimin për gjykim me një trupë tjetër, për shkakun se prania e prokurorit është e detyrueshme. Në vazhdim, kërkuesi personi nën hetim paraqet një kërkesë të re, prokurori rrëzimin e kërkesës dhe gjykata me gjyqtarë të ndryshëm, tashmë të seancës paraprake ka vendosur pranimin e kërkesës, duke caktuar masën e sigurimit "arrest në shtëpi" dhe "garanci pasurore". Ndaj këtij vendimi kanë ushtruar ankimi dhe personi nën hetim dhe gjykata e Apelit e ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor.
- Për çështjen tjetër ndaj 2 personave nën hetim ekziston dyshimi për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga neni 78, 22 dhe 278/1 i K.Penal, e lidhur me përdorimin e armës pistoletë për vrasje në tentativë. Gjyqtari ka vendosur pa kaluar në seancë, moskalimin e çështjes, për shkak të mosparaqitjes së kërkesës nga personi i legjitimuar. Nuk ka të dhëna për ushtrimin e ndonjë ankimi.
- Për çështjen tjetër ndaj personit nën hetim ekziston dyshimi për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga neni 79/dh, 22 dhe 25, si dhe 278/1 i K.Penal, e lidhur me përdorimin e armës së zjarrit për kryerjen e veprës penale të vrasjes në rrethana cilësuese në bashkëpunim edhe me 3 persona të tjerë. Prokurori ka kërkuar rrëzimin e kërkesës dhe Gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Ndaj këtij vendimi nuk është ushtruar ankimi.

3. Gjetjet

3.1. Baza e vlerësimit:

Referuar qëllimit dhe objektivit të inspektimit, analiza e të dhënave të marra nga zyrat e prokurorive, është përqëndruar në drejtim të (i) proporcionalitetit të masave të propozuara, (ii) veprimeve procedurale të kryera nga ana e prokurorit për të identifikuar dyshimin e arsyeshëm të bazuar në prova, (iii) nivelit të arsyetimit bërë nga ana e prokurorit për t'i siguruar gjykatës se ekzistojnë së bashku ose veçmas kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit me karakter personal.

Analiza e këtyre të dhënave, duke patur në konsideratë faktin se çështjet lidhur me procedurat për caktimin e masave të sigurimit, janë të lidhura drejtëpërdrejtë me respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, konkretisht me lirinë e personit, është bazuar në analizën dhe interpretimin e dispozitave përkatëse të Kushtetutës, Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, të Kodit të Procedurës Penale ku parashikohen konkretisht kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit, procedurat përkatëse për caktimin, zbatimin e rivlerësimin e këtyre masave, si edhe në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Sipas parimeve të përgjithshme të Kushtetutës, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik¹¹. Këto të drejta mund të kufizohen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, në përpjestim me gjendjen që e ka dituar atë, si dhe nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut¹². Përsa i përket kufizimit të lirisë së personit, Kushtetuta ka parashikuar konkretisht se kjo mund të ndodhë përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj, dhe ndër rastet e përcaktuara është edhe kufizimi kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale, ose për të prandaluar kryerjen prej tij të veprës penale, ose largimin e tij pas kryerjes së saj¹³. Në vijim, Kushtetuta parashikon edhe garancitë përkatëse për personin kur ai i nënshtrohet kufizimit të lirisë¹⁴, të cilat zbatohen edhe kur kjo ndodh për efekt të procedurave hetimore të filluar ndaj tij.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, pjesë e sistemit të brendshëm juridik¹⁵, në respektim të të drejtës për liri të personit ka parashikuar garanci ndaj privimit të lirisë, duke e konsideruar ndër të tjera arrestimin/paraburgimin si një formë ekstreme të kufizimit të lirisë së lëvizjes. Në

¹¹ Neni 15 i Kushtetutës

¹² Neni 17 i Kushtetutës

¹³ Neni 27 i Kushtetutës

¹⁴ Neni 28 e vijues i Kushtetutës

¹⁵ Pas ratifikimit dhe hotimit të saj në Fletoren Zyrtare

këtë kuptim, konventa e parashikon kufizimin e lirisë së personit si rast përjashtimor e cila duhet të jetë në përputhje me procedurën e parashikuar në ligj. Ndër rastet në të cilat parashikon konventa, lidhur me kufizimin e lirisë së personit, është edhe rasti kur ka arsye të besueshme për të dyshuar se ai ka kryer një veprë penale ose kur ka motive të arsyeshme për të besuar se është e nevojshme që të pengohet të kryejë një veprë penale ose të largohet pas kryerjes së saj. Edhe për këtë rast, ashtu si edhe rastet e tjera përjashtimore të kufizimit të lirisë së personit, konventa parashikon në mënyrë specifike edhe garancitë përkatëse që gjejnë zbatim në këtë rast, që lidhen me kontrollin gjyqësor brenda një afati të shkurtër dhe të arsyeshëm.

Parimet dhe garancitë e parashikuar në Kushtetutë dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i gjejmë të pasqyruar edhe në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, ku rregullohen në mënyrë të hollësishme caktimi i masave të sigurimit personal objekt i këtij inspektimi. Masat e sigurimit personal sipas Kodit të Procedurës Penale ndahen në masa shtrënguese dhe në masa ndaluese¹⁶. Masat ndaluese ndryshe nga masat shtrënguese, mund të zbatohen jo për të gjitha veprat penale, por vetëm kur procedohet për vepra penale për të cilat ligji cakton dënim me burgim më të lartë, në maksimum se një vit si dhe në faktin që, qëllimi i vetëm i marrjes së këtyre masave është parandalues.

Është me rëndësi të theksohet, ashtu siç është konsoliduar edhe nga praktika e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë¹⁷, se masat e sigurimit nuk janë dënime penale, por janë masa që lidhen me nevojat e sigurimit dhe jepen mbi disa kushte dhe kritere të përcaktuara saktësisht në titullin V të K.Pr.Penale.

Në nenin 228 të Kodit të Procedurës Penale janë parashikuar kushtet e përgjithshme dhe të veçanta që duhet të plotësohen për caktimin e masave të sigurimit personal. Në interpretim të kësaj dispozite, tashmë e konsoliduar edhe nga praktika gjyqësore¹⁸, kushtet të cilat duhet të plotësohen në mënyrë kumulative për të caktuar një masë sigurimi, janë: 1. Të ekzistojë dyshimi për kryerjen e një veprë penale; 2. Të mos ekzistojnë shkaqe padënueshmërie; 3. Të plotësohet njëri prej kushteve të veçanta: rreziku i marrjes apo vërtetësisë së provës; ose rreziku i largimit; ose rreziku i kryerjes së veprave penale prej personit të dyshuar.

Në nenin 229 të K.Pr.Penale janë parashikuar kriteret e përgjithshme për caktimin e një mase sigurimi, në përputhje me parimet e përshtatshmërisë dhe proporcionalitetit. Sipas kësaj dispozite, në caktimin e masave të sigurimit mbahet parasysh përshtatshmëria e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret, dhe proporcionaliteti pasi çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale

¹⁶ Neni 227 të K.Pr.Penale.

¹⁷ Vendimi Unifikues i Gj.L. nr. 3/2002, vendim nr. 33 datë 08.09.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, vendim nr. 00-2021-108 i Vendimit datë 05.02.2021 të Gjykatës së Lartë.

¹⁸ Vendimi Unifikues i Gj.L. nr. 4/2009, nr. 7/2011, Vendimi nr. 00-2017-323 i Vendimit (59) datë 19.04.2017.

konkrete. Mbahen parasysh në veçanti vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal. Kur i pandehuri është i mitur, gjykata mban parasysh interesin e tij më të lartë dhe kërkesën për të mos ndërprerë proceset edukative konkrete.

Ndërsa kriteret e veçanta për caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg", janë parashikuar në nenin 230 të K.Pr.Penale, në të cilat është parashikuar se kjo masë mund të vendoset kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të pandehurit.

Prezumimi i pafajësisë kërkon që nëse përdoret paraburgimi ai nuk duhet të konsiderohet si i vendosur si dënim, por vetëm si një masë paraprake në rastet kur rrethana të veçanta e kërkojnë atë për administrimin sa më të mirë të drejtësisë. Paraburgimi është masa më e rëndë që mund të përdoret për një person të akuzuar për kryerjen e një vepre penale, e për këtë zbatim i tij duhet të ketë një karakter të jashtëzakonshëm dhe duhet të jetë i kufizuar nga parimi i ligjshmërisë, nga prezumimi i pafajësisë, nga nevoja dhe proporcionaliteti, në përputhje me atë që është domosdoshmërisht e nevojshme në një shoqëri demokratike, prandaj bëhet fjalë për një masë konservatore jo ndëshkuese¹⁹.

Masat e sigurimit sipas parashikimeve të nenit 244 të Kodit të Procedurës Penale, vendosen me kërkesën e prokurorit, i cili i paraqet gjykatës kompetente arsyet ku bazohet kërkesa, duke e bashkëlidhur të dhënat e nevojshme që sipas nenit 245/1/c të K.Pr.Penale përligjin masën e sigurimit. Referuar këtij parashikimi, gjykata nuk mund të disponojë kryesisht mbi caktimin e një mase sigurimi nëse nuk paraqitet një kërkesë nga prokurori. Si i tillë roli i prokurorit është shumë i rëndësishëm, në respektimin e kushteve dhe kriterëve për caktimin e masës së sigurimit dhe për këtë arsye, prokurori brenda kompetencave të tij procedurale duhet të tregojë kujdesin e tij për ushtruar në mënyrë sa më efektive funksionin e tij drejtues dhe kontrollues të hetimeve paraprake dhe veprimtarisë së policisë gjyqësore. Kjo dilijencë e prokurorit, si organi i cili ushtron ndjekjen penale duhet të vazhdojë edhe pas zbatimit të masës së sigurimit për të mbikqyrur dhe vlerësuar nëse vazhdojnë të ekzistojnë njëjtat kushte dhe kriteret, të cilat mundësojnë procedimin e mëtejshëm, në zbatim të nenit 260 të K.Pr.Penale ku parashikohet revokimi dhe zëvendësimi i masave të sigurimit. Revokimi dhe zëvendësimi i masës së sigurimit parashikohet si një e drejtë e palëve për t'u kërkuar në çdo kohë, por gjithsesi nga ana e legjislatorit në funksion të rritjes së garancive të lirisë së personit i cili i është nënshtruar zbatimit të masës së arrestit, ka parashikuar në nenin 246/6 të K.Pr.Penale detyrimin e prokurorit për të informuar periodikisht gjykatën që ka dhënë vendimin e cila ka mundësi të vendos vazhdimin, zëvendësimin ose revokimin e masës së sigurimit.

Kodi i Procedures Penale ka parashikuar dy mënyra për caktimin e masave të sigurimit personal²⁰. Mënyra e parë është rasti kur prokurori, mbasi ka vlerësuar në mënyrë të njëanshme se në ngarkim të personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet për një vepër të caktuar penale ekziston dyshimi i bazuar

¹⁹ GJAMDNJ çështja *López Álvarez kundër Honduras. Fond, Réparations et Frais. 1 shkurt 2006, Série C, nr. 141.*

²⁰ *Vendimi nr. 4/2009 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për çështje penale.*

në prova për kryerjen e veprës penale, duke patur parasysh kushtet dhe kriteret që parashikon Kodi i Procedurës Penale, në nenet 228 e vijues të tij, i bën kërkesë gjykatës bazuar në nenin 244/1 të K.Pr.Penale që të caktojë një masë sigurimi personal, me qëllim që të garantojë nevojat e sigurimit. Kjo procedurë e caktimit të masës së sigurimit nuk është një gjykim i mirëfilltë me elementët që ai ka të përcaktuar sipas Kodit të Procedurës Penale, për shkak se, nevojat e sigurimit, këtë fazë të procedimit e konsiderojnë sekret dhe nuk e detyrojnë as prokurorin dhe as gjykatën të njoftojnë të pandehurin dhe mbrojtësin e tij lidhur me këtë veprim procedural. Të drejtat e të pandehurit për t'u garantuar një proces i rregullt me zbatimin e normave kushtetuese dhe atyre ndërkombëtare për të mbrojtur dhe garantuar liritë në një procedim penal, ligjëvënësi i ka përcaktuar në një fazë të dytë e cila parashikohet në nenin 248 të K.Pr.Penale, sipas të cilës gjykata detyrohet që, jo më vonë se tre ditë nga zbatimi i masës, të marrë në pyetje personin për të cilin është vendosur arresti në burg ose në shtëpi dhe nëpërmjet kësaj të verifikojë kushtet dhe kriteret për zbatimin e kësaj mase në raport me nevojat e sigurimit, si dhe për masat e tjera të sigurimit, shtrënguese ose ndaluese, gjykata procedon me marrjen në pyetje brenda pesë ditëve nga zbatimi i masës. Mënyra e dytë që K.Pr.Penale parashikon për caktimin e masave të sigurimit përgjithësisht është nëpërmjet verifikimit të veprimeve me iniciativë të policisë gjyqësore në rastet e arrestimit në flagrancë, apo të ndalimit të personit të dyshuar për një veprë penale i cili ka rrezik ikje, e parashikuar si e tillë posaçërisht në nenin 259/3 të K.Pr.Penale.

Një garanci tjetër kushtetuese që i njihet në mënyrë të pavarur vetë të paraburgosurit është ajo për të kërkuar në çdo kohë e rrethanë në gjykatë revokimin apo zëvendësimin e masës së sigurimit. Revokimi, zëvendësimi dhe shuarja e masave të sigurimit kanë si qëllim që të sigurohet në vazhdimësi përshtatshmëria e masave të sigurimit me kushtet dhe kriteret e zbatimit të tyre.

Me revokim të masës së sigurimit kuptohet heqja apo shfuqizimi i masës së sigurimit të dhënë në rastet kur kjo masë nuk është në përputhje me kushtet dhe kriteret e parashikuara nga K.Pr.Penale. Termi revokim rrjedh nga latinishtja: *revocatio-rikthim, revocatum libertatum - rikthim i lirisë*. Revokimi i masës së sigurimit bëhet vetëm me vendim gjykate.

Në rastet kur papajtueshmëria e masës së sigurimit me kushtet dhe kriteret për caktimin e saj ekzistojnë që në kohën e caktimit të saj revokimi i masës përbën korrigjim të një gabimi dhe, si i tillë ai bëhet kryesisht nga gjykata në çdo gjendje të procedimit p.sh. kur gjykata në zbatim të nenit 248 të K.Pr.Penale merr në pyetje brenda tri ditëve personin e arrestuar dhe gjatë pyetjes së tij konstaton se nuk ekzistojnë apo mungojnë kushtet dhe kriteret për masën e dhënë atëherë gjykata vendos revokimin e masës së sigurimit.

Por papajtueshmëria e masës së sigurimit me kushtet dhe kriteret për caktimin e saj mund të dalin më vonë, për shkak të ndryshimit të rrethanave të faktit ose të ligjit. Mund të ndodhë që gjatë procedimit penal të dalë që vepra penale është kryer në kushtet e nevojës ekstreme, mbrojtjes së nevojshme ose ndjekja penale është parashkruar apo është shfuqizuar dispozita penale etj. Në këto raste revokimi vendoset me kërkesën e palëve ose dhe kryesisht nga gjykata, në zbatim të kërkesave të nenit 246/6 të sipërpërmendur.

Gjithashtu në nenin 260/4 parashikohet e drejta e gjykatës për të vendosur edhe kryesisht gjatë procedimit për sigurimin e provës ose gjatë gjykimit.

Me zëvendësim kuptohet zëvendësimi i një mase sigurimi të dhënë më parë, me një tjetër më të lehtë apo më të rëndë, në varësi të ndryshimit të kushteve dhe kriterëve për caktimin e masës. Gjykata duhet që rast pas rasti të verifikojë nëse ekziston apo jo ndonjë nga shkaqet për zëvendësimin e masës së sigurimit, të parashikuar në nenin 260/2 të K.pr.Penale, që lidhen zbutjen e nevojave të sigurimit²¹, me faktin se masa e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit²² apo me faktin se masa nuk i përgjigjet dënimit që mund të caktohet²³.

Zëvendësimi i masës së sigurimit me një masë tjetër më të rëndë bëhet nga gjykata me kërkesë të prokurorit, i cili duhet të paraqesë të dhëna dhe fakte që vërtetojnë se nevojat e sigurimit janë rënduar. Një rast i tillë është ai i parashikuar nga neni 231 i K. Pr.Penale sipas të cilit, kur personi ndaj të cilit është caktuar masë sigurimi shkel detyrimet që lidhen me atë masë, gjykata mund të vendosë zëvendësimin ose bashkimin me një masë tjetër më të rëndë, duke pasur parasysh rëndësinë, motivet dhe rrethanat e shkeljes.

Zëvendësimi i masës së sigurimit me një masë tjetër më të lehtë bëhet nga gjykata me kërkesën e të pandehurit apo edhe kryesisht. Pra gjykata mund të vendosë kryesisht për zëvendësimin e masës së sigurimit vetëm në rastet kur ajo konstaton se janë kushtet dhe kriteret për caktimin e një mase sigurimi më të lehtë, pasi zëvendësimi me një masë më të rëndë mund të bëhet vetëm me kërkesë të prokurorit.²⁴

Bazuar në nenin 246 të K.r.Penale gjykata mund të vendosë zëvendësimin e masës së sigurimit me një masë më të lehtë kur nga informacioni i prokurorit çdo dy muaj rezulton se nevojat e sigurimit janë zbutur.

Procedura përkatëse e gjykimit lidhur me revokimin apo zëvendësimin e masës së sigurimit, duhet të ofrojë garancitë e duhura në kontekstin e një gjykimi që ka për objekt shqyrtimin e një kërkesë që lidhet me caktimin dhe vazhdimin e zbatimit të një mase që ka të bëjë me kufizimin e lirisë së individit²⁵. Gjykimi zhvillohet në seancë gjyqësore dhe në prani të palëve²⁶.

Lidhur me kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit personal, revokimit apo

²¹ Në këtë rast mbahen parasysh gjendja shëndetësore e të pandehurit, moshë, rrethanat familjare, motivet që e shtynë në kryerjen e veprës penale si dhe çdo rrethanë tjetër që zbut nevojën e sigurimit.

²² Kjo mund të jetë në rastin e ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale.

²³ p.sh. kur rezulton më vonë se vepra penale është kryer nga i pandehuri duke u shtyrë nga motive me vlera pozitive, morale të larta apo kryerja e veprës nën udhëzimet e padrejta të eprorit.


²⁴ Neni 260/3 i Kodit të Procedurës Penale

²⁵ Assenov kundër Bullgarisë, 1998

²⁶ Vendimet e Kolegjit Penal me nr. 73,74 datë 03.07.2003 ku është shprehur se "Kërkesat për revokimin, zëvendësimin apo shuarjen e masave të sigurimit duhet të shqyrtohen në seancë gjyqësore në prani të prokurorit, të pandehurit dhe mbrojtësit.

zëvendësimin e tyre, evidentohet një jurisprudencë e pasur nga Gjykata e Lartë, të cilat rezultojnë të përdorur edhe në vendimet gjyqësore të marrë në shqyrtim për efekt të këtij inspektimi. Përmendim këtu vendimet Unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me nr. 3/2002, nr. 1/2009, nr. 4/2009 dhe nr. 7/2011. Gjithashtu në këtë fushë, evidentohet edhe një jurisprudencë shumë e pasur e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, të cilat nëpërmjet vendimeve të tyre kanë elaboruar interpretimin e rasteve të kufizimit të lirisë dhe procedurave përkatëse, të parashikuar në nenin 5 të KEDNJ "E drejta për liri dhe siguri". Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj me nr. 20 datë datë 01.06.2011 është shprehur se: "... respektimi i KEDNJ-së dhe standardeve kushtetuese është detyrim jo vetëm i saj, por edhe i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, në mënyrë të veçantë Gjykatës së Lartë për shkak të kompetencave të veçanta të saj të natyrës rishikuese, por edhe në drejtim të unifikimit të praktikës gjyqësore". Gjatë këtij inspektimi, u evidentuan në disa raste argumentimi edhe mbi bazën e këtyre vendimeve të GJEDNJ-së.

Lidhur me vlerësimin e praktikave të inspektuara, janë marrë në konsideratë edhe të dhëna mbi përhapjen e veprës penale të "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyes dhe municionit" të parashikuar nga neni 278 i K.Pr.penale. Për këto të dhëna i kemi referuar Raportit të Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit, ku jepen të dhëna lidhur me tendencën e kësaj vepre penale për një periudhë 5 vjeçare. Kështu në Raportin e Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit për vitin 2021, është raportuar se: "Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin "Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike" për vitin 2021 është 6,39 %, ndërkohë që në vitin 2020 ka qenë 5,99 % ose me e ulët. Nga të dhënat statistikore në vitin 2021 vërehet tendenca në rritje prej 16,94 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarakë dhe municionit" i Kodit Penal në krahasim me vitin 2020". Dhe në vazhdim jepet në mënyrë grafike ecuria e kësaj vepre penale, krahas veprave të tjera penale të përfshirë në grupin "Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike" ku përfshihet edhe neni 277 i K.Penal për periudhën 2017- 2021.



Lidhur me shpërndarjen gjeografike lidhur me këtë grup veprash në raport me procedimet e regjistruara në shkallë vendi, për vitin 2020 konstatohet se në tre zyrat e prokurorive të inspektuara Shkodër, Vlorë e Fier janë regjistruar 5 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, duke qëndruar në shkallë renditje nga më e larta tek më e ulta pas Tirana që zë 34 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra, të ndjekur nga Durrës dhe Elbasan 8 %, dhe Lezhë 6 %.

Gjithashtu këtë lloj shpërndarje e gjejmë edhe për vitin 2021, për zyrat e prokurorive Shkodër dhe Fier, ndërsa në Vlorë 4%, duke qëndruar në shkallë renditje nga më e larta tek më e ulta pas Tirana që zë 34 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra, të ndjekur nga Durrës 9 %, Elbasan 8 %, Lezhë 6 %.

Këto vlera, tregojnë për një nivel përhapje të veprës penale të "Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve, armëve shpërthyes dhe municionit", në tre zyrat ku është kryer inspektimi.

3.2. Proporcionaliteti i masave të propozuara;

Nga të dhënat e marra nga 3 zyrat e prokurorive subjekt i këtij inspektimi, është konstatuar se lidhur me veprën penale të "Mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyes dhe municionit", nga ana e prokurorit janë propozuar masa sigurimi personal shtrëngues. Këto masa sigurimi janë propozuar ndaj personave të cilët kanë qenë të arrestuar në flagrancë apo të ndaluar, ashtu edhe ndaj personave të cilët nuk kanë qenë në këto kushte. Gjithashtu masat e sigurimit personal janë propozuar nga ana e prokurorit, si ndaj personave të cilët kanë qenë të dyshuar vetëm për kryerjen e veprës penale të "Mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyes dhe municionit" ashtu edhe ndaj personave të cilët kanë qenë të dyshuar për kryerjen e veprës penale të "Mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyes dhe municionit", të shoqëruar edhe me vepra të tjera.

- **Për të 3 zyrat e prokurorive, në total janë konstatuar 12 kërkesa të prokurorit me objekt "për vleftësim arrestimi në flagrancë/ndalimi dhe caktim mase sigurimi personal shtrëngues" ndaj personave të dyshuar për kryerjen vetëm të veprës penale të "Mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyes dhe municionit". Dy prej personave të dyshuar ka qenë të mitur.**

Për këto raste masa e sigurimit personal shtrëngues është kërkuar bazuar në faktin penal të mbajtjes së armës luftarake në automjet, lokal e ambiente të tjera publike, duke u kualifikuar sipas nenit 278/1 të K.Penal.

Lloji i masës së sigurimit personal shtrëngues i propozuar ndaj personave të mitur në 2 çështje që i përkasin 2 zyrave të ndryshme të prokurorisë ka qenë në 1 rast "detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" të parashikuar në nenin 234 të K.pr.penale dhe në 1 rast "Vendosja e të miturit

nën mbikëqyrje", parashikuar nga neni 83 i Kodit Drejtësisë Penale për të Mitur. Dhe këto kërkesa janë pranuar edhe nga ana e gjykatës.

Ndaj personave të tjerë, lloji i masës së sigurimit personal shtrëngues i propozuar në të gjitha zyrat e prokurorive objekt inspektimi, ka qenë në 7 raste "arrest në burg" të parashikuar në nenin 238 të K.Pr.Penale, nga të cilat janë pranuar 6 nga ana e gjykatës dhe për 1 rast është vendosur aplikimi i nenit 236 i K.Pr.Penale.

Në 3 raste masa e propozuar ka qenë për 2 "arrest në shtëpi" të parashikuar në nenin 237 i K.Pr.Penale dhe në 1 rast "arrest në shtëpi" dhe "garanci pasurore" në zbatim të nenit 236 të K.Pr.Penale. Për këto raste, gjykata ka pranuar kërkesat e prokurorisë, duke caktuar për këto tre raste masat e sigurimit të propozuara.

Lloji i masës së sigurimit personal shtrëngues në të gjitha rastet sa më sipër, referuar akteve të dosjeve gjyqësore, janë vlerësuar në 10 raste si proporcionale në raport me shkallën e nevojave të sigurimit për rastet konkrete, rëndësinë e faktit dhe sanksionin që parashikohet për veprën penale të parashikuar nga neni 278/1 i K.Penal, dhe me rrethanat që lidhen me autorin e dyshuar, deri në fazën e kërkuar. Ndërsa në 2 raste masa e sigurimit "arrest në shtëpi" e propozuar nga ana e prokurorit nuk është vlerësuar si proporcionale.

Më poshtë, nisur nga problematikat e konstatuar, vlerësohet të trajtohen rastet e masës së sigurimit "arrest në shtëpi" të propozuar nga ana e prokurorit, 2 prej të cilave janë vlerësuar si joproportionale dhe në 1 rast proporcionale; rasti i masës së sigurimit "arrest në burg" i propozuar nga ana e prokurorit dhe zëvendësimi me masën e sigurimit "garanci pasurore"; rasti i masës së sigurimit "*Vendosja e të miturit nën mbikëqyrje*", parashikuar nga neni 83 i Kodit Drejtësisë Penale për të Mitur:

I. Dy rastet në të cilat masa e sigurimit "arrest në shtëpi" e propozuar si jo proporcionale, i përkasin zyrave të prokurorisë Fier dhe Shkodër.

a) Për rastin e masës së sigurimit "arrest në shtëpi" të kërkuar nga prokurori i zyrës Fier, për nevoja të procedimit nr. 578 datë 16.06.2021, konstatohet se fakti penal lidhet me konstatimin e një arme tip pistoletë që mbahej në çantën e supit nga shtetasi I.H. i moshës 27 vjeç, i cili ndodhej si klient në ambientet e një lokali në qytetin e Fierit. Për këtë fakt penal, personi ka qenë arrestuar në flagrancë dhe brenda afatit ligjor, nga prokurori është proceduar me kërkesë me shkrim për vlefhtësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimit të masës së sigurimit "arrest në shtëpi" të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale. Kërkesa është pranuar nga ana e gjyqtarit të gjykatës së rrethit gjyqësor Fier, dhe vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar.

Për rastin në fjalë, në drejtim të proporcionalitetit të masës së sigurimit të kërkuar referuar arsytimit në kërkesën e prokurorit, është për t'u evidentuar fakti se nuk gjendet një arsytim i tillë. Në kërkesë konstatohet se në tërësinë e saj, nuk janë arsytuar kushtet dhe kriteret e

përgjithshme për caktimin e masës së sigurimit "arrest në shtëpi" si masa më e përshtatshme me shkallën e nevojave të sigurimit dhe në raport me rëndësinë e faktit penal, sanksionin e dënimit të tij dhe rrezikshmërinë e personit, pa ju referuar saktësisht edhe kushteve të veçanta për vendosjen e masës së sigurimit. Kështu prokurori pas përshkrimit të faktit penal, veprimeve hetimore të kryera dhe dokumentacionit të sjellë nga mbrojtja lidhur me gjendjen familjare dhe shëndetësore të familjarëve të tij, shprehet se: "Pra, ekzistojnë kushtet dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta, të parashikuara nga nenet 228, 229, 237 të Kodit të Procedurës Penale për caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues ndaj të arrestuarit I.H., për arsye se: 1. Nga hetimet e kryera rezulton se ka dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se shtetasi I.H., ka konsumuar elementët e veprës penale "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarakë dhe municioneve" parashikuar nga nenet 278/1/2 të K.Penal. 2. Nga hetimet e kryera rezulton se ka dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se shtetasi I.H. ka konsumuar elementët e veprës penale të parashikuar nga nenet 278/1/2 të K. Penal. 3. Ekziston nevoja e kryerjes së veprimeve të tjera hetimore administrimi i akteve të ekspertimit etj. Pra, ekzistojnë kushti dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta, të parashikuara nga nenet 228, 229, 237 të Kodit të Procedurës Penale për caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues ndaj të arrestuarit I.H. për arsye se: Sa më sipër, bazuar në nenet 228, 229, 230, 251/1 e 252, si dhe nenet 244/1 e 258/1 të Kodit të Procedurës Penale. KËRKOJ:"

Kërkesa për masën e sigurimit të propozuar nga ana e prokurorit, është pranuar nga ana e gjyqtarit, i cili në vendimmarrjen e tij i referohet vetëm nenit 244, pika 3 të K. Pr. Penale që parashikon se: "3. Gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori", duke mos bërë asnjë parashtrim nëse janë marrë parasysh pretendimet e mbrojtjes, si dhe arsyeve mbi përshtatshmërinë e vetë masës së "arrestit në shtëpi" me rrethanat konkrete apo të papërshtatshmërisë së masave të tjera të sigurimit. Kështu më konkretisht gjyqtari shprehet se: "Përsa i përket kërkesës për caktimin e një mase sigurimi personal gjykata çmon se në ngarkim të personit nën hetim I.H. plotësohen kushtet dhe kriteret ligjore për një gjë të tillë pasi: Së pari: në ngarkim të personit nën hetim ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova, se ai mund të jetë autor i veprës penale, "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit" të parashikuar nga neni 278/1 i K.penal. Provat mbi të cilat është mbështetur dyshimi i arsyeshëm janë aktet që i janë bashkëngjitur kërkesës për gjykim. Kundrejt kërimit të prokurorit për të caktuar ndaj personit nën hetim si masë sigurimi atë të "arrestit në shtëpi", parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, mbrojtësja ishte dakort duke e vërtetuar edhe gjendjen shëndetësore të prindërve të tij. Në aktin "Vërtetim" nr.719, datë 16.06.2021 të lëshuar nga administratori i Nj. Administrative Dërmenas të Bashkisë Fier, ku pasqyrohet fakti se prindërit e të arrestuarit të cilët ai i ka në ngarkim, shtetasit H. K dhe T.K janë me probleme mendore. Nga akti "Fletë përmbledhje e daljes" e lëshuar nga QSU "Nënë Tereza" Tiranë e datës 28.05.2018 rezulton se pacientja T. K ka qenë e shtruar pranë këtij spitali me diagnozën "AVC Ishemik cerebral i majtë". Nga akti "Përgjigje rekomandimi" i lëshuar në datën 28.05.2021 nga Dr. I. XH në Spitalin Rajonal Fier rezulton se shtetasja T. K është me diagnozën "Gjendje post AVX Ishemik Cerebral sinistër". Së dyti përsa i përket masës konkrete të sigurimit që do të caktoj ndaj të arrestuarit I.H., gjykata lidhur

me kërkimin e prokurorit për të caktuar ndaj tij atë të "arrestit në shtëpi", parashikuar nga neni 237 K.Pr.P., ka parasysh zbatimin e pikës 3 të nenit 244 të K.Pr.P. Së treti: Gjykata duke patur parasysh përshtatshmërinë e masës së sigurimit me shkallën e nevojave të sigurimit si dhe raportin e saj me rëndësinë e faktit dhe sanksionin që parashikon neni 278/1 i K.Penal, në zbatim edhe të pikës 3 të nenit 244 të K.Pr.Penale, çmon të caktoj si masë sigurimi ndaj personit nën hetim L.H., atë të "arrestit në shtëpi", parashikuar nga neni 237 K.Pr.P. PËR KËTO ARSYE ... Gjykata duke parë edhe nenet 259/3, 228/1,2, 229/1,2., 237 dhe 245 të K.Pr.P. VENDOSI ..."

Nga trajtimi i rastit në fjalë lidhur me proporcionalitetin, bazuar në nenet 244, 228, 229, 230, 237 e 238 të K. Pr. Penale, vlerësohet se kërkesa e prokurorit për caktimin e masës së sigurimit "arrest në shtëpi", parashikuar nga neni 237 i K. Pr. Penale, është jo proporcionale me shkallën e nevojave të sigurimit, rëndësinë e faktit, rrezikshmërinë e veprës penale dhe të personit. Me veprimet e tij të mbajtjes pa leje të armëve në ambiente publike, personi nën hetim ka shprehur rrezikshmëri të veçantë dhe po në këtë kuadër paraqitet edhe rrezikshmëria e veprës penale të parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal, në rrethanat e përhapjes së madhe të saj në këtë periudhë që është konsumuar dhe fakti penal konkret, pasojvave më të rënda që mund të sjellë mbajtja pa leje e një arme, shoqërimit ose përdorimit të saj në shumë raste për kryerjen e veprave penale të tjera.

Masa e sigurimit "arrest në shtëpi" vlerësohet se nuk ka qenë e përshtatshme, pasi në rastin konkret nevojat e sigurimit nuk plotësoheshin në raport të drejtë me rëndësinë e faktit të përshkruar në kërkesë, si dhe sanksionit të veprës penale, fakt që duket se është shprehur edhe nëpërmjet vendimit të gjykatës, e cila i referohet vetëm nenit 244, pika 3 të K. Pr. Penale dhe nga ana e saj nuk bën asnjë parashtrim, nëse i ka marrë parasysh pretendimet e mbrojtjes, si dhe nuk ka bërë arsyetim mbi përshtatshmërinë e vetë masës së "arrestit në shtëpi" me rrethanat konkrete apo të papërshtatshmerisë së masave të tjera të sigurimit.

Neni 244, pika 3, K. Pr. Penale parashikon se "3. Gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori", të cilën gjykata e ka përmendur edhe si shkak për caktimin e masës së sigurimit "arrest në shtëpi", duke u shprehur: "Gjykata duke patur parasysh përshtatshmërinë e masës së sigurimit me shkallën e nevojave të sigurimit, si dhe raportin e saj me rëndësinë e faktit dhe sanksionin që parashikon neni 278/1 i Kodit Penal, në zbatim edhe të pikës 3 të nenit 244 të K. Pr. Penale, çmon të caktojë si masë sigurimi ndaj personit nën hetim L. H. (K.) atë të "arrestit në shtëpi", parashikuar nga neni 237 i K. Pr. Penale".

Gjithashtu, vlen për t'u përmendur se pavarësisht gjendjes shëndetësore, në lidhje me pretendimin për prindërit se personi nën hetim i kishte në ngarkim, nga prokurori nuk është mbajtur parasysh fakti se nga çertifikata familjare po e datës 16.06.2021, rezultonte se përveç personit të arrestuar në flagrancë, në përbërjen familjare janë edhe vëllai dhe motra e personit të arrestuar (të moshave 24 dhe 21 vjec), ndërsa dokumentacioni shëndetësor i përket vetëm nënës së tij T. K. Nga vërtetimi i gjendjes gjyqësore të administruar më pas ka rezultuar se personi ka qenë i dënuar (rehabilituar).

b) Për rastin e masës së sigurimit "arrest në shtëpi" dhe "garanci pasurore" të kërkuar nga prokurori i zyrës Shkodër për nevoja të procedimit penal nr. 524, datë 03.06.2021 të regjistruar për nenin 278/1 i K.Penal, konstatohet se fakti penal lidhet me konstatimin nga ana e policisë të hedhjes së një arme pistoletë nga shtetasi H.N, në kohën kur ai ka qenë duke udhëtuar me një automjet. Policia ka konstatuar faktin penal, pasi ka ndjekur makinën me të cilën udhëtonte ky person. Për këtë fakt penal, personi ka qenë arrestuar në flagrancë dhe brenda afatit ligjor, nga prokurori është proceduar me kërkesë me shkrim për vleftësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimit të masës së sigurimit "arrest në shtëpi" dhe "garanci pasurore" të parashikuar nga neni 237 dhe 236 i K.Pr.Penale. Kërkesa është pranuar nga ana e gjykatës së rrethit gjyqësor Shkodër, dhe vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar.

Në kërkesën e prokurorit, në drejtim të proporcionalitetit nuk rezulton të ketë një analizë lidhur me caktimin e kësaj mase sigurimi. Prokurori në kërkesën e tij ka dalë në konkluzionin për llojin e masës së sigurimit, pa asnjë arsytim mbi kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit. Kështu prokurori pasi përshkruan rrethanat e ngjarjes së ndodhur dhe faktin e arrestimit, shprehet se: *"Për të dyshuarin H.N. i cili është arrestuar në flagrancë janë respektuar kërkesat e nenit 251 dhe 252 mbi gjendjen e flagrancës dhe ka dyshime pasi: Ekzistojnë dyshime të arsyeshme dhe të bazuara në ligj për faktin e ndodhur, fakt i cili parashikohet si veprë penale në kodin penal shqiptar. Ekzistojnë dyshime të arsyeshme dhe të bazuara në ligj se shtetasi H.N. ka kryer këtë veprë penale. Dispozita për këtë veprë parashikon dënim 5 deri në 7 vjet burgim. Për këto arsye ndaj të dyshuarit duhet të caktohet masa e sigurimit arrest në shtëpi dhe garanci pasurore, prandaj në bazë të neneve 228, 229, 244, 258, 237, 236 të K.Pr.Penale KERKOJ: ..."*

Ndërsa konstatohet një analizë nga ana e gjykatës lidhur me përshtatshmërinë dhe proporcionalitetin e kësaj mase sigurimi, duke u vlerësuar edhe në raport me dokumentacionin mbi gjendjen familjare, sociale dhe shëndetësore dhe garancinë, të paraqitur gjatë seancës për caktimin e masës së sigurimit.

Nga trajtimi i rastit në fjalë lidhur me proporcionalitetin, bazuar në nenet 244, 228, 229, 230, 237 e 238 të K. Pr. Penale, vlerësohet se kërkesa e prokurorit për caktimin e masës së sigurimit "arrest në shtëpi", parashikuar nga neni 237 i K. Pr. Penale, është jo proporcionale me shkallën e nevojave të sigurimit, rëndësinë e faktit, rrezikshmërinë e veprës penale dhe të personit. Referuar këtij fakti penal, me anë të veprimeve të personit nën hetim të mbajtjes pa leje të armës në automjet, qarkullimin me armë në automjet dhe hedhjen e kësaj arme gjatë rrugës, është vlerësuar se personi nën hetim rezulton se ka shprehur rrezikshmëri të veçantë, dhe se po në këtë kuadër paraqitet edhe rrezikshmëria e veprës penale të parashikuar nga neni 278/1 i K.Penal, pasi referuar sanksioneve të kësaj veprë penale, parashikohet dënim me burgim nga 5 deri në 7 vjet.

Nga aktet e para hetimore, mbi të cilat është bazuar prokurori në vlerësimin e tij për caktimin e masës së sigurimit, nuk ekziston ndonjë e dhënë lidhur me gjendjen familjare të këtij shtetasi, motivin e kryerjes së veprës penale apo lidhur me rrethanat e konstatimit të mbajtjes pa leje të armës në automjet dhe hedhjen e tij, të dhëna këto që do të mundësonin një vlerësim të ndryshëm lidhur me proporcionalitetin e kësaj mase sigurimi, referuar rëndësisë së faktit në raport me

sanksionin e lartë që parashikon kjo vepër penale, shkallës së nevojave të sigurimit apo edhe rrethanave të tjera lehtësuese të parashikuar nga Kodi Penal. Gjithashtu referuar llojit të masës së sigurimit personal shtrëngues "garanci pasurore", të kërkuar nga ana e prokurorit, nga këto akte të para hetimore nuk identifikohet si kusht i vetëm ekzistues 'rreziku që ai të largohet' dhe nuk rezulton edhe ndonjë ofrim i ndonjë garancie nga vetë personi i arrestuar apo person tjetër që mund të dilte garant, kushte këto të domosdoshëm për përcaktimin e llojit të masës së sigurimit "garanci pasurore" sipas nenit 236 të K.Pr.Penale.

Gjithashtu, për t'u evidentuar është edhe fakti, se megjithëse në vendimin e saj gjykata bën një analizë në drejtim të përshtatshmërisë së masës së sigurimit të propozuar nga ana e prokurorit, konstatohet se në këtë vendimmarrje ajo është kontraditore, pasi ndonëse në faqen 7 pas interpretimit që i bën nenit 236 të K.pr.penale, shprehet se: *"Në rastin konkret, provohet plotësimi i dy kushteve: se personi nën hetim është e nevojshme një masë shtrënguese, siç është ajo e arrestit në shtëpi, dhe se ekziston rreziku i ikjes"* duke mos u ndalur konkretisht në identifikimin e tyre me rastin konkret, nga ana tjetër në faqen 8, arsyeton se, *... ekziston rreziku që i dyshuari të largohet për t'iu shmangur përgjegjësisë penale për vetë sanksionin që parashikon kjo vepër penale, apo të kryejë vepra më të rënda penale në këto kushte, masa e sigurimit, ajo e arrestit në shtëpi e zëvendësuar në të njëjtën kohë nga paraqitja e garancisë pasurore, parashikuar nga neni 237 dhe 236 i K.Pr.Penale është e përshtatshme me nevojat e sigurimit. Prandaj, kërkesa e mbrojtësit të personit të dyshuar për caktimin e një mase më të butë gjën mbështetje në prova dhe në ligj, pasi parashtruan argumente dhe prova që i dyshuari nuk do t'i shmanget hetimit, apo se nuk do të kryejë vepra tjetër në të ardhmen."*

Referuar këtij arsyetimi të fundit të gjykatës, konstatohet se në rastin konkret nga ana e gjykatës ka një zbatim të gabuar lidhur me zbatimin e nenit 236 të K.Pr.Penale. Sipas kësaj dispozite, ashtu siç është pranuar edhe nga vetë gjyqtari në faqen 7 të vendimit, masa e sigurimit "garanci pasurore" mund të vendoset kur plotësohen këto kushte: i) ndaj personit është caktuar ose do të caktohet një masë sigurimi arrest me burg apo arrest në shtëpi; ii) masa e sigurimit arrest në burg apo arrest në shtëpi është vendosur ose do të vendoset vetëm për shkakun e ekzistencës së rrezikut të ikjes së personit sipas kushtit të përcaktuar në shkronjën "b" të paragrafit 3 të nenit 228 të K.Pr.P.; iii) vetë personi i dyshuar ose një person tjetër ofrojnë një shumë monetare të përshtatshme si garanci për të vërtetuar se nuk do të largohet deri në përfundim të gjykimit, duke kërkuar të hetohet në gjendje të lirë. Sipas arsyetimit të gjykatës, në faqen nr.8 të tij, në rastin konkret të caktimit të masës së sigurimit ndaj H.N., ekziston jo vetëm rreziku që i dyshuari të largohet për t'iu shmangur përgjegjësië penale, por edhe të kryejë vepra më të rënda penale. Kjo e fundit i referohet kushtit të veçantë të masës së sigurimit, të parashikuar nga neni 228/3/c të K.Pr.Penale, e cila nuk përfshihet në kushtet e zbatimit të nenit 236 të K.Pr.Penale. Nisur nga këto të dhëna, vlerësohet se ka kontraditoritet në pjesën arsyetuese të vendimit gjyqësor e cila passjellë në vetevete edhe konfuzion në vendimmarrjen e gjyqtarit, lidhur me pjesën urdhëruese të tij.

II. Rasti në të cilën masa e sigurimit “arrest në shtëpi” është vlerësuar si proporcionale.

Për rastin në të cilën kërkesa e prokurorit për caktimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi” është vlerësuar si proporcionale, duke u pranuar si e tillë nga gjykata, lidhet me zyrën Vlorë për çështjen me nr. 839/2021, lidhur me faktin penal të gjetjes së armës së zjarrit një shtetasi që e mbante në marsupin e tij dhe i cili në atë moment ndodhet në ambientet e jashtëme të një lokali.

Për këtë fakt penal, personi ka qenë arrestuar në flagrancë dhe brenda afatit ligjor, nga prokurori është proceduar me kërkesë me shkrim për vlefësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimit të masës së sigurimit “arrest në burg” të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale. Kërkesa është marrë në shqyrtim nga gjykata e rrethit gjyqësor Vlorë dhe në seancën e zhvilluar, në momentin procedural të marrjes së fjalës nga ana e prokurorit për paraqitjen e kërkesës së tij, prokurori ka ndryshuar qëndrimin e tij duke kërkuar caktimin e masë së sigurimit “arrest në shtëpi”, të parashikuar nga neni 237 të K.Pr.Penale. Avokati në fjalën e tij, ka arsyetuar mbi papërshtatshmërinë e masës së sigurimit “arrest në burg”, sipas kërkesës me shkrim të prokurorit dhe në fund ndodhur përpara ndryshimit të qëndrimit të prokurorit, është shprehur në çmim të gjykatës. Gjykata në vendimmarrjen e saj, të datës 18.06.2021 ka vlerësuar si të përshtatshme caktimin e masës së sigurimit të kërkuar nga prokurori në seancë.

Pas rreth 1 muaji, në datë 26.07.2021 nga ana e të dyshuarit paraqitet në gjykatë kërkesë për zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi” në një masë më të butë. Gjykimi është zhvilluar në seancën e datës 28.07.2021, me gjyqtar tjetër, për shkak të shkarkimit me vendim të KPK-së të gjyqtarit të mëparshëm. *Prokurori në këtë seancë ka qenë i njëjti si edhe në seancën e vlefësimin dhe caktimit të masës, dhe nga ana e tij është mbajtur qëndrim për rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se të njëjtat fakte janë marrë parasysh kur i është dhënë masa e sigurimit 237 i K.Pr.penale.* Lidhur me këtë kërkesë, në përfundim nga gjykata me vendimin e datës 28.07.2021 është vendosur rrëzimi i kërkesës. Vendimi ka marrë formë të prerë për shkak se nuk është ankimuar.

Nga trajtimi i rastit në fjalë lidhur me proporcionalitetin e masës së propozuar nga ana e prokurorit, referuar parashikimeve të nenit 229/1, 2 të K.Pr.Penale, konstatohet se tek kërkesa e tij mungon analiza lidhur me këto kritere. Prokurori në përmbajtjen e kërkesës së tij me shkrim, identifikon llojin e veprës penale dhe llojin e masës së dënimit që parashikohet për të, kalon në konstatimin në mënyrë të përgjithshme mbi kryerjen e veprave penale të tjera, moshën e personit dhe rethanat personale të tij, por nuk i trajton këto sesi lidhen dhe identifikohen në përcaktimin e llojit të masës së sigurimit të kërkuar prej saj. Kështu prokurori pasi ka përshkruar rrethant e faktit penal, veprimet hetimore të kryera nga oficeri i policisë gjyqësore, ka kaluar në argumentet lidhur me gjendjen e flagrancës dhe kushtet e arrestimit, për të kaluar më pas në nëndarje të vendimit që titullohet *“Në lidhje me kushtet për caktimin e masës së sigurimit dhe faktorët që mbahen parasysh” ku shprehet se: “Në caktimin e llojit dhe të masës së sigurimit gjykata duhet të ketë parasysh: - Kryerja e veprave penale të tjera; - përhapjen e kryerjes së*

veprave penale të "Armbëmbajtjes pa leje" të parashikuar nga neni 278 (paragrafi i parë) i Kodit Penal në Rrethin Gjyqësor Vlorë; - sanksionin e parashikuar nga legjislatori për këto lloj veprash penale që është vetëm ai me burgim; - moshën e personit të arrestuar dhe rrethanave personale të tij. Në ngarkim të personit nën hetim E.B. ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova, për këto arsye ndaj tij duhet të caktohet masa e sigurimit "Arrest në burg" të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, PËR KËTË ARSYE në bazë të neneve 228, 229, 238, 258 dhe 259 të K.Pr.Penale, KËRKOJ: ..."

Gjithashtu edhe në paraqitjen e kërkesës së ndryshuar në seancë gjyqësore nga ana e prokurorit, konstatohet mungesë e analizës së kriterëve për caktimin e masës së sigurimit. Kështu sipas procesverbalit të seancës gjyqësore në fjalën e prokurores citohet se: "Lexon kërkesën, provat janë bashkëngjitur kërkesës. Përfundimisht kërkon, vleftësinin të ligjshëm të arrestimit në flagrancë ndaj shtetasit E.B. i arrestuari ka qenë dënuar me vendimin nr. 238 datë 12.04.2017, është i formës së prerë është vënë në ekzekutim me datë 28.04.2021, ku është marrë dhe kontakti i parë i këtij të pandehuri me shërbimin e provës. Në këto momente u njohëm dhe me aktet e paraqitura nga avokati, ku rezultoi të ketë një certifikatë familjare, ku shtetasi E.B. ka dy fëmijë të mitur në ngarkim dhe raport mjekësor ku i arrestuari ka plagë të shkaktuar me armë zjarri, referuar raporteve të ndodhura në fillim të qershorit të vitit 2021. Në lidhje me ngjarjen i arrestuari ka shpjeguar që armën e mbante për qëllime vetëmbrojtje, duke qenë se ndaj tij ishte tentuar të qëllohej disa herë. Ndodhur në këto rrethana në moemntin e parë kemi kërkuar "arrest në burg", por duke qenë se kemi tashmë dhe të dhënat mjekësore dhe gjendjen e tij familjare në këto kushte cmojmë se masa më e përshtatshme është e ajo e arrestit në shtëpi. Pra për momentin ndryshojmë qëndrimin tonë. Provat shkresore ndodhen bashkëngjitur fashikullit të gjyqimit. Përveç tyre po paraqesim praktiken e ekzekutimit të vendimit penal me nr. 238 vendimi datë 12.04.2017."

Lidhur me ndryshimin e qëndrimit të prokurorit, në kuadër të vlerësimit të proporcionaliteti, konstatohet se nga aktet e para hetimore, mbi të cilat është bazuar prokurori në kërkesën e tij për masë sigurimi "arrest në burg", që në momentin e parë kur i dyshuari është pyetur në cilësinë e personit nën hetim nga ana e oficerit të policisë gjyqësore është bërë me dije se armën e mbante për vetëmbrojtje për shkak të një ngjarje të ndodhur më parë. Ky akt si edhe aktet e tjera, janë dorëzuar në prokurori më datë 15.06.2021, një ditë pas arrestimit në flagrancë të personit dhe kërkesa e prokurorit është e datës 16.06.2021. Nisur nga këto të dhëna, konstatohet se nga ana e prokurorit nuk janë kryer veprime të mëtejshme vetë apo nëpërmjet urdhërimit të oficerit të policisë gjyqësore, për të mundësuar marrjen e të dhënave si ato të bëra të njohura në seancë gjyqësore. Marrja e të dhënave lidhur me dëmtimin e shkaktuar apo dënimin e tij, ishin të mundshme, për faktin se bëhet fjalë për dëmtimet të shkaktuar nga një ngjarje kriminale për të cilën patjetër në prokurori regjistrohesh procedim penal dhe që i përkiste një periudhe kohe shumë të shkurtër- vetëm rreth 17 ditësh. Po kështu të dhënat lidhur me një dënim të mëparshëm ku si prokuror i çështjes, paraqitet sërish i njëjti prokuror ishin të mundura për t'u marrë më parë nga zyra e prokurorisë Vlorë ku mbahet një kopje e praktikës lidhur me urdhërin e ekzekutimit të dënimit penale të formës së prerë. Duke patur këto të dhëna, edhe vlerësimi i prokurorit në drejtim

të përshtatshmërisë dhe proporcionalitetit të masës së sigurimit të propozuar, do të ishte më i plotë dhe si i tillë do të mund të evitonte ndryshimin e qëndrimit. Për me tepër, që është detyra e prokurorit, në rast se vihet në dijeni për të dhëna të cilat lidhen me nevojat e sigurimit, të veprojë për të mundësuar marrjen e tyre dhe kryerjen e një analize të plotë dhe të argumentuar.

Për rastin në fjalë, lidhur me proporcionalitetin konstatohet se edhe në vendimin e gjykatës, nuk ka analizë të plotë dhe shteruese, të lidhur me arsyetimin e ekzistencës së kriterëve edhe nga ana e gjykatës, në vendimmarrjen e saj. Megjithëse nga ana e gjykatës citohet mbajtja parasysht të rrethanave familjare, faktit të plagosjes së të arrestuarit lidhur me një ngjarje kriminale, gjyqtari ndalet në përshkrimin e tyre, por nuk bën një analizë në drejtim të identifikimit të kriterëve për caktimin e masës së sigurimit që i përshtatet personit në fjalë. Në vendimin e gjykatës konstatojmë edhe kontraditën midis vlerësimit të tij se ekzistojnë kriteret e përcaktuar në nenin 230 të K.Pr.Penale dhe në vazhdim, konkludon për masën e sigurimit të parashikuar nga neni 237 të K.pr.penale. *Kështu më konkretisht, Gjykata shprehet se: "Përsa i përket kërkesës për caktimin e masës së sigurimit "Arrest në burg", të kërkuar nga organi i akuzës, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale gjykata vlerëson se kjo kërkesë në lidhje me caktimin e kësaj mase sigurimi duhet të pranohet për shkak se u përgjigjet rrethanave dhe provave mbi të cilat bazohet kërkesa si dhe rolit të këtij të arrestuari në kryerjen e kësaj veprë penale." Më pas gjyqtari vazhdon me analizën e kushteve²⁷ dhe më pas kalon tek analiza e kriterëve, duke u shprehur se: "Caktimi i kësaj mase sigurimi personal është në përputhje dhe me kriteret e parashikuara në nenin 229 dhe 230 të K.Pr.Penale si rëndësia e faktit, përhapja e veprës penale të parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal dhe sanksioni që parashikon ligji për veprën penale për të cilën dyshohet i arrestuari. Gjykata mban parasysht rrethanat familjare të tij ku rezultoi se para 20 ditëve ai është qëlluar me armë zjarri në sy të fëmijëve të mitur para banesës së tij në fshatin Kaninë ku mbeti i plagosur dhe vetëm para disa ditëve ka dalë nga spitali, faktin që ka në ngarkim dy fëmijë të mitur të moshë 6 dhe 7 vjeç ku fëmija i vogël ka dhe probleme të veçanta shëndetësore të provuara dhe nga aktet mjekësore përkatëse. Nisur nga rrethanat e mësipërme gjykata vlerëson se masa më e përshtatshme është ajo e kërkuar nga organi i akuzës në seancën gjyqësore e parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale "Arrest në shtëpi". PËR KËTO ARSYE Gjykata në bazë të neneve 259 e 245 të K.Pr.Penale VENDOSI"*

Lidhur me zëvendësimin e masës së sigurimit, qëndrimi i prokurorit është i shprehur me gojë në seancë gjyqësore duke arsyetuar qartë konkluzionin e arritur mbi rrëzimin e kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit, të lidhur me mosndryshimin e rrethanave dhe mosparaqitjen e provave të reja. Prokurori arsyeton faktin se nuk paraqiten të dhëna të reja nga ato që janë paraqitur

²⁷ "Neni 228/3 i K.P.Penale parashikon kushtet për vendosjen e masave të sigurimit "3. Masa e sigurimit personal vendosen: ...". Dyshimi se shtetasi E.B. ka marrë pjesë në kryerjen e veprës penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit" parashikuar nga neni 278/1 të Kodit Penal bazohet në raportin e shërbimit të punonjësvë të policisë, procesverbalin e kuptjes së vendit të ngjarjes, procesverbalin e sekuestrimit, deklaratimet e shtetasit S.B dhe të vetë arrestuarit etj. Rezulton se në lidhje me provat ato janë marrë nga ana e organit të akuzë dhe i arrestuari nuk ka mundësi që të ndikojë në marrjen ose vërtetësinë e tyre. Gjithashtu nuk ka të dhëna se ai mund të shmanget hetimeve."

nga mbrojtja gjatë seancës së caktimit të masës së sigurimit dhe të cilat janë marrë parasysh për dhënien e masës së sigurimit që kërkohet të zëvendësohet.

Edhe gjykata në vendimin e saj mbi të njëjtat argumente si edhe të prokurorit, ka arsyetuar qartë dhe në mënyrë ezauruese, mbi mospranimin e kërkesës, referuar kuptimit të zëvendësimit të masës së sigurimit sipas parashikimeve të nenit 260/2 të K.Pr.Penale. Kështu, gjykata shprehet se: *“I arrestuari E.B. nëpërmjet mbrojtësit të tij ka shprehur kërkesën që masa e sigurimit personal arrest me shtëpi të zëvendësohet me një masë sigurimi më të butë duke parashtruar të njëjtat rrethana dhe kushte ligjore të arsyetuara në vendimin nr. 159 datë 18.06.2021 me të cilin është vendosur caktimi i masës së sigurimit personal “arrest në shtëpi” ndaj këtij shtetasi, vendim i paankimueshëm nga palët. Për këtë arsye nuk u paraqit ndonjë rrethanë e re që gjykata t’u marrë në konsideratë për të vlerësuar nëse ekziston apo jo nevoja për të zëvendësuar masën e arrestit në shtëpi. ... nga ana e kërkuarit u pretendua zëvendësimi i masës së sigurimit me një masë tjetër më të butë me qëllim përkujdesjen shëndetësore ndaj fëmijës së mitur. Gjykata vlerëson se ky pretendim është marrë në konsideratë nga prokuroria dhe është vlerësuar i drejtë edhe nga gjykata në momentin që ka vendosur masën e sigurisë arrest në shtëpi ndaj këtij shtetasi. Praktika gjyqësore e referuar nga kërkuari është zbatuar në rastin konkret duke u caktuar nga gjykata një masë e ndryshme nga ajo e arrestit në burg, saktësisht masa e arrestit në shtëpi, duke u marrë në konsideratë pikërisht fakti i gjëndjes familjare të të arrestuarit. Që nga data 18.06.2021 kur është zbatuar kjo masë sigurimi personal, nuk rezulton të ketë asnjë rrethanë e re për palën kërkuese.”*

III. Rasti i masës së sigurimit “arrest në burg” i propozuar nga prokurori dhe e vlerësuar si proporcionale, për të cilën nga ana e gjykatës është caktuar me zëvendësim në aplikim të nenit 236 të K.Pr.Penale, “Garanci pasurore”.

Rasti për të cilën kërkesa e prokurorit për vendosjen e masës së sigurimit “arrest në burg” është vlerësuar proporcionale dhe për të cilën nga ana e gjykatës është vendosur për t’u aplikuar masa e sigurimit “garanci pasurore” parashikuar nga neni 236 i K.Pr.Penale, i përket zyrës së prokurorisë së Vlorës, procedimi penal nr. 378/2021 i regjistruar më datë 27.03.2021.

Ky procedim penal lidhet me faktin penal të gjetjes në çantën që mbante me vete shtetasi S.S., të një arme zjarri e llojit pistoletë me 7 fishekë në krehër. Konstatimi i këtij fakti penal, është bërë pas kontrollit personal të ushtruar nga policia të këtij shtetasi në ambientet e një lokali rreth orës 20.00.

Për ngjarjen në fjalë, nga ana e oficerit të policisë gjyqësor është vendosur arrestimi në flagrancë dhe materialet janë dërguar në prokurori, ku prokurori me kërkesën e datës 28.03.2021, ka kërkuar në gjykatë “vlefësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”.

Çështja rezulton të jetë shqyrtuar nga gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i cili me vendimin nr. 82 datë 30.03.2021 ka vendosur: *“- Vlefësimin e ligjshëm të arrestimit të shtetasit S.S., - Caktimin ndaj shtetasit S.S. të masës së sigurimit “Arrest në burg” dhe zëvendësimin e asaj*

me masën e sigurimit "garanci pasurore" parashikuar nga neni 236 i K.Pr.Penale. – Depozitim në një nga bankat e nivelit të dytë për llogari të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë të shumës 500 000 lekë, shumë e cila duhet të depozitohet brenda datës 31.03.2021. – Pas depozitimit të shumës aktet ti paraqiten prokurorit të çështjes i cili pas verifikimit të kryejë veprimet procedural sipas nenit 236 pika 5 të K.Pr.Penale. – Në rast të ekzekutimit të masës së sigurimit "Garanci pasurore" shtetasi S.S. duhet të paraqitet pranë Prokurorisë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë sa herë që do të njoftohet prej tyre."

Vendimi është ankimuar më datë 06.04.2021, nga prokurori dhe Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin datë 16.04.2021 ka vendosur dryshimin e vendimit duke caktuar masën e sigurimit "Arrest në burg".

Me marrjen e një vendimi sa më sipër, Prokurori i Apelit ka nxjerrë urdhërin e ekzekutimit të datës 16.04.2021, drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë duke urdhëruar vendosjen nën masën e sigurimit personal "arrest në burg" pranë I EVP- Vlorë, të të dyshuarit S.S.

Në vazhdim, nga ana e prokurorit për shkak të mosgjjetjes së këtij të dyshuari është proceduar me kërkesë drejtuar gjykatës për deklarim ikje. Në këtë kërkesë, prokurori ka arsyetuar se "... nga aktet rezultojnë se, i dyshuari S.S. është larguar nga banesa dhe nga vendbanimi, me qëllim për t'i shpëtuar ndjekjes penale". Në dokumentacionin shoqëruar të kërkesës së prokurorit, konstatohet se janë dy procesverbale të kërkimit të personit që nuk gjendet, të mbajtur nga oficeri i policisë gjyqësore ku është shënuar se kërkimi është bërë në banesën e këtij shtetasin në fshat dhe nuk është gjetur, ndërsa të afërmit e tij kanë thënë se është larguar Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me të njëjtin gjyqtar që ka caktuar edhe masën e sigurimit, me vendimin nr. 1452 datë 09.06.2021 ka vendosur deklarimin e ikjes dhe duke i caktuar një avokat mbrojtës, kryesisht. Në arsyetimin e saj, gjykata konstaton se: "Nga aktet në dosje rezultojnë se nga shërbimet e policisë janë kryer veprime procedurale dhe operative për kapjen e këtij personi disa herë duke shkuar në banesën e tij, por nuk është gjetur dhe familjarët kanë pretenduar se është larguar për arsye shëndetësore. Në këto rrethana gjykata vlerëson se kërkesa duhet të pranohet për shkak se provohet se kërkimet janë kryer të plota dhe të vazhdueshme."

Çështja rezultojnë të jetë dërguar për gjykim me kërkesë e datës 27.07.2021 të të njëjtit prokuror, në ngarkim të arrestuarit të akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 278/1 e kryer në rrethana rënduese neni 50/ç i Kodit Penal. Sipas kërkesës për gjykim, rezultojnë se i pandehuri ka qenë disa herë i dënuar. Fakti i dënimit i është bërë prezent edhe nga vetë i arrestuari gjatë seancës për vlefësimin e arrestimit dhe më pas gjatë hetimit është provuar sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore.

Nga trajtimi i rastit në fjalë lidhur me proporcionalitetin e masës së propozuar nga ana e prokurorit, referuar parashikimeve të nenit 229/1, 2 të K.Pr.Penale, sipas kërkesës së prokurorit, konstatohet se mungon analiza lidhur me këto kritere. Gjithashtu, konstatohet se edhe lidhur me kushtet sipas parashikimeve të nenit 228 të K.Pr.Penale, nuk ka analizë. Prokurori në mënyrë të përgjithshme shprehet mbi ekzistencën e kushteve dhe kritereve, duke u mbështetur

vetëm në faktin penal dhe llojin e veprës penale. Konstatohet gjithashtu se edhe në bazueshmërinë ligjore të vendosur nga ana e prokurorit në kërkesën e tij, nuk reflektohet fakti nëse për shtetasin për të cilën kërkohet masa, ekzistojnë të gjitha kushtet e parashikuara në nenin 228/3/a/b/c apo vetëm njëra prej tyre. Kështu prokurori pasi përshkruan faktin penal dhe veprimet hetimore të kryer nga policia që kanë passjellë edhe arrestimin në flagrancë të të dyshuarit, shprehet se: *“Fakti penal i mësipërm ka dyshime për veprën penale të “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal. Për shkak të dyshimit të krijuar nga policia gjyësore në datën 26.03.2021, në orën 20.00, është bërë “Arrestimi në flagrancë” i shtetasit S.S., i biri i L. dhe V., i datëlindjes 13.03.1987, lindur e banues në fshatin Armen – Vlorë, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal. Nisur nga sa më sipër, ekzistojnë të gjitha kushtet ligjore të parashikuara nga neni 251 i Kodit të Procedurës Penale që përligjin këtë masë sigurimi dhe lënia në fuqi e saj i shërben interesave të hetimit të çështjes penale. Gjithashtu, duke qenë se ekzistojnë kushtet për caktimin e masës së sigurimit siç është ekzistenca e një dyshimi të arsyeshëm të bazuar në prova, mundësia e shmangies nga hetimet, duke patur parasysh shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale e të autorit, sanksionet që parashikohen për veprën penale të cilën ai dyshohet të ketë kryer, si dhe kriteret ligjore për caktimin e masës së sigurimit, bazuar në nenet 258/1 e 244/1 të Kodit të Procedurës Penale, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i paraqes këtë KËRKESË ...”*

Pavarësisht mungesës së analizës së kushteve dhe kriterëve të kërkesës së prokurorit, lidhur me masën e sigurisë së kërkuar “arrest në burg”, konstatohet se referuar rrethanave të faktit, personalitetit të të pandehurit i cili rezulton të jetë i dënuar më parë, llojit të veprës penale, sanksionit të veprës penale, ashtu siç është arsyetuar edhe nga Gjykata e Apelit për këtë çështje, kjo masë sigurimi e propozuar nga prokurori vlerësohet se është e përshtatshme dhe proporcionale. Kështu më konkretisht, në vendimin e saj Gjykata e Apelit arsyeton se: *“çmon se vendimi për pjesën me të cilin është vendosur vleftësimi i ligjshëm i arrestit në flagrancë është i drejtë dhe i bazuar në ligj, Pjesa e vendimit të gjykatës që ka vendosur caktim mase sigurimi garanci pasurore parashikuar nga neni 236 i K.Pr.Penale duhet të ndryshohet nga kjo gjykatë duke pranuar ankimin e prokurorisë... . rëndësia e faktit penal, parë nga ligjvënësi, dhe provat e shqyrtuara deri në këtë fazë të hetimit është në përputhje dhe në të njëjtin këndvështrim që e ka parë gjykata e faktit në rastin konkret. Gjykata e Apelit çmon se pjesa e vendimit të ankimuar për të cilin është vendosur masa e sigurimit “garanci pasurore në vlerën 500.000 lekë”, duhet të ndryshohet nga kjo gjykatë... . Në këtë përfundim kjo gjykatë arrin për faktin se masat e sigurimit mund të caktohen vetëm kur ekzistojnë dhe provohen kushtet dhe kriteret e përcaktuara në ligj. Në nenet 228, 229 dhe 230 të K.Pr.Penale janë përcaktuar kushtet e përgjithshme dhe të veçanta si dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit në përgjithësi dhe të arrestit në burg” në veçanti. Në rastin objekt shqyrtimi, ekzistojnë kushtet për caktimin e një mase sigurimi të karakterit personal, çka e ka pranuar dhe gjykata e faktit në arsyetim... Masa e sigurimit nuk është e përshtatshme për arsye se ka rrezik për marrjen ose vërtetësinë e provës, ekziston rreziku që të dyshuarit të largohen dhe ka rrezik që ky i dyshuar të kryejë një veprë tjetër penale. Për më tepër*

që i arrestuari është dyshuar për një vepër penale me rrezikshmëri shoqërore siç është ajo e mbajtjes pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyesë dhe i municionit" parashikuar nga nenet 278/1 i Kodit Penal. Të gjitha këto edhe për faktin se mbi bazën e fakteve të konstatuara dhe të pasqyruara në proceverbalet përkatëse nga punonjësit e policisë del se ky i arrestuar u kap me armë zjarri pa leje në ambiente publike, çka e bën këtë ngjarje me rrezikshmëri të lartë shoqërore si fakt dhe si subjekt i veprës penale dhe ka nevojë të hetohet nën masën e sigurimit dhe me përshtatshmja është ajo e arrestit në burg. Arsyetimi i përdorur nga gjykata e shkallës së parë se bashkëshortja e të pandehurit është shtatëzënë dhe ka problem shëndetësor që sipas raportit përkatës ajo duhet të qëndrojë në regjim shtrati dhe të kontrollohet vazhdimisht nga familjarët për parametrat nuk është i drejtë për sa u përshtrua. ... Nisur nga faktet e parashtruara fakti që i dyshuari paraqesin rrezikshmëri të theksuar shoqërore pasi është kapur duke mbajtur në lokal ambiente publike armë zjarri tipit pistoletë me 7 fisheke janë kritere që nuk e përligjin një masë sigurimi më të butë dhe në të tillë situatë është më e drejtë që ndaj të arrestuarit të miratohet masa e sigurimit "arrest në burg" parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale. në vlerësimin e këtij kolegji të gjykatës së Apelit dyshimi është i arsyeshëm edhe pse nuk është komestuar nga i dyshuari. ... **Gjykata e faktit nuk ka zbatuar drejtë kërkesat e neneve 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale dhe gjykata e faktit nuk ka mbajtur parasyshtatshmërinë e veprës që akuzohet me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret.** Në vlerësimin e këtij kolegji të gjykatës së apelit rezulton që ekzistojnë kritere të veçanta nga ato që parashikon neni 230 i Kodit të Procedurës Penale që kushtëzojnë marrjen e masës ekstreme arrest në burg për shtetasin S.S. Gjykata e shkallës së parë në caktimin e masës së sigurimit arsyeton se ekziston për nevoja familjare duhet të caktohet masa e sigurimit garanci pasurore dhe nuk analizon kriteret e përcaktuar në nenin 229 të K.Pr.Penale. Gjykata e faktit nuk i ka analizuar ato me situatën konkrete të çështjes. Ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova, se personi nën hetim dyshohet se ka konsumuar një vepër penale të parashikuar si të tillë nga legjislativi penal."

Lidhur me vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor, konstatohet se nga ana e gjyqtarit është vlerësuar kërkesa e prokurorit për llojin e masës së sigurimit e bazueshmërinë për caktimin e masës së sigurimit "garanci pasurore", të lidhur me ekzistencën e një kushti të parashikuar nga neni 228/3/b të K.Pr.Penale, rrezikun e ikjes dhe duke konkluduar njëkohësisht në mos ekzistencën e kushteve të tjera të parashikuar në shkronjën a, c të të njëjtit paragraf të nenit 228. Por në lidhje me këto konkludime nga ana e gjyqtarit nuk ka analizë të provave të administruara të cilat të reflektojnë provueshmërinë apo mosprovueshmërinë e ekzistencës së kushteve të paragrafit 3 të nenit 228 të K.Pr.Penale. Gjykata ka përmendur faktin se i arrestuari është i dënues, por nuk shkon më tej me analizën sesi reflektohet në identifikimin e kushteve dhe kriterëve për caktimin e masës së sigurimit që ka konkluduar dhe po arsyeton për t'a vendosur. Kështu gjykata arsyeton se: "Përsa i përket kërkesës për caktimin e masës së sigurimit "Arrest në burg", të kërkuar nga organi i akuzës, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale gjykata vlerëson se kjo kërkesë në lidhje me caktimin e kësaj mase sigurimi duhet të pranohet për shkak se u përgjigjet rrethanave dhe provave mbi të cilat bazohet kërkesa si dhe rolit të këtij të arrestuari në kryerjen e kësaj veprë penale. Neni

228/3 i K.Pr.Penale parashikon kushtet për vendosjen e masave të sigurimit "3. Masa e sigurimit personal vendosen: ...". Dyshimi se shetasi S.S. ka marrë pjesë në kryerjen e veprës penale "Mbrojtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit" parashikuar nga neni 278/1 të Kodit Penal bazohet në raportin e shërbimit të punonjësve të policisë, proceverbalin e kontrollit, procesverbalin e sekuestrimit, pohimeve të vetë të arrestuarit etj. Rezulton se në lidhje me provat ato janë marrë nga ana e organit të akuzë dhe i arrestuari nuk ka mundësi që të ndikojë në marrjen ose vërtetësinë e tyre. Vetë i pandehuri e ka pranuar veprën penale dhe ka shprehur pendim. Gjithashtu nuk ka të dhëna se ai mund të kryejë vepër tjetër penale të kësaj rëndësie. Rezulton se ai është dënuar për një vepër penale të kryer para 10 vitesh. Gjykata mban parasysht faktin se ekziston rreziku i ikjes dhe shmangies nga hetimi i çështjes. Caktimi i kësaj mase sigurimi personal është në përputhje dhe me kriteret e parashikuara në nenin 229 dhe 230 të K.Pr.Penale si rëndësia e faktit, përhapja e veprës penale të parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal dhe sanksioni që parashikon ligji për veprën penale për të cilën dyshohet i arrestuari. Gjykata vlerëson se ekzistojnë kushtet për pranimin e masës së sigurimit "Garanci pasurore" të kërkuar nga mbrojtja dhe i arrestuari bazuar në nenin 236 të K.Pr.Penale që parashikon: 1.2.3.4.5.6. Gjykata mban parasysht faktin se nga provat e paraqitura nga mbrojtja rezulton se bashkëshortja e të pandehurit është shtatzanë dhe ka probleme shëndetësore që sipa raportit përkatës ajo duhet të qëndrojë në regjim shtrati dhe të kontrollohet vazhdimisht nga familjarët për parametrat. Nga certifikata familjare dhe pohimet në seancën gjyqësore rezulton se ata jetojnë vetëm. Nisur nga rrethanat dhe provat që disponon aktualisht akuzat në lidhje me të dyshuarin S.S., gjykata vlerëson se masa më e përshtatshme është ajo e parashikuar nga neni 236 i K.Pr.Penale "Garancia pasurore" pasi lejon kryerjen e veprimeve hetimore ndaj të dyshuarit dhe njëkohësisht garanton mosshmangien nga hetimi i mëtejshëm dhe gjykimin i çështjes."

Në vazhdim të konstatimit sa më sipër, lidhur me arsyetimin e vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor, konstatohet edhe mungesa e arsyetimit lidhur paragrafin konkret të nenit 236 që është i zbatueshëm në rastin konkret. Në paragrafin të parë të nenit 236 të K.Pr.penale jemi para zbatimit në rastet kur vlerësohet zëvendësimi i masës së sigurimit "arrest në shtëpi" ose "arrest në shtëpi", ndërsa në paragrafin e dytë, jemi para zbatimit në rastet kur kjo masë vendoset pa u caktuar dy masat e sipërpërmendura, por me kushtin që për këto masa ekziston kushti i rrezikut të ikjes.

Lidhur me shumën së garancisë pasurore të vendosur, konstatohet se në vendim, nuk ka ndonjë analizë lidhur me përcaktimin e shumës së garancisë, referuar parashikimeve të nenit 236/3 të K.Pr.penale "3. Shuma e garancisë pasurore përcaktohet nga gjykata, pasi merr mendimin e palëve, bazuar në nevojat reale të sigurimit, rrethanat personale dhe familjare të të pandehurit, si dhe gjendjen e tij financiare". Ky parashikohet si detyrim për gjykatën në ligj, dhe shumë e rëndësishme, bazike pasi është e lidhur jo vetëm me faktin e krijimit të sigurisë se kjo shumë do

t'a bëjë atë që të pengohet për t'u larguar²⁴ dhe për t'u paraqitur kur kërkohet gjatë hetimit e gjykimit, por edhe të mos jetë e tepruar²⁵, në raport me burimet finaciare.

IV. Rasti i masës së sigurimit "Vendosjen në mbikëqyrje" për të miturin në konflikt me ligjin N. S".

Rasti i përket zyrës së Prokurorisë Fier, lidhur me procedimin penal me nr. 396, datë 02.05.2021, për të cilën nga ana e prokurorit është kërkuar "Vendosje në mbikëqyrje" e të miturit në konflikt me ligjin, N.S., si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit", parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal.

Fakti penal lidhet me ngjarjen e datës 30.04.2021, ku oficeri i policisë gjyqësore pranë Drejtorisë së Policisë Vendore Fier, në orën 23.00 ka kryer arrestimin në flagrancë të shtetasit N. S (i mitur), për veprën penale të parashikuar nga neni 278/1 të K. Penal, pasi rreth datës 12-13 prill të vitit 2021, është gjuajtur me armë zjarri në fshatin Ninësh, Mallakastër. Nga informacionet është konkluduar se autori i mundshëm ishte shtetasi N. S, të cilit nga këqyrja e telefonit i janë konstatuar disa foto ku paraqitej shtetasi N. S me një armë zjarri në dorë. Nisur nga kjo indicje shtetasi N. S ka treguar ku kishte fshëhur armën e zjarrit, pushkë karabinë me katër fishekë.

Prokurori me kërkesën e datës 02.05.2021 "*Për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit*", ka kërkuar ndaj të miturit në konflikt edhe caktimin e masës së sigurimit "*detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore*" të parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale, *pasi ai dyshohet për kryerjen e veprës penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit"*.

Kërkesa është regjistruar në gjykatë më datë 02.05.2021 duke u caktuar edhe gjyqtari, i cili në datë 03.05.2021 ka caktuar seancën për shqyrtimin e kërkesës së prokurorit. Në seancën e zhvilluar në datën e caktuar, nga ana e prokurorit është ndryshuar qëndrim bazuar në sugjerimet e gjykatës dhe të psikologes se qënia e të miturit në mbikëqyrje do të ishte masa më e përshtatshme me të cilën ka rënë dakord edhe prokurori. Dhe si rrjedhim, në përfundim të seancës gjyqësore prokurori ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit "*Vendosja e të miturit në mbikëqyrje*", parashikuar nga neni 83 i Kodi Drejtësisë Penale për të Mitur. Mbrojtësi ka kërkuar caktimin e një mase më të butë të parashikuar nga neni 83 i Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur.

Në përfundim të gjykimit, Gjykata me vendimin nr.661, datë 03.05.2021, ka vendosur: "*Vleftësimin e paligjshëm të arrestit në flagrancë të kryer nga policia gjyqësore. Caktimin e masës së sigurimit "Vendosjen në mbikëqyrje" e babait të tij shtetasit B. S, për të miturin në konflikt me ligjin N. S"*.

²⁴ *Emkoff kundër Republikës Federale Gjermane, Seria A nr. 7, 27 qershor 1968*

²⁵ *Neumeister kundër Austrisë, Seria A, nr. 8, 27 qershor 1968; Mangouras kundër Spanjës* ²⁷ *GJEDNJ* i 28 shtator 2010

Vendimi ka marrë formë të prerë, pasi nuk është ankimuar nga palët.

Nga trajtimi i rastit në drejtim të proporcionalitetit, në kërkesën me shkrim të prokurorit konstatohet se nga ana e tij pasi arsyetohet fillimisht për kushtet për caktimin e masës së sigurimit³⁰, kalohet në analizën e kriterëve sipas nenit 229 të K. Pr. Penale, si përshtatshmëria e masës së sigurimit me nevojën e sigurimit, ruajtja e një raporti të drejtë midis rëndësisë së faktit dhe sanksionit që parashikohet për veprën penale konkrete me llojin e masës së sigurimit, si dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale. Mbi këtë arsyetim, prokurori konkludon për caktimin e masës së sigurimit "detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore", të parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale. Kështu më konkretisht, prokurori shprehet se: *"Në caktimin e llojit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues ndaj të dyshuarit duhet të merren parasysh dhe kriteret ligjore të caktimit të masës të parashikuar nga neni 229 që janë: përshtatshmëria e masës së sigurimit me nevojën e sigurimit; ruajtja e një raporti të drejtë midis rëndësisë së faktit dhe sanksionit që parashikohet për veprën penale konkrete me llojin e masës së sigurimit; si dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale. Për të gjitha arsytet e lartpërmendura, masa e sigurimit është më e përshtatshme në raport me masat e tjera të sigurimit personal me karakter shtrëngues. Kjo masë diktohet nga rrethanat e kryerjes së veprës penale, nga rrezikshmëria e veprës penale dhe e personit nën hetim. Gjithashtu, duke iu referuar përshtatshmërisë së masës së sigurimit me shkallën e nevojave të sigurimit, në raport me rëndësinë e faktit, kjo masë siguri, i përmbush nevojat e sigurimit për hetimet që po zhvillohen në ngarkim të të dyshuarit. Për sa më sipër, bazuar në nenin 228, 229, 238, 258 dhe 259 të Kodit të Procedurës Penale, KËRKOJMË:"*

Ndërsa vendimi i gjykatës është i strukturuar dhe arsyetuar plotësisht³¹ në lidhje me arrestimin në flagrancë të të miturit dhe për caktimin e masës së sigurimit vendosja e të miturit në mbikëqyrje sipas interpretimit të nenit 83 të K.D.P.M dhe është marrë menjëherë në përputhje me nenin 81, pika 3 të K.D.P.M.

³⁰ Prokurori arsyeton: *"Nga sa paraqitëm më sipër, konstatojmë se ekzistojnë kashtet e përgjithshme dhe të veçanta të parashikuara në nenet 228 e 229 të K.Pr.Penale që ndaj të dyshuarit të caktohet një masë siguri personal me karakter shtrëngues. Konkretisht, së pari, ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova se, personi nën hetim, ka kryer veprën penale për të cilën është arrestuar. Së dyti, nuk ekzistojnë shkaqe padëmueshmërie dhe të shuarjes së veprës penale, që përjashtojnë shtetasin N. S nga përgjegjësia penale. Së treti, referuar rrethanave të faktit dhe personalitetit të personit nën hetim, rezulton se, ekziston rreziku eventual që personi nën hetim të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me ato për të cilat po procedohet, i arrestuari, dyshohet se ka kryer një vepër me rrezikshmëri të lartë shoqërore, me pasojë të rënda dhe të përhapur."*

³¹ Në vendimin e gjykatës vihen re pjesë të mbetura nga vendime të tjera si ajo në faqen 9 "dhe vendimi i organit procedues do duhej që në aktin përkatës Procesverbal për arrestimin në flagrancë të të miturit F. duhej të argumentonte dhe pse ka qenë e nevojshme kufizimi i lirisë së të miturit, arrestimi i të miturit F.". Ka gabime materiale në faqen 10 ku thuhet "ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në provë, se i dyshuari konsumuar elementet e veprave penale të parashikuara në nenet 283/1 e 278/1 të Kodit Pena).

Konstatohet se në vendimmarrjen e saj, gjykata analizon paligjshmërinë e arrestimit në flagrancë, duke u mbështetur si në parashikimet e nenit 252 të K.Pr.Penale dhe parashikimeve të nenit 86 Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur. Gjukata ka arsyetuar faktin se i mituri në konflikt me ligjin, nuk ka qenë në gjendje flagrante siç e kërkon neni 252 i K.Pr.Penale dhe se në interpretim të nenit 86 të Kodit të Drejtësisë Penale duke qenë se ndaj të miturit nuk mund të caktohet masa e sigurimit "arrest në burg", ai edhe nuk mund të arrestohet. Kështu më konkretisht gjykata shprehet se: *"gjukata konstaton se i mituri në konflikt me ligjin, N., është arrestuar në flagrancë nga policia gjyqësore në datën 30.04.2021 ora 16:45 pasi dyshohet se ai ka mbajtur pa leje një armë pa leje, konkretisht në fshatin ...ku në anën veriore të ullishtes kishte fshehur një gardh me rrjet teli të mbuluar me shkurre dhe ferra e në fund të këtyre shkurreve gjendej një armë automatike "karabinë". ... Në rastin konkret, gjykata vëren se i mituri nuk është kapur në kryerje e sipër të veprës penale dhe as me sende e prova material. Nuk i është gjetur atij arma në banesë, në shkollë, në sendet e tij personale, por është gjetur në një vend të treguar nga i mituri, në tokën e një shtetasi tjetër, çka thjesht ngre dyshime mbi të miturin por nuk provon fajësinë e përfshirjen e të miturit në këtë vepër penale, tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Po ashtu, i mituri nuk ka qenë në ndjekje nga policia gjyqësore, personi i dëmtuar apo persona të tjerë. Në datën 30.04.2021 i mituri është kthyer nga shkolla si çdo ditë të zakonshme dhe ka gjetur shërbimet e policisë në banesën e tij duke kryer kontrole e verifikime mbi bazën e informacioneve e shërbimeve operative konfidenciale, i mituri ka bashkëpunuar. Gjithashtu referuar nenit 5 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, sipas të cilit dispozitat e Kodit të Procedurës Penale zbatohen në procesin e drejtësisë penale për të mitur vetëm për çështje që nuk janë të rregulluara nga ky Kodi ose nëse përmbajnë rregullime më të favorshme për të miturit; si dhe parimit të përcaktuar në nenet 15 dhe 85 të K.D.P.Mitur të cilët parashikojnë se arrestimi nuk zbatohet nëse qëllimi mund të realizohet përmes një mase më të butë dhe se arrestimi zbatohet në përputhje me parashikimet e këtij Kodi, si dhe në përputhje me legjislacionin procedural penal për atë sa nuk parashikohet ndryshe në këtë Kod.; dhe të interpretuara këto dispozita në harmoni me nenin 86 të K.D.P.M ku parashikohet se: "...", arrihet në përfundimin se arrestimi në flagrancë i të miturit në konflikt me ligjin është kryer në kundërshtim me normat proceduriale të sanksionuara në K.D.P.M si dhe me parimet e drejtësisë miqësore për të miturit. Në rastin konkret, gjykata vlerëson se ndonëse dispozita (neni 86 i K.Pr.Penale) i referohet caktimit të një mase sigurimi nga Gjukata, kjo dispozitë duhet mbajtur në konsideratë edhe në rastet e arrestimit në flagrancë (pasoja e të cilës është vendosja e të miturit në institucione paraburgimi, fakt ky që nuk vjen në përputhje me interesin e të miturin dhe me konceptin e garantimit të një drejtësie penale miqësore), pasi logjikisht nuk mund të arrestohet në flagrancë një i mitur ndaj të cilit nuk mund të caktohet si masë sigurimi "arrest në burg". Nëse gjykata nuk mund të kufizojë lirinë e të miturit, për një vepër të tillë (me një masë dënimi në minimum 7 vjet burgim), si mundet oficeri i policisë gjyqësore të kufizojë lirinë e një të mituri, i cili potencialisht mund të qëndrojë i arrestuar 96 orë (...). kjo kohë do të dëmtonte të miturin emocionalisht dhe të pengonte procesin e tij të formimit arsimor e edukativ. ... Gjukata çmon se në rastin konkret vepra penale për të cilën akuzohet i mituri dënohet në minimum 5 vjet; po ashtu masa nuk ka qenë e domosdoshme sepse i mituri në konflikt me ligjin N.nuk rezulton që të përbente*

rrezik serioz për të tjerët apo për veten dhe se ky rrezik nuk mund të menjanohej me ndonjë mënyrë tjetër apo përpiqej t'i shmangej drejtësisë. ..."

Interpretimi në këtë mënyrë i nenit 86 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, vlerësohet se nuk gjën mbështetje në nenin 85 të Kodit Drejtësisë Penale për të Mitur, të cilin gjykata e ca cituar edhe në vendim. Referuar nenit 15 të K.D.P.M, në parim arrestimi, ndalimi ose burgimi i një të mituri nuk zbatohet nëse qëllimi mund të realizohet përmes një mase më të butë dhe përdoren vetëm si një masë e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër. Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur në dispozita të ndryshme të tij flet për të miturin e arrestuar (nenet 51/2, 54, 73).

Neni 85 i K. D. P. M, parashikon se i mituri mund të arrestohet ose ndalohet në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe të këtij Kodi. Kur nuk urdhëron lirimim e menjëhershëm, prokurori, pa vonesë, por, sidoqoftë brenda 48 orëve nga arrestimi ose ndalimi, kërkon vlefësimin e tyre në gjykatën kompetente. Mosrespektimi i këtij afati bën që arrestimi ose ndalimi të humbasë fuqinë dhe i mituri të lirohet menjëherë, përveç kur gjykata i vlefëson ato dhe cakton masë sigurimi. Pra, në përputhje me parashikimet e këtij Kodi dhe me K.Pr. Penale, neni 255, pika 3, i mituri mund të arrestohet ose ndalohet, ndërsa lloji i masës së sigurimit caktohet në përputhje me nenet 81 e vijues të K.D.P.M, ku përveç masave të sigurimit të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale dhe atyre të veçanta të parashikuara nga neni 82 i K. D. P. M, që mund të caktohen ndaj të miturit në konflikt me ligjin, masa e sigurimit "arrest në burg", përveç kushteve të nenit 228, të Kodit të Procedurës Penale, mund të vendoset për të miturin vetëm si një alternativë e fundit dhe në përputhje edhe me kushtet e nenit 86 të K.D.P.M. Ndalimi i vetëm është i parashikuar në nenin 230, pika 4 të K. Pr. Penale, ku shprehimisht sanksionohet se të miturit nuk mund të arrestohen kur akuzohen për kundravajtje penale.

Nisur nga qëndrimi që ka mbajtur në kërkesë prokurori dhe ndryshimin e kërkesës për llojin e masës së sigurimit gjatë seancës gjyqësore, bazuar në arsyetimet e gjykatës, vlerësohet se trajtimi i çështjeve me të mitur, në raste kur duhet të vendoset arrestimi në flagrancë/ndalimi dhe kërkohet të caktohet një masë sigurimi proporcionale ndaj një të mituri, paraqet ende problematika në drejtim të vlerësimit të drejtë të këtyre kërkesave të ligjit dhe interpretime të ndryshme në praktikë të dispozitave, në mënyrë që prokurori në kërkesë dhe gjykata në vendim të mbajnë parasysh dhe të arsyetojnë interesin më të lartë të të miturit, nevojat specifike të tij dhe kërkesën për të mos ndërprere proceset edukative, të mirërritjes dhe zhvillimit normal të një të mituri.

Si konkluzion, vlerësohet se bazuar në nenet 244, 228, 229 të K. PR. Penale e neneve 15, 81, 82, 83, 85, 86 të K.D. P. M të K. Pr. Penale, kërkesa e prokurorit për caktimin e masës së sigurimit "detyrimi për tu paraqitur nga policinë gjyqësore", parashikuar nga neni 234 i K. Pr. Penale dhe po ashtu edhe qëndrimi i rënë dakord me masën e propozuar nga gjykata, është në raport proporcional me kriteret e dispozitave të mësipërme, duke marrë parasysh kriterin e nenit 229, pika 3 të K. PR. Penale "*kur i pandehuri është mitur gjykata mban parasysh interesin e tij më të*

lartë dhe kërkesën për të mos ndërprerë proceset edukative konkrete” dhe në raport të drejtë me shkallën e nevojave të sigurimit dhe rrethanat e tjera të analizuara në vendimin e gjykatës.

* * *

- **Për të 3 zyrat e prokurorive, në total janë konstatuar 24 kërkesa të prokurorit me objekt “për vleftësim arrestimi në flagrancë/ndalimi dhe caktim mase sigurimi personal shtrëngues” ndaj personave të dyshuar për kryerjen të veprës penale të “Mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyes dhe municionit” të shoqëruar me vepra të tjera.**

⇒ Nga këto çështje, në 15 prej tyre kërkesa e prokurorit ka qenë e lidhur me përdorimin e armës luftarake në ambiente publike, e cila ka qenë e llojit pistoletë, pushkë, automatik, lëndë shpërthyes, dhe që janë kualifikuar sipas nenit 278/1 dhe në 2 raste 278/4 i K.Penal. Veprat e tjera penale kanë qenë të parashikuar nga neni 79/c, 79/dh, 78, 76, 274, 89, 84, 242 i K.Penal. Për këto raste nga ana e prokurorit është vlerësuar caktimi i masës së sigurimit “arrest në burg” për 11 raste, në 1 rast caktim mase sigurimi “arrest në burg” me afat 30 ditë e kërkuar dy herë, 2 raste caktim mase sigurimi “arrest në shtëpi” dhe 1 rast “ndalim i daljes jashtë shtetit” dhe “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Në 1 nga rastet e caktimit të masës së sigurimit “arrest në burg”, dhe të 2 rasteve të caktimit të masës së sigurimit “arrest në shtëpi” personi ndaj të cilit është propozuar masa janë të mitur.

Çështjet sa më sipër, lidhur me caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” janë vlerësuar si proporcionale në raport me rëndësinë e faktit të përdorimit të armës, pasojave të shkaktuara, sanksionit të veprave penale për të cilat dyshohet personi, ndër të cilët edhe vepra penale e parashikuar nga neni 278/1 e 278/4 i K.Penal dhe rrezikshmërisë së veçantë të autorit të veprës penale. Dhe si të tilla janë vlerësuar 10 raste edhe nga ana e gjykatës në vendimmarrjen e saj pas shqyrtimit të kërkesës për vleftësim arrestimi/ndalimi dhe caktim mase sigurimi. Ndërsa për 1 rast, gjykata ka caktuar masën e sigurimit “arrest në burg” me afat.

Më poshtë, nisur nga problematikat e konstatuar dhe qëndrimi i një gjykate më të lartë, vlerësohet të trajtohen rastet e masës së sigurimit “arrest në burg” me afat të vendosur nga ana e gjykatës; “arrest në shtëpi” të propozuar nga ana e prokurorit ndaj të miturit në konflikt; 2 prej të cilave janë vlerësuar si joproporcionale dhe në 1 rast proporcionale; rasti i masës së sigurimit “arrest në burg” me afat i propozuar nga ana e prokurorit; rasti i masave të sigurimit personal shtrëngues “ndalimi për të dalë jashtë shtetit” dhe “detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” të propozuar nga prokurori; rasti i masës së sigurimit “arrest në burg” për të miturin.

1. Rasti i çështjes për të cilën nga ana e prokurorisë është kërkuar masa e sigurimit “arrest në burg” dhe nga ana e gjykatës është vendosur caktimi i masës së sigurimit “arrest në burg” me afat.

Rasti i përket zyrës së prokurorisë Vlorë, procedimi penal me nr. 01. datë 01.01.2021, lidhur me masën e sigurimit të kërkuar ndaj të dyshuarit K.K. bazuar në ekzistencën e dyshimit për kryerjen e veprave penale të parashikuar nga neni 79/c, 22 dhe 278/1 i K. Penal.

Fakti penal lidhet me një konflikt në banesë, në marrëdhënie familjare – dhëndri me familjarë të nuses, dhe për rrjedhojë ka pasur përdorim të armës me pasojë plagosjen e një personi. Konflikti ka ndodhur brenda në banesën e familjarëve të nuses, ku ka ardhur dhëndri Xh.M. dhe si rrjedhojë e këtij konflikti, nga ana e familjarit të nuses, shtetasi K.K. është marrë një armë pistoletë që ndodhej brenda një kasaforte në banesë, dhe është qëlluar dy herë nga ballkoni dhëndri, i cili ka marrë plagë në kurriz (pjesa e shpatullës) duke marrë mjekim në spital. Për këtë, janë arrestuar edhe K.K. dhe Xh.M., dhe për të dy këto pas ardhjes së materialeve në prokurori është urdhëruar regjistrimi i procedimit penal ndaj K.K. për veprën penale të parashikuar nga neni 79/c, 22 dhe 278/1 i K.Penal dhe ndaj Xh.M për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a/4 të K.Penal. Prokurori ka paraqitur kërkesën e tij në gjykatë, duke kërkuar krahas vlefhtësimin të arrestimit, edhe caktimin e masës “Arrest në burg” për veprat penale të parashikuar nga neni 79/c-22 dhe 278/4 të Kodit Penal ndaj shtetasit K.K. dhe caktimin e masës “arrest në shtëpi” për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a/4 të Kodit Penal ndaj Xh.M.

Kërkesa është shqyrtuar nga ana e gjykatës së rrethit gjyqësor Vlorë, e cila me vendimin nr. 3 datë 03.01.2021 ka vendosur vlefhtësimin e arrestimit ndaj dy personave, dhe: *Caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” me afat 20 ditë parashikuar nga neni 245 i K.Pr.Penale ndaj personit nën hetim K.K. dhe caktimin ndaj shtetasit Xh.M. masën e sigurimit personal “arrest në shtëpi” parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penal...*

Vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë më datë 11.01.2021, për shkak se nuk është ankimuar.

Në vazhdim, për këtë çështje konstatohet se nga ana e të njëjtit prokuror i kërkesës për vlefhtësimin e arrestimit dhe caktimit të masës së sigurimit, në përfundim të afatit 20 ditor të masës së sigurimit “arrest në burg”, dhe pikërisht në datën 22.01.2021 ora 15:18, është bërë kërkesë tjetër, duke kërkuar tashmë ndaj të njëjtit person të dyshuar për të njëjtat vepra penale, caktimin e masës së sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” të parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale.

Nga trajtimi i rastit në drejtëm të proporcionalitetit, konstatohet se nga ana e prokurorit në kërkesën e tij, shprehet për mbajtjen parasysht të kriterëve të parashikuar nga neni 229, 230 të K.P.Penale duke i cituar si të tilla, por pa u analizuar konkretisht lidhur me të dhënat e rastit konkret dhe se cilat nga këto kriterë plotësohen. Gjithashtu nuk ka një analizë të veçantë lidhur me këto kriterë për secilin nga personat nën hetim për të cilët kërkohet masa. Po kështu, ndërkohë që

shprehet në këtë mënyrë për ekzistencën e këtyre kriterëve, kërkon masë sigurimi "arrest në burg" për njërin person nën hetim dhe "arrest në shtëpi" për personin tjetër. Kështu prokurori shprehet se: "Nisur nga sa më sipër është e nevojshme që në ngarkim të të ndaluarve duhet të caktohet një masë sigurimi shtrënguese për vazhdimin e mëtejshëm të hetimeve të këtij procedimi penal pasi: Përveç sa më sipër çmohet se ekzistojnë kushtet dhe kriteret ligjore të parashikuara në nenet 228 e 229, 230 të K.Pr.Penale që ndaj të pandehurit të caktohet një masë sigurimi me karakter shtrëngues. ... Në kërkesën lidhur me llojin e masës së sigurimit që kërkohet të caktohet mbahet parasysh proporcionaliteti dhe përshtatshmëria specifike e nevojave të sigurimit në rastin konkret me llojin e masës së sigurimit. Në caktimin e masës së sigurimit duhet të kihet parasysh raporti me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Duke qenë se ndalimi i shtetasit është bërë konform rregullave procedurale duke ju bërë të qartë të drejtat dhe detyrimet ligjore në përputhje me nenet 253 dhe 258/1 të K.Pr.Penale si dhe bazuar në nent 228, 229 e 230, 245, 254, 259 të K.Pr.Penale."

Këto masa vlerësohen të jenë në proporcion, duke bërë edhe një dallim midis dy personave për të cilat ka dyshim për kryerjen e veprave penale të ndryshme të cilat paraqesin rrezikshmëri të ndryshme referuar si rrethanave të faktit dhe masës së dënimit, si dhe të dhënave personale.

Ndërkohë që nga ana e prokurorit paraqitet kërkesat sa më sipër lidhur me masën e sigurimit "arrest në burg", pasi paraprakisht ka konkluduar për ekzistencën e kushtit të parashikuar nga neni 228/3/c të K.Pr.Penale, që përcakton "kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të së pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilën procedohet", nga ana e gjykatës, në vendimmarjen e saj, është arsyetuar dhe konkluduar për caktimin e një mase sigurimi me afat, sipas parashikimeve të nenit 245/1/d të K.Pr.Penale, duke konkluduar mbi ekzistencën e kushtit të parashikuar nga neni 228/3/a të K.Pr.Penal që përcakton "kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit", për të cilat ka arsyetuar konkretisht lidhur me të dhënat e rastit konkret. Më konkretisht në vendimin e saj gjykata shprehet se: "Gjykata, vlerëson se, në rastin konkret plotësohet kushti i dytë i veçanti i parashikuar nga shkronja a, pika 3 të nenit 228 të K.Pr.Penale. Shkronja a, pika 3 e nenit 228 të K.Pr.Penale ka parashikuar se: "...". Gjykata vlerëson se për shkak të lidhjes së personave të përfshirë në ngjarje (lidhje gjinie e krushqie) mund të helmohen provat, veprimet të karakterit sekret që ka urdhëruar prokurori, vlerësohen si shkaqe të rrezikshme që vënë në rrezik marrjen dhe vërtetësinë e provave. Në këto kushte, plotësohet edhe ky kusht për caktimin e masës së sigurimit ndaj personave nën hetim. ... Gjykata vlerëson se në caktimin e masës së sigurimit mban në konsideratë, veprat penale për të cilat dyshohen personat nën hetim, marrëdhënien midis shtetasve të përfshirë në konflikt si dhe pasojat e shkaktuara. Gjykatë vlerëson se, duke qenë se nga ngjarja e ndodhur ka mbetur i dëmtuar shtetasi Xh.M. dhe në aplikim të nenit 244 pika 3 të K.pr.Penale duhet të caktohet masa e sigurimit personal "arrest në shtëpi" parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale ndaj shtetasit Xh.M. Lidhur me personin nën hetim K. K. duke vlerësuar faktin se është urdhëruar

kryerja e veprimeve të tjera hetimore disa prej të cilave të karakterit sekret, faktit se në deklaratimet e disa prej shtetasve dhe vetë deklaratimet e para të të arrestuarit K.K., se me armë ka qëlluar shtetasi E.K., priten rezultatet e akteve të ekspertimit mjeko-ligjor, me qëllim që të garantohet hetimi i plotë e me dilgjencë nga prokurori nga njëra anë dhe garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nga ana tjetër, duhet të caktohet masa e sigurimit personal arrest në burg” me afat 20 ditë për personin nën hetim K. K.”.

Megjithëkëtë, konstatohet se nga ana e gjykatës, me vazhdimin e arsyetimit të saj të lidhur me pritjen e rezultateve të kryerjes së akteve të ekspertimit apo veprime të tjera hetimore të pakonkretizuar lidhur me rrezikun ose vërtetësinë e tyre e marrjes së tyre³², vlerësohet se tejkalojnë qëllimin e aplikimit të dispozitës në fjalë. Aplikimi i kësaj mase është gjithmonë i lidhur me rastet kur prova nuk do të arrihej të merrej ose nuk do të garantohej vërtetësia e saj nëse i pandehuri nuk do të ishte siguruar me një masë sigurimi. Ky është interpretimi që është bërë ndër vite edhe nga Gjykata e Lartë³³, në funksion të garancisë së parashikuar kundrejt arbitraritetit – privimin e lirisë së personit pa pasur dyshimin e bazuar në prova³⁴.

Lidhur me proporcionalitetin e masës së sigurimit të kërkuar nga prokurori, me përfundimin e afatit 20 ditor të masës së sigurimit “arrest në burg” të përcaktuar nga ana e gjykatës, rezulton se sërish në kërkesën e tij nuk ka një analizë të veçantë lidhur me masën e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur”. Kërkesa lidhur me këto kritere, është e njëjtë me ato të kërkesës fillestare kur është kërkuar edhe vleftësimi i arrestimit në flagrancë të shtetasit në fjalë. Në kërkesën e prokurorit konstatohet se në pjesën përshkruese lidhur me faktet, në raport me kërkesën e parë, janë përshkruar administrimi i akteve mjeko ligjore dhe rezultatet e tyre; administrimi mbi karakteristikat mbi sjelljen dhe vërtetimet mbi vazhdimin e gjimanzit nga ana e K.K., dhe faktin që është sportist i dalluar, dhe duke dalë në konkludim nga vetë prokurori se: “*se i arrestuari është një person i rregullt dhe i disiplinuar*”; faktin që prokurori është në pritje të akteve të ekspertimit teknik të armës balistik, teknik teshash, vendimit për ekspertim teknik-thike, vendimet e ekspertimit biologjik të këmbëzës së armës si dhe vendimet për ekspertim tamponi – GSR. Lidhur me këto në vazhdim prokurori shprehet se: “*në këto kushte jemi në pritje të akteve*

³² Gjykata në vendimin nr. 3 datë 03.01.2021 arsyeton se: “Gjykata, vlerëson se, në rastin konkret plotësohet kushti i dytë i veçantë i parashikuar nga shkronja a, pika 3 të nenit 228 të K.Pr.Penale. Shkronja a pika 3 e nenit 228 të K.Pr.Penale ka parashikuar se ... Gjykata vlerëson se për shkak të lidhjes së personave përfshirë të ngjarjes (lidhje gjinie e krushqie) mund të helomohen provat, veprimet e karakterit sekret që ka urdhëruar prokurori, vlerësohen si shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen dhe vërtetësinë e provave. Lidhur me personin nën hetim K.K. duke vlerësuar faktin se është urdhëruar kryerja e veprimeve të tjera hetimore disa prej të cilave të karakterit sekret, faktit se në deklaratimet e disa prej shtetasve dhe vetë deklaratimet e para të të arrestuarit K.K., se me armë ka qëlluar shtetasi E.K. priten rezultatet e akteve të ekspertimit mjeko-ligjor, me qëllim që të garantohet hetimi i plotë e me dilgjencë nga prokurori nga njëra anë dhe garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nga ana tjetër, duhet të caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” me afat 20 ditë për personin nën hetim K.K.”

³³ Vendim i Kolegjtit Penal të Gjykatës së Lartë me nr. 34 datë 28.01.2000, 170 datë 14.08.2000, nr. 457 datë 20.07.2001,

³⁴ Procedura Penale. Komentar.- autorë Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda, Tiranë 2010

përkatëse. Nga ana tjetër konkludohet se me administrimin e këtyre akteve ka vende për ndryshimin e cilësimit juridik të faktit penal, në atë të veprës penale të "Vrasja e kryer në kushtet e tronditjes së fortë psikike të çastit", ngelur në tentativë të parshikuar nga neni 88/22 i Kodit Penal ose atë të "Plagosjes së rëndë me dashje" e kryer ndaj një personi që është krushqi e afërt me autorin të parashikuar nga neni 88/2 i K.Penal." Më pas po në kuadër të proporcionalitetit, nga aktet e paraqitur nga prokurori në seancë nuk rezultojnë që të jenë administruar aktet e ekspertimit të cilat sipas edhe prokurorit do të shërbenin për të vlerësuar nga ana e tij për ndryshimin e kualifikimit juridik të faktit penal të ndodhur, dhe për rrjedhojë fakti penal mbetet i pandryshuar dhe si e tillë, edhe rëndësia e saj dhe sanksioni përkatës. Referuar kërkesës, lidhur me proporcionalitetin, rezultojnë se nga ana e prokurorit nuk ka një analizë të veçantë lidhur me masën e sigurimit "detyrim për t'u paraqitur". Kërkesa lidhur me këto kritere, është e njëjtë me ato të kërkesës fillestare kur është kërkuar edhe vleftësimi i arrestimit në flagrancë të shtetasit në fjalë, dhe si e tillë nuk përputhet me rolin që ka prokurori në caktimin e një mase sigurimi. Masa e sigurimit, sipas parashikimeve të nenit 244/1 të K.P.Penale, mund të vendoset vetëm pas një kërkesë të prokurorit dhe si e tillë është ai i cili duhet të argumentojë para gjykatës, mbi shkaqet e vendosjes së një lloji mase. Kështu prokurori shprehet se: "Nisur nga sa më sipër është e nevojshme që në ngarkim të të ndaluarve duhet të caktohet një masë sigurimi shtrënguese për vazhdimin e mëtejshëm të hetimeve të këtij procedimi penal pasi: Përveç sa më sipër çmujmë se ekzistojnë kushtet dhe kriteret ligjore të parashikuara në nenet 228 e 229, 230 të K.Pr.Penale që ndaj të pandehrit të caktohet një masë sigurimi me karakter shtrëngues. ... Në kërkesën lidhur me llojin e masës së sigurimit që kërkohet të caktohet mbahet parasysh proporcionaliteti dhe përshtatshmëria specifike e nevojave të sigurimit në rastin konkret me llojin e masës së sigurimit. Në caktimin e masës së sigurimit duhet të kihet parasysh raporti me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Duke qenë se ndalimi i shtetasit është bërë konform rregullave procedurale duke ju bërë të qartë të drejtat dhe detyrimet ligjore në përputhje me nenet 253 dhe 258/1 të K.Pr.Penale si dhe bazuar në nenet 228, 229 e 230, 245, 254, 259 të K.Pr.Penale."

Në seancë gjyqësore, prokurori ka arsyetuar në drejtim të provave si edhe në kërkesë, duke shtuar mbi pyetjen e gjykatës faktin që ³⁵shtetasi Xh.M. ka pasur një problem ka qëndruar vetëm 3 ditë në spital është lënë me arrest shtëpie, më pas dhe nga konsultimi që është bërë me mjekun duhet të ëshkoj në spital në Tiranë. Kemi bërë një urdher për shsqërimin e detyrueshëm në moemtnin që do të krijohen kushtet duhura. Nga fundi i muajit Janar ky shtetas do të qëndroj në Spitali Ushtarak sepse dhe nga mjeku është thënë që nuk duhet për këtë arsye e ka remomanduar ta mbaj dhe disa kohë plumbin në shpatull.... Gjendja e tij shëndetësore e Xh.M. është drejt përmirësimit kami administruar dhe një memo, kemi parashtruar dhe me shkrim me ekspertimin e faktorit të qitjes... ka vend për ndryshimin e cilësimit juridik të faktit penal. Nuk jemi përpara 2 veprave penale ato të vrasjes së kryer në kushtet e tronditjes së fortë psikike të çastit parashikuar nga neni 88/22 të K.penal ose atë të palgosjes së rëndë me dashje e kryer ndaj një personi që është krushqi e afërt me autorin parashikuar nga neni 88/2 i K.penal. Janë në bashkëjetesë dhe armëmbajtje pa leje në

³⁵ Teksti literalisht sipas procesverbalit të seancës gjyqësore.

varësi të përgjigjes që do na vijë. Marrëdhëniet janë normalizuar palët kanë hequr dorë për të marrë raportin mjeko ligjor, fakti që është në shkollë është sportist i dalluar, fakti penal ka ndodhur në banesën e të arrestuarit. Është vetë viktima që ka provokuar këtë ngjarje. Kërkojmë detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore. Nga kqyrja e vendit të ngjarjes është sekuestruar një gëzhgjë dhe një plumb në trupin e Xh.M., mendojmë që ngjarja në momentet e para ishte e rëndë. Kemi disponuar me këtë lloj akuze, kjo akuzë nuk ka vnd dhe arsye të plota për të ndryshuar cilësimin e veprës në këtë mënyrë". Prokurori në arsyetimin e tij, si në kërkesë dhe në seancë gjyqësore, është skeptik dhe konfuz vetë lidhur me cilësimin juridik që do t'i japë faktit penal, dhe nuk arsyeton lidhur me marzhin e dënimit për këto vepra penale ku vetëm njëra prej tyre e përmendur nga prokurori neni 88/2 i K.Penal parashikon një masë dënimi nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim. Konstatimi më tej i prokurorit i disa rrethanave si normalizimi i marrëdhënieve, vazhdimi i shkollës, të qenit sportist i dalluar, bashkëjetesa, mënyra sesi ka ndodhur ngjarja, nuk janë shoqëruar me ndonjë analizë lidhur me identifikimin e treguesit të proporcionalitetit të masës së sigurimit. Gjithashtu në këtë analizë para gjykatës, prokurori megjithëse shprehet mbi gjendjen shëndetësore të të dëmtuarit Xh.M. mbi të cilin vijon të zbatohet masa e sigurimit "arrest në shtëpi", nuk bën ndonjë lloj analize në raport me masën "detyrim për t'u paraqitur" ndaj personit nën hetim K.K. i cili është i dyshuar për shkaktimin e dëmtimeve me armës zjarri të këtij të dëmtuari.

Masa e re e kërkuar nga ana e prokurorit, "detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore", vlerësohet si jo proporcionale referuar veprës penale për të cilën dyshohet të jetë nën hetim personi ndaj të cilit kërkohet masa e sigurimit dhe qëndrimin e të dhënave të parashtruar nga ana e prokurorit. Prokurori nuk shprehet për një vepër penale konkrete për të cilën do të duhet të kërkohet masa e sigurimit, në arsyetimin e tij, megjithëse në kërkesë ka përcaktuar se kualifikimi juridik mbetet i pandryshuar. Përveç kësaj, nga ana e prokurorit nuk janë sjellë të dhëna/prova që tregojnë që të mund të vlerësohen se ka ndryshuar përshtatshmëria dhe proporcionaliteti i masës së sigurimit në drejtim të zbutjes së nevojave të sigurimit. Edhe gjykata në vendimin e saj, ka mbajtur qëndrimin për rrezikshmëri të theksuar shoqërore, dhe ka argumentuar mbi caktimin e masës së sigurimit në përputhje me nenin 244/3 të K.Pr.Penal sipas të cilit "Gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga ana e prokurorit". Më konkretisht, gjykata shprehet se: "Gjykata vlerëson shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën dyshohet personi nën hetim. Gjykata çmon se ndërsa rrezikshmëria shoqërore është kusht për ekzistencën e veprës penale, shkalla e saj shërben pothuajse si njësi matëse për klasifikimin e veprave penale dhe për përcaktimin e llojeve të masës së dënimit apo masës së sigurimit. Gjykata, vlerëson se vepra penale e cila dyshohet se është konsumuar nga personi nën hetim paraqet rrezikshmëri të theksuar. Gjykata, mban në konsideratë edhe shkallën e dënimit të parashikuar nga dispozitat ligjore konkrete. Prokurori kërkon caktimin e masës së sigurimit parashikuar nga neni 234 i K.pr.Penale ndaj personit nën hetim. Lidhur me masën e sigurimit të kërkuar, prokurori argumentoi se, nga ana e organit procedues nuk është bërë e mundur të administrohen aktet të cilat janë lënë si detyrë nga ana gjykatës, por nga hetimi dinamik ka vend për ndryshimin e akuzës.

Prokurori në seancë deklaroi se janë në pritje të aktit të ekspertimit për shtetasin Xh.M. dhe se fillimisht akuzat ka qenë e rëndë dhe cilësimi i faktit do të ndryshohet prej tij. Po kështu nga ana e prokurorit janë administruar akte në lidhje me ndjekjen e procesit mësimor nga personi nën hetim si dhe faktin se ai është pajisur me certifikatë "Krenaria e Qytetit" nga Kryetari i Bashkisë Vlorë, për rezultate të larta në sportin e boksit. Nga ana e mbrojtjes së personit nën hetim u parashtrua se marrëdhëniet me shtetasin Xh.M janë normalizuar dhe për këtë paraqiti deklaratën noteriale nr. 116 rep, nr. 38 kol, datë 23.01.2021, të lëshuar prej këtij shtetasi. Po kështu, u paraqit edhe deklaratë noteriale nr. 138 rep, nr. 43 kol të lëshuar nga shtetasit A.M. dhe A. K. për normalizimin e marrëdhënieve me shtetasin Xh. M.. Nga ana e mbrojtjes u paraqit edhe vërtetim .. datë 22.01.2021, nga Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Vlorë, sipas të cilit shtetasi K. K. ka qëndruar në vetëizolim prej datës 28.11.2020 deri më datë 12.12.2020, për shkak të covid 19. Po kështu, u depozitua një vlerësim psiko-emocional i nxënësit K. K., realizuar nga psikologjia e shkollës, ku bëhet një përshkrim i natyrës së nxënësit K. K. si i qetë, i rregullt dhe me synime në fushën e sportit dhe rendit. Po kështu, psikologjia ka bërë edhe një përshkrim të gjendjes psiko-emocionale të nxënësit për shkak të Covid 19. Gjykat duke vlerësuar të gjitha rrethanat e mësipërme si dhe në përputhje me nenin 244/3 të K.Pr.Penale i cili parashikon " Gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori ", vlerëson se duhet të caktoj ndaj personit nën hetim K. K. masën e sigurimit "Detyrim për t'u paraqitur në Policinë Gjyqësore" parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale, me frekuencë paraqitje dy herë në muaj, ditë të premtë, ora 14.00."

Është për t'u konstatuar në veprimtarinë e prokurorit, se nëse nga ana e tij vlerësohet se ka një ndryshim të kualifikimit të faktit penal, e cila është e rëndësishme në drejtim të vlerësimit të proporcionalitetit të masës së sigurimit, duhet të procedojë me një ndryshim të kualifikimit përkatës me akt përkatës të arsyetuar sipas parashikimeve të nenit 287/2³⁶ të K.P.Penale nëse personi është në cilësinë e personit nën hetim dhe me ndryshim akuzë sipas nenit 34/1 të K.Pr.Penale nëse personi është në cilësinë e të pandehurit. Kjo është mënyra procedurale e parashikuar lidhur me dhënien e një kualifikimi ligjor të veprës penale për faktin penal të atribuar personit nën hetim dhe ndaj të cilit vlerësohet propozimi i një mase sigurimi. Kjo kompetencë i është dhënë vetëm prokurorit në fazën e hetimeve paraprake dhe si i tillë ai është i detyruar ta respektojë. Gjykata në caktimin e masës së sigurimit, ashtu siç është pranuar tashmë edhe nga praktika gjyqësore, në drejtim të faktit penal që i atribuohet personit ndaj të cilit vlerësohet kërkesa e prokurorit për caktimin e një mase sigurimi, në aplikimi të nenit 228/1 të K.Pr.Penal për krijimin e "dyshimit të arsyeshëm" duhet të vlerësojë ekzistencën e një ose më shumë provave, që tregojnë se është kryer një veprë penale dhe se autori i saj mund të jetë personi ndaj të cilit kërkohet caktimi i masës së sigurimit³⁷. Përveç ekzistencës së provave e standardit të tyre të nevojshëm për të vendosur masën e sigurimit është e domosdoshme të vlerësohen me kujdes ato akte që janë

³⁶ 2. Kur gjatë hetimeve paraprake ndryshon cilësimi juridik ose ndonjë rrethanë e kryerjes së veprës penale, prokurori urdhëron pasqyrimin e tyre në shënime të bëra sipas paragrafit 1 të këtij neni.

³⁷ Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë me nr. 311 datë 19.12.2008.

paraqitur si prova- pra nëse këto akte përbëjnë prova në kuptimin e nenit 149 i K.Pr.Penale dhe nëse janë marrë në respektim të ligjit procedural. Kjo është e domosdoshme përse kohë neni 228/1 i K.Pr.Penale parashikon shprehimisht dyshimin e bazuar në 'prova'- nocion ky që është ai i parashikuar nga neni 149 i K.Pr.Penale. Shqyrtimi i tyre – përfshirë analizën e tyre, duhet të bëhet njëlloj si në gjykimin e çështjes në themel në drejtim të faktit të përdorshmërisë së tyre, dhe jo për standardin që duhet të krijojnë këto akte në tërësi si prova për provimin e fajësisë apo jo³⁸.

Gjithashtu nga trajtimi i rastit konkret në veprimtarinë e prokurorit, është evidentuar edhe fakti se nga të dhënat e marra, ndaj vendimit të gjykatës që ka caktuar masë sigurimi me afat, nuk rezultojnë të jetë ushtruar ankimi nga ana e prokurorit, si dhe nuk ka një qëndrim me shkrim për mosushttrim ankimi, që të jetë e administruar në dosje. Lidhur me këtë, referuar ndryshimeve kushtetuese dhe të Kodit të Procedurës Penale, e më konkretisht nenit 408 të K.pr.penale, sipas të cilit ankimi mund t'a ushtrojë vetëm prokurori i çështjes, vlerësohet se është e nevojshme që në rastet kur prokurori vlerëson të mos ushtrojë ankimin ndaj vendimit të gjykatës për caktimin e masës së sigurimit sipas nenit 249 të K.Pr.penale, t'i paraqes arsyet me shkrim lidhur me këtë vlerësim dhe t'ia paraqes Drejtuesit të Prokurorisë i cili mund t'a vlerësojë në kuadër të të drejtës së tij për të nxjerrë udhëzim jo të detyrueshëm, sipas Udhëzimit të Përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm me nr. 12/2020 i ndryshuar³⁹. Gjithashtu rezultojnë se ndaj vendimit gjyqësor, nuk është ushtruar ankimi as nga personi nën hetim, duke sjellë për rrjedhojë marrjen formë të prerë të këtij vendimi.

II. Rasti i çështjes së kërkimit nga ana e prokurorit masa e sigurimit "arrest në shtëpi" ndaj të miturit në konflikt me ligjin.

Rasti i përket zyrës së prokurorisë Vlorë, procedimi penal me nr. 352 datë 19.03.2021, lidhur me masën e sigurimit të kërkuar ndaj të dyshuarit të miturit në konflikt me ligjin, V.M. bazuar në ekzistencën e dyshimit për kryerjen e veprave penale të parashikuar nga neni 84, 274, 278 e 25 i K.Penal.

³⁸ Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 181 datë 14.5.1999 në gjykimin me objekt: rekurs i prokurorisë ndaj vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor për caktimin e masës së sigurimit "arrest në shtëpi", pas kërkesës së prokurorit "arrest në burg" në përfundim të afatit 10 ditor të masës së sigurimit "arrest në burg", është shprehur se: "Gjykata në këtë fazë të gjykimin, përderiza hetimet paraprake nuk kanë përfunduar, nuk mund të angazhohet për të përcaktuar fajësinë ose jo të të pandehurve".

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin e saj me nr.82 datë 25.03.2009 shprehet se "Sipas dispozitës së nenit 380 të K.Pr.Penale, për të marrë vendimin, gjykata duhet të bazohet në prova dhe nuk mund të perdore prova të tjera, veç atyre që janë marrë ose janë verifikuar në shqyrtimin gjyqësor.

³⁹ Në nenin 13 të këtij udhëzimi është parashikuar mundësia e Drejtuesit të Prokurorit për të nxjerrë udhëzim jo të detyrueshëm lidhur me masat e sigurimit, por nuk është rregulluar konkretisht ky moment lidhur me ankimin ndaj vendimit të gjykatës për masat e sigurimit.

Fakti penal lidhet me ngjarjen e datës 17.03.2021, ku është qëlluar me armë zjarri e llojit pistoletë në ajër në ambiente të jashtëme në fshatin Akërnj. Me armë është qëlluar nga shtetasi V. M. dhe arma ka qenë e shtetasit D.LI. Të dy këta shtetas së bashku me persona të tjerë janë nisur nga një fshat tjetër për të shkuar në Akërnj, pasi D. i ka thënë se kishte 'sherr' me një person në fshatin ku ndodhi ngjarja. Për këtë ngjarje janë arrestuar shtetasit e mitur në konflikt me ligjin V.M dhe shtetasi D. LI. për veprën penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit", "Kanosja" dhe "Prishja e qetësisë publike" dhe "Moskallëzim krimi" sipas neneve 278, 25, 84, 274 dhe 300 i Kodit Penal. Të dy shtetasit rezultojnë përkatësisht V.M. i moshës 17 vjeç dhe D. LI i moshës 16 vjeç, dhe të jenë nxënës shkolle.

Prokurori ka paraqitur kërkesën e tij në gjykatë, duke kërkuar krahas vleftësimit të arrestimit, edhe caktimin e masës "Arrest në burg" për veprat penale të parashikuar nga neni 278, 25, 84 dhe 274 të Kodit Penal ndaj shtetasit V.M. dhe caktimin e masës "detyrim paraqitje në policinë gjyqësore" për veprën penale të parashikuar nga neni 278, 25, i Kodit Penal ndaj shtetasit D.LI.

Çështja rezulton të jetë shqyrtuar nga Gjykata e rrethit gjyqësor Vlorë, e cila me vendimin nr. 77 datë 20.03.2021 pasi ka vleftësuar si të ligjshëm arrestimin në flagrancë për të dy të dyshuarit, ka caktuar ndaj të dyshuarit të miturit në konflikt V.M. masën e sigurimit personal "detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale dhe ndaj të dyshuarit tjetër D.LI masën e sigurimit personal "detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale.

Nga trajtimi i rastit në drejtim të proporcionalitetit, konstatohet se në kërkesën e tij prokurori shprehet për mbajtjen parasysh të kriterëve të parashikuar nga neni 229, 230 të K.P.Penale duke i cituar këto në mënyrë literale, por pa u analizuar konkretisht lidhur me të dhënat e rastit konkret dhe se cilat nga këto kriterë plotësohen. Gjithashtu nuk ka një analizë të veçantë lidhur me këto kriterë për secilin nga personat nën hetim për të cilët kërkohet masa. Po kështu, ndërkohë që shprehet për ekzistencën e këtyre kriterëve pa i identifikuar për secilin prej personave ndaj të cilëve do kërkohet masa, kërkon masë sigurimi "arrest në shtëpi" për njërin person nën hetim dhe "detyrim paraqitje" për personin tjetër. Kështu prokurori shprehet se: "Përveç sa më sipër çmujmë se ekzistojnë kushtet dhe kriteret ligjore të parashikuar në nenet 228 e 229, 230 të K.Pr.Penale që ndaj të pandehurit të caktohet një masë sigurimi me karakter shtrëngues. Konkretisht ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në provat⁴⁰ ...Në kërkesën lidhur me llojin e masës së sigurimit që

⁴⁰ Vazhdon me kushtet, "...të cilat në unitetin e tyre krijojnë dyshimin se veprat penale kanë ndodhur dhe se janë kryer nga personi i arrestuar. Me "dyshim të arsyeshëm" në kuptim të nenit 5&1 (c) do të kuptojmë që heqja ose kufizimi i lirisë personale të personit do të bëhet në rast se ka baza të forta për arrestimin e tij. Kusht i rëndësishëm është dyshimi i arsyeshëm, sipas të cilit askush nuk mund t'u nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin Unifikues nr. 3 datë 27.09.2002 kanë përcaktuar se: "Dyshimi i arsyeshëm nënkupton bindjen që krijohet nga provat e marra e të shqyrtuara në përputhje me kërkesat e ligjit, të cilat në unitetin e tyre tregojnë se vepra penale ka ndodhur dhe se ajo është kryer nga ai që akuzohet". Nuk ka shkaqe padëmueshmërie ose t'eshuarjes së veprës penale, pasi i arrestuari e ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe është i përgjegjshëm para ligjit për veprimet e kryera, si dhe vepra penale nuk është parashikuar apo shuar në ndonjë mënyrë tjetër. Kushti themelor për caktimin

*kërkohej të caktohet mbahet parasysh proporcionaliteti dhe përshatshmëria specifike e nevojave të sigurimit në rastin konkret me llojin e masës së sigurimit. Në caktimin e masës së sigurimit duhet të kihet parasysh raporti me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Duke qenë se ndalimi i shtetasit është bërë konform rregullave procedurjale duke ju bërë të qartë të drejtat dhe detyrimet ligjore në përputhje me nenet 251, 252, 253 dhe 258/1 të K.Pr.Penale si dhe bazuar në nenet 228, 229 e 230, 245, 254, 259 të K.Pr.Penale KËRKOJMË:
...*

Pavarësisht nga mungesa e një arsytimi sa më sipër në kërkesën e prokurorit, këto masa vlerësohet të jenë në proporcion, duke bërë edhe një dallim midis dy personave për të cilat ka dyshim për kryerjen e veprave penale të ndryshme të cilat paraqesin rrezikshmëri të ndryshme referuar si rrethanave të faktit dhe masës së dënimit. Kështu rezulton se pavarësisht se personi autorë të dyshuar të veprës penale janë të mitur, rrethanat në të cilat ata kanë kryer veprën penale të lidhur me marrjen e armës, shkuarjen në vendin e ngjarjes për të "zgjidhur" grindje të mëparshme dhe më pas përdorimi i armës duke qëlluar, tregon për një rrezikshmëri të lartë shoqërore, dhe për këtë arsye lind e nevojshme krijimi i një garancie në drejtim të ruajtjes së sigurisë publike. Po kështu fakti penal i referohet disa veprave penale për njërin person të mitur dhe për një vepër penale për tjetrin, por që të dy lidhen me mbajtjen e armës në automjet e mjedise të hapura për publikun e parashikuar si e tillë sipas veprës penale të "Mbajtjes së armës" të parashikuar nga neni 278/1 të K.Penal që parashikon një marzh dënimi nga pesë deri në shtatë vjet. Referuar këtyre të dhënave bazuar në Kodin e Drejtësisë Penale për të miturit, neni 81, 86 të tij, për këta të mitur vlerësohet se duhet të caktohet një masë sigurimi, dhe lidhur me llojin e masës merret në konsideratë që të miturit vazhdojnë shkollën duke zhvilluar mësimin online⁴¹, por njëkohësisht edhe roli i secilit në kryerjen e veprave penale. Bazuar në këto vlerësime duke në kuadër të kërkesës për mosndërprerja të proceseve edukative, të mirërritjes dhe të zhvillimit normal të një të mituri, vlerësohen masa të përshatshme ato të propozuar nga ana e prokurorit duke bërë identifikimin e masës së "arrestit në shtëpi" për personin e mitur përdorues të armës dhe të "detyrimit për t'u paraqitur" për personin e mitur mbajtës të armës.

Në drejtim të proporcionalitetit të masës së sigurimit, konstatohet se edhe nga ana e gjykatës, si edhe në kërkesën e prokurorit, në vendimmarrjen e saj, nuk bëhet një analizë e plotë e kriterëve

e masave të sigurimit personal është ekzistenca e veprës penale dhe përgjegjëshmëria e atij që akuzohet. Vepra penale duhet të jetë e parashikuar nga Kodi Penal ose nga ndonjë ligj tjetër, që e konsideron atë si vepër penale. Në shkronjën "c" të pikës 3 të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, parashikohet rasai (kushti) "kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të së të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të njëjtë lloj me atë për të cilin procedohet". Përmbajtja e dispozitës së sipërcituar të shkronjës "c" të pikës 3 të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale lidhet me nevojën për cakimin e masës së sigurimit për të përmbushur funksionin parandalues të posaçëm të shtetit për garantimin e rendit e të sigurisë publike, paprekshmërinë e jetës, shëndetit, pronës dhe interesave e të drejtave të tjera të ligjshme nga kryerja e veprave penale nga ana e të pandehurit." Vazhdohet me llojin e masës së sigurimit.

⁴¹ Sipas deklaratimit të avokatit në seancë.

për caktimin e masës së sigurimit, në drejtim të mënyrës sesi identifikohen elementët e veçanta tek personi për të cilin ka vendosur mospranimin e kërkesës së prokurorit, dhe duke mos bërë asnjë dallim me përshtatshmërinë dhe proporcionalitetin e të njëjtës masë sigurimi të vlerësuar për personin tjetër, edhe ky i mitur, i cili dyshohej vetëm për mbajtje të armës, referuar parashikimit të nenit 245/2 të K.Pr.Penale që përcakton se: “2. Kur vepra penale është kryer nga dy ose më shumë persona, gjykata disponon në një vendim, duke arsyetuar kushtet dhe kriteret për secilin prej tyre.”. Kështu në vendimin e saj gjykata shprehet se: “Në këto rrethana, është e domosdoshme që ndaj shtetasit V.M., të caktohet një masë sigurimi. Kështu, rrezikshmëria shoqërore e veprës penale të “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, të parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal si dhe e autorit të saj, shtetasit V.M., plotëson kushte dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për caktimin e masës së sigurimit personal të karakterit shtrëngues, që parashikohen nga nenet 228 dhe 229 të Kodit të Procedurës Penale, por meqënëse ky i dyshuar sapo ka hyrë në moshën që merr përgjegjësi edhe penale, kjo tregon se rrezikshmëria e tij është e vogël, e për pasojë edhe masa e kërkuar nga prokuroria për këtë të arrestuar e kalon funksionin që masa ka. Kjo do të thotë, që masa më e përshtatshme për të arrestuarin V.M., është ajo e “detyrimit për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale. ... Në këto rrethana është e domosdoshme që ndaj shtetasit D. LL, të caktohet një masë sigurimi. Kështu, rrezikshmëria shoqërore e veprës penale të “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, të parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal si dhe e autorit të saj, shtetasit D.LL, plotëson kushtet dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për caktimin e masës së sigurimit personal të karakterit shtrëngues, që parashikohen nga nenet 228 dhe 229 të Kodit të Procedurës Penale, por meqënëse ky i dyshuar sapo ka hyrë në moshën që merr përgjegjësi edhe penale, kjo tregon se rrezikshmëria e tij është e vogël, e për pasojë edhe masa e kërkuar nga prokuroria për këtë të arrestuar e kalon funksionin që masa ka. Kjo do të thotë, që masa më e përshtatshme për të arrestuarin V.M., është ajo e “detyrimit për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale. PËR KËTO ARSYE, GJykata duke u bazuar në nenet ... VENDOSI ...”

Gjithashtu konstatohet se si në kërkesën e prokurorit dhe vendimmarrjen e gjykatës, nisur nga fakti se për të dy personat për të cilët bëhet kërkesa për vlefësim arrestimi në flagrancë dhe caktim mase, janë nën 18 vjeç, nuk përmenden dispozitat e Kodit të Drejtësisë Penale për të mitur, ligji me nr. 37/2017 e konkretisht dispozitat përkatëse lidhur me masën e sigurimit, neni 15⁴² dhe 86⁴³.

⁴² “1. Arrestimi, ndalimi ose burgimi i një të mituri nuk zbatohet nëse qëllimi mund të realizohet përmes një mase më të butë. 2. Arrestimi, ndalimi ose burgimi i një të mituri zbatohet në përputhje me parashikimet e këtij Kodi, si dhe në përputhje me legjislacionin procedural penal, për atë sa nuk parashikohet ndryshe në këtë Kod. 3. Masat e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, përdoren vetëm si një masë e fundit, për një kohë sa më të shkurtër, si dhe janë objekt i rishikimit të rregullt periodik nga gjykata.”

⁴³ “Përveç parashikimeve të nenit 228, të Kodit të Procedurës Penale, masa e arrestit në burg mund të vendoset për të miturin vetëm si një alternativë e fundit dhe vetëm nëse ekziston edhe ndonjë nga kriteret e mëposhtme: a) sankcioni i parashikuar për veprën penale, për të cilën ai akuzohet është me burgim dhe ka minimumin e dënimit mbi 7 vjet; b) masa është e domosdoshme, sepse i mituri: i) përbën rrezik serioz për të dhe/ose për të tjerët dhe ky rrezik nuk mund

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, përmban rregullime të posaçme lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregulla procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, si dhe një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale⁴⁴. Në funksion të përshtatshmërisë dhe proporcionalitetit të një mase sigurimi, veçanarisht kur është rasti për të mitur, duhet të gjejnë vend interpretimi bazuar në dispozitat e këtij kodi të posaçëm për këtë kategori personash⁴⁵. Në funksion të implementimit dhe zbatimit të këtij kodi, në prokuroritë dhe gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm janë marrë masat që hetimi dhe gjykimi të bëhet nga magistratë të veçantë të cilët marrin edhe trajnimet përkatëse në këtë fushë.

Një konstatim tjetër, lidhur me këtë çështje është edhe fakti se megjithë qëndrimin ndryshe të gjykatës, nga ana e prokurorit nuk është reaguar me ndonjë ankim dhe gjithashtu nuk konstatohet të ketë një qëndrim me shkrim për mosushtrim ankimi. Lidhur me këtë, ashtu siç u arsyetua edhe në rastin më sipër, vlerësohet se është e nevojshme që në rastet kur prokurori vlerëson të mos ushtrojë ankimin ndaj vendimit të gjykatës për caktimin e masës së sigurimit sipas nenit 249 të K.Pr.penale, t'i paraqes arsyet me shkrim lidhur me këtë vlerësim dhe t'ia paraqes Drejtuesit të Prokurorisë i cili mund t'a vlerësojë në kuadër të të drejtës së tij për të nxjerrë udhëzim jo të detyrueshëm, sipas Udhëzimit të Përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm me nr. 12/2020 i ndryshuar⁴⁶.

III. Rasti i çështjes ku nga ana e prokurorit është vlerësuar kërkimi i masës së sigurimit “arrest në shtëpi”, e vlerësuar kjo si proporcionale, dhe nga ana e gjykatës është pranuar kërkesa për këtë masë sigurimi, por është urdhëruar moszbatimi i saj nga e hëna deri në të premten e çdo muaji për të mosndërprerë procesin mësimor.

të mënjanohet me ndonjë mënyrë tjetër; ii) përpiqet t'i shmangët drejtësisë. Neni 87 Zbatimi i masës së arrestit në burg për të miturit 1. Çdo muaj nga zbatimi i vendimit të arrestit gjykata edhe kryesisht, pasi dëgjon palët, vendos vazhdimin, zëvendësimin ose revokimin e masës. 2. Prokurori ka barrën e provës për të arsyetuar vazhdimin e arrestit në burg. 3. Dispozitat e Kodit të Procedurës Penale zbatohen për atë që është e mundur për paraburgimin ndaj të miturit në konflikt me ligjin. 4. Pavarësisht nga parashikimi i bërë në pikën 3, të këtij neni, i mituri nuk mund të mbahet në paraburgim më shumë se gjysma e kohës së paraburgimit të caktuar për të rriturin, sipas Kodit të Procedurës Penale.”

⁴⁴ Neni 1 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

⁴⁵ Në nenin 81 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur me titull “Caktimi i masës së sigurimit”, parashikon se: “Ndaj të miturit nuk mund të caktohet një masë sigurimi më e rëndë, nëse i njëjti qëllim mund të realizohet me një masë më të lehtë. 2. Kur kërkohet të caktohet masë sigurimi ndaj një të mituri, prokurori në kërkesë dhe gjykata në vendim mban parasysh dhe arsyeton interesin më të lartë të të miturit, nevojat specifike të tij dhe kërkesën për të mos ndërprerë proceset edukative, të mirërritjes dhe të zhvillimit normal të një të mituri. 3. Në caktimin e masës së sigurimit, gjyqtari dëgjon personalisht të miturin dhe jep vendimin menjëherë.”

⁴⁶ Në nenin 13 të këtij udhëzimi është parashikuar mundësia e Drejtuesit të Prokurorit për të nxjerrë udhëzim jo të detyrueshëm lidhur me masat e sigurimit, por nuk është rregulluar konkretisht ky moment lidhur me ankimin ndaj vendimit të gjykatës për masat e sigurimit.

Rasti i përket zyrës së Prokurorisë Shkodër, lidhur me procedimin penal nr. 415 datë 07.05.2021, ku është kërkuar caktimi i masës së sigurimit "arrest në shtëpi" ndaj të miturit në konflikt të dyshuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga nenet 274, 278/1 dhe 293/b të K.Penal.

Fakti penal lidhet me ngjarjen e ndodhur në datën 06.05.2021, në afërsi të një banese është shtënë me armë luftarake dhe nga qitja ishte shkaktuar zhurmë që kishte shqetësuar banorët e zonës. Nga kqyrja e vendit të ngjarjes, janë gjetur gëzhjojë, predhë dhe dëmtime si ato të gjuajtjes me armë. Për ngjarjen në fjalë, është arrestuar në flagrancë, i mituri E.N. i cili ka pranuar në deklaratimet e tij faktin e qëllimit me armë zjarri dhe ka treguar se ku e kishte fshehur armën e zjarrit.

Prokurori në kërkesën e tij të datës 08.05.2021, ka kërkuar vlefësimin e arrestimit në flagrancë dhe njëkohësisht caktimin e masës së sigurimit "arrest në shtëpi", duke arsyetuar se ka mbajtur parasysh përshatshmërinë e masës së sigurimit në raport me shkallën e nevojave të sigurimit, rëndësinë e faktit; sanksionin që parashikohet për veprat penale, personalitetin e personit nën hetim, rrethanat familjare të të arrestuarit, faktin që është i mitur dhe nxënës shkolle.

Kërkesa e prokurorit është regjistruar në gjykatë më datë 08.05.2021, ora 15:09 dhe nga gjyqtari i caktuar është caktuar seanca më datë 10.05.2021 ora 09.00. Seanca është zhvilluar në datën e përcaktuar në orën 09.06, ku është paraqitur prokurori i cili ka kërkuar sipas kërkesës me shkrim dhe i mituri, me mbrojtësin. Ky i fundit kërkoj një masë më të butë me qëllim mosndërprerjen e procesit mësimor. Në seancë gjyqësore ka qenë i pranishëm edhe prindi dhe psikologja.

Dhe si e tillë, mbi të njëjtat argumente është vlerësuar si masë proporcionale kundrejt të miturit në konflikt me ligjin, edhe nga gjykata në vendimin e datës 10.05.2021, por duke i bërë një përcaktim zbatimit të kësaj mase në raport me ditët e javës. Kështu, nga gjyqtari është përcaktuar se kjo masë nuk duhet të zbatohet nga e hëna deri të premten e çdo muaji, ora 07.00 deri në orën 15.30, për t'i mundësuar të miturit në konflikt me ligjin, ndjekjen e procesit mësimor.

Në vendimmarrjen e saj gjykata arsyeton se, sipas ligjit nr 37/2017 KDPM, masa e sigurimit persona "Arrest ne burg" nuk mund të caktohet pasi vjen në kundërshtim me parashikimet e nenit 86/a të këtij ligji, sipas të cilit "*Sanksioni i parashikuar nga vepra penale për të cilën akuzohet është me burgim dhe ka minimumin e dënimit mbi 7 vjet*". Gjykata vijon se bazuar në parashikimet e nenit 229/3 të K.Pr. Penale dhe nenit 81 e vijues të ligjit nr. 37/2017 masa e sigurimit personal më e përshatshme që duhet të caktohet ndaj të miturit në konflikt me ligjin, është ajo e arrestit në shtëpi parashikuar nga neni 237 i K.Pr. Penale.

Ky vendim gjyqësor ka marrë formë të prerë për shkak se nuk është ankimuar.

Nga trajtimi i rastit, në drejtim të proporcionalitetit të masës së propozuar nga ana e prokurorit, konstatohet se ajo vlerësohet proporcionale në raport me faktin penal për të cilën dyshohet i mituri në konflikt, sanksionin që parashikojnë veprat penale, rrethanat në të cilat e ka kryer veprën penale e lidhur me përdorimin e armës në mjedis publik dhe për më tepër afër banesave të cilat paraqesin rrezikshmëri të lartë shoqërore si të faktit penal ashtu edhe të vetë autorit, dhe që gjithsesi nuk mund t'a ulin këtë rrezikshmëri thjesht nga fakti që është i mitur dhe nxënës shkolle.

Në drejtim të proporcionalitetit, në kërkesën me shkrim të prokurorit konstatohet se në analizën e tij, prokurori bën një arsyetim të përgjithshëm të kritereve për caktimin e masës së sigurimit, duke cituar elementët që duhen marrë parasysh sipas formulimit të dispozitës në fjalë dhe pa i lidhur ato sesi identifikohen në rrethanat e rastit konkret. E vetmja rrethanë që përmend prokurori në këtë arsyetim është fakti që i arrestuari është i mitur dhe nxënës shkolle, por edhe për këtë moment nga ana e tij nuk vazhdohet me arsyetimin sesi lidhet me përshtatshmërinë e masës së sigurimit "arrest në shtëpi" me anë të të cilës konkludon. Gjithashtu, për shkak të specifikës që ka rasti konkret, e lidhur me një subjekt të posaçëm siç është i mituri, në arsyetim nga ana e prokurorit nuk ka asnjë analizë lidhur me dispozitat konkrete të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur të cilat rregullojnë në mënyrë të veçantë edhe rastet e masës së sigurimit. Nga ana e prokurorit, përmendet thjesht si bazë ligjore neni 86 i Kodit Penal për të të Miturit në momentin kur duhet të konkludoj. Kështu prokurori shprehet se: *"Në caktimin e llojit të masës së sigurimit me karakter shtrëngues ndaj të ndaluarit duhet të merren parasysh dhe kriteret ligjore të caktimit të masës së sigurimit të parashikuara nga enmi 229 i K.Pr.Penale që janë: a) Përshtatshmëria e masës së sigurimit, me shkallën e nevojave të sigurimit; b) Ruajtja e një raporti midis rëndësisë së faktit me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete; c) Rrethanat e kryerjes së veprës penale si ato lehtësuese dhe rënduese. Duke mbajtur parasysh: përshtatshmërinë e masës së sigurimit në raport me shkallën e nevojave të sigurimit; përshtatshmërinë e masës së sigurimit në raport me rëndësinë e faktit; sanksionin që parashikohet për këto vepra penale; personalitetin e personit nën hetim, rrethanat familjare të të arrestuarit, faktin që i arrestuari është i mitur dhe nxënës shkolle, në rastin konkret masa e sigurimit personal "arrest në shtëpi", parashikuar nga neni 237 të K.Pr.penale plotësojnë nevojat e sigurimit. Bazuar në nenet 228, 229, 237, 258 dhe 259 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenin 86 të Kodit Penal për të Miturit, KËRKOJ:"*

Ndërsa nga ana e gjykatës në analizën e saj lidhur me llojin e masës së sigurimit personal, pasi bëhet citimi i formulimit të nenit 229 të K.P.Penale ku parashikohen kriteret për caktimin e masës së sigurimit personal, vazhdohet me identifikimin që në fillim të faktit se personi ndaj të cilit do të caktohet masa e sigurimit është i mitur dhe vazhdon me kohë të plotë arsimin e mesëm, për të mbështetur më tej me arsyetimin mbi bazën e dispozitave të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, megjithëse arsyetimi paraqitet i përgjithshëm pa u reflektuar rrethanat konkrete dhe si individualizohen ato në zbatim të këtyre dispozitave për proporcionalitetin e masës së sigurimit "arrest në shtëpi". Kështu gjykata shprehet se: *"Përsa i përket llojit të masës së sigurimit personal, Gjykata mban parasysh parashikimet e nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale me titull "...", i cili parashikon: ... Në caktimin e llojit të masës së sigurimit personal që duhet caktuar ndaj të miturit në konflikt me ligjin, ... gjykata mban parasysh dhe se: i mituri në konflikt me ligjin, shtetasi shqiptar është i mitur, është i moshës rreth 17 vjeç e është i padënuar. Ai vazhdon me kohë të plotë arsimin e mesëm. Bazuar në nenet 10, 15, 22/2, 47/7, 81, 86/1/1 e 97/2 të ligjit me nr. 37/2017 Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur", gjykata në shqyrtimin e kërkesës së paraqitur për gjykim vlerëson me përparësi interesin më të lartë të të miturit, në këtë rast të miturit në konflikt me ligjin, të dyshuarit E.N. në vendimmarrjen e saj në lidhje me të miturin, nga Gjykata merren në konsideratë rrethanat individuale të tilla si: moshën e të miturit në konflikt me ligjin, nivelin e*

zhvillimit, kushtet e jetesës, mënyrën e rritjes dhe e zhvillimit, edukimin dhe arsimimin e tij, gjendjen shëndetësore, gjendjen familjare dhe rrethanat e tjera, të cilat lejojnë vlerësimin individual. Gjykata vlerëson se ndaj të miturit në konflikt me ligjin, shtetasit shqiptar... nuk mund të caktohet masa e sigurimit personal " arrest në burg", pasi i njëjti qëllim mund të realizohet me një masë më të butë. I mituri në konflikt me ligjin, dyshohet për kryerjen e veprave penale "Kanosja" për të cilën ligji (neni 84 i Kodit Penal) parashikon dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se një vit; "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit" për të cilin ligji (278/1 i Kodit Penal) parashikon dënimin me burgim nga pesë deri në shtatë vjet; për veprën penale neni 274 i K.Penal parashikon një dënim me burgim jo më të ulët në maksimum se dy vjet dhe për veprën penale për të cilën ligji neni 293/b i Kodit penal parashikon dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se tre vjet. Sipas ligjit numër 37/2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur", masa e sigurimit personal "Arrest në burg" nuk mund të caktohet ndaj tij, pasi kjo vjen në kundërshtim me parashikimet e nenit 86/a të këtij ligji, sipasa të cilit: "Sanksioni i parashikuar për veprën penale, për të cilën ai akuzohet është me burgim dhe ka minimumin e dënimit mbi 7 vjet.". Pra nuk plotësohet kushtet dhe kriteret ligjore për të caktuar ndaj tyre masën e sigurimit "Arrest në burg". Më tej gjyqtari citon parashikimin e nenit 86 të K.Pr.Penal që lidhet me kushtet për caktimin e masës së sigurimit në raport me parashikimin e përgjithshëm për të gjitha subjektet në nenin 228 të K.Pr.Penale, për të kaluar më tej nga gjyqtari në arsyetimin e kushteve të parashikuar në nenin 228 K.Pr.Penale në rastin konkret dhe më konkretisht shprehet se: "Vërtet në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin, shtetasit shqiptar E.N. ekzistojnë dyshime të arsyeshme e të bazuara në prova se ai mund të ketë kryer veprat penale parashikuar nga neni 84 i Kodit penal; parashikuar nga neni 274 i Kodit Penal; parashikuar si krim nga neni 278/1 i Kodit Penal, "Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike", vërtetë ai nuk ka shkaqe padënueshmërie apo të shuarjes së veprave penale apo dënimit, por provohet se nuk ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vëretësinë e provës, pasi ato tashmë janë marrë, nuk ekziston rrezik që ai të largohet, si dhe nuk provohet që për shkak të rrethanave të faktit apo personalitetit të tij ai mund të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj për të cilën dyshohet. Gjykata në vendimmarrjen e mban parasysh dhe arsyeton interesin më të lartë të të miturit në konflikt me ligjin, nevojat specifike të tij dhe kërkesën për të mos ndërprerë proceset edukative (arsimimin) të mirërritjes dhe të zhvillimit normal të tij. Nisur nga sa më sipër, Gjykata bazuar në parashikimet e neneit 229/3 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 81 e vijues të ligjit numër 37/2017, çmon se masa e sigurimit personal më e përshtatshme që duhet caktuar ndaj të miturit në konflikt me ligjin, shtetasit shqiptarë E.N. është ajo e "Arrest në shtëpi", parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, pasi me këtë masë plotësohen dhe nevojat e sigurimit. Kjo masë siguri nuk duhet të zbatohet nga e hena deri të premtën e çdo muaji, nga ora 07.00 deri në orën 15.30 minuta, për t'i mundësuar të miturit në konflikt me ligjin E.N. ndjekjen e procesit mësimor. PËR KËTO ARSYE..."

Referuar këtij interpretimi të gjykatës në drejtim të proporcionalitetit të masës së sigurimit, veç faktit lidhur me mënyrën sesi analizohet ajo në kërkesën e prokurorit dhe vendimit të gjykatës të sipërpërmendur, konstatohen edhe tre problematika si më poshtë:

Së pari: në vendim gjyqtari duke u shprehur "Vërtet në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin, shtetasit shqiptar E.N. ekzistojnë dyshime të arsyeshme e të bazuara në prova se ai mund të ketë kryer veprat penale parashikuar nga neni 84 i Kodit penal; parashikuar nga neni 274 i Kodit Penal; parashikuar si krim nga neni 278/1 i Kodit Penal, "Nderhyrja në të dhënat kompjuterike", vërtetë ai nuk ka shkaqe padëmueshmërie apo të shuarjes së veprave penale apo dënimit, por provohet se nuk ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, pasi ato tashmë janë marrë, nuk ekziston rrezik që ai të largohet, si dhe nuk provohet që për shkak të rrethanave të faktit apo personalitetit të tij ai mund të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj për të cilën dyshohet" ka pranuar mosekzistencën e asnjë kushti të veçantë të parashikuar në nenin 228/3 të K.pr.penale e cila është e domosdoshme për caktimin e një mase sigurimi personal ndaj një personi. Me këtë arsyetim të gjyqtarit ndaj personit nën hetim nuk mund të vendoset asnjë masë sigurimi, ndërkohë që nga ana e tij konkludohet për caktimin e një mase sigurimi në plotësim të nevojave të sigurimit sipas kriterëve të parashikuar në nenin 229 të K.pr.penale.

Së dyti: gjyqtari konkludon se ndaj personit nën hetim të mitur në konflikt me ligjin nuk mund të caktohet masë sigurimi "arrest në burg", pasi kjo vjen në kundërshtim me ligjin nr. 37/2017 të Kodit të Drejtësisë Penale për të mitur e konkretisht nenin 86/a të tij. Ky interpretim që bën gjykata, vlerësohet se është një interpretim i gabuar referuar kuptimit të kësaj dispozite. Nëpërmjet kësaj dispozite, legjislatori duke u ndodhur para një subjekti të posaçëm dhe vulnerabal, siç janë të miturit dhe për të cilët prevalon interesi më i lartë i tij në drejtim të mosndërprerjes së procesit edukativ, të mirërritjes dhe zhvillimit normal të tij, ka parashikuar marrjen në konsideratë edhe të disa kriterëve të posaçme të cilat kushtëzojnë caktimin e masës së sigurimit arrest në burg. Këto kriterë nuk parashikohen të ekzistojnë në mënyrë kumulative, dhe si të tilla në arsyetim anasjelltas sipas vendimit të gjykatës nuk do të ishte i mjaftueshëm vetëm konkludimi i mosekzistencës së kriterit lidhur me sanksionit për të konkluduar se në rastin konkret nuk mund të vendoset caktimi i masës së sigurimit "arrest në burg". Por vlerësohet se nga ana e gjyqtarit për të arritur në këtë konkludim, duhet të arsyetojë edhe faktin se në rastin konkret nuk ekziston as kriteri tjetër, ekzistenca vetëm e të cilës mund të passjellë vlerësimin e caktimit të masës së sigurimit "arrest në burg".

Së treti, lidhur me këtë çështje, është vlerësuar se masa e sigurimit "arrest në shtëpi" në mënyrën sesi është caktuar nga ana e gjykatës për zbatim, e kufizuar në disa ditë të javës, është një tejkalim i llojit të kësaj mase të përcaktuar sipas nenit 237 të K.P.Penale. Kështu sipas kësaj dispozite "1. Me vendimin e arrestit në shtëpi, gjykata urdhëron të pandehurin të mos largohet nga banesa e tij ose nga një vend i caktuar ku ai banon, kurohet ose mbahet me asistencë. 2. Kur cakton këtë masë, gjykata përcakton edhe mënyrën e ekzekutimit dhe të mbikëqyrjes së saj". Në kuptim të këtij parashikimi, me vendosjen e arrestit në shtëpi, personit i privohet liria ashtu si edhe në paraburgim, por në dallim nga kjo e fundit, personi nuk vendoset në një institucion paraburgimi, por në një banesë. Për rrjedhojë, kjo masë sigurimi do të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën kohore që ajo do të zgjas përsa kohë ekzistojnë kushtet dhe kriteret, e nevojat e sigurimit të vlerësuar si të përshtatshëm dhe proporcionale dhe brenda kufijve kohorë të parashikuar sipas rregullimit në

paragrafin 4 të kësaj dispozite. Përcaktimi i mënyrës së zbatimit dhe mbikëqyrjes së kësaj mase, sipas parashikimit në paragrafin e dytë të kësaj dispozite, lidhet me mënyrën sesi do të vendoset lidhur me kontrollin e saj, duke lënë hapësirën që në këto raste gjykata të aplikojë eventualisht edhe legjislacionin aktual mbi mbikëqyrjen elektronike apo mbikëqyrjen nëpërmjet forcave të rendit në rastet që e konsideron të nevojshme⁴⁷. Një parashikim i tillë, u pa i domosdoshëm në kushtet e zbatimit të masës dhe mënyrës sesi do të kontrollohet zbatimi i saj, në funksion të përcaktimit të shkëlqes së zbatimit të kësaj dispozite e cila do të përbënte shkak për të kërkuar zëvendësimin e saj konform nenit 260/3 të K.Pr.Penale.

Ndërsa në mënyrë të veçantë për të miturit, e lidhur kjo me rastin konkret në ligjin me nr. 37/2017 Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, në nenin 82 të tij, është parashikuar se *“Përveç masave të sigurimit të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, ndaj të miturit në konflikt me ligjin mund të vendosen edhe këto masa: a) vendosja e të miturit në mbikëqyrje; b) vendosja e të miturit në një shërbim të specializuar”*. Sipas këtij parashikimi, nëse nga ana e gjyqtarit vlerësohej se në rastin konkret nuk do të duhej të ndërpritej procesi mësimor, duke shkuar në shkolle, në përputhje me parimin e përshtatshmërisë dhe proporcionalitetit, mund të vlerësonte caktimin e masës së vendosjes së të miturit në mbikëqyrje, sipas rregullimeve të parashikuara për këtë masë në nenin 83 të K.D.P.M. Por, kjo do të duhet të ishte si një masë e vecantë, dhe jo si pjesë e ‘integruar’ e një mase tjetër që në thelb, e bën të pazbatueshme.

Për sa u arsyetua më sipër, disponimi i gjykatës lidhur me caktimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi”, vlerësohet si një zbatim i gabuar nga gjyqtari në vendimmarrjen e tij mbi mënyrën sesi e ka përcaktuar zbatimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi”. Në këto kushte, vendimi në fjalë duhet të ishte kundërshtuar nga ana e prokurorit në Gjykatën e Apelit si një vendim i cili nuk e bën efektive nevojën e sigurimit dhe përshtatshmërinë e masës së sigurimit të pretenduar të “arrestit në shtëpi” ndaj personit nën hetim.

Ashtu si edhe në rastet e tjera konstatohet se edhe në këtë çështje, prokurori nuk rezulton të ketë ushtruar të drejtën e ankimit lidhur me mënyrën e disponimit të gjyqtarit në rrasat konkret, duke pasqyruar edhe marrjen e vendimit formë të prerë. Për këtë qëndrim të prokurorit, gjithashtu nuk konstatohet të ketë një qëndrim me shkrim lidhur me mosankimin.

IV. Rasti i çështjes ku nga ana e prokurorit është vlerësuar kërkimi i masës së sigurimit “arrest në burg” me afat,⁴⁸ dhe nga ana e gjykatës është pranuar kjo kërkesë.

Rasti i përket zyrës së Prokurorisë Shkodër, lidhur me procedimin penal nr. 51 datë 12.01.2021, ku nga ana e prokurorit është kërkuar caktimi i masës së sigurimit “arrest në burg” me afat 30 ditor ndaj të dyshuarit A.D. për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga nenet 89 e 278/1 të K.Penal. Fakti penal, në çështjen në fjalë lidhet me përdorimin e armës së zjarrit pistoletë nga ana e personit

⁴⁷ *Relacioni i Kuvendit lidhur me ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale, me ligjin nr. 35/2017.*

⁴⁸ *Në raportin individual të inspektorëve është vlerësuar proporcional, ndërsa personalisht lidhur nga rrethanat e faktit mendoj se nuk është proporcionale lidhur me caktimin e një afati, arsyetimi si më poshtë.*

të dyshuar, në ambjent publik përkundrejt dy personave, të cilët janë plagosur në këmbë. Si shkak i kësaj ngjarje, ka qenë një konflikt i ndodhur midis njërit prej të dëmtuarve dhe një shtetase që punonte si balerinë në një lokal muzike live, ku gjatë kësaj kohe nga ky shtetas është thyer edhe një shishe. Pas këtij konflikti, të dëmtuarit së bashku me një person tjetër janë larguar nga lokali, dhe rreth orës 22.00, ndërkohë që ishin në këmbë në rrugë u janë afruar dy persona që i janë prezantuar si 'djemtë' e lokalit ku kishte ndodhur konflikti dhe u kanë kërkuar arsye pse kishin thyer shishen. Gjatë kësaj kohe, njëri prej dy personave të prezantuar si 'djemtë' e lokalit ka nxjerrë një pistoletë duke i plagosur në këmbë dy shtetasit njëri prej të cilëve dhe personi që kishte thyer shishen në lokal. Pas goditjes me armë, dy personat ndër të cilët edhe ai që kishte qëlluar me armë, janë larguar me vrap dhe njëri prej të dëmtuarve i ka ndjekur me vrap. Ky i fundit gjatë kësaj ndjekje është goditur dhe nga një automjet duke e hedhur në tokë. Lidhur me këtë ngjarje, janë kryer veprime proaktive përgjimi të vendosur nga ana e prokurorit, dhe më datë 12.01.2021 është identifikuar si autor i veprës shtetasi A.D., njëkohësisht edhe personi që ka në përdorim lokalit me muzikë live ku ka ndodhur konflikti, duke u bërë njëkohësisht edhe ndalimi nga ana e policisë gjyqësore.

Prokurori në kërkesën e tij të datës 13.01.2021, ka kërkuar vlefhtësimin e ndalimit dhe njëkohësisht caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg" me afat 30 ditë. Seanca gjyqësore është zhvilluar më datë 14.01.2021, ku nga ana e prokurorit është mbajtur i njëjti qëndrim si edhe më sipër, në relacion të kërkesës dhe nga ana e mbrojtësit është mbajtur qëndrimi për moscaktim të masës së sigurimit.

Gjykata e rrethit gjyqësor Shkodër, gjyqtari përkatës i caktuar, brenda afatit ligjor, më datë 14.01.2021 ka vendosur vlefhtësimin e ndalimit, dhe caktimin e masës së sigurimit me afat të kërkuar nga ana e prokurorit. Sipas vendimit të gjykatës, për llogaritjen e këtij afati, ka përcaktuar ditën e ndalimit.

Në vazhdim, lidhur me të njëjtën çështje nga ana e të njëjtit prokuror, me kërkesën e datës 10.02.2021, regjistruar në gjykatë në të njëjtën ditë ora 11.20, është kërkuar caktimi i masës së sigurimit "arrest në burg" me afat 30 ditë, *në mënyrë që të bëhet e mundur administrimi i aktit të ekspertimit teknik të ekzaminimit të pamjeve filmike të marra nga vendi i ngjarjes*. Seanca gjyqësore është zhvilluar në datë 11.02.2021 nga i njëjti gjyqtar në prani të palëve, ku nga ana e prokurorit është mbajtur i njëjti qëndrim si edhe në kërkesë, dhe nga ana e mbrojtësit është mbajtur qëndrimi për moscaktim i masës së sigurimit.

Gjykata, i njëjti gjyqtar si më sipër, me vendimin nr. 62 datë 11.02.2021 ka pranuar kërkesën e prokurorit për caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg" me afat 30 ditë, me efekt 12.02.2021 ora 11:00 deri më datë 12.03.2021.

Brenda periudhës së afatit të caktuar lidhur me masën e sigurimit, pikërisht vetëm 5 ditë pas caktimit të masës më datë 17.02.2021, konstatohet se nga ana e të njëjtit prokuror, është përpiluar një kërkesë për revokimin e masës së sigurimit ndaj shtetasit nën hetim për të cilën kishte kërkuar dy herë masë sigurimi "arrest në burg" me afat e cila është përcjellë më datë 19.02.2021 në gjykatë kur edhe rezulton të jetë e regjistruar si çështje. Për shqyrtimin e kësaj kërkesë është caktuar e

njëta gjyqtare që kishte kërkesat e mëparshme, e cila ka zhvilluar seancën më datë 23.02.2021 në prani të prokurorit të çështjes, i njëjti me dy kërkesat e mëparshme dhe personit nën hetim/mbrojtja. Në këtë seancë është mbajtur i njëjti qëndrim nga ana e prokurorit dhe nga mbrojtja është shprehur qëndrimi i tij dakortësues për revokimin e masës së sigurimit të kërkuar nga ana e prokurorit. Në përfundim të gjykimit në datën 23.02.2021, gjykata ka vendosur rrezimin e kërkesës së prokurorit.

Ndaj këtij vendimi rezulton që nga ana e prokurorit të jetë ushtruar ankimi në Gjykatën e Apelit Shkodër. Ankimi rezulton të jetë i depozituar në Gjykatën e rrethit gjyqësor më datë 26.02.2021, dhe është dërguar së bashku me aktet në Gjykatën e Apelit më datë 16.03.2021 ku është regjistruar dhe është caktuar gjyqtari kryesues. Ndërkohë rezulton se ankimi i prokurorit, nga ana e gjykatës së rrethit gjyqësor (sekretaria) i është dërguar për njofim të dyshuarit të përfaqësuar nga mbrojtësi me shkresën e datës 02.03.2021 dhe marrë më datë 08.03.2021, si dhe shkresa përcjellëse për dërgimin e akteve në Gjykatën e Apelit është e datës 12.03.2021. Seanca për këtë gjykim është zhvilluar më datë 18.03.2021 ku është dalë edhe me vendimin përkatës. Në seancë prokuroria është përfaqësuar nga prokurori i apelit. Nga shqyrtimi i kësaj çështje ka rezultuar se të dyshuarit në fjalë, sipas vendimit nr. 127 datë 13.03.2021 i është shuar masa e sigurimit "arrest në burg me afat 30 ditë" dhe si e tillë, ankimi ka mbetur pa objekt. Për këtë arsye nga ana e gjykatës së Apelit është vendosur mospranimi i ankimit.

Ndërkohë që rezulton se më datë 11.03.2021 ora 10:16:18 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor është regjistruar një kërkesë tjetër e të njëjtit prokuror si më sipër, për shuarjen e masës së sigurimit⁴⁹ të vendosur sipas vendimit gjyqësor nr. 62 datë 11.02.2021. Prokurori në kërkesën e tij me shkrim, e bazon kërkesën për shuarje të masës së sigurimit në argumentin se personi nën hetim nuk ka kryer veprën penale dhe ka mbaruar afati i mbajtjes në burg, sipas nenit 261 të K.Pr.Penale.

Për shqyrtimin e kërkesës, rezulton të jetë caktuar një gjyqtar tjetër, e ndryshme nga gjyqtari që ka shqyrtuar tre kërkesat e mëparshme dhe lidhur me këtë ndryshim ka një shënim në sistem nga zv/kryetari se: *"gjyqtarja e hetimeve e ka të pamundur të kryej gjykimin sot, dhe nesër me datë 12.03.2021 i fillon leja e miratuar nga zv/kryetari i gjykatës"*. Seanca është zhvilluar më datë 13.03.2021, në ditë pushimi, e shtunë, në mungesë të prokurorit dhe në prani të mbrojtësit të personit nën hetim i cili është shprehur dakort me kërkesën. Dhe në përfundim të shqyrtimit të kësaj çështje, në të njëjtën datë 13.03.2021 ora 09:40 nga ana e Gjykatës është vendosur: *Pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Shuarjen e masës së sigurimit "Arrest me burg me afat 30 ditë", parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj shtetasit A.D.i, caktuar me vendimin nr.62 (909), datë 11.02.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe urdhërohet lirim i menjëhershëm i tij nga salla e gjykimit, nëse ndaj tij nuk zbatohet ndonjë masë tjetër sigurimi "Arrest në burg", ose ndonjë dënim tjetër penal me burgim.*

⁴⁹ referimi është bërë në akte të veçanta të kërkesës së prokurorit, procesverbalit i seancës gjyqësore dhe vendimit të gjykatës.

Nga trajtimi i rastit në fjalë, lidhur me proporcionalitetin e masës së kërkuar, vlerësohet të ndalemi në të katër kërkesat e prokurorit, dy për caktim mase sigurimi me afat dhe dy kërkesa të tjera për revokim dhe shuarje të masës së sigurimit, duke trajtuar njëkohësisht edhe disa çështje interpretimi të ligjit në raport me veprimtarinë e prokurorisë dhe të gjykatës.

I. Përsa i përket kërkesës për caktimin e masës së sigurimit të parë, me afat, konstatohet se në kërkesën e tij prokurori nuk bën një analizë në drejtim të përshtatshmërisë dhe proporcionalitetit të masës së sigurimit të kërkuar, me provat në rastin konkret. Prokurori konkludon lidhur me shkallën e nevojave të sigurimit, raportit midis rëndësisë së faktit dhe sanksionit të veprës penale, por nuk ka një arsyetim sesi të dhënat/provat në rastin konkrete identifikojnë këto elemente të vlerësimit të llojit të masës së sigurimit "arrest në burg" sipas parashikimeve të nenit 229, 230 të K.Pr.Penale dhe në vijim plotësimin e kushtit të veçantë për dhënien e masës së sigurimit me afat, sipas parashikimeve të nenit 245/1/d të K.Pr.Penale ku përcaktohet se: *"caktimi i kohëzgjatjes së masës, kur ajo është urdhëruar për të garantuar marrjen ose vërtetësinë e provës"*. Për më tepër, që ky kusht *"kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit"*, nuk është evidentuar si i tillë, në konkludimin që prokurori i ka bërë kushteve të veçanta sipas parashikimeve të nenit 228/3 të K.pr.penale. Prokurori në kërkesën e tij, ka konkluduar mbi ekzistencën e kushtit *"rrezikut të shmangies hetimit, gjykimit dhe vuajtjes së dënimit"*. Kështu më konkretisht në kërkesën e prokurorit arsyetohet se: *"Për caktimin e masave të sigurimit personal duhet të ekzistojnë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta si dhe të respektohen kriteret për caktimin e tyre. Në rastin konkret: Ekziston një dyshim i arsyeshem i bazuar në prova (të dhënat hetimore të marrë nga burimet përkatëse të provës) të cilat në unitetin e tyre tregojnë se vepra penale është kryer dhe se është kryer nga personi që dyshohet, nuk ka shkaqe padëmueshmërie ose të shuarjes së veprës penale. Për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të dyshuarit, pasi ka rrezik që ai të shmangët hetimit, gjykimit dhe vuajtjes së dënimit është e nevojshme që ndaj tij të caktohet një masë sigurimi me karakter shtrëngues. Përsa i përket kriterëve për caktimin e masave të sigurimit: Masa e sigurimit që do të kërkojmë është e përshtatshme për shkallën e nevojave të sigurimit që ekzistojnë në rastin konkret. Ekziston një raport i drejtë midis rëndësisë së faktit dhe sanksionit që parashikohet për veprën penale konkrete me llojin e masës së sigurimit. Në ngarkim të personit nën hetim A.D. ekziston dyshimi i bazuar në prova, për këto arsye ndaj tij, duhet të caktohet masa e sigurimit e "Arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i K.Pr.penale, me afat për marrjen e provave të nevojshme në ngarkim të këtij shtetasi. Prandaj në bazë të neneve 88, 228, 229, 258 dhe 259 të K.Pr.Penale KËRKOJ: 1. Vlefësimin e ligjshëm të arrestit të personit nën hetim A.D. 2. Të caktohet masë sigurimi personal "Arrest në burg", që parashikohet nga neni 238 i K.Penal, ndaj personit nën hetim A.D., me afat 30 ditë."*

Lidhur me këtë konstatim të arsyetimit të kërkesës së prokurorit, vlen të theksohet se i takon organit procedues të vërtetojë se arrestimi i të pandehurit është i domosdoshëm për të parandaluar

një veprimtari të kundraligjshme të tij lidhur me marrjen dhe vërtetësinë e provë në të kundërt masa e sigurimit personal nuk gjen mbështetje në dispozitën e lartpërmendur⁵⁰ dhe si e tillë në kushtet kur nuk ka të dhëna për aplikimin e kësaj dispozite, referur rrezikshmërisë së faktit penal dhe të autorit të dyshuar lidhur me veprimet e kryera në këtë ngjarje me plagosje të dy personave me armë si dhe veprimin e goditjes me automjet, masa e sigurimit që mund të kërkohej ishte ajo e "arrestit në burg" pa afat.

Lidhur me vendimmarrjen e gjykatës në caktimin e masës së sigurimit, proporcionalitetit të saj, konstatohet se nga ana e saj sipas vendimit është vendosur pranimi i kërkesës së prokurorit, duke konkluduar se ekzistojnë kushtet e përgjithshme të parashikuar nga neni 228/1,2 i K.pr.penale dhe kushti i posaçëm i parashikuar nga neni 228/3 që lidhet me rrezikun që i dyshuari të kryejë përsëri të njëjtën veprë dhe të bëhet pengesë për një hetim të plotë, të shpejtë dhe të gjithanshëm të çështjes. Gjykata shprehet konkretisht se: "*Ndaj të dyshuarit duhet vendosur masë sigurimi për shkak se nga vetë natyra e veprës penale ekziston rreziku që ai të kryejë përsëri të njëjtën veprë dhe të bëhet pengesë për një hetim të plotë, të shpejtë dhe të gjithanshëm të çështjes.*" Dhe lidhur me kriteret për caktimin e masës së sigurimit, gjykata bën një arsyetim të përgjithshëm të kriterëve të përgjithshme duke mos u ndalur konkretisht në mënyrën sesi identifikohen të dhënat e provat e paraqitur nga prokurori/mbrojtja në seancë për shkallën e nevojave të sigurimit dhe proporcionalitetin e masës "arrest në burg", për të cilën përcaktohen edhe kriteret të veçanta. Kështu gjykata shprehet se: "*Për sa i takon kriterëve për caktimin e masës së sigurimit, neni 229 i K.Pr.Penale parashikon se: "...*" Në vendosjen e kësaj mase sigurimi gjykata mban parasysh raportin mes rëndësisë së faktit dhe sanksionit të parashikuar për këtë veprë penale, me masën e sigurimit. Në rastin konkret veprat penale për të cilat dyshohet shtetasi A.D., dënohen me një muaj burg të ulët dënimi prandaj një fakt i tillë flet për një rrezikshmëri të lartë të veprave penale. A.D.duhet vendosur masa e sigurimit "Arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penal, por me një afat 30 ditor". Lidhur me afatin, nga ana e gjykatës arsyetohet në vazhdim se: "*... duhet vendosur masa e sigurimit "arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i K.pr.penale, por me një afat 30 ditor. Gjatë këtij afati kohor gjykata çmon se duhen kryer disa veprime hetimore, për të cilat janë marrë tashmë vendimet nga ana e organit të akuzës dhe konkretisht: të realizohet veprimi hetimor i këqyrjes së kamerave të sigurimit së vendosur në ambiente publike si dhe të kryhet akti i ekspertimit kimik në lidhje me faktorët plotësues të qitjes në duar të të dyshuarit. Duke u nisur nga tërësia e rrethanave të analizuara më sipër, kjo gjykata çmon se nevojat e sigurimit nuk mund të përmbushen me asnjë masë tjetër më të lehtë, për shkak të rrezikshmërisë së veprës e cila drejtohet ndaj shëndetit të individit si dhe për shkak të rrezikshmërisë së autorit".* Kjo mënyrë e të interpretuarit nga ana e gjykatës lidhur me përcaktimin e kohëzgjatjes së masës së sigurimit, nuk është në përputhje me parashikimin e nenit 245/1/d të K.P.Penale. Siç është theksuar edhe në rastin më sipër, aplikimi i kësaj mase është gjithmonë i lidhur me rastet kur prova nuk do të arrihej të merrej ose nuk do të garantohet vërtetësia e saj nëse i pandehuri nuk do të ishte siguruar me një masë sigurimi. Gjykata në vendimmarrjen e saj, nuk ka asnjë arsyetim lidhur me faktin se përse

⁵⁰ Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë me nr. 34 datë 28.01.2000

provat që do të rezultojnë nga kryerja e veprimeve hetimore nuk do të mund të merreshin apo nuk do të garantohej vërtetësia e tyre, nëse personi do të qëndronte pa masë sigurimi. Kryerja e veprimeve hetimore është detyrë funksionale e prokurorit në kuadër të ushtrimit të ndjekjes penale lidhur me çështjen në fjalë, rezultatet e të cilave mund të ndikojnë në ekzistencën e kushteve dhe kritereve të caktimit të masës së sigurimi, dhe është për këtë shkak që legjislatori ka parashikuar në nenet 260 të K.Pr.Penale mundësinë e të proceduarit të mëtejshëm lidhur me revokimin/zëvendësimin e një mase sigurimi personal. Për më tepër, që nga ana e gjykatës, nuk ka një konkludim të qartë lidhur me ekzistencën e kushtit të parashikuar nga neni 228/3/a e K.Pr.Penale, e cila është e domosdoshme në funksion të aplikimit të nenit 245/1/d të K.Pr.penale. Ky është qëndrimi që është mbajtur edhe nga Gjykata e Lartë, përmendim vendimin nr. 86 datë 11.11.2021, e cila shprehet se: *“55. Në kundërshtim me përmbajtjen e përcaktimeve të sipërcituara Gjykata – gjyqtari për hetimet paraprake – megjithëse ka verifikuar nevoja sigurimi të ndryshme nga përcaktimi i nenit 228/3/a të KPP, të cilat nuk kanë të bëjnë me verifikimin e rrezikimit të “ndotjes” së provës, nën pretekstin e marrjes së një prove, të kërkuar nga i hetuari, që nuk disponon (rrezikon) rekuizitat e sipërkërkuara, për më tepër të një pretendimi të paraqitur në vendin dhe kohën e gabuar, jo para Prokurorit, si i vetmi subjekt, në këtë fazë të hetimeve paraprake të procedimit penal, i legjitimuar (me përjashtim të rasteve të “sigurimit të provës”) me cilësinë e titullarit të drejtimit të kësaj faze për marrjen e provave – sigurimin e burimeve të provave në funksion të vendimarrjes finale të kësaj faze, kërkesës për “dërgimin e çështjes në gjyq” apo të “pushimit” të çështjes, në kushtet e verifikimit, sikurse vetë ajo gjykatë ka pranuar, të një nevoje sigurimi tjetër, asaj të parashikuar nga shkronja “c” e pikës 3, të nenit 228 të KPP, ka disponuar caktimin e afatit të kohëzgjatjes së masës së sigurimit personal “Arrest në burg” ndaj të hetuarit S., në masën prej 25 ditë. “*

Lidhur me vendimin gjyqësor në fjalë, konstatohet gjithashtu edhe fakti se nga ana e gjykatës në pikën 2 të dispozitivit, është përcaktuar se afati i masës së sigurimit, fillon nga dita e ndalimit. Ky urdhërim i gjykatës, vlerësohet se nuk është në përputhje me vetë institutin e masës së sigurimit. Masa e sigurimit personal shtrëngues “arrest në burg” dhe arrestimi në flagrancë/ndalimi pavarësisht se kanë të bëjnë me privimin e lirisë së një personi, janë dy institute të ndryshme të cilat gjejnë rregullim të veçantë në Kodin e Procedurës Penale në drejtim të kushteve dhe procedurave të ndjekur lidhur me to që përfshin edhe kohëzgjatjen e tyre. Sipas teorisë dhe praktikës shqiptare arresti në flagrancë/ndalimi nuk janë masa sigurimi. Pavarësisht se nga qëllimet që ndjekin dhe pasojat që sjellin, arrestimi në flagrancë dhe ndalimi duken si masa sigurimi, pasi në të vërtetë nëpërmjet tyre realizohet kapja e të dyshuarit dhe izolimi i tyre, ato nuk mund të konsiderohen masa sigurimi, por veprime procedurale që diktohen nga rrethanat konkrete, të flagrancës apo të ikjes⁵¹. Në lidhje me këtë Gjykata e Lartë në vendimin nr. 489 datë 12.12.2000 është shprehur se: *“Kolegji i tërheq vëmendjen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës, e cila e ka konsideruar arrestimin në flagrancë si masë sigurimi. Një masë e tillë sigurimi nuk njihet nga*

⁵¹ Arrestimi në flagrancë dhe ndalimi – Demokratizimi i legjislacionit penal nga Halim Islami, Shtëpia botuese “Luarasi”, 2000.

Kodi i Procedurës Penale, por arrestimi në flagrancë është veprim me iniciativë i organit procedues që konfirmohet i ligjshëm ose jo nga gjykata."

Nisur nga këto dy koncepte të ndryshme të arrestimit/ndalimit dhe masës së sigurimit arrest në burg, kur kjo masë e sigurimit përcaktohet me afat sipas parashikimeve të nenit 245/1/d të K.Pr.Penale, me qëllimin e garantimit të marrjes apo vërtetësisë së prove, e cila do të rrezikohej nëse personi do të lihej pa masë sigurimi, dhe nisur nga mundësia që parashikon Kodi i Procedurës penale, neni 261/1/ ç të K.Pr.Penale që kjo masë sigurimi mund të ripërsëritet brenda kufijve të parashikuar nga neni 264 dhe 267 të K.Pr.Penale, përcaktimi i fillimit të këtij afati në masën e sigurisë në drejtim të interpretimit logjik, nuk mund të ketë fuqi prapavepruese, por nga dita e caktimit të kësaj mase. Kjo është praktika që gjejmë edhe në Gjykatën e Lartë⁵².

⁵² Përmendim: 1. **Vendimin nr. 281 datë 24.04.2002** të Kolegjit të Gjykatës së Lartë, e cila ka arsyetuar se: "... Mbi kërkesën e prokurorisë, me 12.03.2002, është bërë ndalimi i Agim Matukes dhe me vendimin nr.18, datë 15.03.2002 të Gjykatës së Rrethit Berat ndaj tij është vendosur masa e sigurimit arrest në burg me afat dhjetë ditor. Me 25.03.2002, me vendimin nr.5, të asaj gjykate, është caktuar masa e sigurimit arrest në shtëpi për të pandehurin Agim Matuka. ... Duke parur parasysh sa me sipër, gjykata e rrethit pranon se në ngarkim të të pandehurit Agim Matuka ekzistojnë dyshime të arsyeshme të bazuara në prova për veprën për të cilën akuzohet dhe duke cmuar rrezikshmerinë e veprës e personalitetin e tij, ka caktuar masën e sigurimit "arrest në shtëpi". Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke ju referuar kritereve të përcaktuara në K.Pr.P., për caktimin e masave të sigurimit personal, çmon se ekzistojnë kushtet për caktimin e masës së sigurimit ndaj të pandehurit Agim Matuka duke pranuar ekzistencën e dyshimeve të arsyeshme dhe faktin se është e nevojshme të kryhen edhe veprime të tjera hetimore për të arritur në përfundimin e kryerjes apo jo të veprës penale nga i pandehuri.... Në këto kushte masa e sigurimit arrest në shtëpi caktuar me vendim të Gjykatës së Rrethit Berat për të pandehurin Agim Matuka duhet të ndryshohet duke caktuar si masë ate të parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale detyrimin për t'u paraqitur në policinë gjyqësore." ;

2. **Vendimi nr. 43 datë 04.04.2005** i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, nga ka rezultuar se: "... Pas ndalimit të saj, me 05.01.2005, dhe marrjes të pandehur me 06.01.2005, Prokuroria pranë Gjykatës së shkalles së parë Tirane, i ka kërkuar gjykatës vlefësimin e ndalimit dhe caktimin për të, të masës së sigurimit "arrest në burg"... Gjykata e shkalles së parë Tirane, me vendimin e datës 08.01.2005 ka vlefësuar të ligjshëm ndalimin dhe ka caktuar si masë sigurimi ndaj të pandehures Elona Farka, ate të "arrestit në burg" me afat 30 ditor, për kryerjen e ekspertimit teknik të dy kasetave diktofonike. ... Me pas, Gjykata e shkalles së parë Tirane, me vendimin e datës 07.02.2005, për çështjen penale me nr.30/1 akti, ka caktuar si masë sigurimi ndaj të pandehures Elona Farka ate të "arrestit në burg". Ky vendim është lene në fuqi nga Gjykata e Apelit Tirane, me vendimin nr.58, datë 28.02.2005. ... Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë çmon se, me të drejtë gjykatat kanë konstatuar se ekzistojnë tre kushtet e parashikuara nga neni 228 i K.Pr.Penale, për caktimin e masave të sigurimit personal. Por nga ana e gjykatave, në caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg" ndaj të pandehures Elona Farka, nuk janë respektuar kërkesat e nenit 230/a të K.Pr.Penale. Nga përmbajtja e kësaj dispozite del se "arrestit në burg" mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër sigurimi është e papershmatshme, për shkak të rrezikshmerisë së veçantë të autorit dhe të pandehurit. Në rastin konkret, qenia femer e të pandehures, mosha e saj, fakti që procedohet për here të parë të çon në konkluzionin se ndaj saj duhet caktuar një masë sigurimi me e lehtë, se ajo e arrestit në burg, siç është masa e sigurimit "arrest shtëpie", parashikuar nga neni 232/d i K.Pr.Penale." ;

3. **Vendimin nr. 32 datë 05.02.2014** të Gjykatës së Lartë, e cila në vendimmarrjen e saj ka vlerësuar si të drejtë caktimin e një mase sigurimi nga Gjykata e rrethit gjyqësor në ditën e fundit të përcaktuar si përfundim afati në përlllogaritje nga dita e vendimit të gjykatës për caktimin e masës së sigurimit, e cila ka qenë në kushtet e vlefësimin të arrestimit në flagrancë të personit ndaj të cilit është caktuar masa e sigurimit. Kështu më konkretisht në këtë vendim,

2. Përsa i përket kërkesës për caktimin e masës së sigurimit të dytë, me afat, konstatohet se nga ana e prokurorit në kërkesën e tij përsëriten të njëjtat argumente lidhur me kushtet dhe kriteret si më sipër, ndërsa rezulton se tek faktet janë përfshirë edhe veprimet hetimore të kryera lidhur me kqyrjen e kamerave dhe marrjen e një vendimi për ekspertim të pamjeve filmike. Në këto fakte konstatohet se nga ana e prokurorit nuk janë përmendur dhe as interpretuar rezultatet e ekspertimit kimik sipas detyrave të gjykatës në vendimmarrje, ndonëse rezulton i përfshirë ky rezultat në aktet dërguar gjykatës për shqyrtimin e kërkesës për masë sigurimi. Lidhur me afatin për masën e sigurimit, konstatohet se nga ana e prokurorit në kërkesë konstatohet se është bërë ky arsyetim "duke patur parasysh se afati mbaron në datë 12.01.2021, në kushtet ku ekzistojnë të njëjtat kushte dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit, ndaj personit nën hetim duhet të caktohet masë sigurimi personale, me afat në mënyrë që të bëhet e mundur administrimi i aktit të ekspertimit

arsyetohet se: " ... i dyshuar, shtetasi K. K., i cili është ndaluar dhe shoqëruar në ambientet e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë, në datë 10.09.2013. ... Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.955 akti, datë 14.09.2013 e ka vlerësuar të ligjshëm ndalimin e personit nën hetim Kid Koshena dhe caktuar masën e sigurimit "arrest në burg me afat 30 ditë". ... Mbi kërkesën e prokurorit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.955/1 akti, datë 14.10.2013 ka vendosur, caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, për personin nën hetim Kid Koshena. ... Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.685, datë 06.11.2013 ka vendosur: Ndryshimin e vendimit nr.955/1 akti, datë 14.10.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke i caktuar të dyshuarit Kid Koshena masën e sigurimit personal "detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore", parashikuar nga neni 234 i K.Pr.P. ... Ndaj vendimit të mësipërm ka ushtruar rekurs Prokurori i Apelit Tiranë, i cili kërkon prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, duke pretenduar se në rrethanat e çështjes, e vetmja masë sigurimi e përshatshme me shkallën e nevojave të sigurimit dhe rëndësinë e faktit është "arrest në burg", sipas nenit 238 të K.Pr.Penale. ... në rrethanat e reja, pas administrimit të një sërë provash shkresore, produkt i veprimeve hetimore të kryera nga organi i akuzës, pas caktimit të masës së arrestit në burg me afat 30 ditor, pranimit i kërkesës së paraqitur nga ana e gjykatës së faktit, duke caktuar ndaj personit nën hetim Kid Koshena masën e sigurimit "arrest në burg (neni 230 i K.Pr.Penale), më të drejtë është vlerësuar nga gjykata e apelit si e pabazuar në ligj. Neni 230 "Kriteret e veçanta për caktimin e masës së "arrestit në burg" i K.Pr.Penale parashikon se: ...Në rastin konkret, vetë prokurori ka kërkuar caktim masë sigurimi me afat 30 ditë për të garantuar nevojat e sigurimit lidhur me marrjen apo vërtetësinë e provave, prova të cilat janë administruar dhe vlerësuar nga gjykata e apelit, gjatë shqyrtimit të ankimit ndaj vendimit nr.955/1 akti, datë 14.10.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. ... Neni 229 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: ... Në interpretim të përmbajtjes së kësaj dispozite procedurale penale, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, e vlerëson masën e sigurimit "detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore", sipas nenit 234 të K.Pr.Penale, të personit nën hetim Kid Koshena, si një masë që i përgjigjet shkallës së nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret.":

4. Vendimin nr. 33/1 datë 08.10.2015 ku gjykata është shprehur se: "Me vendimin nr. 33, datë 08.09.2015, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur: - pranimit e kërkesës. Vlefshësinë e ligjshëm të "arrestimit në flagrancë" të personit nën hetim. Caktimin e masës së sigurimit.... "arrest në burg" me afat 1 (një) muaj. ... Kërkesa e paraqitur nga Prokuroria e Përgjithshme për caktimin e masës së sigurimit personal "arrest në burg" me një afat (një) muaj ndaj shtetasit Anton Agustin Leka, është e bazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë do të pranohet."

Të njëjtin interpretim e gjejmë edhe në 1 rast objekti inspektimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, dhe këtë praktikë e gjejmë edhe në disa çështje që kemi evidentuar nëpërmjet kërkimit në sistem në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

teknik të ekzaminimit të pamjeve filmike të marra nga vendi i ngjarjes.” Ndërkohë, ashtu si edhe në kërkesën e parë, konkludon ndonëse pa një arsyetim dhe pa cituar as dispozitën përkatëse, mbi ekzistencën e kushtit të posaçëm për vendosjen e masës së sigurimit shtrëngues se *ka rrezik që personi nën hetim ti shmanget hetimit, gjyqimit dhe vuajtjes së dënimit.*

Gjykata, në vendimin e saj me të cilën ka pranuar kërkesën e prokurorit sa më sipër, duke caktuar një masë tjetër me afat, konstatohet se bën të njëjtin përshkrim dhe arsyetim lidhur me kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit, si edhe në vendimmarrjen e mëparshme për këtë çështje, duke konkluduar sërish për kushtin sipas parashikimeve të nenit 228 të K.Pr.Penale *në ekzistencën e rrezikut që ai të kryejë përsëri të njëjtin veprë dhe të bëhet pengesë për një hetim të plotë, të shpejtë dhe të gjithëanshëm të çështjes.* Si dhe lidhur me afatin për masën e sigurimit, i referohet të njëjtit arsyetim si edhe më parë duke përcaktuar sërish të njëjtat detyra *si veprimi hetimor i këyqyrjes së kamerave të sigurisë së vendosur në ambiente publike si dhe të kryhet akti i ekseprimit kimik në lidhje me faktorët plotësues të qitjes në duart e të dyshaurit A.D.,* ndonëse në kërkesën e prokurorit dhe në aktet bashkëlidhur evidentohen se këto detyra kanë përfunduar.

Edhe në këto akte të prokurorit dhe të gjykatës, si edhe në aktet e mëparshme, vërejmë të njëjtat çështje të trajtuar më parë, lidhur me interpretimin e kushteve dhe kriterëve për caktimi e një mase sigurimi, si edhe në zbatimin e nenit 245/1/d të K.Pr.Penale. Gjithashtu është për t'u theksuar edhe fakti i mosrakordimit në dispozitivin e vendimit të gjykatës, midis afatit 30 ditor të shprehur me datat e përcaktuar shprehimisht të shtrirjes së efekteve. Kështu referuar datave 12.02.2021 ora 11:00 deri 12.03.2021 rezulton se janë 28 ditë, dhe jo 30 ditë siç është përcaktuar si afat, çka krijon konfuzion në përlllogaritjen e datës lidhur me ecurinë e mëtejshme të procedurave që mund të ndiqen, dhe që do të konstatohen në vijim me pasqyrimin e rrethanave të mëtejshme të ecurisë procedurale lidhur me masën e sigurimit ndaj të njëjtit shtetas në këtë çështje.

3. Përsa i përket kërkesës për revokimin e masës së sigurimit konstatohet se në kërkesën e prokurorit pasi përshkruhen rrethanat e faktit, është vazhduar me rezultatet e veprimeve hetimore dhe me konkluzionin se nga ana e personit nën hetim me masë sigurimi, nuk provohet që të ketë kryer veprat penale të parashikuar nga neni 278/1, 89 i K. Penal. Mbi bazën e këtij argumentimi, nga ana e prokurorit referohet se mungojnë kushtet dhe kriteret e zbatimit të masës së sigurimit dhe se për këtë arsye, në mbështetje të nenit 260 të K.Pr.Penale kërkohet revokim i masës së sigurimit e lirim të menjëhershëm të personit nën hetim. Me kërkesën, bashkëlidhur me aktet hetimore, është vendosur edhe vendimi i datës 17.02.2021 i të njëjtit prokuror mbi pushimin e hetimeve lidhur me nenin 89 të K.Pr.Penale e cila rezulton të jetë e njëjtë si edhe kërkesa për revokim, duke shtuar faktin e pushimit të çështjes penale për nenin 89 të K.Penal ndaj personit me masë sigurimi, sipas nenit 328/1 shkronja 'f' e K.Pr.Penale.

Lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, konstatohet se nga ana e saj, përshkruhen rrethanat e faktit, rezultatet e veprimeve hetimore si edhe rrjedhën procedurale deri në këtë fazë që lidhet me

kërkesën e prokurorit për revokimin e masës së sigurimit "arrest në burg". Në pjesën përshkruese të vendimit, nga ana e gjykatës përmendet edhe vendimi i pushimit i marë nga ana e prokurorit, për të cilën sqarohet se nuk është paraqitur ende në gjykatë për shkak të njoftimit të palëve. Në vazhdim, nga ana e gjykatës, është kaluar në analizën lidhur me kushtet për caktimin e masës së sigurimit të parashikuar në nenin 228 të K.Pr.Penale, duke cituar këtë dispozitë dhe duke konkluduar se tashmë ndaj personit nën hetim, *ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova për kryerjen e veprës penale të "Vrasjes me dashje", në bashkëpunim, në tentativë dhe "Mbjajtjes pa leje të armëve luftarake" të parashikuar nga neni 76, 25, 22 dhe 278/2 i K.Penal.* Lidhur me ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, nga ana e gjykatës është argumentuar ajo se çfarë ka rezultuar nga ana e veprimeve hetimore të kryera dhe duke e interpretuar lidhur me veprimet e kundraligjshme që sipas gjykatës janë kryer nga ana e personit nën hetim, dhe që përbëjnë shkak për ndryshimin e akuzës nga plagosje tashmë në vrasje të mbetur në tentativë. Më tej, nga ana e gjykatës, kalohet në konstatimin e ekzistencës së kushteve të parashikuar në nenin 228/2,3 të K.Pr.Penale ku për këtë të fundit identifikon të njëjtin kusht të posaçëm si edhe në dy vendimmarrjet sa më sipër, lidhur me *"rreziku që ai të kryejë përsëri të njëjtat vepra dhe të bëhet pengesë për një hetim të plotë, të shpejtë dhe të gjithëanshëm të çështjes."* Lidhur me kriteret për caktimin e masës së sigurimit, nga ana e gjykatës, pasi bëhet citimi i dispozitës, konkludon mbi rrezikshmërinë e lartë të veprave penale për të cilën dyshohet personi nën hetim e lidhur me marzhin e dënimit, duke e lidhur këtë me proporcionalitetin e masës së sigurimit arrest në burg. Në vazhdim, nga ana e gjykatës, argumentohet lidhur me kërkesën e prokurorit për revokim të masës së sigurimit sipas parashikimeve të nenit 260 të K.pr.penal, për të cilën fillimisht citon parashikimet e kësaj dispozite, për të kaluar në arsyetimin e saj teorik në interpretim të dispozitës se kërkesa e prokurorit nuk është detyrim, dhe se është gjykata ajo që shqyrton nëse ekzistojnë kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit, dhe vijuar më tej me analizën në rastin konkret ku sipas saj konkludohet se ekzistojnë ende kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit, nuk kanë ndryshuar dhe madje janë rënduar nevojat e sigurimit, duke u shprehur për nevojën e kryerjes së veprimeve të tjera hetimore. Për këtë konkludim, gjykata arsyeton se *"Fakti që prokurori ka vendosur të pushojë hetimet më datë 17.02.2021 lidhur me veprat penale të parashikuara nga nenet 278/1 dhe 89 të Kodit Penal, ndaj të dyshuarit A. D., nuk përbën shkak që ai t'i drejtohet gjykatës me një kërkesë për pushimin e hetimeve ndaj të dyshuarit, kërkesë e cila shqyrtohet nga gjyqtari i hetimeve paraprake dhe në varësi të vendimit të këtij të fundit, mund të kërkohet edhe shuarja e masës së sigurimit, në kuptim të nenit 261/1 pika a të K.Pr.Penale."* Në vazhdim të arsyetimit të saj, gjyqtarja përmend arsyetimin e vendimit unifikues nr. 1 datë 08.01.2009 të Gjykatës së Lartë lidhur me caktimin e masës së sigurimit, kushtet dhe kriteret, zbatimin e nenit 246/6 të K.Pr.Penale, duke dalë në konstatimin përkatës se në rastin konkret masat e sigurimit duhet të qëndrojnë në fuqi.

Lidhur me veprimtarinë e prokurorit dhe gjyqtarit të gjykatës së rrethit gjyqësor, kërkesës dhe vendimmarrjes përkatëse, konstatohet se është e drejta e prokurorit bazuar në nenin 260/1 të K.Pr.Penale që të bëjë vlerësimin për kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit, dhe

në rast se konkludon se nuk qëndrojnë në drejtim të zbutjes në rastin konkret, të procedojë me aplikimin e nenit 260/1 të K.pr.penale. Në momentin kur nga ana e tij, është vlerësuar mosprovueshmëria e kryerjes së veprave penale nga ana e personit i cili është nën masën e sigurimit, rezulton se nga ana e tij janë përmbushur të gjitha veprimet hetimore dhe për këtë arsye, nga ana e prokurorit duhet të veprohet në kuadër të të drejtës së tij funksionale bazuar në nenin 327 të K.Pr.Penale, duke iu drejtuar gjykatës me kërkesë për pushimin e çështjes në ngarkim të personit nën hetim dhe duke kërkuar edhe revokimin e masës së sigurimit.

Në rastin konkret konstatohet se nga ana e prokurorit nuk ka një zbatim korrekt të dispozitave procedurale si më sipër, gjë që është vënë në dukje edhe nga ana e gjykatës në arsyetimin e vendimarrjes së saj e cila si subjekt procedural nga ana tjetër, ka të drejtën për të shqyrtuar kërkesën për revokimin e masës së sigurimit për të vlerësuar ekzistencën e kushteve dhe kriterëve të masave shtrënguese.

Lidhur me çështjen në fjalë, deri në këtë fazë, është e rëndësishme për t'u evidentuar edhe koha kur është proceduar me dërgimin e dosjes për gjykim në apel, pas ankimit të ushtruar nga ana e prokurorit ndaj vendimit të gjykatës mbi mospranimin e kërkesës për revokim. Kështu, konkretisht rezulton se megjithëse ankimi nga ana e prokurorit është bërë brenda 3 ditëve, njoftimi i këtij ankimi është realizuar pas 6 ditëve pune, dhe më pas dosja është përgatitur për t'u dërguar në apel pas 3 ditëve nga data e njoftimit dhe pikërisht në datën 12.03.2021, si data e fundit e përfundimit të afatit të masës sipas vendimit të gjykatës. Ndërsa në apel, dosja është regjistruar në datë 16.03.2021 kohë kur efektivisht ka përfunduar afati. Referuar këtyre të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 249/3 të Kodit të Procedurës Penale, ku është përcaktuar se *sekretaria e gjykatës që ka dhënë vendimin detyrohet që brenda 3 ditëve nga realizimi i njoftimeve të dorëzohet aktet në gjykatën që do të shqyrtojë ankimin dhe gjykata tjetër, apeli duhet t'a shqyrtojë brenda 10 ditëve nga marrja në dorëzim e akteve*, konstatohet se nuk ka një respektim të këtij afati për dorëzimin e dosjes në Gjykatën e Apelit. Ky afat, edhe pse me jo me pasojë pavlefshmërie, gjithsesi është një afat i detyrueshëm për t'u zbatuar nga gjykatat dhe sekretaritë e tyre. Çdo moszbatim i tyre, pavarësisht nga pasoja në vetvete, është shkelje e ligjit dhe urdhërimeve të tij⁵³.

⁵³ *Vendimi nr. 72 datë 30.06.2003 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Në këtë vendim, gjykata shprehet se: "Ligji parashikon afate të shkurtra kohe për gjykatën e shkallës së parë, lidhur me shqyrtimin e kërkesave të prokurorit për caktim mase sigurimi si dhe për dërgimin e akteve gjykatës së apelit, kur ndaj vendimit bëhet ankim. Për një pjesë nga këto afate të shkurtra procedurale, që parashikohen në seksionin e dytë të titulluar "masat shtrënguese", ligjvënësi ka parashikuar moszbatimin e tyre me pasoja pavlefshmërie, kurse për pjesën tjetër, ai ka vendosur afate, por nuk ka përcaktuar të njëjtat pasoja për moszbatimin e tyre. Rasti i kësaj natyre, gjendet në veç përmbajtjen e nenit 249/3 të K.Pr.P., kur përcaktohet se ankimi kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë së bashku me aktet i dorëzohen gjykatës që do të shqyrtojë ankimin, brenda 5 ditëve. Ndërsa në pikën 5 të nenit 249 të K.Pr.P., i vihet detyrë gjykatës së apelit, që ankimin ta shqyrtojë brenda 10 ditëve nga marrja në dorëzim e akteve. Më tej, në pikën 7 të nenit 249 të K.Pr.P., përcaktohet se kur vendimi nuk shpallet brenda afatit të caktuar, akti në bazë të të cilit është marrë masa shtrënguese e humbet fuqinë.*

Nga analiza që i bën kësaj dispozite, Kolegji Penal arrin në përfundimin se ligjvënësi ka dashur të kufizojë kohën për të proceduar mbi një ankim ndaj një vendimi për masë sigurimi, në dy forma. Së pari, duke e kufizuar sekretarinë

Në K.Pr.Penale e pikërisht në nenin 249 gjejmë të rregulluar të drejtën e ankimit kundër masave të sigurimit. Kështu në bazë të kësaj dispozite prokurori, i pandehuri ose mbrojtësi i tij mund të bëjnë ankim në gjykatën e Apelit (paragrafi 1), dhe kundër vendimit të gjykatës së apelit mund të bëhet rekurs për shkelje të ligjit në Gjykatën e Lartë (paragrafi i 8).

Në vazhdim, kërkesa e ankimit paraqitet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin e ankimuar, e cila detyrohet që brenda 3 ditëve nga realizimi i njoftimit të ankimit, të dorëzojë aktet në gjykatën që do të shqyrtojë ankimin (paragrafi i 3). Kjo kërkesë shqyrtohet brenda 10 ditëve nga marrja në dorëzim e akteve (paragrafi i 4). Pas shqyrtimit të këtij ankimi, Gjykata vendos, sipas rastit, shfuqizimin, ndryshimin ose miratimin e vendimit, edhe për arsye të ndryshme nga ato që janë parashtruar ose nga ato që tregohen në pjesën arsyetuese të vendimit (paragrafi i 6). Kur vendimi nuk shpallet ose nuk zbatohet brenda afatit të caktuar, akti në bazë të të cilit është marrë masa shtrënguese e humbet fuqinë (paragrafi i 7).

Në këtë dispozitë parashikohen disa nga garancitë më thelbësore të garantuar në nenin 6.1 të KEDNJ, të njohura nga jurisprudenca e Komisionit dhe e GJEDNJ për t'u zbatuar në procedimet në rastet e kundërshtimit të paraburgimit në nenin 5.4 të KEDNJ.

Kështu K.Pr.Penale ka vendosur afate për shqyrtimin e ankimit, duke parashikuar njëkohësisht se në rast dështimi të këtij shqyrtimi masa shtrënguese e humbet fuqinë. Nëpërmjet këtij parashikimi ligjvënësi ka dashur të kufizojë kohën për të proceduar mbi një ankim ndaj një vendimi për masë sigurimi në dy forma : së pari duke e kufizuar sekretarinë gjyqësore të shkallës së parë, që brenda 3 ditëve pas realizimit të njoftimit të ankimit, të depozitojë aktet në sekretarinë e gjykatës së apelit që do ta shqyrtojë atë; së dyti të kushtëzojë gjykatën e apelit që brenda 10 ditëve nga marrja në dorëzim e akteve, të shqyrtojë kërkesën, dhe jo vetëm atë, por edhe të shpallë vendimin e saj. Pra, nga kjo gjykatë, brenda 10 ditëve duhet të caktohet trupi gjyqësor, të caktohet data e seancës, të bëhet shpallja e saj dhe të njoftohen palët lidhur me këtë, të zhvillohet gjykimi, të vendoset lidhur me sa kërkohet dhe të shpallet vendimi. Në qoftë se një gjë e tillë nuk realizohet brenda këtij afati kohor, sjell si rezultat humbjen e fuqisë së masës shtrënguese të caktuar. *Siç shikohet vetëm*

gjyqësore të gjykatës së shkallës së parë, që brenda 5 ditëve të paraqitjes së kërkesës ankimore, të depozitojë aktet në sekretarinë e gjykatës së apelit që do ta shqyrtojë atë. Së dyti, të kushtëzojë gjykatën e apelit që brenda 10 ditëve nga marrja në dorëzim e akteve, të shqyrtojë kërkesën, dhe jo vetëm atë, por edhe të shpallë vendimin e saj. Pra, kjo gjykatë, brenda 10 ditëve duhet të caktojë trupin gjyqësor, të caktohet data e seancës, të bëhet shpallja e saj dhe të njoftohen palët lidhur me këtë, të zhvillohet gjykimi, të vendoset lidhur me sa kërkohet dhe të shpallet vendimi. Në qoftë se një gjë e tillë nuk të realizohet brenda këtij afati kohor, sjell si rezultat humbjen e fuqisë së masës shtrënguese të caktuar, sikurse parashikon neni 249/7 i K.Pr.P.

Lidhur me afatin 5 ditor të kalimit të akteve nga njëra gjykatë tek tjetra, ligjvënësi ka dashur të kufizojë në kohë dhe të shpejtojë procedurat për gjykimin e ankimit ndaj masave të sigurimit, por gjithsesi, këtë ai, nuk e ka lidhur me pasojë pavarëshmërie e për pasojë, edhe me shuarje të masës së sigurimit. Afatet procedurale, edhe pse nuk parashikohen me pasojë pavarëshmërie, janë vënë për t'u zbatuar nga gjykatat dhe sekretariatë e tyre, dhe jo për tu vlerësuar nga pasojat që sjell moszbatimi i tyre. Çdo moszbatim i tyre, pavarësisht nga pasoja në vetvete, është shkelje e ligjit dhe urdhërimeve të tij"

mosrespektimi i afatit 10 ditor nga ana e gjykatës së apelit, shoqërohet me pasojë humbjen e fuqisë së masës shtrënguese, ndërsa nuk e gjejmë edhe tek afati tjetër 3 ditor që duhet të respektohet nga sekretaria e gjykatës së rrethit gjyqësor që është një element i rëndësishëm në respektimin e qëllimit të kësaj garancie – për të kufizuar në kohë dhe të shpejtojë procedurat për gjykimin e ankimit ndaj masave të sigurimit.

4. Lidhur me kërkesën e prokurorit për shuarje të masës së sigurimit, konstatohet se kjo kërkesë e titulluar “për konstatimin e shuarjes së masës së sigurimit” rezulton të jetë në përshkrim e njëjtë me kërkesën për revokim, përveç konkludimit para dispozitivit për shkak të ndryshimit të dispozitës përkatëse ku referohet dhe ku është arsyetuar se: *“Në kushtet ku është e provuar se personi nën hetim A. D. nuk ka kryer veprë penale dhe duke qenë se ka mbaruar edhe afati i mbajtjes në burg të personit nën hetim, afat ky i caktuar nga gjykata në vendimin e saj, në mbështetje të nenit 261 të K.Pr.Penale”* kërkohet konstatimi i shuarjes së masës së sigurimit.

Një kërkesë e tillë e prokurorit, vlerësohet se nuk është në përputhje me parashikimet ligjore, sipas parashikimeve të nenit 261/1/ç të K.Pr.Penale. Referuar kësaj dispozite, një masë sigurimi e humbet fuqinë e saj nëse pas mbarimit të afatit të parashikuar nga gjykata, nuk është urdhëruar përsëritja e saj brenda kufijve të parashikuar nga nenet 264 dhe 267 të K.Pr.Penale. Konstatohet se gjykata ka vendosur si afat përfundim të masës së sigurimit “arrest në burg” datën 12.03.2021 ndërkohë që prokurori e ka paraqitur kërkesën më datë 11.03.2021, dhe si e tillë nuk jemi në kushtet e zbatimit të kësaj dispozite nga ana e prokurorit. Duhet theksuar se nga ana e prokurorit, përkundrejt qëndrimit të gjykatës lidhur me kërkesën e tij për revokimin e masës së sigurimit, ishte bërë ankimi dhe nga ai duhej të pritej sipas procedurës vendimmarrja e gjykatës së apelit. Për më tepër, që nga ana e prokurorit, duke e lidhur edhe me kërkesën e mëparshme për revokim të tij që para 1 muaji, në kushtet kur ai kishte dalë në një konkluzion se nga ana e personit nën hetim me masë sigurimi, nuk ishte përdorur armë në ngjarjen në Ijalë, konform nenit 327 të K.Pr.Penale duhej të ishte proceduar konform detyrimeve të tij funksionale si organi kompetent për ushtrimin e ndjekjes penale me përfundimin e hetimeve, njoftimin e vendimit të pushimit të çështjes për nenin 89 të K.Penal duke qenë se është kundravajtje dhe me kërkesën përkatëse drejtuar gjykatës për pushimin e çështjes në ngarkim të këtij shtetasi për krimin e parashikuar nga neni 278/1 i K.Penal, ku të kërkohej edhe shuarja e masës së sigurimit referuar nenit 261/1/a të K.P.Penale.

Lidhur me vendimin e gjykatës, rezulton se gjyqtari në pjesën përshkruese –arsyetuese pasi ka përshkruar rrethanat e faktit, vendimmarrjet e gjykatës për caktimin e masës së sigurimit dhe arsyet e vendosjes me afat të këtyre kërkesave, ka kaluar në rezultatet e veprimeve hetimore të kryera dhe kërkesën e prokurorit ku shprehet edhe qëndrimi i tij lidhur me moskryerjen e veprës penale nga ky person dhe kalimin e afatit të masës së sigurimit me afat. Në pjesën ku është vlerësimi i gjykatës, gjyqtari citon nenin 261 të K.P.Penale, interpreton këtë në aspektin teorik lidhur me masën e sigurimit “arrest në burg” dhe pastaj kalon në arsyetimin e aplikimit të saj në rastin konkret ku argumenton faktin se deri në datë 12.03.2021 nga prokurori nuk është kërkuar përsëritja e masës

së sigurimit, dhe për më tepër që prokurori i është drejtuar gjykatës me kërkesë për shuarje të masës së sigurimit. Gjykata shton në këtë argumentim, se në kushtet e shuarjes së kësaj mase për shkak të kalimit të afateve ligjore dhe në kushtet kur prokuroria nuk ka kërkuar caktimin e një mase të re sigurimi, gjykata nuk mund të disponojë në caktimin e një të tillë kryesisht. Dhe mbi bazën e këtij argumentimi nga ana e gjykatës është vendosur pranimi i kërkesës së prokurorit për shuarjen e masës së sigurimit dhe lirinë e menjëhershëm të tij.

Lidhur me çmuarjen e gjykatës⁵⁴, për shuarjen e masës së sigurimit “arrest në burg” me afat të vendosur në vendimin e datës 11.02.2021, duke iu referuar konfuzionit të periudhës së afatit të vendosur të sipërpërmendur nga gjykata në vendimin e caktimit të masës së sigurimit⁵⁵, konstatohet se nga ana e gjykatës është vendosur për shuarjen e masës në një ditë të mesme – që është një ditë para përfundimit të afatit 30 ditor dhe një ditë pas afatit 12.03.2021. Lidhja me këtë datë, duke qenë se është favorizuese në drejtim të kohës dhe duke qenë se bëhet fjalë për privimin e lirisë së personit, vlerësohet si e drejtë. Por referuar këtij arsyetimi të gjykatës, duke e lidhur përfundimin e afatit me datën 12.03.2021 ora 11.00, konstatohet se sipas orës së regjistrimit dhe kalimit të praktikës gjyqtarit që është data 11.03.2021 ora 10:18:21, datës së vendimmarrjes së gjykatës data 13.03.2021 ora 09:40, nga ana e gjykatës me zhvillimin e seancës më datë 13.03.2021 është cënuar liria e personit nën hetim, pasi rezulton që ai të jetë mbajtur në burg pa arsye të paktën 21 orë. Përsa i përket pjesës arsyetuese lidhur me shuarjen e masës⁵⁶, duke e lidhur me arsyetimin e përdorur lidhur me datën 12.03.2021, konstatohet se gjykata me të drejtë ka konstatuar faktin se në gjykatë nuk ka një kërkesë për përsëritje të masës së sigurimit “arrest me burg”, sipas parashikimeve të nenit 261/1/ç të K.Pr.Penale, dhe duke e lidhur këtë edhe me kërkesën e prokurorit të një date të mëparshme, por vlerësohet se në dispozitiv nga ana e gjykatës nuk mund shprehej për pranimin e kërkesës së prokurorit. Kjo për shkak se sipas arsyetimit edhe më sipër, prokurori e ka bërë kërkesën një ditë para se të përfundonte afati i masës së sigurimit “arrest në burg”.

Një çështje tjetër që rezulton lidhur me gjykimin e çështjes lidhur me kërkesën e prokurorit për shuarjen e masës së sigurimit, është edhe konstatimi i aktit se çështja është shqyrtuar nga një gjyqtar tjetër, i ndryshëm nga gjyqtari që ka shqyrtuar tre kërkesat e mëparshme dhe lidhur me këtë ndryshim ka një shënim në sistem nga zv/kryetari se: *“gjyqtari i hetimeve e ka të pamundur të kryej gjykimin sot, dhe nesër me datë 12.03.2021 i fillon leja e miratuar nga zv/kryetari i gjykatës.”*

⁵⁴ Vendimmarrja e gjykatës, konstatohet se është pa orë, por sipas procesverbalit të seancës rezulton të jetë shpallur më datë 09.40.

⁵⁵ Vendimi datë 11.02.2021, të gjyqtares, për caktimin e masës së sigurimit të dytë, me afat. Kështu referuar datave 12.02.2021 ora 11.00 deri 12.03.2021 rezulton se janë 28 ditë, dhe jo 30 ditë siç është përcaktuar si afat, çka krijon konfuzion në përlllogaritjen e datës lidhur me ecurinë e mëtejshme të procedurave.

⁵⁶ Përsa shikohet nga vendimi gjyqësor.

Referuar parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale dhe konkretisht nenit 278/2 të K.Pr.Penale, kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar. Në mungesë të dosjes gjyqësore dhe informacionit të sistemit të sipërcituar, nuk mund të vlerësohet respektimi i kriterëve për ndryshimin e gjyqtarit, lidhur me çështjen në fjalë e cila rezultonte deri në këtë gjykim të ishte në fazën e hetimeve paraprake. Nuk kemi të dhëna nëse nga ana e gjyqtarit që ka shqyrtuar tre kërkesat e mëparshme, të ketë një shprehje vullneti lidhur me pamundësinë e shqyrtimit të kësaj çështje në ditën që ishte në punë dhe as brenda afatit datë 13.03.2021 që nuk përfshihet në lejen e zakonshme dhe kur rezultoi të jetë gjykuar nga gjyqtari zëvendësues. Por referuar afatit të shkurtër që parashikohet për shqyrtimin e këtyre kërkesave sipas nenit 261 të K.Pr.Penale, 48 orë sipas paragrafit 3, si dhe nisur nga shkaku i paraqitur sipas të dhënave të hedhur në sistem, vlerësohet se nuk krijohet bindja mjaftueshëm se nga ana e gjyqtarit ka qenë e arsyeshme mosvazhdimi i shqyrtimit të kësaj çështje dhe zëvendësimi i tij me një gjyqtar tjetër. Kështu rezultoi se kërkesa e prokurorit është paraqitur më datë 11.03.2021 ora 10:16:18 dhe gjyqtari ka qenë në detyrë, pasi planifikimi i tij për lejen përfshinte datën 12 mars, dhe në datat 16-19 mars 2021 dhe në këto kushte gjykimi nëse ishte e pamundur për t'u realizuar në datën 12 mars mund të zhvillohej më datë 13 mars brenda afatit 48 orë të parashikuar për këto lloj masash. Është e rëndësishme të theksohet se zëvendësimi i përkohshëm që vendos kryetari sipas parashikimeve të ligjit me nr. 96/2016⁵⁷ bëhet duke vlerësuar pamundësinë e gjyqtarit për të marrë pjesë në gjykim dhe si e tillë bëhet pengesë për shqyrtimin e një çështje, siç është rasti i gjykimeve të tilla për të cilat afati është i shkurtër. Por gjithmonë nga ana e kryetarit duhet të bëhet një vlerësim i kujdesshëm në respektim të vlerave themelore të magjistratit në ushtrimin e funksioneve të tij nga njëra anë dhe ruajtjes së reputacionit të organeve të drejtësisë dhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor nga ana tjetër. Gjyqtari nga ana tjetër që kërkon të zëvendësohet, duhet të vlerësojë se ushtron funksionet e tij, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin, dhe duhet t'i ushtrojë ato në mënyrë korrekte, në kohë të arsyeshme, të ndërjegjshme, të kujdesshme, të zellshme dhe sistematike⁵⁸.

V. Rasti i çështjes ku nga ana e prokurorit është vlerësuar kërkimi i masës së sigurimit “ndalimi për të dalë jashtë shtetit” dhe “detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore”, dhe nga ana e gjykatës është pranuar kjo kërkesë.

Rasti i përket zyrës së Prokurorisë Shkodër, lidhur me procedimin penal nr. 218 datë 03.03.2021, ku është kërkuar caktimi i masës së sigurimit “ndalimi për të dalë jashtë shtetit” dhe “detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore”, ndaj të dyshuarit D.J. për kryerjen e veprës penale të “Plagosja e lehtë me dashje” dhe “Mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit” të parashikuar nga nenet 89 e 278/1 të K.Penal.

Fakti penal lidhet me ngjarjen e ndodhur në datën 18.02.2021, rreth orës 12:30 në lagjen “Qemal Stafa” në Parrucë të qytetit Shkodër, ku shtetasi D.J. ka goditur me një send të fortë shtetasin K.B. teksa ky i fundit ndodhej në dyqanin e tij. Nga pamjet filmike të regjistruara nga kamerat e sigurisë

⁵⁷ Neni 80/1/d i ligjit.

⁵⁸ Neni 3 i ligjit me nr. 96/2016.

së dyqanit të shtetasit K.B., rezulton se ai është goditur me një send që autori e ka nxjerrë nga brezi, në dukje pistoletë (përdorur si mjet mekanik). Në datën 25.03.2021 policia gjyqësore ka ndaluar me iniciativë shtetasin D.J. dhe nga ana e prokurorisë është regjistruar procedimi penal për veprat penale të parashikuar nga neni 89 dhe 278/1 i K.penal.

Prokurori në kërkesën e tij, pasi ka kërkuar vlefhtësimin e ndalimit, ka kërkuar edhe caktimin e dy masave të sigurimit të sipërmendura, duke vlerësuar se ka të dhëna të mjaftueshme për kryerjen e veprës penale të "Plagosjes së lehtë me dashje" të parashikuar nga neni 89 i K.Penal dhe mbetet e paprovuar vepra penale e parashikuar nga neni 278/1 i K.Penal. Kërkesa është regjistruar në gjykatë më datë 27.03.2021 dhe brenda afatit ligjor më datë 28.03.2021 është zhvilluar seanca, ku nga ana e prokurorit është mbajtur i njëjti qëndrim si kërkesa me shkrim dhe nga mbrojtja është kërkuar moscaktimi i asnjë mase sigurimi. Pas përfundimit të shqyrtimit të kësaj kërkesë, më datë 28.03.2021 nga ana e gjyqtarit të caktuar, Gjykata e rrethit gjyqësor Shkodër, është vlefhtësuar ndalimi dhe caktuar masat e sigurimit të kërkuar nga ana e prokurorit.

Nga trajtimi i rastit në fjalë, lidhur me proporcionalitetin e masave të sigurimit të propozuar nga ana e prokurorit, konstatohet se nga ana e prokurorit arsyetimi është mbështetur pikërisht në kriteret ligjore të parashikuar në nenn 229 të K.Pr.Penale. Në funksion të analizës së elementëve vlerësues të përshtatshmërisë dhe nevojave të sigurimit, prokurori arsyeton duke i lidhur me rrethanat konkrete lidhur me faktin penal, duke identifikuar nëpërmjet tyre edhe llojin e masave të sigurimit të propozuar. Kështu më konkretisht, prokurori arsyeton se: *"Vepra penale për të cilën dyshohet i ndaluar ka cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për të garantuar rendin dhe sigurinë publike dhe jetën e shëndetin e personave, marrëdhënie këto të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal, nga veprimet ose mosveprimet kriminale. Lloji dhe masa e dënimit që parashikojnë dispozitat e Kodit Penal, për veprat penale të parashikuara nga nenet 89 dhe 278/1 të K.Penal, dënohen në maksimum deri në 7 vjet burgim. Duke mbajtur parasysh përshtatshmërinë e masës së sigurimit: me shkallën e nevojave të sigurimit; me rëndësinë e faktit; mekanizmin e kryerjes së veprës penale, rrezikshmërinë relative të veprave penale dhe rrezikshmërinë e autorit të tyre, faktin që vepra penale është kryer pas debateve të mëparshme, faktin që të ndaluarit nuk i është sekuestruar armë zjarri me vehte apo në mjetin e drejtuar prej tij apo në banesë, nuk është fiksuar armë zjarri dhe nuk ka prova të mjaftueshme në lidhje me këtë vepër penale, ndërsa ajo e parashikuar nga neni 89 i K.penal, ndiqet me ankimin e të dëmtuarit dhe akoma nuk i është marrë ankim apo heqje dorë nga ankimi, faktin që i dyshuari është larguar nga vendi i ngjarjes dhe fshehur dhe ekziston rreziku që ai të fshihet përsëri, ka mbajtur një qëndrim pjesërisht mohues të tij, faktin që dyshohet se vepra është kryer me qëllim hakmarrje, marrëdhëniet mes palëve nuk janë normalizuar, faktin që ekziston rreziku që i dyshuari të largohet dhe t'i fshihet drejtësisë dhe sanksionin që parashikohet për këtë vepër penale (me burgim deri në 7 vjet). Në rastin konkret çmohet se masat e sigurimit "Ndalim i daljes jashtë shtetit" dhe "Detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore", të parashikuara nga nenet 233 dhe 234 të K.Pr.Penale, plotësojnë nevojat e sigurimit. Mbështetur në sa u tha më sipër dhe në bazë të neneve 228, 229, 233-234, 244, 258 dhe 259 të Kodit të Procedurës Penale: KËRKOJ: ..."*

Referuar këtij arsytimi të prokurorit, vlerësohet se në rastin konkret qëndrimi i prokurorit duhet të jetë i qartë nëse ekziston ende apo mungon dyshimi i arsyeshëm për kryerjen e veprave penale, për të cilën nga ana e tij si prokuror është kërkuar masa e sigurimit, pasi rasti i dytë do të çonte në mosçaktimin e masave të sigurimit. Prokurori në kërkesë nga njëra anë arsyeton se nuk ka prova të mjaftueshme në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 278 i K.Penal (pasi nuk i është gjetur në banesë/në automjet/me vehte) dhe nga ana tjetër e mbështet kërkesën për masë sigurimi në faktin dhe sanksionin që i referohet të njëjtës vepër penale, e cila është edhe vepra penale që vazhdon t'i atribuohet personit ndaj të cilit kërkohet masa e sigurimit sipas urdhërit të regjistrimit të procedimit penal. Qëndrimi i qartë lidhur me dyshimin e arsyeshëm është i rëndësishëm për t'u vlerësuar dhe përshtatshmëria e masës së sigurimit, qoftë edhe ato të kërkuara në rastin konkret, në kuptimin që ajo të kërkohet vetëm mbi bazën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova për veprën penale konkrete, pa krijuar konfuzion me nivelin e provave që duhet të ekzistojnë në fakt për ta krijuar atë. Gjithashtu, prokurori shprehet se për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i K.Penal që ndiqet me ankimin e të dëmtuarit, këtij të fundit nuk i është marrë ankim apo heqje dorë nga ankimi. Në nenin 228 të K.Pr.Penale në të cilën janë përcaktuar kushtet që duhet të plotësohen për çaktimin e masave të sigurimit personal, në pikën 1 është theksuar kushti i rëndësishëm sipas të cilit askush nuk mund t'u nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova. Sipas kësaj dispozite, për çaktimin e masave të sigurimit personal, përfshirë edhe atë të arrestit në burg duhet që, në ngarkim të personit ndaj të cilit kërkohet të merret kjo masë, të ekzistojë jo çfarëdolloj dyshimi, por një dyshim i arsyeshëm dhe, në të njëjtën kohë, ky dyshim, duhet të jetë i bazuar në provat që janë administruar në fashikullin e procedimit penal në ngarkim të një personi, në formën e kërkuar nga ligji, deri në momentin e marrjes së vendimit për çaktimin e kësaj mase. Këto prova duhet të tregojnë se është kryer një vepër penale dhe se autori i saj mund të jetë personi ndaj të cilit kërkohet çaktimi i masës së sigurimit⁵⁹. Ky është një qëndrim i vazhdueshëm që është mbajtur edhe në praktikën gjyqësore, siç rezulton nga ajo e Gjykatës së Lartë edhe me anë të vendimeve unifikuese⁶⁰ dhe që është plotësisht në përputhje me interpretimin që i bëhet nga GJEDNJ. Gjithashtu në drejtim të nivelit të provave, ashtu siç është pranuar edhe nga praktika e Gjykatës së Lartë, këto prova duhet të jenë të tilla që të mos vënë në dyshim ekzistencën e veprës penale. Ky i fundit është një kusht i rëndësishëm mbi bazën e të cilit fillon një procedim penal, që është hapi i parë për të vazhduar më tej me nevojën për kërkimin e masës së sigurimit⁶¹. Po kështu, në vijim të këtij niveli provave, Gjykata e Lartë ka mbështetur qëndrimin se provat mbi bazën e të cilave mbështetet dyshimi i arsyeshëm, duhet të ekzistojnë në fakt dhe nuk mund të jenë të dyshimta në

⁵⁹ Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 245 datë 04.11.2009, nr. 173 datë 14.07.2009

⁶⁰ Vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë me nr. 3/2009, nr. 7/2011.

⁶¹ Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë me nr. 308 datë 17.12.2008 – në këtë vendim Gjykata është shprehur se: "... gjykatat pranojnë në vendimet e tyre se më datën 17.09.2008, në fshatin Skuraj në afërsi të lumit Mat, shtetasi E.P. është kapur nga punonjësit e policisë duke prerë me gur fleksibël një shtyllë metalike të tenksionit të lartë, jo funksionale, me konstruktion hekur. Neni 156 i K.Penal parshikon si vepër penale shkatërrimin apo dëmtimet e tjera me dashje të rrjetit elektrik, apo të çdo rrjeti ndërlidhës, gjë që në rastin në shqyrtim nuk ekziston, sepse shtylla ka qenë jashtë funksionit të rrjetit elektrik, gjë që ka të bëjë me ekzistencën e veprës penale. ..."

vetvete.⁶² Referuar këtij kuptimi, nëse prokurori nuk ka prova ose ekzistenca e provave është e dyshimtë ndaj personit nën hetim nuk mund të kërkohej caktimi i një mase sigurimi për veprën penale të parashikuar nga neni 278 i K.Penal, për shkak të mungesës së kushtit të domosdoshëm të parashikuar nga neni 228/1 i K.Pr.Penale.

Po kështu edhe lidhur me veprën penale të parashikuar nga neni 89 i K.Penal, vetë prokurori në kërkesën e tij pranon faktin se i dëmtuari nuk ka paraqitur ankim dhe si e tillë referuar nenit 284 të K.Pr.Penale, për këtë veprë penale nga prokuroria nuk mund të vendosej regjistrimi i procedimit penal. Neni 284/1 i K.Pr.Penale parashikon shprehimisht se: *"Për veprat penale të parashikuara nga nenet ... 89, ... të Kodit Penal, ndjekja penale mund të fillojë vetëm me ankimin e viktimës, i cili mund t'a tërheq atë në çdo fazë të procedimit."* Për rrjedhojë për sa kohë prokurori nuk mund të fillojë ndjekjen penale për veprën penale në fjalë, nuk mund të kërkojë masë sigurimi, megjithëse pas mbi një muaj nga koha e ngjarjes, prokurori ende nuk ka mundur të marrë ankimin/vullnetin e viktimës për të proceduar në lidhje me këtë veprë penale.

Por pavarësisht kësaj, konstatohet se nga ana e gjykatës, është mbajtur i njëjti qëndrim si prokurori në vendimmarrjen e saj, duke pranuar ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm për të dy veprat penale të parashikuar nga neni 89 dhe 278/1 i K.Penal. Konstatohet se në vendim nuk ka një arsyetim të qartë lidhur me faktin sesi identifikohen rrethanat, të dhënat e grumbulluar deri në këtë fazë të gjyqimit që krijojnë dyshimin e arsyeshëm dhe gjithashtu lidhur me kushtet e tjera të përgjithshme dhe të veçanta, konstatohet se ka një moskoherencë në arsyetim. Të njëjtën gjë edhe lidhur me proporcionalitetin e masës së sigurimit. Gjykata shprehet: *"Në rastin konkret meqenëse janë kushtet dhe kriteret e parashikuara nga neni 228 dhe 229 i Kodit të Procedurës Penale, kjo gjykatë pranoi dhe kërkesën për t'i caktuar një masë sigurimi personal shtrëngues, duke çmuar si të përshtatshme masën e sigurimit të kërkuar nga organi i akuzës, kjo bazuar në nenin 244/3 të Kodit të Procedurës penale. ... Rezulton se vepra penale për të cilën dyshohet shtetasi D.J, e parashikuar nga neni 89 dhe 278/1 i K.Penal, është një veprë që parashikon një sanksion të lartë. Pra vepra penale ka një rrezikshmëri shoqërore të lartë. ... në rastin objekt gjykimi, duke qenë se vepra penale është e rëndë, krijohet dyshimi se i dyshuari duke qenë i lirë mund të zhdukë apo të shrembërojë provat. ... Duke lu kthyer rastit objekt gjykimi, lidhur me personalitetin e të dyshuarit, rezulton se ai është i moshës 29 vjeç, pra në atë moshë të rritur sa të kuptojë pasojat e veprës penale, i padënuar më parë. Këto rrethana flasin për një rrezikshmëri jo të lartë shoqërore të të*

⁶² Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë me nr. 311 datë 17.12.2008, ku gjykata shprehet se: *"Nga arsyetimi i vendimeve të gjykatave të faktit, del qartë se prej tyre ka një konfundim në aplikimin e nenit 228/1 të K.Pr.Penale. Kjo dispozitë kërkon si kusht bazë për krijimin e "dyshimit të arsyeshëm" ekzistencën e një ose më shumë provave, që tregojnë se është kryer një veprë penale dhe se autori i saj mund të jetë personi ndaj të cilit kërkohet caktimi i masës së sigurimit. Ndërkohë konstatohet lehtësisht se ndryshe nga ç'ka kërkon dispozita e mësipërme, gjykatat e faktit, arsyetimin e vendimeve të tyre e bazojnë mbi dyshime për ekzistencën e provave. Është e qartë se dyshimi lidhur me ekzistencën e një prove është pjesë që lidhet me procesin e të provuarit gjatë hetimit paraprak, por kurrësi dyshimi nëse ekziston ose jo një provë nuk mund të jetë "dyshim i bazuar në prova", sipas kuptimit të dispozitës së nenit 228/1 të K.Pr.Penale."*

dysshuarit, por rrethanat e tjera të sipërcituara nga gjykta, duhen marrë parasysh në caktimin e masës së sigurimit dhe gjykta çmon se justifikojnë marrjen e një mase sigurimi personal siç është ajo e kërkuar nga organi i akuzës dhe asnjë masë tjetër nuk mund të jetë e përshtatshme. ...”

VI. Për rastin e çështjes për të cilën masa e sigurimit “arrest në burg” për një të mitur është vlerësuar si proporcionale.

Rasti i përket zyrës së prokurorisë Shkodër, lidhur me procedimin penal me nr. 621 datë 27.06.2021⁶³, ku është kërkuar caktimi i masës së sigurimit “arrest në burg” ndaj të miturit në konflikt me ligjin E.Y, krahas një të rrituri H.V., të dysshuar të dy për kryerjen e veprës penale “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese” dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit” të parashikuara nga neni 79/dh e 25 dhe 278/1 të K.P.

Fakti penal⁶⁴ lidhet me gjuajtjen me armë zjarri pas një konflikti mbi ndarjen e shezlloneve në plazh, midis anëtarëve të dy familjeve, dhe për pasojë kanë ngelur të vrarë katër shtetas. Për këtë ngjarje është bërë arrestimi në flagrancë i dy personave, ndër të cilët edhe një i mitur, për veprën penale “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese” dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit” të parashikuara nga neni 79/dh e 25 dhe 278/1 të K.Penal.

Nga ana e prokurorit në kërkesën e tij, pas vlerësimit për ligjshmërinë e arrestimit në flagrancë, është vlerësuar që në rastin konkret masa e sigurimit më e përshtatshme për të dy personat nën hetim është “arrest në burg”.

Kërkesa është regjistruar si çështje në Gjykatë duke u caktuar gjyqtari, i cili ka caktuar seancën në datën 01.07.2021. Në këtë seancë prokurori ka mbajtur të njëjtin qëndrim, ndërsa nga ana e mbrojtësit të të miturit është kërkuar lënia në çmim të gjykatës lidhur me vleftësimi e arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së arrestit në shtëpi, me afat, si dhe mbrojtja e personit tjetër nën hetim ka kërkuar vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit të “arrestit në burg” me afat.

⁶³ Për këtë rast është administruar vetëm kërkesa e prokurores, vendimi i gjykatës së rrethit gjyqësor dhe i Gjykatës së Apelit.

⁶⁴ Fakti penal për të cilin është referuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër lidhet me ngjarjen e ndodhur në datën 27.06.2021, rreth orës 00:35, në Velipojë, vendin e quajtur Pulaj-Plazh dhe konkretisht oborrin e lokal “G.” ku janë gjetur të vrarë shtetasit K.V., E. G., Nh. G., dhe M. Z... Gjithashtu pas informacionit të marrë se në Spitalin Rajonal Shkodër, kanë shkuar të plagosur shtetasit H.V. dhe i mituri E.Y, të cilët pasi janë mjekuar janë nisur me urgjencë në Spitalin Ushtarak Tiranë, për mjekim të specializuar. Sipas të dhënave paraprake ngjarja ka ndodhur për motive të dobëta, për ndarjen e shezllonëve në plazh. Anëtarët e familjes Verracaku kanë shkuar për sqarime në lokalin e vëllezërve G. Gjatë debatit është qëlluar me armë nga të dyja palët. Fakti se në vendngjarje është qëlluar nga disa persona konfirmohet nga numri, lloji dhe modeli i gëzhojave që janë gjetur në vendin e ngjarjes, ku dyshohet se janë përdorur të paktën 4 lloje armesh. Përveç të arrestuarve në flagrancë H. V. dhe të miturit në konflikt me ligjin E. D., në vendngjarje kanë qenë dhe shtetasit A., A. dhe Sh.V., të shpallur në kërkim.

Ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim i mituri në konflikt me ligjin E.D. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 183, datë 02.08.2021 ka vendosur miratimin e vendimit nr. 324 (3556), datë 01.07.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me ndryshimin që ndaj të miturit në konflikt me ligjin të caktohet si masë sigurimi shtrënguese "Vendosja e të miturit në mbikëqyrje" parashikuar nga neni 82/1/a i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, duke urdhëruar lirimin e menjëhershëm të tij.

Nga trajtimi i rastit konkret, në drejtim të proporcionaliteti të masës së sigurimit konstatohet se sipas kërkesës së prokurorit nuk ka një arsyetim konkret lidhur me kriteret, sesi këto kriteret janë identifikuar nga rrethanat në faktin konkret dhe në drejtim të individualizimit të nevojave të sigurimit për secilin të arrestuar për të cilën drejtohet kërkesa për cakimin e masës së sigurimit. Për më tepër që njëri prej të arrestuarve është person i mitur. Kështu prokurori pasi arsyeton mbi kushtet e parshikuar në nenin 228 të K.Pr.penale, shprehet se: *"Masa e sigurimit e kërkuar prej nesh është në përshtatshmeri të plotë me shkallën e nevojave të sigurimit në rastin konkret, si dhe në raport të drejtë me sanksionin që parashikohet për veprat penale për të cilat dyshohen dy të arrestuarit. Çdo masë tjetër sigurimi e ndryshme nga arresti në burg është e papërshtatshme për shkak të rrethanave të cituara më lart, rrezikshmërisë së veprave penale dhe autorëve të dyshuar për kryerjen e tyre, qëndrimin të të dyshuarve në raport me ngjarjen në fjalë, pasojës së rëndë që ka ardhur. Nisur nga sa më sipër përfundimisht i kërkojmë gjykatës."* Në këtë arsyetim, nga ana e prokurores evidentohet mosargumentimi lidhur edhe me kushtet për vendosjen e arrestit në burg për të miturin, referuar parashikimeve përkatëse në Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturin. Nga ana e prokurores vendoset baza ligjore e parashikuar nga nenet 258/1 dhe 244/1 të K.Pr.Penale.

Edhe në vendimin e gjykatës, konstatohet si edhe tek prokurori një arsyetim i përgjithshëm në drejtim të kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për caktimin e një mase sigurimi, si dhe duke mos individualizuar nevojat e sigurimit për secilin të arrestuar ndaj të cilëve drejtohet kërkesa. Kështu në vendimin e saj, gjykata shprehet se: *"Për sa i përket kërkesës së prokurorisë për caktimin e masës së sigurimit personal, gjykata në vendimin e saj mbajti parasysh nenin 27 dhe 28 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, gjykata, bazuar në nenet 228 dhe 229 të K.Pr.Penale, sipas të cilëve askush nuk mund t'i nënshtrohet një mase sigurimi personal në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova. ...Gjykata, referuar nenit 229 të K.Pr.P, që përcakton kriteret për caktimin e masës së sigurimit personal, sipas të cilit gjykata në caktimin e masës së sigurimit personal duhet të mbajë parasysh, përshtatshmerinë e masës, me shkallën e sigurimit që kërkohet në rastin konkret. Gjithashtu masa duhet të jetë në rraport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Kështu, referuar rëndësisë së cënimit të marrëdhënieve konkrete të cënuara, të mbrojtura posaçërisht nga ligji penal, dispozitat e kodit kanë parashikuar dënime të caktuara. Në cakimin e masës së sigurimit gjykata duhet të mbajë parasysh dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuar nga Kodi Penal, vazhdimësinë e kryerjes së veprës penale si dhe përsëritjen. Referuar rrezikshmërisë së veprave penale, masës së dënimit që parashikohet për këto vepra penale (jo më pak se 25 vjet ose burgim të përjetshëm për veprën penale ... të parashikuar nga neni 79/dh-25 të Kodit Penal dhe nga 5 deri në 7 vjet për veprën penale "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve*

luftarake dhe e municionit" parashikuar nga neni 278/1 të Kodit Penal), rrezikshmërinë shoqërore të të arrestuarve, faktin se ata nuk e pranojnë faktin e ndodhur. Gjykata konkludon se masa e sigurimit personal e kërkuar nga organi i akuzës "Arresti në burg", parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale është masa më e përshtatshme referuar rastit konkret dhe asnjë masë tjetër nuk mund t'i plotësojë nevojat e sigurimit. Pretendimi i mbrojtjes se ndaj personit nën hetim dhe të miturit në konflikt me ligjin duhet të caktohet një masë sigurimi me afat dhe më e butë për të miturin, nuk qëndron, kjo pasi, siç u arsyetua edhe më sipër referuar rrezikshmërisë së veprës penale, masës së dënimit që parashikohet për këtë vepër penale (vetëm me burgim), faktin se të arrestuarit kanë mbajtur qëndrim mohues ndaj faktit të ndodhur, gjykata çmon se të arrestuarit paraqesin rrezikshmëri të tillë për vendosjen e masës së sigurimit personal më të rëndë atë "Arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale. hetimet në rastin konkret janë komplekse dhe në këtë moment nuk është e mundur të caktohet një masë sigurimi me afat." Në këtë arsyetim, nga ana e gjyqtarit evidentohet mosargumentimi lidhur edhe me kushtet për vendosjen e arrestit në burg për të miturin, referuar parashikimeve përkatëse në Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturin. Nga ana e gjyqtarit vendoset baza ligjore e parashikuar nga nenet 238, 244, 258 dhe 259 të K.Pr.Penale.

Vendimi është i periudhës gusht të vitit 2021, jashtë periudhës së vendosur për inspektim dhe si e tillë, përmendet në kuadrin e një informacioni sa më të plotë lidhur me rastin konkret⁶⁵.

⇒ Nga 24 kërkesat, në 9 prej tyre, kërkesa e prokurorit ka qenë e lidhur me gjetjen e armës së zjarrit kryesisht automatik e fishekë në banesë, e shoqëruar edhe me gjetjen në banesë e ambiente publike edhe të lëndës narkotike, si dhe gjithashtu edhe me vepra të tjera penale si kultivimi i bimëve narkotike, kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit. Vepra penale e "Mbajtjes pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit" është kualifikuar në këto raste si pas neneve 278/2, 278/3, 278/3.4, 278/1.3, 278/1.2, 278/1, 25 të K.Penal.

Për këto raste, nga ana e prokurorit është vlerësuar caktimi i masës së sigurimit "arrest në burg" në 8 raste dhe "detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" në 1 rast. Këto kërkesa janë vlerësuar si proporcionale në raport me rëndësinë e faktit të mbajtjes së armës, sanksionit të veprave penale për të cilat dyshohej personi, ndër të cilët edhe vepra penale e parashikuar nga neni 278 i K.Penal, sipas paragrafit përkatës. Dhe si të tilla janë vlerësuar në 6 raste edhe nga ana e gjykatës, ndërsa për 1 rast gjykata ka vendosur "arrest në burg" me afat dhe në 1 tjetër gjykata ka

⁶⁵ Gjykata e Apelit konstatohet se ka vlerësuar si të drejtë nevojën e caktimit të një mase sigurimi nga gjykata e rrethit gjyqësor, por se nga ana e saj është vlerësuar rreziku jo shumë i lartë i ikjes dhe pamundësisë për të dëmtuar porat apo për të kryer sërish të njëjtën vepër penale, dhe për rrjedhojë masa e sigurimit personal "Vendosja e të miturit në mbikëqyrje" parashikuar nga neni 82/a i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur ka krijuar bindjen si më e përshtatshme referuar dyshimit të zbehtë që ekziston për kryerjen nga i mituri të veprave penale.

vendosur "garanci pasurore".

Më poshtë, nisur nga problematikat e konstatuara dhe lloji i masës së sigurimit, vlerësohet të trajtohen rastet e masës së sigurimit "arrest në burg" me afat të vendosur nga ana e gjykatës, të "garancisë pasurore" të vendosur nga ana e gjykatës kundrejt kërkesës për caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg" nga prokurori dhe masës së sigurimit "detyrim për t'u paraqitur nga policia gjyqësore" të propozuar dhe të vendosur nga ana e gjykatës.

I. Rasti i çështjes për të cilën nga ana e prokurorisë është kërkuar masa e sigurimit "arrest në burg" dhe nga ana e gjykatës është vendosur caktimi i masës së sigurimit "arrest në burg" me afat.

Çështja i përket zyrës së prokurorisë Shkodër, lidhur me procedimin penal nr. 255 datë 16.03.2021, ku nga ana e prokurorit është vlerësuar kërkimi i masës së sigurimit "arrest në burg" ndaj një personi të dyshuar për kryerje të veprave penale "Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik" dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit" të parashikuara nga nenet 236/1 dhe 278/1 të K.Penal.

Fakti penal, lidhet me ngjarjen e ndodhur në datën 15.03.2021, ku shtetasi R.D. nuk i ka ndaluar një pike kontrolli të policisë në lagjen "Bahçallëk", Shkodër. Pas ndjekjes, shërbimet e policisë kanë bërë të mundur ndalimin e tij, por shtetasi R.D. ka bërë rezistencë duke fyer punonjësit e policisë. Pas shoqërimit, gjatë kontrollit të ushtruar në automjetin e tij, është gjetur një armë zjarri pistoletë TT, me krehër me 7 fishekë, dhe në vazhdim nga ana e policisë është kryer arrestimi në flagrancë i tij.

Nga ana e prokurorit në kërkesën e tij, pas vlefësisimit për ligjshmërinë e arrestimit në flagrancë, është vlerësuar që në rastin konkret masa e sigurimit më e përshtatshme për personin nën hetim është "arrest në burg". Në kërkesën e tij, të ndarë në tre pjesë, prokurori pasi përshkruan rrethanat e faktit dhe analizon lidhur me arrestimin në flagrancë, e vazhdon arsyetimin e tij lidhur me ekzistencën e kushteve dhe kriterëve të përgjithshme e të veçanta për caktimin e masës së sigurimit në rastet e arrestit në burg, të parashikuara në nenin 228, 229 dhe 230 të K.Pr. Penale. Nga ana e prokurorit si kushte të veçanta në rastin konkret, është konkluduar në ato që parashikohen në shkronjat b dhe c të nenit 228/3 të K.Pr.Penale. Mbi këtë arsyetim, nga ana e prokurorit është proceduar me kërkesën për vlefësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg".

Kërkesa e prokurorit është regjistruar në gjykatën e rrethit gjyqësor më datë 16.03.2021, ku çështja i është kaluar për gjykim, gjyqtarit të caktuar. Nga ky i fundit është caktuar zhvillimi i seancës më datë 17.03.2021, ku nga ana e prokurorit është mbajtur i njëjti qëndrim si edhe në kërkesën me shkrim, dhe nga ana e mbrojtjes duke mos qenë dakort me faktet, është kërkuar mospranimi i kërkesave dhe në alternativë caktimin e masës së sigurimit "arrest në shtëpi" të parashikuar nga neni 237 i K.pr.penale.

Gjykata në përfundim të gjykimit, më datë 17.02.2021 ka vendosur pas vlefësimit të ligjshëm të arrestimit në flagrancë, masën e sigurimit "Arrest në burg", të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, masë e cila sipas saj do të ekzekutohet për një afat deri në datë 16.04.2021. Në arsyetimin e saj, nga ana e gjykatës, pasi është përshkruar fakti penal, kërkesa e prokurorit dhe e mbrojtësit, është kaluar në argumentimin e saj për vlerësimin si të drejtë të kërkesës së organit të akuzës. Në këtë pjesë të arsyetimit të saj, nga ana e gjykatës analizohet ligjshmëria e arrestimit në flagrancë, për të kaluar në masën e sigurimit që duhet të caktohet. Vendimi ka marrë formë të prerë në datë 23.03.2021, pa u ankimuar.

Në përfundim të afatit të masës së sigurimit, nga ana e të njëjtit prokuror si më sipër, me kërkesën e datës 13.04.2021 të titulluar "*vazhdimi i masës së sigurimit personal*", është kërkuar vazhdimi pa afat të masës së sigurimit "arrest në burg" pa afat, parashikuar nga neni 238 i K.pr.penale. Në këtë kërkesë nga ana e prokurorit janë përshkruar rrethanat e faktit, veprimet hetimore të kryera për periudhën për të cilën është caktuar afati dhe rezultatet përkatëse, për të kaluar më pas në arsyetimin mbi caktimin e masës së sigurimit duke u theksuar se çmohet masa e sigurimit "arrest në burg" pa afat pasi kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit jo vetëm nuk kanë ndryshuar në drejtim të lehtësimit të pozitës së të dyshuarit, por përkundrazi është konfirmuar ekzistenca e faktit penal. Prokurori arsyeton lidhur me provat e marra, duke bërë edhe një përshkrim të tyre lidhur me faktin penal. Dhe vazhdon, me konkludimin e ekzistencës së kushteve dhe kriterëve për caktimin e masës së sigurimit si ato të përshkruar në momentin fillestar, por pa u ndaluar në këtë kërkesë.

Kërkesa e prokurorit është regjistruar më datë 13.04.2021, dhe seanca është zhvilluar më datë 14.04.2021 ku nga ana e prokurorit është mbajtur i njëjti qëndrim si edhe në kërkesë. Mbrojtja ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit me afat deri në dy javë, për të verifikuar dhe plotësuar organi i akuzës disa prova dhe dyshime të ngritura nga i dyshuari.

Gjykata, me të njëjtën gjyqtare si më sipër, me vendimin e saj nr. 199 datë 14.04.2021 ka vendosur caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg" për një afat deri më 12.05.2021. Vendimi ka marrë formë të prerë në datë 17.05.2021, pa u ankimuar.

Në përfundim të afatit të masës së sigurimit, nga ana e të njëjtit prokuror me kërkesën e datës 11.05.2021 të titulluar "*vazhdimi i masës së sigurimit personal*", është kërkuar vazhdimin pa afat të masës së sigurimit "arrest në burg" pa afat, parashikuar nga neni 238 i K.pr.penale.

Kërkesa e prokurorit është regjistruar më datë 11.05.2021, dhe seanca është zhvilluar më datë 12.05.2021 ku prokuroria është përfaqësuar përkundrejt një autorizimi⁶⁶, nga një prokuror tjetër, i cili ka mbajtur të njëjtin qëndrim si edhe në kërkesën e prokurorit të çështjes. Mbrojtja ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit "arrest në shtëpi".

⁶⁶ Autorizimi është i firmosur nga drejtuesi i seksionit, i cili është i njëjte me prokurorin që është paraqitur në seancë.

Gjykata, me të njëjtën gjyqtar, me vendimin e saj nr. 243 datë 12.05.2021 ka vendosur caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg" pa afat. Në arsyetimin e saj, nga ana e gjykatës, pasi janë përshkruar rrethanat e faktit, veprimet hetimore të kryera/aktet e marra gjatë periudhës së afatit dhe të paraqitur nga ana e prokurorit, si dhe kërkesën e prokurorit dhe të mbrojtësit. Në vijim, gjykata ka kaluar në vlerësimin e saj mbi gjetjen si të drejtë të kërkesës së prokurorit për llojin e masës së sigurimit, duke arsyetuar përkundrajt provave të rezultuara gjatë periudhës të përcaktuar lidhur me afatin, për të kaluar në konkludim të pambështetur në ndonjë analizë lidhur me ekzistencën e kushteve dhe kriterëve, për caktimin e masës së sigurimit.

Kundër vendimit është bërë ankim dhe Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 86, datë 15.04.2021 ka vendosur miratimin e vendimit nr. 149 (1802), datë 24.03.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Nga trajtimi i rastit në fjalë, në drejtim të proporcionalitetit të masës së sigurimit, mbi kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, vlerësohet se në kërkesën e parë të prokurorit duhej të bëhej një interpretim më konkret i rëndësisë së faktit penal dhe sanksionit të veprave penale në mënyrë që të individualizohesh sesi reflektohen këto në tregues të rrezikshmërisë së veprës dhe autorit, referuar kriterit të veçantë të parashikuar nga neni 230 i K.pr.penale. Më konkretisht prokurori shprehet se: *"Veç kushteve të mësipërme, në caktimin e një mase sigurimi personal, duhet të merren në konsideratë edhe kriteret e përgjithshme dhe kriteret e veçanta (në rast arresti në burg), të parashikuara përkatësisht nga nenet 229 dhe 230 të K.Pr.Penale. në nenin 229 të K.Pr.Penale parashikohet se: 1. ... 2. 3." Ndërsa në nenin 230 të K.Pr.Penale parashikohet se: "1. ... 2. ... 3. ... 4. ..."* Përsa më lart, nisur nga nevojat e sigurimit, rëndësia e faktit penal dhe sanksioni që parashikohet për të, rrezikshmëria e veprës penale dhe e autorit të dyshuar të saj, çmohet se masa më e përshtatshme në rastin konkret është ajo e "Arrestit në burg", parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale. Caktimi i një mase të tillë, vjen si nevojë e garantimit të normalitetit të hetimit dhe të gjykimin të çështjes, shmangies së rrezikut për kryerjen e veprave të tjera penale prej tij, ashtu edhe sigurimin që ai të mos largohet, të fshihet, por t'i nënshtrohet ekzekutimit të dënimit eventual kur vendimi i dënimit të ketë marrë formë të prerë." Po kështu edhe në dy kërkesat në vazhdim, konstatohet e njëjta problematikë në drejtim të këtij arsyetimi duke qenë se prokurori nuk ndalet në analizë, por i referohet analizës së bërë në kërkesën e parë duke e lidhur me faktin e pandryshueshmërisë së tyre. Megjithatë, në drejtim të proporcionalitetit dhe përshtatshmërisë së masës së sigurimit të kërkuar, ashtu siç ka arsyetuar prokurori referuar provave të mbledhura, vlerësohet se është e drejtë dhe në raport të drejtë me rrethanat e faktit, rëndësinë e këtij fakti, rrezikshmërinë që paraqesin veprimet e personit nën hetim e reflektuar edhe në shkallën e lartë të rrezikshmërisë së vetë personit.

Edhe në vendimin e gjykatës, konstatohet se nga ana e saj, nuk ka një analizë të plotë lidhur me kushtet dhe kriteret e caktimit të një mase sigurimi, për të përcaktuar se përse masa e caktuar "arrest në burg" është më e përshtatshme në rastin konkret, referuar kjo arsyetimit sipas

parashikimit ligjor në nenin 245/c, ç të K.pr.penale. Nga ana e gjykatës përmenden si dispozita me numrat përkatës, por nuk ndalet në asnjërën prej tyre për t'i interpretuar lidhur me rastin konkret dhe në veçanti as lidhur me kushtin e posaçëm që plotësohet në rastin konkret. Kështu gjykata shprehet se: *"Në të njëjtën seancë gjyqësore nga përfaqësuesi i organit të akuzës është kërkuar që ndaj të dyshuarit të caktohej masa e sigurimit, "arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, bazuar kjo kërkesë në nenin 244 të Kodit të Procedurës Penale. Meqënëse në këtë rast janë kushtet dhe kriteret e parashikuara nga nenet 228 dhe 229 të Kodit të Procedurës Penale, kjo gjykatë pranoi kërkesën për t'i caktuar këtij të dyshuari një masë sigurimi personal shtrëngues, duke çmuar si të përshtatshme masën e sigurimit personal shtrëngues të kërkuar nga organi i akuzës, kjo bazuar dhe në nenin 244/3 të Kodit të Procedurës Penale"*.

Për afatin e masës së sigurimit, nga ana e gjykatës arsyetohet me veprimet që duhet të kryhen nga ana e prokurorisë duke i lidhur ato me pretendimet e mbrojtësit, në formën e veprimeve hetimore konkrete dhe pa saktësuar më parë ekzistencën e kushtit të veçantë të parashikuar në nenin 228/3/a të k.pr.penale, çka e bën në thelb zbatim të gabuar në rastin konkret nga ana e gjykatës aplikimin e masës së sigurimit me afat sipas parashikimeve të nenit 245/1/d të K.pr.penale. Kështu gjykata shprehet se: *"Meqënëse në rastin konkret arma e gjetur tek mjeti i drejtuar nga i dyshuari ende nuk është ekzaminuar dhe konkluduar se është armë zjarri për të cilën nevojitet leja nga organi kompetent, si dhe u pretendua se fakti nuk ka ndodhur në versionin e ngritur nga organi i akuzës, por ashtu siç pohoi i dyshuari, kjo gjykata e pranoi kërkesën e organit të akuzës për t'i caktuar masë sigurimi këtij të dyshuari, konkretisht verifikimin dhe ekspertimin e armës, si armë zjarri teknikisht e rregullt, si dhe verifikimin e pretendimit të të dyshuarit për ecurinë e veprimeve të tij dhe të punonjësve të policisë. Kjo gjykatë i sugjeron organit të akuzës të sekuestrojë dhe të kqyrë të gjitha pamjet filmike të kamerave të sigurisë së atyre ambjenteve nga ka kaluar i dyshuari e sidomos ku ka qëndruar dhe është kryer komunikim i parë mes tij dhe punonjësve të policisë, si dhe të pyeten me cilësinë e dëshmitarëve punonjësit e policisë që janë përfshirë tek kjo ngjarje. Rezultatet e këtyre veprimeve janë të domosdoshme për vazhdimin e hetimeve paraprake dhe duhen siguruar brenda një afati të arsyeshëm, që kjo gjykatë e vlerësoi të mjaftueshme deri më datë 16.04.2021. Aplikimi i kësaj mase me afat, sipas parashikimeve të nenit 245/1/d të K.Pr.Penale është gjithmonë i lidhur me rastet kur prova nuk do të arrihej të merrej ose nuk do të garantohej vërtetësia e saj nëse i pandehuri nuk do të ishte siguruar me një masë sigurimi. Ky është interpretimi që është bërë ndër vite edhe nga Gjykata e Lartë⁶⁷, në funksion të garancisë së parashikuar kundrejt arbitraritetit – privimin e lirisë së personit pa pasur dyshimin e bazuar në prova⁶⁸. Më rastin konkret, për provat të cilat kërkon të kryhen brenda afatit të përcaktuar, nuk rezulton të jetë paraqitur ndonjë rrethanë që të krijonte dyshimin se prova nuk do të arrihej të merrej apo të rrezikohej vërtetësia e saj. Arma sipas vendimit të ekspertimit balistik të oficerit të policisë gjyqësore është dërguar tek eksperti përpara datës se të bëhej kërkesa e prokurorit për caktimin e masës së sigurimit dhe si e tillë, nuk ka ndonjë rrezik për marrjen e rezultateve të saj. Po kështu*

⁶⁷ Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë me 170 datë 14.08.2000, nr. 457 datë 20.07.2001,

⁶⁸ Procedura Penale, Komentar: - autorë Halim Islami, Arsan Hoxha, Iir Panda, Tiranë 2010

veprimet e tjera lidhur me verifikimin e pretendimeve të të dyshuarit për ecurinë e veprimeve të tij dhe të punonjësve të policisë, janë veprime që në thelb lidhen me veprimtarinë e ushtrimit të ndjekjes penale nga ana e prokurorit për vërtetimin e dyshimit të ngritur ndaj personit për veprën penale për të cilën ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal, dhe si e tillë në kushtet kur për sigurimin e këtyre provave nuk ka rrezik për marrjen apo vërtetimin e tyre, urdhërimi në këtë fazë të hetimeve paraprake nga ana e gjykatës që shqyrton masën e sigurimit, nuk është në përputhje me rolin që ajo ka referuar parashikimeve procedurale penale të gjyqtarit të hetimeve paraprake⁶⁹. Nga ana e kësaj gjykate, në shqyrtimin e këtyre çështjeve përsa kohë që hetimet paraprake nuk kanë përfunduar, nuk mundet të marrë në analizë provimin e fajësisë apo pafajësisë së personit të dyshuar, por referuar të dhënave provuese të ngrumbulluar deri në çastin e shqyrtimit të kërkesës të mund të vlerësojë që dyshimet e arsyeshme të jenë të bazuara në prova⁷⁰.

Në dy vendimet në vazhdim të gjykatës, me anë të të cilave ka vlerësuar sërish caktimin e masës së sigurimit me afat dhe në vazhdim pa afat, konstatohet se në vendimin e gjykatës, në drejtim të proporcionalitetit të masës së sigurimit analiza mungon, në kuptim të asaj se çfarë vlerësohet e domosdoshme dhe e nevojshme referuar parashikimit të nenit 245 të K.Pr.Penale që përcakton se vendimi i gjykatës duhet të përmbajë parashkrimin e shkaqeve të posaçme dhe të të dhënave që përlligjin masën e sigurimit. Madje në këto vendime, gjykata nuk i citon dispozitat lidhur me kushtet dhe kriteret sipas neneve 228, 229 dhe 230 të K.Pr.Penale, por këto gjenden vetëm në fund të shënuar si bazë ligjore mbi të cilën mbështetet për dispozitivin e vendimit.

Kështu në arsyetimin e saj në vendimin për caktimin e masës së sigurimit me afat për herë të dytë nga ana e gjykatës, pasi janë përshkruar rrethanat e faktit, veprimet hetimore të kryera/aktet e marra

⁶⁹ Neni 278 i K.Pr.Penale parashikon kompetencat e kësaj gjykate.

⁷⁰ Vendim unifikues i Gjykatës së Lartë me nr. 7/2011, ka është arritur në përfundimin unifikues se: "Kolegjet e Bashkuara vijnë në përfundim unifikues se dyshimi i arsyeshëm, provat ku ai bazohet për të justifikuar caktimin dhe vijtimin e zbatimit të masës së sigurimit, nuk nevojitet të ketë të njëjtën shkallë sigurie dhe vlerë provueshmërie për të konkluduar sikurse provat që janë të domosdoshme për dhënien ose jo të vendimit të dënimit ndaj të pandehurit. Mjafton që ato të jenë të tilla që, në gjendjen ku janë aktet e procedimit, prej tyre mund të nxirren përfundime se ndaj të hetuarit a të gjykuarit ekziston një shkallë e arsyeshme mundësie e fajësisë për kryerjen e veprës penale në ngarkim të tij.

Dispozita e pikës 1 të nenit 228 tregon vetë dallimin e natyrës së veçantë të gjykimt dhe mënyrën e kriteret mbi të cilat krijohet bindja e gjykatës për caktimin ose jo të masës së sigurimit krahasuar me atë të dhënies ose jo të vendimit të dënimit. Në rastin e parë, gjykimi mbështetet në dyshime të arsyeshme bazuar në prova, që tregojnë mundësinë e kryerjes së veprës penale objekt procedimi dhe mundësinë e atribuimit, pra të ekzistencës së fajësisë, pikërisht në drejtim të të gjykuarit për atë veprë penale (fumus commissi delicti), ndërsa në rastin e dytë, gjykimi mbështetet vetëm në prova që vërtetojnë, jashtë çdo dyshimi, dhe e bindin gjykatën për kryerjen ose jo të veprës prej tij."

Edhe GjEDNJ në një vendim të saj Fox, Campbell and Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar, 30.08.1990, shprehet se: "dyshimi i arsyeshëm presupozon ekzistencën e fakteve apo të informacioneve të cilat do të kënaqnin një vëzhgues objektiv që personi në fjalë mund të ketë kryer një veprë penale"

gjatë periudhës së afatit dhe të paraqitur nga ana e prokurorit, si dhe kërkesën e prokurorit dhe të mbrojtësit. Në vijim, gjykata kalon në vlerësimin e saj mbi gjetjen si të drejtë të kërkesës së prokurorit për llojin e masës së sigurimit, por me veçantinë e caktimit të një afati, duke vazhduar me arsyetimin konkret të nevojës së këtij afati, duke u shprehur se *“Kjo gjykatë, pasi dëgjoji palët, çmoi dhe vlerësoi aktet e paraqitura, e gjen kërkesën e organit të akuzës të drejtë dhe të bazuar në ligj, por, sërish vlerëson se kjo masë sërish duhet të caktohet me afat. Gjukata në rastin konkret konstaton se organi i akuzës ka kryer vetëm një pjesë të veprimeve hetimore të kërkuar për t’u kryer nga kjo gjykatë, duke i plotësuar pjesërisht ato. ...Rezultatet e këtyre veprimeve janë të domosdoshme për vazhdimin e hetimeve paraprake dhe duhen siguruar brenda një afati të asyreshëm, që kjo gjykatë e vlerësoi të mjaftueshme deri më datë 12.05.2021. Kjo masë u vlerësua si më e përshtatshme, për arsye të rrethanave në të cilat mendohet të jenë kryer veprat penale, si dhe rrezikshmërisë që këto vepra penale paraqesin. Kërkesat e organit të akuzës dhe ky vendim gjyqësor janë mbështetur në aktet e kryer nga policia gjyqësore, më 15/16.03.2021 deri më 12.04.2021, me të cilat mbrojtja e të dyshuarit është njohur dhe nuk paraqiti ndonjë kundërshtim përse i përket vlefshmërisë së tyre. Për këto arsye, Gjukata bazuar në nenet 11, 12, 13, 228, 229, 232, 238, 244, 245 të Kodit të Procedurës Penale, VENDOSI ...”*

Në arsyetimin e saj në vendimin për caktimin e masës së sigurimit me afat, nga ana e gjykatës, pasi janë përshkruar rrethanat e faktit, veprimet hetimore të kryera/aktet e marra gjatë periudhës së afatit dhe të paraqitur nga ana e prokurorit, si dhe kërkesën e prokurorit dhe të mbrojtësit. Në vijim, gjykata ka kaluar në vlerësimin e saj mbi gjetjen si të drejtë të kërkesës së prokurorit për llojin e masës së sigurimit, duke arsyetuar përkundrejt provave të rezultuara gjatë periudhës të përcaktuar lidhur me afatin, për të kaluar në konkludim të pambështetur në ndonjë analizë lidhur me ekzistencën e kushteve dhe kriterëve, për caktimin e masës së sigurimit, duke u shprehur se: *“Me datë 11.05.2021 organi i akuzës e riparaqet kërkesën për caktimin e një tjetër mase sigurimi “arrest në burg”, pa afat, duke pretenduar se tashmë janë kryer veprimet e nevojshme hetimore për të mbështetur dyshimet e ngritura ndaj të dyshuarit R.D. konkretisht, ... në këto kushte, kjo gjykatë vlerëson kërkesën e organit të akuzës të drejtë dhe të bazuar në ligj, duke caktuar masën e sigurimit të kërkuar nga organi i akuzës, parashikuar nga neni 238 i K.P.P-së, pa afat. Kjo masë u vlerësua si më e përshtatshme, për arsye të rrethanave në të cilat mendohet të jenë kryer veprat penale, si dhe rrezikshmërisë që këto vepra penale paraqesin. Kërkesat e organit të akuzës dhe ky vendim gjyqësor janë mbështetur në aktet e kryera nga policia gjyqësore, më 15/16.03.2021 deri më 10.05.2021, me të cilat mbrojtja e të dyshuarit është njohur dhe nuk paraqiti ndonjë kundërshtim përse i përket vlefshmërisë së tyre. Për këto arsye, Gjukata bazuar në nenet 11, 12, 13, 228, 229, 232, 238, 244, 245 të Kodit të Procedurës Penale, VENDOSI ...”*

Gjithashtu lidhur me këto vendime të gjykatës, vlerësohen të evidentohen të njëjta konstatime mbi mënyrën e interpretimit të nenit 245/1/d të K.Pr.Penale mbi caktimin e masës së sigurimit me afat. Kështu për caktimin e kësaj mase me afat, gjykata shprehet se: *“Gjukata në rastin konkret konstaton se organi i akuzës ka kryer vetëm një pjesë të veprimeve hetimore të kërkuara për t’u kryer nga kjo*

gjykatë, duke i plotësuar pjesërisht ato. Konkretisht organi i akuzës nuk ka paraqitur një procesverbal ku të fiksohej se janë verifikuar të gjitha ambientet publike dhe jo, që ndodhen apo shtrihen gjatë gjithë segmentit rrugor të pretenduar nga punonjësit e policisë se kanë kaluar ata dhe mjeti që po ndiqnin të drejtuar nga i dyshuari, deri tek vendi ku pretendohet se është gjetur duke parkuar mjetin e drejtuar prej tij i dyshuari, lidhur me faktin nëse kanë të instaluar kamera sigurie, gjithmonë me qëllimin për të verifikuar pohimet e personave të përfshirë në ngjarjen konkrete, duke filluar që nga pretendimi i ecjes me shpejtësi e deri tek kundërshtimet e bera nga i dyshuari..... Rezultatet e këtyre veprimeve janë të domosdoshme për vazhdimin e hetimeve paraprake dhe duhen siguruar brenda një afati të arsyeshëm, që kjo gjykatë e vlerësoi të mjaftueshme deri më datë 12.05.2021.” Këto veprime të urdhëruar nga ana e gjykatës, ashtu siç është arsyetuar edhe në caktimin e parë të masës së sigurimit me afat, sërisht vlerësohet se në thelbin e tyre lidhen me veprimet hetimore mbi provueshmërinë e fajësisë së të dyshuarit për kryerjen e veprës penale për të cilën ekziston tashmë një dyshim i arsyeshëm në nivelin që kërkohet referuar kuptimit të nenit 228/1 të K.Pr.Penale, dhe si të tilla i shërbejnë veprimtarisë së prokurorit për të konkluduar përfundimin e hetimeve, dhe paraqitjen e kërkesës në gjykatë. Nuk konstatohet që nga ana e gjykatës, për këto veprime të jetë arsyetuar fakti që kanë të bëjnë me garantimin e marrjes apo vërtetësisë së provës dhe në këto rrethana urdhërimi i këtyre veprimeve nga ana e gjykatës në funksion të caktimit të masës së sigurimit me afat nuk përputhet me kuptimin e asaj që kërkohet nga neni 245/1/d i K.Pr.Penale në referim të nenit 228/3/a të K.Pr.Penale.

Nga ecuria e kësaj çështje lidhur me caktimin e masës së sigurimit përfundimisht “arrest në burg” vlen të ngrihen disa problematika mbi mënyrën e të proceduarit të prokurorit.

Së pari, ashtu siç është konstatuar edhe më sipër, prokurori nuk rezulton të ketë reaguar me anë të mjetit procedural të ankimit ndaj vendimit të gjykatës, e cila ka vendosur masë sigurimi me afat. Mos reagimi i prokurorit me anë të këtij mjeti procedural të parashikuar si një e drejtë e tij, referuar nenit 249, 408 të K.Pr.Penale, përballë reagimit të tij me përsëritjen e kërkesës së tij për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” pa afat, tregojnë një qëndrim jo në përputhje me funksionin e tij si drejtues i fazës së hetimeve paraprake. Referuar dispozitave kushtetuese dhe procedurale, prokurori është organi kompetent që ushtron ndjekjen penale dhe është ai i cili drejton, mbikëqyr dhe kontrollon të gjithë veprimtarinë hetimore në fazën e hetimeve paraprake lidhur me marrjen e provave, duke konkluduar si për atribuimin e veprës penale ndaj një personi ashtu edhe lidhur me masën e sigurimit, duke qenë ai personi kompetent në bazë të nenit 244/1 të K.Pr.Penale mund të investojë gjykatën për caktimin e një mase sigurimi personal. Nisur nga ky rol që i është dhënë me ligj prokurorit, ai nuk mund të qëndrojë ‘indiferent’ ndaj një ‘ndërhyrje’ që i bëhet në këto kompetenca edhe nga gjykata të cilës vetë ligji nëpërmjet parashikimit të nenit 244/3 të K.P.Penale i ka kufizuar mundësinë e caktimit të një mase sigurimi personal më të rëndë sesa ajo e kërkuar nga ana e prokurorit. Në këtë këndvështrim të rolit të prokurorit në fazën e hetimeve paraprake, mund të vlerësohet se edhe masa e sigurimit personal me afat e parashikuar në nenin 245/1/d të K.Pr.Penale duke qenë se ajo urdhërohet për të garantuar marrjen ose vërtetësinë e provës, është e

lidhur në thelb me veprimtarinë e ushtrimit të ndjekjes penale të prokurorit dhe si e tillë, është ai më mirë se kushdo tjetër që njih rrezikun e veprimtarisë së personit nën hetim përkundrejt marrjes apo vërtetimit të një prove. Për rrjedhojë, duke pasur këtë rol drejtues në hetimet e një çështje penale, prokurori duhet të ketë dilijencën e duhur për të reaguar, me qëllim të mbarëvajtjes së hetimeve dhe përfundimit me zgjidhjen e duhur.

Së dyti, duke u bazuar në të njëjtin arsyetim sa më sipër mbi rolin e prokurorit, nga ana e tij duhet të tregohet kujdesi i duhur mbi argumentimin e të gjitha kushteve dhe kritereve të cilat veç e veç apo në unitet me njëra tjetrën tregojnë shkaqet e caktimit të një mase sigurimi personal. Ky kujdes duhet të jetë si në aspektin formal në citimin e dispozitave përkatëse ligjore dhe arsyetimin e tyre në raport me rrethanat e rastit konkret.

Në rastin e çështjes në fjalë, për të cilën rezulton se nga ana e prokurorit është proceduar me tre kërkesa për caktimin e masave të sigurimit personal, konstatohet se në kërkesën e dytë dhe tretë, prokurori është shprehur me kërkesën e tij për vazhdimin e masës së sigurimit personal "arrest në burg" me afat dhe nisur nga kjo kërkesë, ka argumentuar në mënyrë "të cunguar" kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit personal duke i referuar ato në kërkesën e mëparshme dhe duke u shprehur mbi pozitën e personit nën hetim në drejtim të moslehtësimit. Në fakt, ky lloj arsyetimi dhe formulimi i prokurorit, duket sikur jemi para rastit të një kërkesë/qëndrimi që mban prokurori kur zbatohet neni 260 i K.P.Penale, kur kërkohet revokimi, zëvendësimi i një mase sigurimi apo shqyrtohet zbatimi i një mase sigurimi sipas parashikimeve të nenit 248 e 246/6 të K.Pr.Penale. Ndërkohë që në rastin konkret, prokurori kërkon të caktohet një masë sigurimi në kushtet kur përfundon afati i të njëjtës masë sigurimi, referuar mundësisë dhe parashikimit ligjor në nenin 261/1/ç të K.Pr.Penale. Kjo praktikë tashmë është e konsoliduar edhe nga Gjykata e Lartë, në një sërë vendimesh të Kolegjeve Penale për çështje të ndryshme dhe e gjejmë si të tillë edhe nga gjykatat pranë të cilëve ushtrojnë veprimtarinë e tyre prokuroritë subjekte të këtij inspektimi⁷¹.

⁷¹ Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë me nr. 181 datë 14.05.1999, ku rezulton se: "Në gjykim prokurori ka kërkuar dhe gjykata e ka miratuar që për të pandehurin M. në bazë të nenit 245/c të Kodit Pr. Penale, arresti të miratohet për afatin 10 ditor, për të garantuar marrjen e provës.

Me mbarimin e këtij afati në rigjykimin e kësaj çështje, organi i Prokurorisë ka paraqitur përpara gjykatës dy prova deklarimet e shtetaseve M. dhe D. H., mbi bazën e të cilave kërkon për të pandehurin M. arrestin në burg pa afat."

Gjykata e Rrethit Kurbin me vendimin nr. 21, datë 08.04.1999 ka vendosur: Mos pranimin e kërkesës së prokurorisë, për caktimin e masës së arrestit në burg, ndaj të pandehurit M. duke caktuar për këtë të pandehur si mase sigurimi masë sigurimi arrest në shtëpi."

Lidhur me këtë seancë dhe vendimmarrje gjykata e Lartë shprehet në vijim se: "Duke shqyrtuar këto prova si dhe të tjera që ndodhën në dosje del se i pandehuri M.P., në datën 27.3.1999 ka qenë i pranishëm në vendin e ngjarjes, se ka patur dhe përdorur armë gjahu, automatik dhe se, me këtë armë ka realizuar vrasjen e një personi dhe plagosjen e një tjetri.

II. Rasti i masës së sigurimit "garanci pasurore" e vendosur nga gjykata, përkundrejt kërkesës së prokurorit për caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg".

Çështja i përket zyrës së Prokurorisë Vlorë, lidhur me procedimin penal nr. 865 datë 03.03.2021, për të cilën nga ana e prokurorit është vlerësuar për të kërkuar caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg" ndaj një personi të dyshuar për kryerjen e veprave penale të "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit" dhe për "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" të parashikuar nga neni 278/3 dhe 283/1 i Kodit Penal.

Fakti penal lidhet me ngjarjen e datës 02.03.2021, ku në banesën e shtetasit Sh.S. gjatë një kontrolli të ushtruar nga ana e policisë është gjetur municion luftarak i llojit fishekë të ndara në dy qeska në sasinë 136 copë+60, lëndë narkotike kanabis sativa në peshën 356.6 gram, 9150 fara bimore si ato të Cannabis Sativa. Para se të kryhej kontrolli, nga ana e policisë është pyetur shtetasi Sh.I. nëse në banesë kishte sende të kundraligjshme, por nga ana e tij është mohuar të kishte. Më pas, duke qenë se nga mimika ka shfaqur shqetësim, është vazhduar me kontrollin përkatës nga ku ka rezultuar gjetja e lëndës narkotike dhe municionit luftarak. Në vazhdim nga ana e policisë, është kryer arrestimi në flagrancë i këtij shtetasi.

Provat e paraqitura në këtë sésancë gjyqësore dhe ato të ndodhura në dosje kanë qenë të mjaftueshme për të patur një dyshim të arsyeshëm se i pandehuri i ka kryer veprat për të cilën akuzohet dhe se ndaj tij duhet të aplikohet si masë sigurimi bazuar në nenin 228/1 të Kodit Pr. Penale "arrest në burg".

Duke patur parasysh sa sipër, kolegji çmon se vendimi nr. 21 datë 8.4.1999 i Gjykatës së Rrethit Kurbin, për të pandehurin M. P.i, është i pabazuar në ligje e prova. Gjykata në këtë fazë të gjykimit, përdërisa hetimet paraprake nuk kanë përfunduar, nuk mund të angazhohet për të përcaktuar fajësinë ose jo të të pandehurve."

Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë me nr. 467 datë 9.8.2001, ku rezulton fakti i caktimit të një mase sigurimi arrest në burg me afat nga ana e gjykatës dhe në përfundim të afatit, nga ana e prokurorit bëhet një kërkesë e re për caktimin e masës së sigurimit arrest në burg. Nga ana e Gjykatës së Lartë, nuk është gjetur si e pabazuar në thelb kërkesa e prokurorit për caktimin e të njëjtës mase sigurimi, por në vendimin e saj, ajo shprehet për caktimin e saj nga ana e gjykatës, duke u bazuar në një dyshim të arsyeshëm të bazuar në prova për kryerjen e veprës penale nga i pandehuri. Më konkretisht Gjykata e Lartë shprehet se: "Me vendimin e mëparshëm (nr. 735 akti date 4.7.2001) gjykata kishte caktuar burg me afat 20 ditë. Duke dhënë një vendim të tillë, autoriteti gjyqësor, në zbatim të ligjit procedural penal, i ka dhënë mundësi organit procedues që brenda një afati të caktuar, të realizojë detyrimet ligjore për të siguruar provat e nevojshme që lidhen me akuzën ndaj të pandehurit por që njëkohësisht lidhen edhe me llojin e masës së sigurimit që do të caktohet përfundimisht ndaj të pandehurit. Gjithashtu caktimi i arrestit me afat krijon mundësi reale për respektimin e të drejtave të shtetasve për të aplikuar një masë sigurimi sa më të drejtë e të bazuar në ligj. Nëse brenda afatit të caktuar nuk merren provat e caktuara në vendimin e gjykatës dhe nuk ka prova të tjera që ta bëjnë të bazuar dyshimin për kryerjen e veprës penale nga i pandehuri, gjykata nuk ka bazë ligjore për të aplikuar masën e arrestit në burg. Në dosje nuk ka asnjë provë, asnjë dokument që të jetë i fallisifikuar e në këto rrethana vendimi i gjykatës duhet të shfuqizohet. Duke ndjekur ecurinë e hetimit dhe sigurimin e provave, organi procedues duhet të bëjë vlerësimet dhe kërkesat e nevojshme për caktim mase sigurimi deri në përfundimin e hetimit."

Prokurori në kërkesën e tij të datës 04.03.2021, pasi ka kërkuar vleftësimin e arrestimit në flagrancë, ka vlerësuar kërkimin e masës së sigurimit "arrest në burg". Kërkesa është regjistruar në gjykatë brenda afatit ligjor, dhe nga gjyqtari është caktuar zhvillimi i seancës më datë 06.03.2021. Në seancën gjyqësore të zhvilluar në këtë datë, prokurori në gjykim ka mbajtur të njëjtin qëndrim si edhe në kërkesën e paraqitur, ndërsa nga ana e mbrojtjes është kërkuar caktimi i masës së sigurimit të detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore ose garanci pasurore në shumën 300.000 lekë, për shkak të personalitetit se nuk është dënuar më parë, nuk shfaq ndonjë rrezikshmëri shoqërore, nuk ekziston rreziku i ikjes apo i shmangies, dhe faktin se është i vetmi që punon në familje, ka tre fëmijë ku dy janë student dhe njëri nxënës. Për faktin e fëmijëve lidhur me arsimin nuk janë depozituar vërtetimet përkatëse, por nga ana e avokatit është paraqitur vetëm çertifikata familjare.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari përkatës i caktuar, me vendimin e datës 06.03.2021 ka vendosur pas vleftësimit të ligjshëm të arrestimit të këtij shtetasi, caktimin e masës së sigurimit "Arrest në burg", dhe zëvendësimin e asaj me masën e sigurimit "Garanci Pasurore", parashikuar nga neni 236 i Kodit të Procedurës Penale. Depozitim në një nga bankat e nivelit të dytë për llogarit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë të shumës 300.000 lekë shumë e cila do të depozitohet brenda datës 08.03.2021. Pas depozitimit të shumës aktet do t'i paraqiten prokurorit të çështjes i cili pas verifikimit të kryejë veprimet procedural sipas nenit 236 pika 5 e Kodit të Procedurës Penale.

Në vijim, konstatohet se nga ana e prokurorit pasi është konstatuar depozitimi i shumës përkatëse të garancisë, më datë 07.03.2021 është nxjerrë urdhëri për ekzekutimin e vendimit penal të gjykatës për masën e sigurimit, duke urdhëruar lirim të menjëhershëm të personit nën hetim dhe duke dërguar këtë urdhër për ekzekutim pranë Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vlorë.

Vendimi gjyqësor nuk rezulton të jetë ankimuar, duke marrë kështu formë të prerë.

Pas trajtimit të rastit në fjalë në drejtim të proporcionalitetit të masës së sigurimit të propozuar nga ana e prokurorit, sipas kërkesës së tij konstatohet se nga ana e prokurorit nuk ka një analizë të plotë dhe shteruese lidhur me përshtatshmërinë dhe proporcionalitetin e masës së sigurimit "arrest në burg". Në kërkesën e tij prokurori megjithëse shprehet lidhur me elemente si sanksioni i veprës penale të parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal, personaliteti, qëndrimi i autorit dhe veprimet e kryera- nga të cilat konkludon në rrezikshmërinë e lartë të autorit, nuk ndalet të arsyetojë sesi këto reflektohen në tregues rrezikshmërie.

Duke e lidhur me llojin e masës së sigurimit të vendosur nga ana e gjykatës, konstatohet se nga ana e prokurorit në kërkesën e tij është konkluduar, ndonëse pa një arsyetim të qartë, në ekzistencën e rrezikut që personi ndaj të cilit kërkohet të caktohet masa e sigurimit mund të kryejë krime më të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilën procedohet, si i vetmi kusht sipas parashikimeve të nenit 228/3/c të K.Pr.Penale. Kështu më konkretisht prokurori pasi përshkruan rrethanat e faktit dhe veprimet hetimore të policisë gjyqësore që kanë passjellë edhe arrestimin në flagrancë të tij,

si dhe arsyetimin mbi arrestimin e ligjshëm, shprehet se: "Nisur nga sa parashirova më lart ekzistojnë kushtet dhe kriteret ligjore dhe për caktimin e një mase sigurimi për të arrestuarin në flagrancë. Në këtë rast ekzistojnë kushtet e përgjithshme për caktimin e masave të sigurimit personal pasi: -konkretisht ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se i arrestuari është autor i veprës penale të parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal. ky dyshim bazohet nga veprimet hetimore të kryera deri në këtë fazë dhe që aktet përkatëse ia kemi bashkëlidhur kësaj kërkesë. Duke patur parasysh të gjitha provat që i kemi paraqitur gjykatës, ekziston dyshimi i arsyeshëm se i arrestuari është autor i veprës penale të parashikuar nga neni 283/1 dhe 278/3 të K.penal. – nuk ekzistojnë shkaqe padënueshmërie apo shkaqe të shuarjes së veprës penale për të arrestuarin. Do mbajmë parasysh sanksionin që parashikon vepra penale. Qëndrimin që ka mbajtur i arrestuari para policisë gjyqësore. Për shkak të rrethanave të faktit, personalitetit, veprimeve konkrete të kryera dhe qëndrimit që ka mbajtur, çmujmë se rrezikshmëria e autorit në këtë rast është e lartë. Ekziston rreziku që ai të kryejë krime më të rënda ose të të njëjtit lloj me atë të cillin procedohet. Nga aktet e administruara deri në këtë fazë të hetimit, rezulton se shtetasi paraqet probleme të shëndetit mendor. Përfundimisht bazuar në nenet 228, 229, 230, 251, 252, 258 dhe 259 të Kodit të Procedurës Penale i paraqesim Gjykatës së Rrethit Gjyqësor këtë: KËRKESË: ..."

Ndërsa nga ana e gjykatës, është konkluduar në ekzistencën e rrezikut të ikjes, si i vetmi kusht sipas parashikimeve të nenit 228/3/b të K.P.Penal dhe duke konkluduar njëkohësisht në mënyrë të shprehur edhe në mosekzistencën e kushteve të tjera të parashikuar në shkronjat "a" dhe "c" të të njëjtit paragraf të nenit 228. Por ashtu si edhe tek kërkesa e prokurorit, edhe tek vendimi i gjykatës, konstatohet se konkludimi si për ekzistencën e njërit kusht dhe mosekzistencën e dy të tjerave, nuk mbështetet në ndonjë arsyetim konkret. Dhe në vazhdim evidentohet se konkludimi mbi ekzistencën e nenit 228/3/b të K.P.Penale, është përdorur për aplikimin e nenit 236 të K.P.Penale, e cila e kërkon si kusht të domosdoshëm ekzistencën e këtij kushti të nenit 228/3 të K.P.Penale, krahas mbështetjes në argumentet lidhur me ekzistencën e kushteve të tjera që kërkon neni 236 kur gjykata duhet të jap masën e sigurimit "arrest në burg". Në arsyetimin lidhur me këto kriteret sipas parashikimeve të nenit 229 dhe 230 të K.pr.penale, konstatohet se gjykata konkludon se caktimi i masës së sigurimit është në përputhje me kriteret e parashikuar në këto dispozita, duke përmendur elementët si rëndësia e faktit, përhapja e veprave penale dhe saksioni që parashikojnë këto vepra penale për të cilat dyshohet i arrestuari, por pa u ndalur konkretisht për secilën nga këto element dhe si identifikohen këto për zbatimin e përputhshmërisë dhe të proporcionalitetit të masës së sigurimit. Kështu më konkretisht gjykata arsyeton se: "Përsa i përket kërkesës për caktimin e masës së sigurimit "Arrest në burg", të kërkuar nga organi i akuzës, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale gjykata vlerëson se kjo kërkesë në lidhje me caktimin e kësaj mase sigurimi duhet të pranohet për shkak se u përgjigjet rrethanave dhe provave mbi të cilat bazohet kërkesa si dhe rolit të këtij të arrestuari në kryerjen e kësaj vepre penale. Neni 228/3 i K.P.Penale parashikon kushtet për vendosjen e masave të sigurimit "3. Masta e sigurimit personal vendosen: ...". Dyshimi se shetasi Sh.I. ka marrë pjesë në kryerjen e veprës penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" dhe Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shperthyesë dhe i municionit" parashikuar nga neni 283/1 dhe 278/3 të Kodit Penal bazohet në

proceverbalin e kontrollit të banesës, procesverbalin e sekuestrimit, etj. Gjykata mban parasysht fakti se ekziston rreziku i ikjes dhe i shmangies nga hetimi i çështjes. Caktimi i kësaj mase sigurimi personal është në përputhje dhe me kriteret e parashikuara në nenin 229 dhe 230 të K.Pr.Penale si rëndësia e faktit, përhapja e veprës penale të parashikuar nga neni 278/3 i Kodit Penal dhe sanksioni që parashikon ligji për veprën penale për të cilën dyshohet i arrestuari. Gjykata vlerëson se ekzistojnë kushtet për pranimin e masës së sigurimit "Garanci pasurore" të kërkuar nga mbrojtja dhe i arrestuari bazuar në nenin 236 të K.Pr.Penale që parashikon: 1.2.3.4.5.6. Rezulton se në lidhje me provat ato janë marrë nga ana e organit të akuzë dhe i arrestuari nuk ka mundësi që të ndikojë në marrjen ose vërtetësinë e tyre. Gjithashtu nisur nga personaliteti i të arrestuarit nuk ka të dhëna se ai mund të kryejë veprë tjetër penale. i vetmi rrezik është ai që mund të shmangët hetimeve. Nisur nga rrethanat dhe provat që disponon aktualisht akuzat në lidhje me të dyshuarin SH.L. gjykata vlerëson se masa më e përshtatshme është ajo e parashikuar nga neni 236 i K.Pr.Penale "Garancia pasurore" pasi lejohet kryerjen e veprimeve hetimore ndaj të dyshuarit dhe njëkohësisht nuk cënon të drejtat e shtetasit në lidhje me lirinë personale të tij."

Në vazhdim të konstatimit sa më sipër, lidhur me arsyetimin e vendimit të gjykatës, konstatohet edhe mungesa e arsyetimit lidhur me faktin se në rastin konkret cili paragraf i dispozitës së parashikuar nga neni 236 të K.Pr.Penale gjen zbatim. Në paragrafin të parë të nenit 236 të K.Pr.Penale, jemi para zbatimit në rastet kur vlerësohet zëvendësimi i masës së sigurimit "arrest në shtëpi" ose "arrest në shtëpi", ndërsa në paragrafin e dytë, jemi para zbatimit në rastet kur kjo masë vendoset pa u caktuar dy masat e sipërpërmendura, por me kushtin që për këto masa ekziston kushti i rrezikut të ikjes.

Lidhur me shumën së garancisë pasurore të vendosur, konstatohet se në vendim, nuk ka ndonjë analizë lidhur me përcaktimin e shumës së garancisë, referuar parashikimeve të nenit 236/3 të K.Pr.Penale "3. Shuma e garancisë pasurore përcaktohet nga gjykata, pasi merr mendimin e palëve, bazuar në nevojat reale të sigurimit, rrethanat personale dhe familjare të të pandehurit, si dhe gjendjen e tij financiare". Por nga ana e gjykatës, është pranuar të vendoset si shumë garancie, vlera e ofruar nga ana e personit nën hetim. Përcaktimi i shumës së garancisë parashikohet si detyrim për gjykatën në ligj, dhe shumë e rëndësishme, bazike pasi është e lidhur me jo vetëm me faktin e krijimit të sigurisë se kjo shumë do t'a bëjë atë që të pengohet për t'u larguar⁷² dhe për t'u paraqitur kur kërkohet gjatë hetimit e gjykimin, por edhe të mos jetë e tepruar⁷³, në raport me burimet financiare.

Nga të dhënat e marra, rezulton që vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë për shkak mosankimimi nga palët, çka të bën të evidentosh faktin se pavarësisht qëndrimit të shprehur me shkrim mbi caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg", dhe me paraqitjen e saj në seancën gjyqësore, nga ana e prokurorit të çështjes nuk është mbështetur ky qëndrim në vazhdim. Ky

⁷² Eemkoff kundër Republikës Federale Gjermane, Seria A nr. 7, 27 qershor 1968

⁷³ Neumeister kundër Austrisë, Seria A, nr. 8, 27 qershor 1968; Mangouras kundër Spanjës⁷³ GJEDNJ i 28 shtator 2010

qëndrim reflektohet me moskryerjen e ankimit ndaj këtij vendimi dhe që për të cilën evidentohet të mos jetë shoqëruar me pasqyrimin e këtij qëndrimi me shkrim.

III. Rasti i masës së sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” e propozuar nga ana e prokurorit.

Çështja i përket zyrës së Prokurorisë Shkodër, lidhur me procedimin penal nr. 52 datë 12.01.2021, për të cilën nga ana e prokurorit është vlerësuar kërkitimi i masës së sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, ndaj shtetasit R.L. për veprat penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit” dhe “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të flohta” parashikuar nga neni 283/1, 278/3 dhe 279/2 i K.Penal.

Fakti penal lidhet me ngjarjen e datës 11.01.2021, ku punonjësit e Policisë së Forcës së Posaçme Shqiponja në DVP Shkodër, të planizuar me shërbim në qytet, kanë konstatuar një mjet tip benz mercedez me targë xxx, me ngjyrë të zezë dhe xhama të errët në zonën e rrethrotullimit të Parrucës, të cilit i kanë bërë shenjë të ndalojë. Gjatë kontrollit kanë konstatuar dy persona, shtetasin R.L. si drejtues dhe një shtetas tjetër, i ulur në sediljen e parë të pasagjerit. Gjatë kontrollit është konstatuar sjellje e dyshimtë e tyre dhe është ushtruar kontroll fizik, ku gjatë të cilit, shtetasit R.L. i janë gjetur në xhepin e xhupit tre bohçe të vogla të thara si ato të cannabis sativa dhe një cigare në dorë, me erë karakteristike të cannabis sativa. Gjatë kontrollit të automjetit, në bagazh është gjetur një shkop bejsbolli prej druri dhe tek sedilja e parë, krahu i pasagjerit një shkop gome policie. Gjithashtu nga kontrolli në banesë, janë gjetur dhe sekuestruar 48 fishekë ushtarak model 56. Bima e dyshuar narkotike pas peshimit ka rezultuar 1.4 gram. Për këto arsye, të ndodhur në gjendje flagrante nga ana e policisë është kryer arrestimi në flagrancë i shtetasit R.L.

Prokurori në kërkesën e tij të datës 13.01.2021, me vlefësimin e arrestimit në flagrancë ka vlerësuar të kërkojë edhe caktimin e masës së sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” ndaj personit të dyshuar për kryerjen e veprave penale sa më sipër. Kërkesa është depozituar në gjykatë brenda afatit ligjor, dhe nga gjyqtarja e ngarkuar është caktuar zhvillimi i seancës gjyqësore më datë 14.01.2021. Në seancën gjyqësore rezulton se është paraqitur një prokuror tjetër, i ndryshëm nga ai i cili ka përpiluar kërkesën dhe gjykata në vendimin e saj shprehet “*në vend të prokurorit S.B.*”. Nga ana e prokurorit të seancës është mbajtur i njëjti qëndrim si edhe në kërkesën me shkrim të prokurorit dhe nga ana e mbrojtësit është mbajtur qëndrimi për caktim të një mase më të lehtë. Gjykata, në vendimin e saj, nr. 24 datë 14.01.2021 ka vendosur pranimin e kërkesave të prokurorit, duke caktuar masën e sigurimit të propozuar nga ana e prokurorit. Vendimi ka marrë formë të prerë pasi nuk është ankimuar.

Nga trajtimi i rastit në fjalë, në drejtim të përshtatshmërisë dhe proporcionalitetit të masës së sigurimit të kërkuar, me provat në rastin konkret, konstatohet se prokurori konkludon lidhur me shkallën e nevojave të sigurimit, raportit midis rëndësisë së faktit dhe sanksionit të veprës penale, por nuk ka një arsyetim sesi të dhënat/provat në rastin konkret identifikojnë këto elemente të vlerësimit të llojit të masës së sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” sipas parashikimeve të nenit 229 të K.Pr.Penale. Kështu më konkretisht në kërkesën e prokurorit arsyetohet se: *“Për caktimin e masave të sigurimit personal duhet të ekzistojnë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta si dhe të respektohen kriteret për caktimin e tyre. Në rastin konkret: Ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova (të dhënat hetimore të marrë nga burimet përkatëse të provës) të cilat në unitetin e tyre tregojnë se vepra penale është kryer dhe se është kryer nga personi që dyshohet, nuk ka shkaqe padënueshmërie ose të shuarjes së veprës penale. Për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të dyshuarit, pasi ka rrezik që ai të shmanget hetimit, gjykimin dhe vuajtjes së dënimit është e nevojshme që ndaj tij të caktohet një masë sigurimi me karakter shtrëngues. Përsa i përket kriterëve për caktimin e masave të sigurimit: Masa e sigurimit që do të kërkojmë është e përshtatshme për shkallën e nevojave të sigurimit që ekzistojnë në rastin konkret. Ekziston një raport i drejtë midis rëndësisë së faktit dhe sanksionit që parashikohet R.L. ekziston dyshimi i bazuar në prova, për këto arsye ndaj tij, duhet të caktohet masa e sigurimit e “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i K.Pr.penale, me afat për marrjen e provave të nevojshme në ngarkim të këtij shtetasi. Prandaj në bazë të neneve 88, 228, 229, 258 dhe 259 të K.Pr.Penale KËRKOJ: 1. Vlefhtësimin e ligjshëm të arrestit të personit nën hetim R.L. 2. Të caktohet masë sigurimi personal “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, që parashikohet nga neni 234 i K.Penal, ndaj personit nën hetim R.L.”*

Gjykata, në vendimin e saj, nr. 24 datë 14.01.2021 ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit, duke analizuar në mënyrë të përgjithshme dhe abstrakte, si dhe duke mos arsyetuar në mënyrë të ndarë kushtet nga kriteret për caktimin e masës së sigurimit. Gjykata pasi citon nenin 228 të K.Pr.Penale me përshkrimin e plotë të saj, kalon në interpretimin teorik të caktimit të masës së sigurimit, dhe për të vazhduar më tej me citimin e nenit 229/2 të k.p.penale dhe trajtimin teorik të saj. Pas kësaj, gjyqtarja shprehet lidhur me rastin konkret si vijon: *“Në rastin konkret rezulton se veprat penale për të cilat dyshohet shtetasi R.L. të parashikuara nga neni 283/1, 278/3 dhe 279 të K.Penal, janë vepra me një rrezikshmëri shoqërore të lartë, pasi parashikojnë vetëm dënim me burgim, me marzhe jo të ulëta. Si rrethana që lejojnë caktimin e një mase sigurimi të caktuar mund të shërbejnë edhe vështirësitë që mund të sjellë për hetimin dhe gjykimin e drejtë dhe të shpejtë të çështjes lënia e lirë e të dyshuarit, ku gjykata ka parasysh përpjekjet e tij për të penguar zbulimin e së vërtetës.”* Vazhdohet në vendim me aspektin teorik lidhur me kuptimin e veprimeve për zbulimin e së vërtetës, për të kaluar në rastin konkret ku gjykata shprehet *“Në rastin objekt gjykimi nuk është arritur të provohet se i dyshuari ka tentuar të largohet, të fshehtë provat por përkundrazi ai ka dhënë shpjegime në lidhje me ngjarjen dhe ka pranuar faktin e mbajtjes së lëndës narkotike dhe të shkopinjve të gomës.”* Më tej, gjykata arsyeton në aspektin teorik mbi personalitetin e të dyshuarit dhe për rastin konkret shprehet se *“i dyshuari rezulton se është i moshës 22 vjeç, i*

padënuar më parë, beqar.”. Dhe vijohet me përfundimin “Këto rrethana flasin për një rrezikshmëri të ulët të të dyshuarit dhe një fakti i tillë duhet marrë parasysh, në caktimin e masës së sigurimit dhe gjykata cmon se justifikojnë marrjen e një mase sigurimi personal siç është ajo e kërkuar nga ana e organit të akuzës “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” duek patur parasysh edhe faktin që gjykata nuk mund të caktojë një masë më të rëndë sesa ajo e kërkuar nga organi i akuzës. PËR KËTO ARSYE Gjykata bazuar në nenet 228, 229, 234, 244, 251, 252, 258, 259, 514 dhe 515 të K.Pr.Penale VENDOSI:”

Pavarësisht sa më sipër, referuar faktit penal të ndodhur dhe kualifikimit përkatës të bërë nga ana e prokurorit deri në fazën në të cilën është propozuar dhe caktuar masa e sigurimit, nga ku rezulton se dy nga veprat dhe pikërisht ato që lidhen me mbajtjen e fishekëve dhe armës së ftohtë, përbëjnë kundravajtje; sasia e lëndës narkotike e konsideruar relativisht e vogël, në raport edhe me mungesën e të dhënave të tjera mbi rrezikshmërinë e vetë personit, është vlerësuar se kjo masë e propozuar është e përshtatshme dhe plotëson nevojat e sigurimit për personin në fjalë.

⇒ Në 3 zyrat e prokurorive subjekt inspektimi, për periudhën e inspektimit janë konstatuar 3 raste të kërkesave të prokurorit për caktimin e masës së sigurimit sipas parashikimeve të nenit 244/1 të K.Pr.Penale, jo në kushtet e një arrestimi në flagrancë/ndalimi. Në të gjitha këto raste konstatohet se fakti penal lidhet me përdorimin e armës së zjarrit, kryesisht për veprën penale të vrasjes, të kualifikuar sipas nenit 78/1 e 25, 79/dh dhe masa e sigurimit e kërkuar ka qenë ajo e “arrestit në burg”. Për të gjitha këto raste, është pranuar kërkesa e prokurorit për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, dhe në vazhdim rezulton se brenda periudhës së inspektimit, është zbatuar masa e sigurimit për 2⁷⁴ raste ndaj 2 personave të dyshuar autor e dhënë pa praninë e personit të dyshuar si autor i veprës penale dhe në të gjitha këto raste rezulton se personi ka dalë para gjykatës për t’u pyetur brenda afatit 3 ditor të parashikuar nga neni 248 i K.Penal. Për gjitha këto raste, rezulton se qëndrimi i prokurorit ka qenë i pandryshuar për vazhdimin e të njëjtës masë sigurimi, e cila është konsideruar si e tillë e përshtatshme dhe proporcionale edhe nga ana e gjykatës.

Gjithashtu në zyrat e prokurorive subjekt inspektimi janë konstatuar edhe tre raste, të cilat lidhen me faktin e masave të sigurimit të caktuar nga gjykata në dhomë këshillimi, mbi bazën e kërkesës së prokurorit sipas parashikimeve të nenit 244/1 të K.P.Penale dhe që i përkasin si kohë para periudhës së inspektimit, ndërsa zbatimi i masës së sigurimit është brenda periudhës së inspektimit.

Më konkretisht, vlerësohet të trajtohen rastet lidhur me këtë lloj gjykimi, duke ngritur më pas edhe disa çështje të evidentuara në drejtim të unifikimit të praktikës së zyrave të prokurorisë në mënyrën e të proceduarit të tyre.

⁷⁴ Për 1 rast rezulton se kërkesa e prokurorit zyrës Vlorë ka qenë drejtuar ndaj tre personave si bashkëpunëtorë në kryerjen e veprës penale të vrasjes dhe të mbajtjes së armës luftarakë.

A. Rastet kur kërkesa për caktimin e masës së sigurimit dhe zbatimin i saj përfshihen brenda periudhës së inspektimit

I. Rasti lidhet me procedimin penal nr.103 datë 01.02.2021 të zyrës Fier, ku nga ana e prokurorit është kërkuar në gjykatë caktimi i masës së sigurimit “arrest në burg” për të katër personat duke i atribuar vetëm veprën penale të “Vrasjes me paramendim” në bashkëpunim parashikuar nga neni 78/1 e 25 i K.penal.

Fakti penal lidhet me ngjarjen e datës 01.02.2021, ku rreth orës 10.30 në vendin e quajtur “Rotondo” e lagjes “Sheq i Madh” në qytetin e Fierit është vrarë me armë zjarri shtetasi Sh. K, i cili në atë moment ishte duke udhëtuar me automjetin e tij, i dyshuari ka qëlluar nga një mjet Fuoristradë Land Rover me targa të huaja, i cili më pas është gjetur i djegur poshtë urës së mbikalimit të autostradës Fier-Vlorë, në fshatin Baltëz, Fier, nga këqyrja e këtij mjete në brendësi të tij është gjetur një armë zjarri automatik MP5, i cili ka të montuar një krehër me 11 gëzhoja dhe predha të plasura nga zjarri dhe në tytën e tij është i montuar një silenciator.

Për këto shtetas, nga ana e prokurores është kërkuar në gjykatë caktimi i masës së sigurimit “arrest në burg” për të katër personat duke i atribuar vetëm veprën penale të “Vrasjes me paramendim” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 78/1 e 25 i K.penal. Kërkesa është shqyrtuar nga ana e gjyqtarës së caktuar të gjykatës së rrethit gjyqësor Fier, ditën e nesërme të kërkesës, duke vendosur pranimin. Vendimi, mbi bazën e urdhërit të prokurorit është ekzekutuar pas rreth një muaji dhe brenda afatit ligjor, në zbatim të nenit 248 të K.P.Penale, personi ndaj të cilit ishte marrë masa e sigurimit është paraqitur para gjyqtarës që ka dhënë masën e sigurimit, e cila pas marrjes edhe mendimit të prokurorit për vazhdimin e masës së sigurimit, ka vendosur vazhdimin e masës së sigurimit “arrest në burg”. Ky vendim është ankimuar edhe në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila e ka miratuar vendimin e Gjykatës së rrethit gjyqësor Fier.

Nga trajtimi i rastit në fjalë, rezulton se nuk evidentohet që kërkesa për caktimin e masës së sigurimit nga ana e prokurorit të jetë kërkuar lidhur me veprën penale objekt i këtij inspektimi, 278/1 i K.penal, pavarësisht se në hyrje të kërkesës shkruhet që procedimi është regjistruar edhe për këtë veprë. Gjithashtu nuk evidentohet edhe fakti i kryerjes së veprës në bashkëpunim, sipas parashikimeve të nenit 25 të K.Penal ndonëse në kërkesë konkludohet se personat e kanë kryer veprën në bashkëpunim. Mungesa e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 278 i K.Penal në atribuim ndaj personave për të cilën është kërkuar masa e sigurimit, vlerësohet e lidhur me kompleksitetin e ngjarjes, pasi deri në momentin e kërkesës nuk identifikohen rolet e personave si bashkëpunëtorë në kryerjen e veprës penale, si ekzekutorë, bashkë ekzekutorë apo ndihmës. Ndërsa, lidhur me parashikimin e faktit të bashkëpunimit, në interpretim llogjik e material të figurës së një veprë penale, kjo duhet të ishte vlerësuar dhe ndarë atribuimi përkatës në momentin që është vlerësuar regjistrimi i emrit të personave si autorë të dyshuar në kryerjen e vrasjes.

Në rrethana të tilla, megjithëse për këtë çështje nga ana e prokurores në kërkesën e saj nuk është propozuar masa e sigurimit edhe për veprën penale armëmbajtjes pa leje, objekt inspektimi, është vlerësuar se nisur nga fakti penal i ardhjes së pasojës pikërisht nga përdorimi i armës së zjarrit, të përfshihet në trajtim si rast i lidhur me veprën penale të parashikuar nga neni 278 i K. penal.

Në drejtim të proporcionalitetit të masës së sigurimit, sipas kërkesës me shkrim të prokurorit, vlerësohet se nuk ka një analizë lidhur me to. Në kërkesën me shkrim të prokurorit, evidentohet se nuk janë të analizuar konkretisht kushtet e kriteret e përgjithshme e të veçanta, parashikuar nga nenet 228, 229 e 230/1 të K.PR. Penale, ku bazohet dyshimi për secilin prej personave të dyshuar si bashkëpunëtorë dhe provat që e krijojnë atë, por përmenden në përgjithësi këto dispozita. Kështu më konkretisht, prokurori në kërkesë shprehet se: *"Nisur nga sa më sipër ka dyshime se shtetasit A. Z. E. T. E. Xh dhe R.C janë bashkëpunëtorë në vrasjen e shtetasit Sh. K.*

Në këto rrethana ekzistojnë kushtet dhe kriteret ligjore për caktimin e masave të sigurimit personal me karakter shtrëngues, të parashikuara nga nenet 228, 229 dhe 230 të K. PR. Penale.

Konkretisht ekziston dyshimi i arsyeshëm se shtetasit A. Z. E. T. E. Xh, dhe R. C në bashkëpunim me njeri-tjetrin kanë kryer veprën penale të vrasjes me paramendim, parashikuar nga neni 78/1, 25 të Kodit Penal, dyshim ky që bazohet në aktet bashkëlidhur kërkesës për caktimin e masës së sigurimit.

Nuk ka shkaqe padëmueshmërie apo shuarje të veprës penale, si dhe duke vlerësuar rrethanat e faktit dhe personalitetin e të dyshuarit ekziston rreziku që i dyshuari të kryejë vepra të të njëjtit lloj, si dhe është i larguar.

Në lidhje me llojin e masës së sigurimit kërkohet që nga ana e Gjykatës të caktohet ajo e arrestit në burg, e parashikuar nga neni 238 i K. Pr. Penale, pasi kjo është masa e përshtatshme në lidhje me nevojat e sigurimit, rrezikshmërinë e veprës dhe të autorit në rastin konkret".

Por pavarësisht kësaj, vlerësohet se bazuar në nenet 244, 228, 229 e 230 të K. Pr. Penale, kërkesat e prokurorit për caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale dhe vazhdimin e saj, janë proporcionale, në raport me shkallën e nevojave të sigurimit për rastin konkret, rëndësinë e faktit dhe sanksionin që parashikohet për veprat penale të "Vrasja me paramendim" dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit", parashikuar nga nenet 78/1-25 dhe 278/1 të Kodit Penal, pasi çdo masë tjetër do të ishte e papërshtatshme, për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprave dhe të dyshuarve. Masa e dënimit që parashikon neni 78/1 i Kodit Penal është dënim me burgim nga 15 gjer në 25 vjet, ndërsa dënimi që parashikon neni 278/1 i Kodit Penal është 5 gjer në 7 vjet burgim.

Proporcionaliteti i masës së sigurimit, është vlerësuar si i tillë edhe nga ana e gjykatës e cila në raport me kërkesën e prokurorit, rezulton se në të janë arsyetuar kriteret për caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg" sipas nenit 229 të K. PR. Penale, në drejtim të rëndësisë së faktit, rrezikshmërisë së veprës dhe të autorëve të dyshuar, në raport me nevojat e sigurimit personal, si dhe kriteret e veçanta të nenit 230/1 të K. Pr. Penale.

Masa e sigurimit "arrest në burg" është e përshtatshme, pasi në rastin konkret nevojat e sigurimit janë të larta, të cilat i garanton vetëm kjo masë, dhe me anë të kësaj masë ruhet raporti i drejte që ekziston midis rëndësisë së faktit të përshkruar në kërkesë, si dhe sanksionit të veprave penale. Mënyra, koha dhe vendi i kryerjes së veprës penale, tregojnë për një rrezikshmëri të lartë të autorëve dhe të veprës që duhet mbajtur parasysh për nevojat e sigurimit, si dhe pasoja e ardhur.

II. Rasti i çështjes penale 336 datë 16.04.2021 të zyrës Fier, për të cilan nga ana e prokurorit është kërkuar në gjykatë caktimi i masës së sigurimit "arrest në burg" për një person duke i atribuar vetëm veprën penale të "Vrasjes me paramendim", në bashkëpunim, mbetur në tentativë të parashikuar nga neni 78/1, 25 dhe 22 i K.penal.

Fakti penal lidhet me ngjarjen e datës 16.04.2021, ora 14.00, kur është njoftuar salla operative e Komisarariat të Policisë Fier se në fshatin Sulaj, Njësia Administrative Dërmenas Fier, ishte plagosur me armë zjarri shtetasi P. P dhe nga pyetja e tij, rezultonte se ishte qëlluar me armë nga shtetasi R. M. Nga këqyrja e vendit të ngjarjes ka rezultuar se në afërsi të banesës së shtetasit L. B është gjetur me cilësinë e provës materiale një gëzhojë model 54, kalibër 7.62mm, si dhe një armë zjarri pushkë model 63, kalibër 7.6mm.

Për këtë ngjarje, nga ana e prokurorisë është urdhëruar regjistrimi i procedimit penal për veprën penale të vrasjes në bashkëpunim dhe në tentativë, sipas parashikimeve të nenit 78/1, 25 dhe 22 të K.penal dhe 278/1 i K.Penal. Pas regjistrimit të procedimit penal me kryerjen e veprimeve hetimore, nga ana e prokurorisë është proceduar me kërkesën për caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg" ndaj një shtetasi duke u evidentuar si autor i vrasjes, dhe duke mos shprehur asnjë fakt për bashkëpunëtorë. Gjithashtu në kërkesë këtij shtetasi i atribuohet vetëm vepra penale e vrasjes dhe jo dhe ajo e mbajtjes pa leje të armëve luftarake, gjë e cila është bërë në vendimin e Gjykatës.

Kërkesa është shqyrtuar nga ana e gjyqtarës së gjykatës së rrethit gjyqësor Fier, ditën e nesërme të kërkesës, duke vendosur pranimin. Nuk ka të dhëna të mëtejshme, brenda periudhës së inspektimit mbi zbatimin e masës së sigurimit dhe ecurinë e mëtejshme lidhur edhe me ndonjë ankimim.

Për çështjen në fjalë, rezulton se nuk evidentohet që kërkesa për caktimin e masës së sigurimit nga ana e prokurorit të jetë kërkuar lidhur me veprën penale objekt i këtij inspektimi, dhe kjo vepër nuk rezulton t'i jetë atribuar këtij personit edhe sipas urdhërit të regjistrimit të procedimit penal si një akt që i përket një faze të mëparshme sesa kërkesa për caktimin e masës së sigurimit. Gjithashtu evidentohet edhe fakti i kryerjes së veprës në bashkëpunim, sipas parashikimeve të nenit 25 të K.Penal, ndërsa rezulton se prokurori nuk ka të shprehur asnjë fakt për bashkëpunëtorë në kërkesë. Mungesa e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 278 i K.Penal në atribuim ndaj personit për të cilën është kërkuar masa e sigurimit, vlerësohet si një zbatim jo korrekt i nenit 287 të K.Pr.Penale sipas të cilit prokurori është i detyruar që të regjistrojë faktin penal, kur ka të dhëna të

mjaftueshme se ka ndodhur dhe që përbën veprë penale, siç evidentohet qartë në rastin konkret të plagosjes me armë zjarri të një personi.

Në rrethana të tilla, megjithëse për këtë çështje nga ana e prokurorit në kërkesën e tij nuk është propozuar masa e sigurimit edhe për veprën penale armëmbajtjes pa leje, objekt inspektimi, është vlerësuar se nisur nga fakti penal i ardhjes së pasojës pikërisht nga përdorimi i armës së zjarrit, të përfshihet në trajtim si rast i lidhur me veprën penale të parashikuar nga neni 278 i K. penal.

Në drejtim të proporcionalitetit të masës së sigurimit, sipas kërkesës me shkrim të prokurorit, vlerësohet se nuk ka një analizë lidhur me to. Në kërkesën me shkrim të prokurorit, evidentohet se nuk janë të analizuara konkretisht kushtet e kriteret e përgjithshme e të veçanta, parashikuar nga nenet 228, 229 e 230/1 të K.Pr.Penale, ku bazohet dyshimi për secilin prej personave të dyshuar si bashkëpunëtorë dhe provat që e krijojnë atë, por përmenden në përgjithësi këto dispozita. Kështu më konkretisht, prokurori në kërkesë shprehet se: *“Nisur sa më sipër ka dyshime se shtetasi R. M ka tentuar të vrasë me armë zjarri, të cilën e mban pa lejen e organeve kompetente shtetërore shtetasin P. P.*

Në këto rrethana ekzistojnë kushtet dhe kriteret ligjore për caktimin e masave të sigurimit personal me karakter shtrëngues, të parashikuara nga nenet 228, 229 dhe 230 të K. PR. Penale.

Konkretisht ekziston dyshimi i arsyeshëm se shtetasi R. M ne bashkëpunim me persona të tjerë, ka kryer veprën penale të vrasjes me paramendim, e mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 78/1, 22, 25 të Kodit Penal, dyshim ky që bazohet në aktet bashkëlidhur kërkesës për caktimin e masës së sigurimit.

Nuk ka shkaqe padënueshmërie apo shuarje të veprës penale, si dhe i dyshuari është larguar, duke ju fshehur hetimit të çështjes.

Në lidhje me llojin e masës së sigurimit kërkojmë që nga ana e Gjykatës të caktohet ajo e arrestit në burg, e parashikuar nga neni 238 i K. Pr. Penale, pasi kjo është masa e përshtatshme në lidhje me nevojat e sigurimit, rrezikshmërinë e veprës dhe të autorit në rastin konkret”.

Por pavarësisht kësaj, vlerësohet se bazuar në nenet 244, 228, 229 e 230 të K. Pr. Penale, kërkesa e prokurorit për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i K. Pr. Penale, është në raport me shkallën e nevojave të sigurimit për rastin konkret, rëndësinë e faktit dhe sanksionin që parashikohet për veprat penale të “Vrasja me paramendim” në bashkëpunim, në tentativë dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit”, parashikuar nga nenet 78/1-25-22 dhe 278/1 të Kodit Penal, pasi çdo masë tjetër do të ishte e papërshtatshme, për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të dyshuarit. Masa e dënimit që parashikon neni 78/1 i Kodit Penal është dënimi me burgim nga 15 gjer në 25 vjet, ndërsa dënimi që parashikon neni 278/1 i Kodit Penal është 5 gjer në 7 vjet burgim.

Proporcionaliteti i masës së sigurimit, është vlerësuar si i tillë edhe nga ana e gjykatës e cila në raport me kërkesën e prokurorit, rezulton se në të janë arsyetuar kriteret për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” sipas nenit 229 të K. PR. Penale, në drejtim të rëndësisë së faktit,

rrezikshmërisë së veprës dhe të autorëve të dyshuar, në raport me nevojat e sigurimit personal, si dhe kriteret e veçanta të nenit 230/1 të K. Pr. Penale.

Masa e sigurimit "arrest në burg" vlerësohet se është e përshtatshme, pasi në rastin konkret nevojat e sigurimit janë të larta, të cilat i garanton vetëm kjo masë, dhe me anë të kësaj mase ruhet raporti i drejte që ekziston midis rëndësisë së faktit të përshkruar në kërkesë, si dhe sanksionit të veprave penale. Mënyra, koha dhe vendi i kryerjes së veprës penale, tregojnë për një rrezikshmëri të lartë të autorëve dhe të veprës që duhet mbajtur parasysh për nevojat e sigurimit dhe po ashtu dh pasoja e ardhur.

III. Për rastin e çështjes penale 292 i regjistruar më datë 03.03.2021 të zyrës së Prokurorisë Vlorë. për të cilën nga ana e prokurorit është kërkuar caktimi i masës së sigurimit "arrest në burg" ndaj tre personave të dyshuar për kryerjen e veprës penale të "Vrasjes me paramendim", e kryer në bashkëpunim dhe "Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit" parashikuar nga nenet 78, 25 dhe 278/1 i K.Penal.

Fakti penal lidhet me përdorimin e armës së zjarrit duke qëlluar në drejtim të një shtetasi, i cili për pasojë ka gjetur vdekjen. Për këtë ngjarje, nga ana e prokurorisë është urdhëruar regjistrimi i procedimit penal për veprën penale të vrasjes në bashkëpunim dhe në tentativë, sipas parashikimeve të nenit 78, 25 dhe 278/1 të K.penal. Fillimisht për këtë vepër është arrestuar në flagrancë një person, për të cilin nga ana e prokurorisë është kërkuar në gjykatë masa e sigurimit "arrest në burg", masë e cila është pranuar edhe nga ana e gjykatës. Në vijim, me kryerjen edhe të disa veprimeve hetimore nga ana e prokurorit është kërkuar caktimi i masës së sigurimit "arrest në burg" në referim të nenit 244/1 të K.Pr.Penale, ndaj tre personave të tjerë duke i cilësuar si bashkëpunëtorë të personit të parë të arrestuar. Kërkesa për caktimin e masës së sigurimit, është vlerësuar në ditën e dytë të kërkesës së prokurorit, nga ana e njëjti gjyqtar A.S. i cili kishte caktuar masën e sigurimit të mëparshëm të arrestit në burg ndaj personit të parë të arrestuar, dhe është pranuar edhe për tre personat kërkesa e prokurorit për caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg".

Duke iu referuar periudhës së inspektimit rezulton se mbi bazën e urdhërit të prokurorit, është zbatuar pas 2 muajsh masa e sigurimit për njërin nga tre personat për të cilët ishte kërkuar masa e sigurimit. Në respektim të nenit 248 të K.Pr.Penale lidhur me këtë ekzekutim, nga ana e prokurorit është dërguar njoftimi në gjykatë, rreth një ditë pasi është njoftuar nga ana e policisë për këtë zbatim, dhe në gjykatë është zhvilluar seanca përkatëse nga i njëjti gjyqtar që ka caktuar masën e sigurimit, ditën e nesërme, brenda afatit 3 ditor të parashikuar në dispozitën e përmendur. Gjykata ka vendosur lënien në fuqi të masës së sigurimit "arrest në burg". Ndaj këtij vendimi rezulton të jetë ushtruar ankim dhe Gjykata e Apelit me vendimin e datës 10.06.2021 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor.

Nga trajtimi i rastit në fjalë, në drejtim të proporcionalitetit të masës së sigurimit të propozuar, sipas kërkesës me shkrim të prokurorit për caktimin e masës vlerësohet se mungon një analizë e plotë lidhur me këto kritere. Kështu prokurori shprehet se: *“Për sa më sipër, çmujmë se ekzistojnë kushtet dhe kriteret ligjore të parashikuara në nenet 228 e 229 të K.Pr.Penale që ndaj të dyshuarve të caktohet një masë sigurimi me karakter shtrëngues. Konkretisht ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova, të cilat në unitetin e tyre krijojnë dyshimin se vepra penale ka ndodhur dhe se është kryer nga personat. Nuk ka shkaqe padëmueshmërie ose të shuarjes së veprës penale, pasi personat e kanë mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe janë të përgjegjshëm para ligjit për veprimet e kryera, si dhe vepra penale nuk është parashikuar apo shuar në ndonjë mënyrë tjetër. Kushti themelor për caktimin e masave të sigurimit personal është ekzistenca e veprës penale dhe përgjegjshmëria e atij që akuzohet. Vepra penale duhe të jetë e parashikuar nga Kodi penal ose nga ndonjë ligj tjetër, që e konsideron atë si vepër penale. Në kërkesën lidhur me llojin e masës së sigurimit që kërkohet të caktohet mbahet parasysh proporcionaliteti dhe përshtatshmëria specifike e nevojave të sigurimit në rastin konkret me llojin e masës së sigurimit. Në caktimin e masës së sigurimit duhet të kihet parasysh raporti me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Të dhënat dhe deklaratimet e sipërcituara, që i bashkëngjiten kësaj kërkesë, mbështesin ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm se shtetasi E.H. dhe S.G janë autorë të veprës penale “Vrasja me paramendim” e kryer në bashkëpunim dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit” parashikuar nga nenet 78-25 dhe 278/1 i Kodit Penal. Ndërsa nga materialet shtesë të dërguara nga policia gjyqësore janë përfutur të dhëna të arsyeshme se shtetasi S.Z. ka konsumuar element të veprës penale “Vrasje me dashje” mbetur në tentativë dhe “Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit” parashikuar nga nenet 76-22 dhe 278/1 të Kodit Penal. Sa më sipër ndaj të arrestuarit janë administruar të dhëna dhe dyshime të arsyeshme bazuar në prova të cilat janë si më poshtë: Për shkak të rrethanave të faktit, personalitetit të të dyshuarve ka rrezik që ata të kryejnë vepra të tjera penale të së njëjtës natyre që dyshohet se ka kryer ose ndonjë veprë tjetër penale më të rëndë si dhe të vërë në rrezik marrjen dhe administrimin e provave të tjera në kuadër të këtij procedimi penal. Për këto arsye, organi i procedimit vlerëson se ndaj tyre duhet të caktohet një nga masat e sigurimit personal me karakter shtrëngues, si për faktin se ndaj tij rëndon dyshimi për kryerjen e një krimi, ashtu edhe për faktin tjetër se kjo masë do të vijë në dobi të zhvillimit të një gjykimi sa më të shpejtë dhe të drejtë. Nga ana tjetër për shkak të rrezikshmërisë të veçantë të veprës, dhe të personit, sanksionit që parashikon dispozita penale, çdo masë tjetër sigurimi, veç asaj të arrestit në burg do të ishte e papërshtatshme. Gjykata duhet të ketë në vëmendje faktin se lënia e lirë e personit nën hetim, vë në rrezik marrjen dhe vërtetësinë e provës, neni 228/3 gëma “a” të K.Pr.Penale. Për këto arsye, dhe duke vlerësuar se çdo masë tjetër sigurimi, veç asaj të arrestit në burg do të ishte e papërshtatshme, bazuar në nenin 244.1 të K.Pr.penale Kërkojmë ...”*

Pavarësisht mungesës së analizës së plotë të kriterëve të kërkesës së prokurorit, lidhur me masën e sigurisë së kërkuar “arrest në burg”, konstatohet se referuar rrethanave të faktit, personalitetit të të dyshuarve të cilët nuk janë gjetur megjithë kërkimet në fillim nga ana e policisë, llojit të

veprës penale, sanksionit të veprave penale, pasojës së ardhur që është vdekja e një personi, vendi publik ku kjo ngjarje ka ndodhur, kjo masë sigurimi e propozuar nga prokurori për të dy personat bazuar në nenet 244, 228, 229 e 230 të K.Pr.penale vlerësohet se është e përshtatshme dhe proporcionale.

Proporcionaliteti i masës së sigurimit së propozuar, është vlerësuar si i tillë edhe nga ana e gjykatës në vendimin për caktimin e masës së sigurimit tek e cila gjithashtu si edhe në kërkesën e prokurorit, konstatohet se mungon një analizë e plotë lidhur me këto kritere. Gjyqtari argumenton se: *"Në caktimin e masës së sigurimit duhet të kihet parasysh raporti me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprat penale konkrete. Caktimi i kësaj mase sigurimi personal është në përputhje dhe me kriteret e parashikuara në nenin 229 dhe 230 të K.Pr.Penale si rëndësia e faktit, dhe sanksioni që parashikon ligji për veprat penale për të cilën dyshohen këta shtetas, pasojat e ardhura, rolit të tyre në kryerjen e veprave penale. Caktimi i kësaj mase sigurimi personal është në përputhje dhe me kriteret e parashikuara në nenin 229, 230 të K.Pr.Penale si rëndësia e faktit, përhapja e veprave penale dhe sanksioni që parashikon ligji për veprat penale për të cilat dyshohen këta shtetas. Rrezikshmëria e veprave penale është shumë e lartë pasi është cënuar jeta e personave dhe mekanizmi i kryerjes së veprave penale tregon rrezikshmëri shumë të lartë të tyre si autorë të dyshuar."*

Po kështu edhe në vendimin gjyqësor mbi verifikimin e kushteve, nuk konstatohet një analizë lidhur me kushtet dhe kriteret, për të konkluduar në vazhdimin e ekzistencës së tyre. Vendimi paraqitet me konkludime të përgjithshme, lidhur me zbatimin e nenit 248 të K.Pr.penale. Madje në të nuk argumentohet edhe lidhur me faktin se përse nuk qëndron argumentimi i mbrojtjes referuar provave të paraqitura. Kështu gjyqtari, pasi janë parashtruar rrethanat e faktit penal, faktin e vendimmarrjes mbi caktimin e masës së sigurimit ndaj personit të cilit po i verifikohen kushtet, dhe në vazhdim edhe faktin e kohës së ekzekutimit të masës së sigurimit, kalon në citimin e dispozitës sipas nenit 248 i K.Penal, në të gjitha paragrafet, dhe më tej vazhdon me deklarin e të arrestuarit mbi vetëdorëzimin e tij dhe të mbrojtjes që ka kërkuar caktimin e një mase tjetër sigurimi më të butë, "arrest në shtëpi" për shkak të mospasjes së paramendimit në kryerjen e veprës penale dhe të paraqitjes së disa rrethana familjare; për të kaluar më tej në konkludimin se gjykata respektoi kërkesat e nenit të mësipërm dhe vlerëson se masa e sigurimit "arrest me burg" e vendosur sipas vendimit nr. 73 datë 25.03.2021 duhet të lihet në fuqi dhe kjo me arsyetimin se deri në këtë moment nga veprimet hetimore shtetasi vazhdon të jetë i dyshuar për të njëjtat vepra penale për të cilat është caktuar dhe masa e sigurimit. Në këtë vendim, gjyqtari më konkretisht arsyeton se: *"Kodi i Procedurës Penale parashikon Neni 248 1. ... 2. ...3... 4. ... 5. ... 6. ... i arrestuari i pyetur në gjykim deklaroi se ai është vetëdorëzuar pasi është njohur sepse kërkohej nga policia. Mbrojtja e të arrestuarit kërkoi caktimin e një mase tjetër sigurimi për shkak se "Arrest në burg" është masa ekstreme që mund të vendoset dhe të caktohet "Arrest në shtëpi" për shkak se nuk ka pasur paramendim në kryerjen e veprës penale dhe u paraqitën disa rrethana familjare. Gjykata pasi respektoi kërkesat e nenit të mësipërm vlerëson se masa e sigurimit "Arrest në burg" të caktuar me vendimin nr. 73 datë 15.03.2021 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ndaj të*

arretuarit Skedjan Gabrani duhet të lihet në fuqi dhe ky i arrestuar të hetohet nën këtë masë sigurimi për shkak se deri në këtë moment nga veprimet hetimore ky shtetas vazhdon të jetë i dyshuar për të njëjtat vepra penale për të cilat është caktuar edhe masa e sigurimit.”

B. Rastet kur kërkesa për caktimin e masës së sigurimit është jashtë periudhës së inspektimit dhe zbatimi është bërë brenda periudhës së inspektimit.

I. Rasti i parë i përket procedimit penal me nr.1251 datë 05.11.2020 të zyrës Fier, që lidhet me faktin penal të përdorimit të armës së zjarrit, duke shkaktuar plagosjen e një personi. Procedimi penal rezulton të jetë i regjistruar për veprën penale të “Plagosjes së lehtë me dashje” në bashkëpunim dhe të “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga neni 89, 25 dhe 278/1 i Kodit Penal.

Lidhur me këtë procedim penal, mbi bazën e kërkesës së prokurorit, Gjykata e rrethit gjyqësor me vendimin që i përket vitit 2020, ka vendosur caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”. Kjo masë është ekzekutuar pas 3 muajve nga vendimi i gjykatës, në mars të vitit 2021 dhe brenda afatit ligjor të parashikuar nga neni 248 i K.Pr.Penale, shtetasi në fjalë është paraqitur para gjyqtarit që ka dhënë vendimin. Kjo seancë është iniciuar pas kërkesës me shkrim të prokurorit të dërguar ditën kur edhe ekzekutuar masa e sigurimit ndaj personit nën hetim, në të cilën nga ana e prokurorit është kërkuar lënia në fuqi e masës së sigurimit “arrest në burg”. Gjykata ka zhvilluar seancën ditën e nesërme të paraqitjes së kërkesës nga ana e prokurorit, duke vendosur⁷⁵ vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit ndaj personit në fjalë. Vendimi nuk është ankimuar nga palët, duke marrë kështu formë të prerë.

Për rastin në fjalë, duke qenë se kërkesa e prokurorisë për caktimin e masës së sigurimit sipas nenit 244 të K.Pr.Penale është bërë në periudhën që nuk është objekt inspektimi, është vlerësuar kërkesa e prokurorit për verifikimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit “arrest në burg” dhe për vazhdimin e saj. Kjo kërkesë është vlerësuar se është në proporcion me nevojat e sigurimit për rastin konkret, rëndësinë e faktit dhe sanksionin që parashikohet për veprën penale të parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal, e shoqëruar edhe me një vepër tjetër penale si ajo e plagosjes së lehtë me dashje, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal. Ndërsa referuar arsyetimit nga prokurori dhe gjykata lidhur me kriterin e proporcionalitetin, është vlerësuar se niveli i arsyetimit në kërkesa të tilla duhet të jetë më i plotë, përse i përket ekzistencës së kushteve dhe kriterëve për vazhdimin e kësaj mase sigurimi. Kështu nga ana e prokurorit në kërkesën “për verifikimin e zbatimit të masës së sigurimit”, arsyetohet se: “*Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Fier, ka regjistruar procedimin penal nr. ... për veprën penale ... Me vendimin nr. ... datë 17.12.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ... për shtetasin ..., është vendosur masa e sigurimit “arrest në burg”, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale. Nga ana e prokurorit, më datë 17.12.2020, është urdhëruar ekzekutimi i vendimit të mësipërm të Gjykatës për masën e sigurimit, vendim i cili është*

⁷⁵ *Vendimi nr.62-2021—2358 (543), datë 30.04.2021*

ekzekutuar nga policia gjyqësore më datë 30.03.2021, ora 16.30 min, duke e dërguar në Dhomat e Paraburgimit, të I.E.V.P.-së Fier. Për këto arsye, në bazë të nenit 248 të K.Pr.Penale, KËRKOJ Verifikimin e zbatimit të vendimit ... Lënien në fuqi të masës së sigurimit "arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale".

Gjykata e cila e ka shqyrtuar kërkesën në respektim të afatit⁷⁶ të parashikuar në nenin 248 të K.Pr.Penale, në vendimin e saj është shprehur se "Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Fier, ka regjistruar procedimin penal nr. ... për veprën penale Për këtë procedim penal organi i akuzës ka kërkuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg" ndaj shtetasit ... për veprat penale për të cilat ai dyshohet. Nga ana e gjykatës me vendimin nr. ... datë 17.12.2020 është caktuar si masë sigurimi "arrest në burg" ndaj shtetasit, vendim i cili është vënë në ekzekutim nga organet kompetente. Në zbatim të vendimit gjyqësor për caktimin e masës së sigurimit ndaj të dyshuarit F.S. është ekzekutuar kjo masë në datën 30.03.2021 ora 16.30, fakti i cili rezulton nga procesverbali i ekzekutimit të vendimit penal që mban të njëjtën datë. Në përputhje me kërkesat e nenit 248 të K.Pr.Penale janë paraqitur akte në gjykatë për marrjen në pyetje të të pandehurit me qëllim verifikimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit ndaj shtetasit F.S. Nga pyetja e këtij shtetasi si dhe aktet e paraqitura rezultoi se nuk ka ndryshuar asnjë rrethanë apo fakt nga caktimi i masës së sigurimit ndaj shtetasit F.S. dhe ekziston e njëjta nevojë sigurimi si në momentin e caktimit të kësaj mase. Në këto rrethana gjykata çmon se masa e sigurimit "arrest në burg" e vendosur ndaj F.S. me vendimin nr. ... Datë ... të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, duhet të vazhdojë Për këto arsye, në bazë të nenit 248 të K.Pr.Penale. VENDOSI Vazhdimin e masës së sigurimit "arrest në burg" të caktuar me vendimin gjyqësor nr. ... datë ...".

Duke qenë se kërkesa e prokurorisë për caktimin e masës së sigurimit është bërë në periudhën që nuk është objekt inspektimi, vlerësohet kërkesa e prokurorit për verifikimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit "arrest në burg" dhe vazhdimin e saj, për të cilën çmohet se është në proporcion me nevojat e sigurimit për rastin konkret, rëndësinë e faktit dhe sanksionin që parashikohet për veprën penale të parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal, e shoqëruar edhe me një vepër tjetër penale si ajo e plagosjes së lehtë me dashje, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal.

II. Rasti i dytë i përket procedimit penal me nr.890 datë 17.08.2020 të zyrës Fier, që lidhet me faktin penal të përdorimit të armës së zjarrit, e cila është kualifikuar si vrasje me paramendim në tentativë dhe në bashkëpunim. Procedimi penal rezulton të jetë i regjistruar për veprën penale të "Vrasja me paramendim", kryer në bashkëpunim, në tentativë dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit", parashikuar nga nenet 78-22-25 dhe 278/1 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve XH. S, V. S, A. S, E. S dhe K. S.

Lidhur me këtë procedim penal, mbi bazën e kërkesës së prokurorit, Gjykata e rrethit gjyqësor me

⁷⁶ në datë 01.04.2021 ora 11:20:17 – 11:24:22 Gjyqtari rezulton të jetë i ndryshëm nga gjyqtari që ka caktuar seancën dhe nuk ka të dhëna nga dosja gjyqësore për këtë ndryshim.

vendimin që i përket vitit 2020, ka vendosur ndaj të gjithë të dyshuarve, caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg". Kjo masë është ekzekutuar ndaj një personi pas 5 muajve nga vendimi i gjykatës, në maj të vitit 2021 dhe brenda afatit ligjor të parashikuar nga neni 248 i K.Pr.Penale, shtetasi në fjalë është paraqitur para gjyqtarit që ka dhënë vendimin. Kjo seancë është iniciuar pas kërkesës me shkrim të prokurorit të dërguar ditën kur edhe ekzekutuar masa e sigurimit ndaj personit nën hetim, në të cilën nga ana e prokurorit është kërkuar lënia në fuqi e masës së sigurimit "arrest në burg". Gjykata ka zhvilluar seancën ditën e nesërme të paraqitjes së kërkesës nga ana e prokurorit, duke vendosur⁷⁷ vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit ndaj personit në fjalë. Vendimi nuk është ankimuar nga palët, duke marrë kështu formë të prerë.

Për rastin në fjalë, duke qenë se kërkesa e prokurorisë për caktimin e masës së sigurimit sipas nenit 244 të K.Pr.Penale është bërë në periudhën që nuk është objekt inspektimi, është vlerësuar kërkesa e prokurorit për verifikimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit "arrest në burg" dhe për vazhdimin e saj. Kjo kërkesë është vlerësuar se është në proporcion me nevojat e sigurimit për rastin konkret, rëndësinë e faktit dhe sanksionin që parashikohet për veprën penale të parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal, e shoqëruar edhe me një vepër tjetër penale si ajo e vrasjes me paramendim, në bashkëpunim, mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 78-25-22 i Kodit Penal. Nga ana tjetër niveli i arsytimit në kërkesa të kësaj natyre vlerësohet të jetë më plotë, përsa i përket ekzistencës së kushteve dhe kriterëve për vazhdimin e kësaj mase sigurimi. Kështu nga ana e prokurorit në kërkesën "për verifikimin e zbatimit të masës së sigurimit", arsyetohet se: *Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Fier, ka regjistruar procedimin penal nr. ... për veprën penale ... Me vendimin nr. ... datë 03.09.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ... për shtetasin ..., është vendosur masa e sigurimit "arrest në burg", të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale. Nga ana e prokurorit, është nxjerrë urdheri i ekzekutimit. ... Në datën 20.05.2021 ora 20.00 oficeri i policisë gjyqësore ka bërë të mundur ekzekutimin e vendimit të Gjykatës për caktimin e masës së sigurimit arrsi në burg, duke izoluar të dyshuarin V., në dhomat e paraburgimit të Komisarariatit të Policisë Fier. Procesi në ngarkim të të dyshuarit është në fazën e hejimeve paraprake madje në përfundim, dhe nuk ka asnjë zbutje të kushteve dhe kriterëve ligjore për të cilën është caktuar kjo masë. Për këto arsye në bazë të nenit 248 të K.pr.penale KËRKOJ Verifikimin e zbatimit të vendimit ... Lënien në fuqi të masës së sigurimit "arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale".*

Gjykata, me të njëjtën gjyqtar, e cila e ka shqyrtuar kërkesën në respektim të afatit⁷⁸ të parashikuar në nenin 248 të K.Pr.Penale, në vendimin e saj është shprehur se " Se Prokuroria i është drejtuar kësaj gjykate me kërkesën për verifikimin e kushteve ... Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. ... datë ..., ka caktuar ndaj shtetasit ... masën e sigurimit personal " arrest në

⁷⁷ Vendimi nr. 62-2021-1785 (400) datë 01.04.2021.

⁷⁸ Në datë 23.05.2021 ora 9:34:27 – 9:53:52. Në seancë rezultoi të jetë paraqitur prokuror tjetër dhe sipas procesverbalit të seancës nuk ka të dhëna për këtë ndryshim.

burg" Prokuroria ... ka nxjerrë urdhërin dt... për ekzekutimin e vendimit ... Vendimi ... është ekzekutuar nga oficeri i policisë gjyqësore me procesverbalin e dt.21.05.2021 ora 20.00. përfaqësuesi i organit të akuzës kërkoi ..., Gjykata duke iu referuar permbajtjes së nenit 248 të K.Pr.penale ... vlerëson se nuk kanë ndryshuar rrethanat mbi bazën e të cilave është caktuar masa e sigurimit ndaj këtij të arrestuari, si dhe nuk rezulton që të jenë zbatuar nevojat e sigurimit në rastin konkret. Mbrojtësi i të arrestuarit V.S. kërkoi zëvendësimin e kësaj mase sigurimi me masën e sigurimit "arrest në shtëpi", duke parashtur se tashmë kanë janë kryer një sërë veprimesh hetimore në funksion të këtij procedimi penal dhe nuk rezulton të jetë e njëjta gjendje fakti. Në lidhje me këtë pretendim, gjykata vlerëson se nuk ka asnjë të dhënë nga aktet që ndodhen në dosjen gjyqësore dhe që tregojnë faktin e ka ndryshuar gjendja e faktit që i atribuohet personit nën hetim V.S. Nga sa më sipër, gjykata çmon se duhet të vazhdojë të zbatohet masa e sigurimit personal... PËR KËTO ARSYE, gjykata bazuar në nenet 234 dhe 248 të K.Pr.Penale, VENDOSI Vazhdimin e masës së sigurimit "arrest në burg" të caktuar me vendimin gjyqësor nr. ... datë ...".

III. Rasti i tretë i përket procedimit penal me nr.979 datë 25.08.2020 të zyrës Shkodër, që lidhet me faktin penal të përdorimit të armës së zjarrit, duke sjellë për pasojë plagosjen në këmbë të dy personave. Këta të fundit në momentin e ngjarjes, kanë qenë me motor dhe janë ndjekur nga autori me një automjet. Fakti penal është kualifikuar si vrasje në rrethana cilësuese në tentativë. Procedimi penal rezulton të jetë i regjistruar për **veprën penale të "Vrasje në rrethana cilësuese"** mbetur në tentativë dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit" të parashikuara nga nenet 79/dh, 22 dhe 278/1 të K. Penal.

Lidhur me këtë procedim penal, mbi bazën e kërkesës së prokurorit, Gjykata e rrethit gjyqësor, me vendimin që i përket vitit 2020, e datës 3 shtator, ka vendosur ndaj të dyshuarit të kryerjes së kësaj veprë penale, caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg". Kjo masë është ekzekutuar në vitin 2021 në datë 22.05.ora 11.00 dhe po në të njëjtën datë është njoftuar edhe prokurori. Nga ana e këtij të fundit në të njëjtën datë është përcjellë njoftimi në gjykatë dhe mbi këtë bazë është iniciuar nga gjyqtari caktimi i seancës në datë 24.05.2021 e cila ka filluar në orën 09:42 ku është paraqitur shtetasi në fjalë. Gjyqtari në fjalë rezulton të ketë marrë për ndjekje këtë çështje, për shkak të bërjes kompetente të saj, si gjyqtar i seancës paraprake e caktuar për shqyrtimin e kërkesës së prokurorisë me objekt pushimin e procedimit penal ndaj të dyshuarit, për të cilin është ekzekutuar masa e sigurimit. Gjyqtari ka zhvilluar seancën, ku kanë marrë pjesë prokurori i çështjes dhe personit nën hetim i shoqëruar nga mbrojtësi. Prokurori në këtë seancë është shprehur për vijimin e masës deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes⁷⁹, ndërsa avokati ka kërkuar mosvazhdimin e kësaj mase. Vendimi nuk është ankimuar nga palët, duke marrë kështu formë të prerë.

⁷⁹ Rezulton se për çështjen në fjalë të jetë kërkuar pushimi nga ana e prokurorit për shkak se nuk provohet dyshimi për kryerjen e veprës penale nga personi për të cilin ishte caktuar masa e sigurimit, dhe në këtë kërkesë nga ana e prokurorit është kërkuar edhe shuarjen e masës së sigurimit. Gjykimi për këtë kërkesë sipas vendimit të gjykatës, nuk ka përfunduar. (nuk ka të dhëna të tjera më të detajuara)

Për rastin në fjalë, duke qenë se kërkesa e prokurorisë për caktimin e masës së sigurimit sipas nenit 244 të K.Pr.Penale është bërë në periudhën që nuk është objekt inspektimi, dhe si e tillë nuk do të përfshihet në trajtimin e këtij raporti. Ndërsa për procedurën lidhur me marrjen në pyetje të personit ndaj të cilit është ekzekutuar masa e sigurimit sipas parashikimit të nenit 248 të K.Pr.Penale, nga ana e prokurorit të kësaj zyre nuk evidentohet kërkesë me shkrim siç ka ndodhur nga prokurorët e zyrës Fier, por nga vendimi i gjykatës⁸⁰ për këtë rast rezulton se prokurori ka mbajtur qëndrimin për vijimin e zbatimit të masë së sigurimit personal, e cila është vlerësuar dhe pranuar edhe nga gjykata si masa më e përshtatshme dhe proporcionale ndaj të dyshuarit. Në vendimin e saj, nga ana e gjykatës konstatohet se megjithëse nga ana e saj përshkruhet roli i saj aktiv në këto lloj gjykimesh, ku përfshihet edhe verifikimi nëse ekzistojnë ose kushtet, kriteret dhe nevojat e sigurimit, nga ana e saj nuk ka një analizë të plotë në drejtim të kushteve të masës së sigurimit për argumentuar në mënyrë të arsyetuar secilën prej tyre. Kështu lidhur me këtë gjykata shprehet se: *"Në vijim si më sipër nisur nga provat e paraqitura nga përfaqësuesi i prokurorisë, Gjykata vlerëson se këto prova janë të mjaftueshme për të krijuar dyshimin e arsyeshëm për personin nën hetim, të cilat justifikojnë nga ana tjetër caktimin e masës së sigurimit. Gjykata vëren se pas pyetjes së personit nën hetim E.D., pas kërkesës së prokurorit për vijimin e masës së sigurimit, çmon se duhet të vijojë masa e sigurimit me karakter shtrëngues ekstrem "arrest në burg", e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale. Gjykata vlerëson se i dyshuari E.D. dyshohet për kryerjen e veprave penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore, sikurse "Vrasje në rrethana të cilësuar", mbetur në tentativë, si dhe "Mbajtja, prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit", parashikuar nga neet 79/dh-22 dhe 278/1 të K. Penal. Gjithashtu gjykata vëren se edhe pse nga ana e organit të akuzës është paraqitur kërkesë për pushimin e procedimit penal., pasi nuk provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm kryerja e veprës penale nga ana e shtetasit E.D., gjykata vlerëson se gjykimi nuk ka përfunduar, ku fillimisht dy palët e dëmtuara kanë identifikuar si autor të ngjarjes, pikërisht shtetasin E.D., ndërsa një prej tyre i ripyetuar më pas e ka mohuar një fakt të tillë, ku nuk rezultojnë të qarta arsyet e ndryshimit të deklaratimit. Ndërsa i dëmtuari tjetër nuk është bërë e mundur pyetja e tij, pasi është larguar jashtë shtetit. Nisur nga sa më sipër gjykata çmon se ndaj personit nën hetim duhet të vijojë masa e sigurimit personal "arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, pasi nisur nga rrethanat e faktit, ekziston mundësia që i dyshuari mund të ndikojë në marrjen apo vërtetësinë e provave". Dhe lidhur me kriteret, gjykata argumenton se: "Kjo masë është në përputhje me kriteret dhe nevojat e sigurimit në rastin konkret, duke vlerësuar personalitetin e personit në hetim, si dhe rrezikshmërinë e veprave penale për të cilat dyshohet".*

C. Konstatime përgjithshme për të tre zyrat për rastet e caktimit të masës së sigurimit personal shtrëngues, sipas nenit 244/1 i K.Pr.Penale, në dhomë këshillimi

Në të tre zyrat është konstatuar se për të gjitha rastet gjykata në kuadër të zbatimit të nenit 248 të K.Pr.Penale, është njoftuar nga ana e prokurorit për zbatimin e masës së sigurimit të caktuar prej saj në mungesë të të dyshuarit. Mënyra e njoftimit të Gjykatës, me anë të të cilit ka vepruar

⁸⁰Referimi sipas vendimit gjyqësor.

prokurori nuk është i njëjtë në të gjitha zyrat. Kështu në rastet e zyrave Shkodër dhe Vlorë, konstatohet se prokurori vepron me një shkresë përcjellëse duke njoftuar gjykatën për zbatimin e masës së sigurimit dhe të shoqëruar me dokumentacionit përkatës të mbajtur nga ana e oficerit të policisë gjyqësore me këtë rast. Ndërsa në zyrën e prokurorisë Fier, konstatohet se nga ana e prokurorit është vepruar me anë të aktit procedural "për verifikimin e zbatimit të masës së sigurimit".

Lidhur me mënyrën e ndryshme të të proceduarit nga ana e prokurorit për vënien në lëvizje të gjykatës, në kuadër të zbatimit të nenit 248 të K.pr.penale, konstatohet se referuar Kodit të Procedurës Penale nuk parashikohet në asnjë dispozitë shprehimisht se është prokurori ai që vë në lëvizje gjykatën, megjithëse kjo është një praktikë e zbatueshme nga të gjitha zyrat e prokurorisë.

Në nenin 246 të K.Pr.Penale ku parashikohet zbatimi i masave të sigurimit me arrest është përcaktuar në paragrafin e 1 se zbatimi i këtyre masave bëhet nga oficeri ose agjenti i policisë i ngarkuar me zbatimin, cili mban procesverbalin përkatës dhe kjo i dërgohet gjykatës që ka dhënë vendimin ose prokurorit. Sipas këtij parashikimi, oficeri ose agjenti i policisë që bën zbatimin e masës së arrestit, ka detyrimin e njoftimit në radhë të parë gjykatës si organi që ka dhënë vendimin dhe të prokurorit që është ngarkuar me ekzekutimin e vendimit të gjykatës. Është gjykata ajo që ka vendosur masën e sigurimit të arrestit vetëm mbi bazën e kërkesës së prokurorit dhe vetëm me praninë e tij, pa u zbatuar kontradiktorialiteti dhe pa u respektuar e drejta themelore që ka personi ndaj të cilit caktohet masa e sigurimit për t'u dëgjuar, për t'u mbrojtur vetë ose me avokat, për të ngritur pretendime dhe paraqitur prova. Dhe pikërisht nisur nga kjo procedurë e zbatuar, me qëllim të garantimit të një procesi të rregullt me zbatimin e normave kushtetuese dhe atyre ndërkombëtare për të mbrojtur dhe garantuar liritë në një procedim penal për personin të arrestuar mbi bazën e këtij vendimi, ligjvënësi ka ngarkuar asaj përgjegjësinë që pas zbatimit të kësaj mase, brenda afatit 3 ditor, personi të paraqitet para gjykatës e cila nëpërmjet marrjes në pyetje verifikon kushtet e kriteret të caktimit të masës së sigurimit dhe nevojat e sigurimit, dhe kur këto kushte nuk ekzistojnë gjykata vendos revokimin ose zëvendësimin e masës. Nëse nga gjykata nuk procedohet në marrjen në pyetje të këtij arrestuari brenda afatit të parashikuar nga neni 248 i K.Pr.Penale, sipas nenit 261 të K.Pr.Penale, paraburgimi i urdhëruar me vendim gjykate e humbet fuqinë.

Për sa më sipër, është e nevojshme që nga ana e oficerit ose agjentit të policisë që kryen zbatimin e masës së arrestit, sipas paragrafit të parë të nenit 246 të K.Pr.Penale të bëhet njoftimi i gjykatës dhe i prokurorit.

Gjithashtu në vijim të rëndësisë që paraqet kjo procedurë me rastin e zbatimit të masës së sigurimit me arrest, është e rëndësishme të theksohet edhe roli aktiv që duhet të ketë prokurori. Ky i fundit është organi i vetëm i cili mund të kërkojë caktimin e një mase siguri dhe në funksion të këtij atributi është ai që ka vlerësuar në mënyrë të njëanshme mbi bazën e provave të paraqitura, duke bindur gjykatën se në rastin konkret ekzistojnë kushtet dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për caktimin e masës së sigurimit. Dhe për rrjedhojë, edhe ai ka përgjegjësinë që lidhur me ekzistencën e kushteve dhe kriterëve, në rast se nuk kanë ndryshuar, duhet të shprehë qëndrimin e

tij arsyetues lidhur me të dhëna konkrete që evidentojnë mosndryshimn e këtyre kushteve e kritereve si dhe nevojës së sigurimit për të cilën është vendosur kjo masë sigurimi. Dhe në këtë këndvështrim referuar rasteve të zyrave të ndryshme, vlerësohet si një praktikë e mirë që në rastin e zhvillimit të këtyre gjykimeve sipas nenit 245 të K.Pr.Penale, qëndrimi i prokurorit të jetë me shkrim.

⇒ Në 3 zyrat e prokurorive subjekt inspektimi, për periudhën e inspektimit janë konstatuar 10 raste të qëndrimit të prokurorit me rastin e shqyrtimit nga gjykata të kërkesave të personit nën hetim për zëvendësimin e masës së sigurimit, sipas parashikimeve të nenit 260/2 të K.Pr.Penale.

Për këto raste, rezulton se kërkesat kanë qenë në 10 raste kërkesa për zëvendësimin e masës së sigurimit "arrest në burg" në një masë sigurimi më të butë.

Në këto raste, në 2 prej tyre gjykata ka vendosur mospranim në 1 rast për shkak të heqjes dorë dhe në 1 tjetër nuk e ka kaluar në seancë për shkak të mosparaqitjes së kërkesës nga personi i legjitimuar.

Në 8 çështjet e tjera për të cilat rezulton se është zhvilluar shqyrtimi i kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit të kërkuar nga personi nën hetim, në 7 prej tyre qëndrimi i prokurorit në seancë ka qenë për mospranimin e kërkesave, duke argumentuar mosndryshimin e nevojave të sigurimit në 1 rast është evidentuar se nga ana e prokurorit nuk ka një qëndrim konkret lidhur me masën e sigurimit që duhej të vendosej.

Për 7 çështjet në të cilat është shprehur qëndrimi i prokurorit për rrëzimin e kërkesës, vendimi i gjykatës ka qenë dakortues me qëndrimin e prokurorit në 5 raste duke vendosur rrëzimin e kërkesës së personit nën hetim për zëvendësimin e masës. Në 2 rastet e tjera gjykata ka vendosur të zëvendësojë masën e sigurimit nga "arrest në burg" në atë "arrest në shtëpi" dhe "garancisë pasurore". Në 1 nga këto raste, ka patur përsëritje të kërkesës për zëvendësim të masës së sigurimit, ku përsëri nga ana e prokurorit është mbajtur qëndrim rrëzimi të kërkesës, ndërsa nga ana e gjykatës është pranuar kërkesa për zëvendësimin me një masë sigurimi më të butë dhe pikërisht "garanci pasurore" dhe "arrest në shtëpi".

Për çështjen në të cilën është evidentuar se nga ana e prokurorit nuk ka një qëndrim konkret lidhur me masën e sigurimit që duhej të vendosej në vazhdim, nga ana e gjykatës është vendosur zëvendësimi i një mase sigurimi më të butë "detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore".

A. 2 rastet lidhur me pranimin e kërkesës për zëvendësim të masës përkundrejt qëndrimit të prokurorit për rrëzimin e kërkesës së personit nën hetim, dhe rasti i zëvendësimit të masës

së sigurimit përkundrejt qëndrimit të prokurorit për zëvendësimin e masës së sigurimit "arrest në burg" në një më butë.

I. Rasti i pranimit të kërkesës së zëvendësimin të masës së sigurimit, i përket zyrës Shkodër dhe lidhet me procedimin penal me nr. 1258, datë 16.10.2020 në ngarkim të shtetasit B.K., për veprat penale "Dhunë në familje", "Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit" dhe "Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive" të parashikuara nga nenet 130/a, 278 dhe 280 të Kodit Penal. Shtetasi në fjalë është arrestuar në flagrancë dhe nga ana e prokurorit të çështjes është kërkuar vlefësimi i arrestit dhe caktimi i masës së sigurimit "arrest në burg" të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale. Gjykata e rrethit gjyqësor Shkodër, me vendimin e 18.10.2020 ka vendosur pranimin e dy kërkesave të prokurorit.

Më datë 13.01.2021 në gjykatë është regjistruar kërkesa e personit nën hetim për zëvendësim/shuarje mase sigurimi "Arrest në burg", me pretendimin se: *kanë ndryshuar rrethanat e caktimit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues; nuk qëndron asnjë dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova, se personi nën hetim B.K. mund t'i shmangët gjykimin; nga organi i akuzës nuk u paraqit para Gjykatës, asnjë shkak i rëndësishëm që mund të rrezikojë marrjen ose vërtetësinë e provës, neni 228/3, germa "a" i KPrPenale; nuk ekziston rreziku që personi nën hetim B.K., të largohet, neni 228/3, germa "b" i K.Pr.Penale; apo se për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit, personi nën hetim mund të kryejë krime më të rënda ose të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet, neni 228/3, germa "c" i K.Pr.Penale.* Përmbajtja e kërkesës së shtetasit B.K. është vetëm për zëvendësimin e masës, nga arrest në burg në më të lehtë, por kërkesa titullohet "zëvendësim/shuarje....". Kjo rezulton qartë edhe në fund të kërkesës, ku është shprehur kërkesa se: *" pas çmuarjes së këtyre arsyeve dhe rrethanave bazuar në nenin 260/2, 246/6 dhe 260/4 në lidhje me nenin 263/1 "b" të K.Pr.Penale kërkojmë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër: - Zëvendësimin e masës së sigurimit personal nga ajo e "Arrest në burg" parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale ndaj personit nën hetim B.K., në një masë sigurimi më të lehtë ose revokimin e plotë të saj."*

Shqyrtimi i kërkesës është zhvilluar në seancën gjyqësore të datës 14.01.2021, nga i njëjti gjyqtar i cili ka caktuar edhe masën e sigurimit, dhe në mungesë të prokurorit, megjithë njoftimin e kryer nga gjykata. Sipas procesverbalit të seancës gjyqësore dhe vendimit gjyqësore, Gjykata ka sqaruar se bazuar në nenin 261/3 të K.P.Penale ka proceduar me gjykimin në mungesë të prokurorit, për shkak se kërkesa është paraqitur për shuarje të masës së sigurimit dhe gjykimi duhet të zhvillohet brenda 48 orëve dhe se prokurori i caktuar për ndjekjen e kësaj çështje nuk është paraqitur, për shkak të ngarkesës në seanca gjyqësore gjykime themeli, por në informacionin e dërguar me shkrim është shprehur për rrëzimin e kërkesës pasi nevojat e sigurimit janë ato që kanë shërbyer për vendosjen e masës, dhe se nuk ekziston asnjë rrethanë që lehtëson apo zbut nevojën e sigurimit; personi paraqet rrezikshmëri shoqërore; ka kanosur bashkëshorten dhe ka mbajtur armë dhe fishekë në banesën e tij.

Në seancë gjyqësore, nga ana e mbrojtësit është depozituar edhe një deklaratë noteriale datë 14.01.2021, në të cilën vëllai personit nën hetim deklaroi se është i gatshëm të depozitojë dhe të ngurtësojë çdo lloj shume që do çmojë gjykata përse i përket garancisë pasurore, si dhe në fund është shprehur për caktimin e masës së sigurimit arrest në shtëpi dhe të garancisë pasurore.

Gjyqtarja e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në përfundim, ka vendosur⁸¹ rrëzimin e kërkesës për zëvendësimin/shuarjen e masës së sigurimit personal të kërkuarit B.K., duke e lidhur si me nevojat e sigurimit sipas nenit 260/2, 4 i K.pr.penale, ashtu edhe me humbjen e fuqisë së paraburgimit sipas nenit 261/3 të K.Pr.Penale.

Kundër vendimit është bërë ankim nga kërkuari i mbrojtësi i tij, dhe dosja është përcjellë në Gjykatën e Apelit Shkodër me shkresën e datës 28.01.2021. Në të njëjtën datë është bërë regjistrimi i saj në Gjykatën e Apelit, duke iu kaluar gjyqtarit përkatës. Kjo e fundit ka caktuar seancën në datën 05.02.2021 ku është zhvilluar edhe gjykimi. I pranishëm në seancë ka qenë edhe prokurori i apelit i cili ka kërkuar miratimin e vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor, duke shtuar ndryshe nga qëndrimi i gjykatës, qëndrimin e tij mbi veprimtarinë e prokurorit të çështjes. Më konkretisht prokurori i apelit në qëndrimin e tij me shkrim shpehet se: *“nga ana e prokurorisë nuk vërtetohet mungesa e dilijencës në hetim pasi hetimet sipas prokurorit kanë përfunduar dhe kërkuari ju është njoftuar akuzë sipas nenit 130/a, 278/1 e 280 të K.Penal”*.

Gjykata në vendimin e saj nr. 33, datë 05.02.2021 ka vendosur prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve gjykatës së shkallës së parë, për rigjykim me tjetër trup gjykues, duke konkluduar mbi marrjen e vendimit të gjykatës në shkelje procedurale të tilla që pasjellin pavlefshmërinë e tij. Gjykata arsyeton se: *“në Kodin e Procedurës Penale janë parashikuar shprehimisht dhe në mënyrë taksative rastet se kur një gjykim penal mund të zhvillohet në mungesë të përfaqësuesit të organit të akuzës, që janë ankimi ndaj vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal parashikuar nga neni 291/3 e vijues të K.pr.Penale ku theksohet se: ..., si dhe gjykimi për shuarjen për masën e e sigurimit referuar nenit 261 të K.Pr.Penale ku citohet qartazi se: ... Ndërsa në të gjitha gjykimet e tjera penale, prezenca e prokurorit jo vetëm është e nevojshme për gjykimin por e domosdoshme dhe kusht për vlefshmërinë e gjykimit dhe vendimmarrjes, me pasojë të parashikuar shprehimisht në ligj, pavlefshmërinë e vendimit gjyqësor dhe gjithë gjykimit. Në rastin në gjykim, ashtu si edhe rezultoi nga kërkesa e depozituar për shqyrtim e shtetasit nën hetim Besnik Kurtaj, rezultoi se ai i është drejtuar gjykatës me një kërkesë referuar neneve 260/2, 246/6, 260/4 i Kodit të Procedurës Penale, të cilat kanë të bëjnë me zëvendësimin e masës së sigurimit, gjykim i cili gjithmonë zhvillohet në prezencën e detyrueshme të prokurorit. Për me tepër që edhe një nga kushtet kryesore që është pretenduar dhe argumentuar si rrethanë për zëvendësimin e masës së sigurimit, është një rrethanë lehtësuese që është deklarata noteriale e viktimës nga vepra penale për faljen dhe normalizimin e marrëdhënieve me të arrestuarin B.K.. Në analizë të pretendimeve në shqyrtim, Gjykata e Apelit konstaton se nuk është pretenduar asnjë nga rrethanat*

⁸¹ Vendimi nr. 21(187), datë 14.01.2021

e parashikuara nga neni 261 të K.Pr.Penale për tu konsideruar si kërkesë për shuarje mase sigurimit, të tilla si:”

Gjithashtu Gjykata e Apelit Shkodër është shprehur edhe lidhur me qëndrimin e prokurorit për mospjesëmarrje në seancë, duke arsyetuar se: *“Qëndrimi i prokurorit të shkallës së parë është në kundërshtim me ligjin kur pretendon të justifikojë mungesën e saj për shkak të ngarkesës nuk mund të paraqitet në gjykim, arsye e cila nuk justifikon mospjesëmarrjen e saj në këtë gjykim”.*

Ndërkohë që Gjykata e Apelit vendosi kthimin e çështjes për rigjykim, ende pa u regjistruar kjo çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor për rigjykimin edhe një herë të kërkesës nga trupë tjetër gjyqësore, më datë 09.02.2021 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor është regjistruar një kërkesë tjetër nga ana e personit nën hetim, për zëvendësimin/revokimin e masës së sigurimit, **duke u bazuar edhe në nenin 246/6 të K.Pr.Penale.**Në këtë kërkesë nga ana e personit nën hetim, është argumentuar se ndër të tjera se deri në datën e sotme 09.02.2021, pra më shumë se 3 muaj nga data e arrestimit të kërkuesit nga ana e prokurorisë nuk është bërë asnjë veprim hetimor; armët e gjetura në banesë është vërtetuar që janë të babait të personit të arrestuar; nga ana e familjarëve është shprehur vullneti për dhënie garancie pasurore në lidhje me procedimin.

Shqyrtimi i kërkesës është zhvilluar tashmë nga një gjyqtar tjetër që është gjyqtari i seancës paraprake, i caktuar për shqyrtimin e kërkesës së prokurorit në përfundim të hetimeve për dërgimin e çështjes për gjykim⁴². Gjyqtari me vendim ka caktuar zhvillimin e seancës më datë 10.02.2021 ora 10.00, e cila rezultoi se nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së prokurores së seancës, ndërsa rezultonte se ishte shoqëruar i paraburgosuri nga toga e shoqërimit IEVP Shkodër. Lidhur me mungesën e saj, sipas procesverbalit të seancës, gjyqtari ka relatuar *“nuk është paraqitur prokurore M.F. ka marrë dënim nga njoftimi i dërguar nga gjykata nuk është paraqitur, u komunikua me të nga ana e sekretarisë gjyqësore por nuk shprehu dëshirën të paraqitej në gjykim.”* Gjyqtari në vazhdim, pasi është shprehur se gjykimi nuk mund të zhvillohej në mungesë të prokurores e caktimin e seancës tjetër më datë 15.02.2021, ka relatuar *“Te njoftohet titullari i prokurorisë lidhur me mosparaqitjen pa shkak të prokurores në këtë gjykim.”* Seanca e datës 15.02.2021, rezultoi të mos jetë zhvilluar për shkak se gjyqtari është detyruar të largohej për shkak të një rasti vdekje, dhe është relatuar kjo nga sekretarja në prani të prokurorit dhe të paraburgosurit. Seanca e radhës është zhvilluar në datë 22.02.2021, ku rezultoi përsëri se nuk është paraqitur prokurori dhe për këtë, gjyqtari relatoi se: *“nuk është paraqitur prokurori. ka marrë dënim nga njoftimi i dërguar nga gjykata, nuk ka paraqitur shkak për të justifikuar mungesën, nuk dihet arsyeja e saj e mosparaqitjes.”* Në këtë seancë rezultonte të ishte shoqëruar i paraburgosuri. Në vazhdim gjyqtari ka marrë vendim për shtyrjen e seancës, duke qenë se gjykimi nuk mund të

⁴² gjyqtari është gjyqtari i seancës paraprake, i cili ka marrë dhe vendimin nr. 784, datë 23.02.2021, ku është vendosur *“Rrëzimi i kërkesës së Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Shkodër për dërgimin e çështjes në gjyq të procedimit penal nr. 1258 viti 2020 me të pandehur B.K. Kthimin e akteve Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Shkodër, prokurorit të hetimit paraprak, për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale “Dhunë në familje” parashikuar nga neni 130/a/4 K.penal në atë të “Dhunë në familje” parashikuar nga neni 130/a/1 K.penal*

zhvillohet pa praninë e prokurorit. Seanca e radhës, është caktuar më datë 23.02.2021, ku rezulton të jenë paraqitur si i paraburgosuri dhe prokurori. Në këtë seancë nga ana e të pandehurit/mbrojtësit kanë konfirmuar kërkesën e tyre për zëvendësimin ose revokimin e masës së sigurimit, duke shtuar edhe se i qëndrojnë kërkesës për garanci pasurore. Nga ana e prokurorit është shprehur qëndrimi për mospranim të kërkesës, duke qenë se nuk kanë ndryshuar kushtet dhe rrethanat nga dita e caktimit të masës së sigurimit.

Në përfundim, gjykata ka vendosur më datë 23.02.2021 pranimin e kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit personal "Arrest në burg" të kërkuarit B.K., me atë të garancisë pasurore të parashikuar nga neni 236 i KrPr.Penale si dhe masën e sigurimit "Arrest në shtëpi" parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, duke u shprehur konkretisht në dispozitiv se: *"Zëvendësimin e masës së sigurimit "arrest në burg" parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale dhënë ndaj të pandehurit B.K. me vendimin nr. 574 (4054) dt.18.10.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me masën e sigurimit personal "Garanci pasurore" parashikuar nga neni 236 i K.Pr.Penale si dhe masën e sigurimit "Arrest në shtëpi" parashikuar nga neni 237 të K.Pr.Penale. Urdhërohet i pandehuri B.K. të mos largohet nga banesa e vella të tij shtetasi S.K. në adresën Kurtmetaj-Demiraj, ...Bashkia Malësia e madhe. Në zbatim të këtij vendimi, urdhërohet depozitimi si garanci pasurore për të pandehurin B.K. të shumën prej 500.000 lekë. Kjo shumë duhet të depozitohet, për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe për depozitimin e saj duhet njoftuar menjëherë prokurori. Në zbatim të nenit 236 të K.Pr.Penale, menjëherë pas depozitimit të shumës së përcaktuar si garanci pasurore, urdhërohet Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe policia gjyqësore që të kryejë ekzekutimin e këtij vendimi... Masa e sigurimit "arrest në burg", e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale qëndron në fuqi deri në momentin e depozitimit të shumës së përcaktuar nga gjykata në zbatim të masës së sigurimit "Garanci pasurore", e parashikuar nga neni 236 i K.Pr.Penale si dhe njoftimin e prokurorit mbi faktin e depozitimit të shumës së garancisë pasurore në fjalë."*

Kundër vendimit, është ushtruar ankim nga prokurori dhe i pandehuri B. K. Në ankim prokurori arsyeton se vendimi i gjykatës nuk përcakton afat për depozitimin e shumës së garancisë pasurore duke prodhuar pasoja për kohë të pacaktuar. Në rrethanat e faktit i pandehuri paraqet rrezikshmëri shoqërore të konsiderueshme; i pandehuri akuzohet për katër vepra penale; ndodhur në fazë të avancuar procedimi penal, nuk rezulton të jenë zbutur nevojat e sigurimit të vlerësuara me vendimin nr. 575, datë 18.10.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, përkundrazi është rritur rëndësia e faktit dhe nevoja e sigurimit. Gjithashtu arsyeton se ekziston rreziku real i ikjes së të pandehurit dhe qëllim shmangien nga gjykimi dhe se në kushtet kur ai akuzohet edhe për veprën e dhunës në familje, asnjë masë tjetër sigurimi nuk mund të garantojë parandalimin e kryerjes së veprave penale përveç asaj të parashikuar nga neni 238 i K. Penal. i pandehuri nëpërmjet mbrojtësit të tij, në ankimin e tij megjithëse arsyeton mbi zbutjen e nevojave të sigurimit, kërkon shuarjen/revokimin e masës së sigurimit "garanci pasurore" parashikuar nga neni 236 i K.P.Penale.

Dosja është regjistruar në Gjykatën e Apelit më datë 23.03.2021, datë në të cilën është vendosur zhvillimi i seancës gjyqësore më datë 29.03.2021. Në këtë seancë janë dëgjuar edhe prokurori i Apelit i cili ka përkrahur ankimin e prokurorit të rrethit gjyqësor dhe i pandehuri/mbrojtësi i tij të cilët edhe ata i janë përmbytur kërkesës së tyre. Mbrojtësi i pyetur nga ana e gjykatës mbi faktin se e ka kërkuar vetë garancinë që kërkon ta heqë, ai ka shpjeguar se: *“gjykata na sjellë shumë probleme në ekzekutim, masa arrest në shtëpi është e mjaftueshme, ai ka dhënë shpjegime, kërkojmë heqjen e masë së garancisë pasurore për shkak të rrethanave”*.

Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. 73, datë 29.03.2021, pas shqyrtimit të ankimeve sa më sipër, të kërkuarit B.K. ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 59(1088) datë 23.02.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Gjykata e Apelit ka konkluduar se janë zbutur nevojat e sigurimit për të dyshuarin, duke arsyetuar në provat e paraqitura gjatë gjykimit që lidhen si me ndryshimin e cilësisë juridik të veprës duke lehtësuar pozicionin e tij lidhur me nevojat e sigurimit; normalizimin e marrëdhënieve bashkëshortore, rrethanave familjare, sociale dhe ekonomike. Gjithashtu arsyeton se nga ana e prokurorisë janë marrë të gjitha provat e nevojshme për hetimin e kësaj çështje, dhe se aplikimi i një mase sigurimi nuk do të përbëjë rrezik për marrjen apo vërtetësinë e provave, dhe duke e referuar këtë lidhur me pretendimin nga ana e prokurorit.

Çështja në zbatim të vendimit nr. 33, datë 05.02.2021 të Gjykatës së Apelit, të sipërpërmendur është regjistruar më datës 26.02.2021 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku është caktuar gjyqtari i seancës paraprake, dhe i njëjti që ka gjykuar kërkesën e dytë të të dyshuarit për zëvendësimin e masës së sigurimit. Me vendim të gjyqtarit datë 01.03.2021 është caktuar seanca më datë 01.03.2021, dhe në këtë datë është zhvilluar seanca duke u relatuar nga ana e gjykatës se nuk janë paraqitur i dyshuari si kërkuar dhe prokuroria. Në vazhdim relatohet se kjo çështje është kthyer për rigjykim nga Gjykata e Apelit Shkodër për gjykimin e saj me tjetër trup gjykues dhe duke qenë se çështja ndodhet në fazën e seancës paraprake pranë gjyqtarit i ka kaluar atij si gjyqtari kompetent. Gjyqtari vijon në relatimin e tij se sipas objektit, masa e sigurimit tashmë është zëvendësuar me “garanci pasurore” dhe “arrest në shtëpi” me vendimin e datës 23.02.2021 të Gjykatës së rrethit gjyqësor dhe sa më sipër kërkesa ka mbetur pa objekt. Për këto arsye, gjykata relaton vendimin për pushimin e gjykimit.

Në dosjen gjyqësore nuk rezultojnë të jenë kryer njoftime përkatëse lidhur me zhvillimin e kësaj seance.

Në vendimin e zbardhur gjyqtari ka relatuar se: *“Gjykata çmon të theksojë se kërkesa me objekt sa më sipër është e drejtë ekskluzive e palës kërkuese dhe përbën një kusht themelor për zhvillimin e gjykimit nga ana e Gjykatës. Nëse nuk ekziston kjo kërkesë e tillë, Gjykata nuk mund të investohet. Si rrjedhojë nëse kërkuesi nuk paraqitet në gjykim pa shkaqe të arsyeshme për të ndjekur çështjen ose, nëse hiqet dorë nga kërkesa para ose, gjatë gjykimit, gjykimi duhet të pushohet. Në rastin konkret nuk u paraqit kërkuesi. Po ashtu gjykata konstaton se vetë kërkesa ka ngelur pa objekt duke qenë se vetë gjykata më herët ka kryer zëvendësimin e masës së sigurimit caktuar ndaj të pandehurit.”*

Nga trajtimi i rastit në fjalë, në drejtim të proporcionalitetit të masës së sigurimit të propozuar për t'u zëvendësuar, sipas qëndrimit të prokurores, konstatohet se nga ana e saj është bërë arsyetim me shkrim në kuadrin e informacionit të kërkuar nga gjykata sipas parashikimeve të nenit 246/6 të K.Pr.penale, duke përshkruar veprimet hetimore konkrete dhe duke i lidhur ato edhe me nevojat e sigurimit. Kështu prokurori shprehet se: "Gjatë procesit hetimor janë grumbulluar të dhëna shtesë që provojnë faktin penal të dhunës në familje dhe mbajtjes pa leje të armëve në banesë dhe po ashtu të municioneve; si dhe autorësinë e të pandehurit B.K. si kryerësi i veprës penale. Gjatë procesit hetimor, organi procedues ka njohur kallëzueset me të drejtat e tyre në cilësinë e viktimës. Në fazën e tanishme të procesit, po procedohet me njoftimin e akteve procedurale që pasojnë vendimmarrjen e B.K. me cilësinë e të pandehurit dhe më pas kryerjes së procedurave, organi i akuzës do të disponojë me vendimmarrjen përfundimtare. Sa më sipër, nuk ekziston asnjë rrethanë që lehtëson apo zbut nevojën e masës së sigurimit në të cilën ndodhet i pandehuri. Përkundrazi, në ngarkim të tij është formuluar akuzë për kryerjen e veprave penale për t'ë cilat është proceduar. i pandehuri paraqet rrezikshmëri shoqërore. Ai ka kanosur bashkëshorten e tij dhe ushtruar sistematikisht dhunë ndaj tij. i pandehuri ka mbajtur disa lloje armësh në banesën e tij. përveç armëve, ai ka mbajtur pjesë të rëndësishme dhe thelbësore për funksionimin e tyre, siç janë një mori fishekësh, fakt tjetër penale që e ngarkon atë me përgjegjësi penale. Ndodhur para para këtij niveli provueshmërie ndaj të pandehurit, duke patur parasysh rëndësinë e faktit që paraqet dhunim në familje, natyrën e sendeve të kundraligjshëm, mekanizmin e ngjarjes dhe gjendjen e akteve, konkludohet se kërkesa për zëvendësimin e masës së sigurimit është plotësisht e pambështetur në prova dhe e pabazuar ligjërisht. Për shkaqet e lartpërmendura, bazuar në nenin 261. 248/2 të Kodit të Procedurës Penale, i kërkojmë gjykatës rrëzimin e kërkesës së mbrojtësit për zëvendësimin e masës së sigurimit personal ndaj të pandehurit dhe vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal "arrest në burg" parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar me vendimin nr. 575 datë 18.10.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër."

Nga ana e gjykatës që ka vendosur mospranimin e kërkesës për zëvendësim megjithëse vlerësohet që nga ana e saj, nuk ka një arsyetim bazuar në argumente konkrete dhe bazuar në një analizë gjithashtu konkrete se përse nuk ishte para rastit të zëvendësimit të një mase sigurimi. Kështu gjyqtarja shprehet se: "gjykata çmon se ky rast nuk përfshihet në rastet e parashikuara nga neni 260/2 dhe 4 të K.Pr.Penale, pasi rezulton se nevojat e sigurimit nuk janë zbutur dhe fakti është po ai, prandaj masa e zbatuar nuk i përgjigjet rëndësisë së faktit dhe dënimit që mund të caktohet. Nga ana e organit të akuzës nuk vërehet dilligjencë në kryerjen e detyrave të tij gjatë hetimeve paraprake pasi nga ana e tij është marrë vendim për njoftim akuzë. Në këto kushte, gjykata përfundimisht çmon se kërkesa e kërkuesit B.K. duhet rrëzuar, si e pabazuar në ligj dhe në prova."

Përsa i përket gjyqtarit, i cili ka pranuar zëvendësimin e masës së sigurimit, në drejtim të proporcionalitetit të masës së sigurimit konstatohet se nga ana e gjyqtarit nuk ka një arsyetim të qartë lidhur me masat e sigurimit të vendosura referuar kuptimit ligjor të tyre. Kështu nga ana e tij, është vlerësuar caktimi i masës së sigurimit të parashikuar nga neni 236 të K.Pr.Penale, ndërkohë që arsyetimi mbi caktimin e kësaj mase bëhet para arsyetimit e analizës për caktimin

edhe të masës së sigurimit "arrest në shtëpi", duke krijuar konfuzion në drejtim të aplikimit të nenit 236 të K.Pr.Penale kur shprehet në rastin konkret për zëvendësimin e masës së sigurimit "arrest në burg" me dy masa sigurimi. Ndërsa në dispozitiv, gjyqtari shprehet se masa e sigurimit "arrest në burg" do të qëndrojë deri në momentin e depozitimit të garancisë pasurore. Kështu më konkretisht sipas vendimit arsyeton duke u bazuar në ekzistencën e dy kushteve të parashikuar në nenin 228 të K.pr.penale dhe që lidhen me rrezikun e ikjes dhe të rrezikut të prishjes së provave, në referim sipas tij të interpretimit ku është bazuar gjykata në vendimmarrjen për caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg" ndaj personit nën hetim. Në lidhje me arsyetimin e rrezikut të ikjes, konstatohet se nga ana e gjyqtarit nuk bëhet ndonjë arsyetim nëse ky si kusht ekziston apo jo, por kalon në konkludimin se tashmë ky rrezik mund të garantohet nga garancia pasurore e ofruar. Kështu gjykata shprehet se: *"Gjykata konstaton se në vendimin e caktimit të masës së sigurimit "arrest në burg" kjo e fundit ka evidentuar rrezikun e ikjes së të pandehurit, pra shmangies nga drejtësia. Megjithatë duhet patur parasysh se ky rrezik është konstatuar në mungesë të paraqitjes së garancive konkrete nga ana e të pandehurit për të shmangur dyshimet për këtë rrezik. Në rastin në gjykim, tashmë, nga ana e të pandehurit është ofruar vendosja e një "garancie pasurore" për të garantuar se ai nuk do të shmanget drejtësisë. Në lidhje me institutin e "garancisë pasurore" duhet thënë se me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017 ... janë kryer disa ndryshime në nenin 236 ku prashikohet aplikimi i "garancisë pasurore" si masë sigurimi. Në logjikën e ligjvënësit në të gjitha rastet kur dyshohet se i pandehuri mund të shmanget përgjegjësisë penale duke ikur, gjykata mund të aplikojë masën e sigurimit të "garancisë pasurore" si një masë e cila pengon të pandehurin të shmanget drejtësisë përsa kohë që interesat e tij pasurore do të cenoheshin në mënyrë automatike në rast shkelje të urdhërimeve të gjykatës dhe po ashtu shkurton shpenzimet e shtetit në rastin e mbajtjes së personave në kushte paraburgimi. Ndodhur në këto kushte Gjykata vlerëson se në lidhje me rrezikun e ikjes, ky rrezik mund të garantohet nëpërmjet vendosjes së një "garancie pasurore" nga ana e të pandehurit. Gjykata vlerëson se shuma prej 500.000 lekë e ofruar për pagim nga ana e mbrojtjes është e mjaftueshme për të garantuar rrezikun e ikjes. Gjykata krijon bindjen e plotë se vendosja e një shume të tillë si "garanci pasurore" do të mënjanonte rrezikun që i pandehuri të shmangej drejtësisë nisur nga fakti se një shumë e tillë do të dëmtonte interesat ekonomik të të pandehurit. Po ashtu nga ana tjetër nuk duhet harruar fakti se i pandehuri ka kryer tashmë dhe rreth 6 muaj burgim në kushte paraburgimi."*

Pastaj kalon në kushtin tjetër duke arsyetuar se përse nuk ekziston, duke vlerësuar në vazhdim caktimin e masës së sigurimit "arrest në shtëpi" si një masë e përshtatshme në kushtet e rrethanave të normalizimit të marrëdhënieve të të pandehurit e bashkëshortes së tij, ofrimin e banesës nga i vëllai i të pandehuri ku të qëndrojë ky i fundit me qëllim të mos jetë në një banesë me bashkëshorten/viktimën, provat janë administruar dhe i pandehuri ka kërkuar gjykim të shkurtuar. Në përfundim, gjyqtari është shprehur në vlerësimin e zëvendësimit të masës së sigurimit për sa kohë që nevojat e sigurimit mund të realizohen nëpërmjet masave të tjera, për të kaluar në dispozitivin përkatës.

Lidhur me sa më sipër, ashtu siç kemi shpjeguar edhe më sipër, mbi kuptimin e zbatimit të nenit 236 të K.Pr.Penale referuar dispozitës aktuale, aplikimi i saj gjen vend edhe në rastet e

zëvendësimin të masës së sigurimit, por gjithmonë kur masa e zëvendësuar duhet të jetë ajo e "arrestit në burg" ose në "shtëpi" dhe kur ekziston vetëm njëri nga kushtet e parashikuar nga neni 228/3/b i K.Pr.Penale rreziku i ikjes. Në këtë kuptim, caktimi edhe i një mase sigurimi si ajo e "arrestit në shtëpi" pas caktimit të "garancisë pasurore", në vetvete e zhbën këtë masë garancie. Dhe vetë legjislatori në aplikimin e kësaj dispozite, ka parashikuar në paragrafin 4 të tij se kur gjykata pranon kërkesën për garanci pasurore nëse e çmon të përshtatshme, përcakton edhe një nga masat shtrënguese të parashikuara nga shkronjat "a", "b" dhe "c", të nenit 232, të këtij Kodi. Këto masa shtrënguese janë "a" ndalimi i daljes jashtë shtetit; "b" detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore; "c" ndalimi dhe detyrimi për qëndrimin në një vend të caktuar. Në këtë mënyrë, vendosja ndaj personit i dy masave që nuk konkurojnë me njëra tjetrën, por janë alternative, vlerësohet si një zbatim i gabuar i gjyqtarit aplikimi i nenit 236 të K. Pr. Penale.

Gjithashtu për t'u evidentuar sërish në kuadër të të njëjtës dispozite, ashtu siç është konstatuar me të drejtë edhe nga ana e prokurores së çështjes, nga ana e gjyqtarit në dispozitivin e tij nuk është përcaktuar afati kohor lidhur me depozitimin e shumës së garancisë, një detyrim ky i parashikuar në paragrafin 4 të saj "gjykata përcakton shumën që duhet të depozitohet dhe afatin brenda të cilit duhet të kryhet depozitimi". Po kështu lidhur me shumën e përcaktuar, nga ana e gjyqtarit nuk ka asnjë arsyetim sesi e vlerësoi se kjo shumë garancie përbënte një shumë të mjaftueshme për të garantuar rrezikun e ikjes, siç arsyeton vetë në vendim. Ky është një detyrim i parashikuar në paragrafin 3 të nenit 236 të K.Penale dhe shumë e rëndësishme, bazike pasi është e lidhur me jo vetëm me faktin e krijimit të sigurisë se kjo shumë do t'a bëjë atë që të pengohet për t'u larguar⁸³ dhe për t'u paraqitur kur kërkohet gjatë hetimit e gjykimit, por edhe të mos jetë e tepruar⁸⁴, në raport me burimet finaciare.

Konstatimet sa më sipër, lidhur me zbatimin e nenit 236 të K.Pr.Penale, nuk janë evidentuar nga Gjykata e Apelit gjatë shqyrtimit të ankimit ndaj vendimit për zëvendësimin e masës së sigurimit, sipas kompetencave që ajo ka referuar parashikimit të nenit 425 të K.Pr.Penale "I. Gjykata e apelit e shqyrton çështjen brenda shkaqeve të ngritura në ankim. Për çështje të ligjit që duhet të shqyrtohen kryesisht, si dhe për shkaqet e ngritura në ankim që nuk bazohen në motive personale, gjykata e apelit shqyrton edhe pjesën që u takon bashkëpandehurve që nuk kanë bërë apel." Vlerësime të tilla nga ana e Gjykatës së Apelit vlerësohen të rëndësishme, për rastin konkret si të lidhur me përshtatshmërinë dhe proporcionalitetin e këtyre masave të sigurimit zëvendësuese. Për më tepër që duhet të theksohet se nga vetë mbrojtësi në seancën gjyqësore të zhvilluar në Gjykatën e Apelit e pyetur nga kjo e fundit është shprehur se: "gjykata na sjell shumë probleme në ekzekutim, masa arrest në shtëpi është e mjaftueshme, ai ka dhënë shpjegime, kërkojmë heqjen e masë së garancisë pasurore për shkak të rrethanave". Një situatë e tillë, në kushtet kur një skemë alternative kërkon kurdoherë përmbushjen e kushteve nga i akuzuari, si dhe kushtin që duhet të

⁸³ *Leinkoff kundër Republikës Federale Gjermane, Seria A nr. 7, 27 qershor 1968*

⁸⁴ *Neumeister kundër Austrisë, Seria A, nr. 8, 27 qershor 1968; Mangouras kundër Spanjës* ⁸⁴ GJEDNJ i 28 shtator 2010

merret fillimisht pëlqimi i të akuzuarit siç është rasti i aplikimit të nenit 236 të K.Pr.Penale, e bën të paefektshme garancinë e vlerësuar nga ana e gjyqtarit të rrethit gjyqësor në kuptim të nenit 236 të K.Pr.Penale dhe si e tillë do gjendeshim para vlerësimit nga ana e Gjykatës së Apelit lidhur me masën e sigurimit që duhet të vijojë i dyshuari, gjë që nuk rezulton të jetë kryer.

Gjetje të tjera:

Lidhur me rastin në fjalë, vlerësohet të ngrihen disa problematika të konstatuara në veprimtarinë e prokurorit dhe të gjykatës në rastin konkret, si më poshtë:

Së pari lidhur me prokurorin, konstatohet se nga ana e tij nuk është respektuar detyrimi ligjor i parashikuar nga neni 246/6 të K.Pr.Penale për dërgimin e informacionit në gjykatë. Ky informacion është dërguar pas kërkesës së gjykatës, për efekt të zbatimit të detyrimit ligjor në kuadër të shqyrtimit të kërkesës së të dyshuarit për zëvendësimin e masës së sigurimit.

Kontrolli gjyqësor është sanksionuar më së miri në nenin 246/6 të K.Pr.Penale që parashikon se:

“Çdo dy muaj nga zbatimi i vendimit të arrestit, prokurori informon me shkrim gjykatën që ka caktuar masën mbi hetimet e 133 kryera dhe nevojat e sigurimit. Informacioni përmban të dhëna për gjendjen e procedimit, pyetjen e të pandehurit dhe personave të tjerë, përshkrimin e të dhënave të marra dhe shoqërohet me kopje të akteve të fashikullit. Kur prokurori nuk informon në afatit e përcaktuar, gjykata verifikon nevojat e sigurimit me kërkesë të të pandehurit ose kryesisht. Gjykata, pasi dëgjon palët, vendos vazhdimin, zëvendësimin ose revokimin e masës së sigurimit. Zbatohen rregullat e parashikuara në nenet 248 dhe 249 të këtij Kodi”

Nëpërmjet parashikimit të kësaj dispozite ligjvënësi synon që ekzistencën e ligjshmërisë së vijimit të zbatimit të masës së sigurimit ‘arrest në burg’ t’ia nënshtrojë verifikimit të detyrueshëm, periodik, në rrugë gjyqësore. Gjykata e Lartë në vendimin e saj Unifikues me nr. 4/2009 ka theksuar se parashikimi i një dispozite të tillë përsa i përket natyrës dhe llojit të gjykimit nuk ka si qëllim të vendosë një komunikim të qëndrueshëm në linjën gjykatë – prokurori, por që prokurori të detyrohet të informojë periodikisht gjykatën për gjendjen e procedimit, në mënyrë që kjo e fundit të garantojë se ky informacion, kjo gjendje të bëhet objekt i shqyrtimit gjyqësor. Në këtë kontekst gjykata do të ketë kështu mundësi për të çmuar nëse ishte vendi për të revokim apo zëvendësim të masës së sigurimit apo vazhdimin e saj. Nëpërmjet këtij vendimi të rëndësishëm për praktikën e zbatimit të nenit 246/6 të K.Pr.Penale, Gjykata e Lartë theksoi detyrimin e prokurorit në respektim të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, për të përmbushur detyrimin për informacion në zbatim të nenit 246/6 të K.Pr.Penale, duke ia ngarkuar atij barrën e provës për të vërtetuar vijimësinë e zbatimit të masës së sigurimit dhe unifikoi gjithashtu praktikën për shqyrtimin e informacionit në seancë gjyqësore ku gjykata duhet të vendos me shpejtësi për vazhdimin apo ndryshimin e masës së sigurimit.

Gjithashtu lidhur me prokurorin videntohet se mospjesëmarrja e saj në seancën gjyqësore të datës 14.01.2021, ashtu siç është vlerësuar edhe nga Gjykata e Apelit në vendimin e saj të datës nr. 33,

datë 05.02.2021, është në kundërshtim me ligjin dhe se arsyetimi bazuar në ngarkesën në punë nuk mund të përlligji mungesën e tij në gjykimin për shqyrtimin e kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit, të parashikuar në nenin 260/2 të K.penal. Ashtu siç është arsyetuar edhe nga Gjykata e Apelit Shkodër, gjykimi lidhur me kërkesën për zëvendësim mase sigurimi, zhvillohet në seancë gjyqësore në prani të domosdoshme të prokurorit të seancës, dhe ky moszbatim sjell pavlefshmëri të vendimit të marrë. Një qëndrim i tillë mbi zhvillimin e këtij lloj gjykimi në seancë gjyqësore në praninë e domosdoshme të prokurorit, është e konsoliduar në praktikë edhe nga vendimet e Gjykatës së Lartë. Përmendim qëndrimin që është mbajtur nga Kolegji Penal në vendimet e saj me nr. 73.74 datë 03.07.2003 ku është shprehur se *“Kërkesat për revokimin, zëvendësimin apo shuarjen e masave të sigurimit duhet të shqyrtohen në seancë gjyqësore në prani të prokurorit, të pandehurit dhe mbrojtësit.”*, nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues me nr. 1/2009, ku shprehen se: *“Mjeti procedural garantues i parashikuar nga pika 6 e nenit 246 të Kodit të Procedurës Penale, i cili duhet të respektohet rigorozisht nga palët e tjera në procedimin penal dhe gjykata, gjen zbatim krahas garancisë tjetër kushtetuese e ligjore që i njihet në mënyrë të pavarur vetë të arrestuarit për të kërkuar në çdo kohë e rrethanë në gjykatë revokimin apo zëvendësimin e masës së sigurimit. Në të dy këto raste, procedura përkatëse e gjykimit duhet të ofrojë garancitë e duhura në kontekstin e një gjykimi që ka për objekt shqyrtimin e një kërkesë që lidhet me caktimin dhe vazhdimin e zbatimit të një mase që ka të bëjë me kufizimin e lirisë së individit”*. Vetë neni 246/6 i K.Pr.Penale pas ndryshimeve të pësuar me ligjin me nr. 35/2017 duke e lidhur me zbatimin e rregullave të parashikuara në nenin 248 të K.Pr.Penale, e ka parashikuar shprehimisht prezencën e prokurorit në seancë. Kështu në nenin 248 të K.pr.Penale është parashikuar se: *“3. Në pyetjen e të arrestuarit marrin pjesë prokurori dhe mbrojtësi, të cilët lajmërohen nga sekretaria e gjykatës. 4. Gjatë debatit gjyësor palët kanë të drejtë të paraqesin prova, me përjashtim të provave me dëshmitarë”*.

Nga aktet që ndodhen në dosjen gjyqësore, rezulton e qartë se kërkesa e mbrojtësit në rastin konkret ka qenë për zëvendësim dhe kjo duket qartë si nga përmbajtja, kërkesa në fund dhe baza ligjore e cila në asnjë moment nuk i referohet nenit 261 të K.Pr.Penale, ku është referuar gjykata e rrethit gjyqësor. Fakti i kërkesës për zëvendësim rezulton të ketë qenë i qartë edhe nga vetë prokurori, e cila në informacionin e saj të datës 14.01.2021, referuar edhe kërkesës për informacion nga ana e gjykatës dhe njoftimit të kësaj të fundit për zhvillimin e seancës për zëvendësim mase sigurimit, arsyeton se nuk janë zbutur nevojat e masës së sigurimit në të cilin ndodhet i pandehuri B.K., dhe se për këtë i kërkon gjykatës rrëzimin e kërkesës së mbrojtësit për zëvendësimin e masës së sigurimit. Baza ligjore e përmendur nga prokurori neni 261, 248/2 të K.pr.Penale, lidhur me këtë informacion/kërkesë, nuk i përputhet rastit konkret. Neni 261 i K.Pr.Penale lidhet me rastet e shuarjes së masës së sigurimit, që siç ka arsyetuar Gjykata e Apelit nuk përputhet me rrethanat e rastit konkret. Neni 248/2⁸⁵ i K.pr.penale lidhet me rastin e zhvillimit të seancës të marrjes në

⁸⁵ Neni 248 i K.Pr.penale parashikon: *“1. Jo më vonë se tri ditë nga zbatimi i masës, gjykata e merr në pyetje personin për të cilin ka vendosur arrestin në burg ose në shtëpi. Për masat e tjera të sigurimit, shtrënguese ose ndaluese,*

pyetje të personit të arrestuar i cili brenda 3 ditëve nga zbatimi i masës së sigurimit "arrest në burg" të caktuar në mungesë (në dhomë këshillimi) nga gjykata sipas parashikimeve të nenit 244/1 të K.Pr.Penale, dhe paraqitet para saj për të verifikuar kushtet dhe kriteret për caktimin e masës dhe nevojat e sigurimit të parashikuara nga nenet 228, 229 dhe 230 të K.Pr.Penale, ndërsa në rastin konkret jemi para zhvillimit të një seance të iniciuar nga kërkesa e personit ndaj të cilit është caktuar masa e sigurimit në prani të tij, kur është shqytuar arrestimi i tij në flagrancë sipas parashikimeve të nenit 259/3 të K.Pr.Penale, dhe pasi ka kaluar një kohë prej rreth 3 muaj nga zbatimi i masës së sigurimit personi në fjalë i kërkon gjykatës zëvendësimin e masës së sigurimit, sipas parashikimeve të nenit 260 të K.pr.penale që parashikon se: " 2. Kur nevojat e sigurimit zbuten ose kur masa e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit ose dënimit që mund të caktohet, gjykata e zëvendëson masën me një tjetër më të lehtë. ... 4. Kërkesa e prokurorit ose e të pandehurit për revokimin, zëvendësimin ose bashkimin e masave të sigurimit shqyrtohet nga gjykata ku ndodhen aktet, brenda pesë ditëve nga depozitimi i saj. Kur është rast, gjykata vendos edhe kryesisht revokimin ose zëvendësimin e masës së sigurimit gjatë marrjes në pyetje të personit të arrestuar, sipas nenit 248, të këtij Kodi, në rastet e parashikuara nga paragrafi 6, i nenit 246⁸⁶, të tij, gjatë procedimit për sigurimin e provës, gjatë seancës paraprahe ose gjatë gjykimit. Referuar mënyrës së proceduarit sipas parashikimeve të nenit 260 dhe 246/6 të K.pr.penale, dhe praktikës gjyqësore tashmë të konsoliduar edhe nga Gjykata e Lartë, në këto raste, procedura përkatëse e gjykimit duhet të ofrojë garancitë e duhura në kontekstin e një gjykimi që ka për objekt shqyrtimin e një kërkesë që lidhet me caktimin dhe vazhdimin e zbatimit të një mase që ka të bëjë me kufizimin e lirisë së individit, dhe si e tillë prania e prokurorit në seancën gjyqësore është e detyrueshme⁸⁷.

Për sa më sipër, mospjesëmarrja e prokurorit në seancë konsiderohet si një qëndrim në kundërshtim me ligjin procedural dhe nga dosja gjyqësore rezulton se për këtë mospjesëmarrje si në informacion dhe në procesverbalin e seancës gjyqësore rezulton se paraqitja e saj, ka qenë pa shkaqe të arsyeshme. Nga dosja gjyqësore rezulton se prokurori e ka marrë njoftimin e dërguar nga gjykata, ku evidentohet jo vetëm kërkesa për informacion për procedimin penal në fjalë, por edhe njoftimi për zhvillimin e seancës me objekt zëvendësim mase sigurimi. Dhe lidhur me këtë në informacionin e paraqitur nga prokurori nuk është prezantuar ndonjë shkak për mosparaqitje.

gjykata procedon me marrjen në pyetje brenda pesë ditëve nga zbatimi i masës. Mbrojtja ka të drejtë të njihet me aktet dhe të marrë kopje të tyre. 2. Nëpërmjet marrjes në pyetje, gjykata verifikon kushtet dhe kriteret e caktimit të masës dhe nevojat e sigurimit, të parashikuara nga nenet 228, 229 dhe 230 të këtij Kodi. Kur këto kushte nuk ekzistojnë, gjykata vendos revokimin ose zëvendësimin e masës. Në të kundërt, gjykata vendos vazhdimin e zbatimit të saj. Gjykata depoziton vendimin e arsyetuar brenda 48 orëve."

⁸⁶ Neni 246/6 të K.Pr.penale parashikon se: "Çdo dy muaj nga zbatimi i vendimit të arrestit, prokurori informon me shkrim gjykatën që ka caktuar masën mbi hetimet e kryera dhe nevojat e sigurimit. Informacioni përmban të dhëna për gjendjen e procedimit, pyetjen e të pandehurit dhe personave të tjerë, përshkrimin e të dhënave të marra dhe shoqërohet me kopje të akteve të fashikullit. Kur prokurori nuk informon në afatin e përcaktuar, gjykata verifikon nevojat e sigurimit me kërkesë të të pandehurit ose kryesisht. Gjykata, pasi dëgjon palët, vendos vazhdimin, zëvendësimin ose revokimin e masës së sigurimit. Zbatohen rregullat e parashikuara në nenet 248 dhe 249 të këtij Kodi"

⁸⁷ Assenov kundër Bullgarisë, 1998

Këtë fakt, e gjejmë vetëm në vendimin e zbardhur të gjykatës, ku në faqen e parë është shënuar si shkak i mungesës "ngarkesa e prokurorit në seanca gjyqësore, gjykime themeli", por që ngelet i pabazuar duke mos gjetur asnjë të dhënë të tillë arsyetuese as në informacionin e prokurorit dhe në procesverbalin me shkrim të seancës.

Gjithashtu më tej, në të njëjtën çështje konstatojmë sërish të njëjtën sjellje të prokurorit për t'u mos u paraqitur në gjykime të tilla, ku sipas nenit 260/4 të K.Pr.Penale duhet të shqyrtohet nga gjykata brenda 5 ditëve nga depozitimi i saj në sekretarinë e gjykatës. Kështu në gjykimin e çështjes, mbi kërkesën e dytë të të dyshuarit për zëvendësimin e masës së sigurimit, ai është bërë pengesë për moszhvillimin e seancës dy herë. Theksohet pengesë, pasi rezulton se për të dy rastet prokurori ka patur dijeni rregullisht për datën e orën e seancës dhe nuk është paraqitur, pa u dokumentuar një shkak i arsyeshëm. Sjellja e prokurorit në këtë rast vijon edhe më tej, kur megjithëse njoftohet nga sekretaria sërish nuk ka marrë pjesë. Në procesverbalin e seancës gjyqësore, nga gjyqtari relatohet: "Nuk është paraqitur prokurori, ka marrë dijeni nga njoftimi i dërguar nga gjykata nuk është paraqitur, u komunikua me të nga ana e sekretarisë gjyqësore por nuk shprehu dëshirën të paraqitej në gjykim". Kjo sjellje e prokurorit, referuar kuptimit të shkeljes disiplinore të parashikuar nga neni 101 i ligjit me nr. 96/2016, përbën mospërbushje të detyrës, sjellje joprofesionale e cila diskretiton figurën e prokurorit dhe njëkohësisht çënojnë besimin e publikut tek organi i prokurorisë. Për më tepër, ky sjellje e prokurorit është bërë shkak për mospërfundimin sa më shpejt të një procedure gjyqësore lidhur me masat e sigurimit, të cilat prekin drejtëpërdrejt një nga të drejtat themelore të garantuar nga Kushtetuta, konkretisht lirinë e personit.

Vetë legjislatori në Kodin e Procedurës Penale, për shkak të kësaj rëndësie, ka parashikuar në kuadrin e garancive përkundrejt arbitraritetit të kufizimit të lirisë, afate të shkurtra për procedurat ligjore lidhur me masat e sigurimit, duke filluar që me kohën e paraqitjes para gjyqtarit, kohën e përfundimit të procesit dhe deri kohën e arsyetimit të vendimit gjyqësor nga ana e gjykatës.

Së dyti lidhur me veprimtarinë e gjykatës, gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër që ka dhënë vendimin nr. 21(187), datë 14.01.2021 mbi rrëzimin e kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit, vlerësohet të diskutohet fakti i konstatuar nga Gjykata e Apelit mbi pavlefshmërinë e vendimit të gjykatës, për shkak të procedurës së ndjekur nga gjyqtari për shqyrtimin e kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit, pa praninë e prokurorit. Përveç sa është argumentuar nga ana e Gjykatës së Apelit, vlen të evidentohet edhe fakti i pasqyruar nga ana e këtij gjyqtari në vendimin e tij lidhur me mungesën e prokurorit. Sipas vendimit gjyqësor rezulton i pasqyruar faktit se: "Prokurori nuk u paraqit, për shkak të ngarkesës me seanca gjyqësore, gjykime themeli, por paraqiti informacionin e plotë që i përket procedimit penal dhe gjykata, bazuar në nenin 261/3 të K.Pr.Penale, procedoi me gjykimin në mungesë për shkak se kërkesa është paraqitur edhe për shuarje të masës së sigurimit dhe gjykimi duhet të zhvillohej brenda 48 orëve." Ndërsa rezulton që si nga procesverbali i seancës ashtu edhe nga informacioni prokurorit e evidentuar si më sipër, nuk rezulton që të ketë një arsyetim i tillë nga vetë prokurori. Mbi këtë arsyetim mbi mungesën e prokurorit, konstatohet se nga ana e tij është proceduar me gjykimin në mungesë. Por gjithashtu përveç këtij shkak, në këtë pjesë të vendimit që lidhet me mungesën e prokurorit, nga ana e

gjykatës vihet re se është përmendur se lloji i kërkesës ka qenë “edhe për shuarje të masës së sigurimit” dhe lidhur me këtë, pa përsëritur argumentet e gjykatës së Apelit, ku në vendimmarrjen e gjykatës së rrethit argumentohet mbi kërkesën objekt shqyrtimi, duke filluar me nenin 260 të K.Pr.Penale, evidentohet qartë se gjyqtari duke e ditur se jemi para kësaj baze ligjore, sërisht ka vepruar duke proceduar me seancë gjyqësore pa praninë e detyrueshme të prokurorit e cila është në kundërshtim me ligjin, dhe me praktikën e konsoliduar siç argumentuam më sipër. E njëjta gjë evidentohet edhe në seancën e zhvilluar pa praninë e palëve në datën 01.03.2021 nga gjyqtari i seancës paraprahe në zbatim të vendimit nr. 33, datë 05.02.2021 të Gjykatës së Apelit.

II. Rasti i dytë i përket zyrës së prokurorisë Fier, lidhur me procedimin penal me nr. 1150, datë 13.10.2020, të regjistruar në ngarkim të shtetasit R. B, i dyshuar për veprat penale të “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, “Kultivimi i bimëve narkotike”, “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga nenet 278/3/4, 283/1 dhe 284/1 të Kodit Penal.

Fakti penal lidhet me ngjarjen e datës 12.10.2020, kur rreth orës 10.00 policia gjyqësore pas një informacioni të marrë se personi nën hetim R. B merret me kultivimin e bimëve narkotike ka ushtruar kontroll në pronën e banesën e këtij të fundit, ku janë gjetur 165 bimë narkotike të kultivuara dhe në brendësi të banesës një armë zjarri automatik kallashnikov model 56, kalibër 7.62mm, një krehër me 20 fishekë, një krehër pa fishekë, 290 fishekë luftarake, si dhe bimë të ngjashme me ato të kanabis sativa në proces tharje.

Mbi bazën e kërkesës së prokurorit, gjykata e rrethit gjyqësor Fier, me vendimin nr. 62-2020-3865-(1290), datë 16.10.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ka vendosur caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” ndaj personit R.B. **i dyshuar për veprat penale të “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, “Kultivimi i bimëve narkotike”, “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga nenet 278/3/4, 283/1 dhe 284/1 të Kodit Penal.**

Me kërkesën e depozituar në gjykatë në datën 28.01.2021 personi nën hetim R. B ka kërkuar zëvendësimin e masës së sigurimit me pretendimet se jeton me dy prindërit e moshuar dhe të sëmurë, ka dy fëmijë të mitur, nuk ka mundësi për të ndërhyrë në hetim, për të prishur procesin hetimor, personi ka mbajtur qëndrim pohues dhe pendues.

Prokurori⁸⁸ ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, pasi hetimi është në përfundimin e tij dhe se nuk ekzistojnë rrethana që kanë zbutur nevojat e sigurimit. Mbrojtësi kërkoi të caktohet masa e sigurimit “garanci pasurore” ose “detyrimi për tu paraqitur në policinë gjyqësore” ose “arrest në shtëpi”, pasi personi nën hetim është në gjendje të rëndë shëndetësore dhe sipas nenit 230/2 të K. PR. Penale nuk mund të caktohet masa e sigurimit “arrest në burg”.

⁸⁸ Lidhur me këtë qëndrim të prokurorit, është konsultuar vetëm vendimi gjyqësor. Nuk është administruar fashikulli gjyqësor.

Gjykata, me të njëjtin gjyqtar që ka caktuar masën e sigurimit, i ka gjetur të bazuara pretendimet e personit nën hetim, duke vendosur me vendimin nr. nr.62-2021-532 (110), datë 01.02.2021 zëvendësimin e masës së sigurimit "arrest në burg" me "garanci pasurore".

Gjyqtari ka konkluduar mbi pranimin e kërkesës së personit nën hetim për zëvendësimin e masës, duke arsyetuar nevojat e sigurimit, si dhe duke pranuar se vazhdojnë të ekzistojnë dyshime të bazuara në prova se personi nën hetim mund të ketë kryer veprat penale për të cilat po hetohet, shkaqet e padënueshmerise apo të shuarjes së veprës penale. Gjyqtari ka arsyetuar duke marrë në konsideratë dokumentet e paraqitura nga personi nën hetim, në lidhje me arsimin e dy fëmijëve, për gjendjen shëndetësore të prindërve të tij, si dhe letër kërkesën me nr.1692 datë 14.03.2020 të Ministres së Drejtësisë në të cilën kërkohet të kihet parasysh nga organi i ndjekjes penale dhe gjykatat mundësia e caktimit të masave të sigurimit të ndryshme nga ajo e "arrestit në burg" ose zëvendësimi i kësaj të fundit me masa të tjera sigurimi, duke pasur parasysh këtu situatën që kalon vendi nga infeksioni i virusit Covid-2019. Më konkretisht gjykata ka arsyetuar se: "Gjykata i gjen të bazuara pretendimet dhe kërkimin e mbrojtësit dhe të personit nën hetim për zëvendësimin e masës së sigurimit të arrestit në burg me një masë tjetër më të butë siç është ajo e garancisë pasurore pasi: së pari: a) – Vazhdojnë të ekzistojnë dyshime të bazuara në prova se personi nën hetim R.B mund të ketë kryer veprat penale, për të cilën po hetohet. B.- Ndaj personit nën hetim nuk ekziston asnjë shkak padënueshmeria apo të shuarjes së veprës penale. Së dyti: Gjendja familjare e personit nën hetim ku ai është me dy fëmij të mitur si dhe gjendja e rënduar shëndetësore e prindërve të tij të cilët kanë bërë edhe ndërhyrje kirurgjikale, përbëjnë kusht të pramuar edhe nga praktika gjyësore për zbutjen e një mase sigurimi, e lidhur kjo edhe me mundësinë e aplikimit të një dënimi alternative në rast se ai do të dërgohet për gjykim e do të deklarohet fajtor. – nga akti vërtetim i dt.15.01.2021 i lëshuar nga institucioni arsimor ... rezulton se nxënësja R.B, lindur në ...2004 në Fier, vijon studimet në klasën e 10 ... - nga akti vërtetim i dt.15.01.2021 i lëshuar nga institucioni arsimor ... rezulton se nxënësi D.B, lindur në ...2007 në Fier, vijon studimet në klasën e 10 ... – në aktin Vërtetim me nr. Dt.15.01.2021 i lëshuar nga administratori i Nj.adm.Dërmenas evidentohet fakti se z.R.B është banor i fshatit.... . personi në fjalë nuk ka qenë problematik në komunitet dhe gëzon respektin e të gjithëve. Familja e z.R.B. është një familje e respektuar në komunitetin e këtij fshati dhe më gjerë. Z.R.B. jeton me prindërit e tij të moshuar dhe kujdeset për ta edhe pse në gjendjen civile prindërit rezultojnë të ndarë. nga dokumenti "Fletë dalje i dt. 13.01.2021 i lëshuar nga spitali Hygeia Tiranë për shtetasen D.B. rezulton se: Diagnoza e daljes: Trombozë akute Historia e sëmundjes: pacienja transferohet në spitalin tonë nga spitali i Fierit ku ka qenë e hospitalizuar për shkak të anginës ...Në dokumentin Epikrizë e dt.19.12.2020 për shtetasin A.B. të lëshuar nga shërbimi kirurgji pranë Spitalit Rajonal Fier evidentohet fakti se ai është shtruar në pavionin Kirurgji (Reanimacion) prej dt.11.12.2020 deri në dt.19.12.2020 me diagnozë CA-Ventrikuli (stomaku). Në dokumentin Epikrizë përcjellëse dt.15.01.2021 për shtetasen D.B. të lëshuar nga shërbimi kirurgji pranë Spitalit Rajonal Fier evidentohet fakti se ajo është shtruar në pavionin Patologji prej dt.14.01.2021 deri në dt.15.01.2021 me diagnozë Tromboz akute... . Së treti: Gjykata në rastin konkret çmon të marrë parasysh edhe letër-kërkesën me nr.... Dt.... i Ministres së Drejtësisë,

drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në të cilët kërkohen të kihen parasysh nga organi i ndjekjes penale dhe gjykatat, mundësia e caktimit të masave të sigurimit të ndryshme nga ajo e arrestit në burg ose zëvendësimi i kësaj të fundit me masa të tjera sigurimi, duke patur parasysh këtu situatën që kalon vendi ynë nga infeksioni i përhapur i virusit covid 2019. Në nenin 260 pika 2 të K.Pr.Penale parashikohet shprehimisht se: Në analizën dhe vlerësimin në tërësi të akteve, Gjykata duke patur parasysh si shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale konkrete ashtu edhe atë të personit nën hetim, përshtatshmërinë e masës së sigurimit me shkallën e nevojave të sigurimit dhe raportin e saj me rëndësinë e faktit, arrin në konkluzionin se zëvendësimi i masës së sigurimit "arrest në burg", me atë "garancia pasurore" të parashikuar nga neni 236 i K.Pr.Penale, do të ishte plotësisht e bazuar dhe do t'i përgjigjej si rëndësisë së faktit.. PËR KËTO ARSYE gjykata duke parë edhe nenet 279 – 382 dhe 260/2 të K.Pr.penale VENDOSI: "

Me këtë arsyetim gjykata ka pranuar kërkesën e personit nën hetim R. B për zëvendësimin e masës së sigurimit "arrest në burg" caktuar me vendimin nr. 62-2020-3865-(1290), datë 16.10.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me masën "garanci pasurore", parashikuar nga neni 236 i K. Pr. Penale, duke urdhëruar personin nën hetim R.B. që të depozitoj në një institucion bankar shumë prej 400.000 lekë për llogari të prokurorisë brenda një afati prej 48 orësh nga marrja e këtij vendimi.

Ndaj vendimit është ushtruar ankim nga prokurori në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila me vendimin nr.74, datë 11.03.2021 ka vendosur: Ndryshimin e vendimit nr.62-2021-532 (110), datë 01.02.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, si më poshtë:

"Zëvendësimin e masës së sigurimit "arrest në burg", me atë të "arrest në shtëpi" Heqjen e masës garanci pasurore në shumën 400.000 lekë duke iu kthyer pronarit të ligjshëm".

Në këtë rast, duke qenë se kërkesa e prokurorisë për vlefësim arresti në flagrancë dhe caktim të masës së sigurimit është bërë në periudhën që nuk është objekt inspektimi dhe nga ana tjetër duke qenë kërkesë e personit nën hetim, nisur nga të dhënat e administruara vlerësohet vetëm qëndrimi i prokurorit në seancën për zëvendësimin e masës së sigurimit. Ky qëndrim vlerësohet se ka qenë në përputhje me nenin 260/1/2 të K. Pr. Penale dhe me kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit, nevojat e sigurimit, duke vlerësuar vazhdimin e masës së sigurimit "arrest në burg", si një masë proporcionale në shkallën e nevojave të sigurimit dhe në raport me rëndësinë e fakteve penale, sanksionin e dënimit dhe rrezikshmërinë e personit e të veprave penale, si i dyshuar për kryerjen e katër veprave penale.

Ky vlerësim, bëhet në raport me arsyetimin e gjyqtarit në vendimmarrjen e tij, e cila rezulton të jetë e pabazuar në mënyrën sesi gjyqtari ka konkluduar në zëvendësimin e masës së sigurimit, në aplikim të nenit 236 të K.Pr.Penale. I njëjti vlerësim është bërë edhe nga Gjykata e Apelit Vlorë në vendimmarrjen e saj, duke u konkluduar se vendimi për zëvendësimin e masës së sigurimit është marrë në vlerësim të gabuar të rrezikshmërisë shoqërore të personit nën hetim, të rrezikshmërisë shumë të lartë të veprave penale dhe të rrethanave të faktit të kryerjes së tyre, ku

personi nën hetim ka shtyrë në kryerjen e veprës penale edhe persona të tjerë punën e të cilëve e shfrytëzonte për të nxjerrë përfitime personale në fushën e lëndëve narkotike.

Sipas kësaj dispozite, masa e sigurimit "garanci pasurore" mund të vendoset kur plotësohen këto kushte: i) ndaj personit është caktuar ose do të caktohet një masë sigurimi arrest me burg apo arrest në shtëpi; ii) masa e sigurimit arrest në burg apo arrest në shtëpi është vendosur ose do të vendoset vetëm për shkakun e ekzistencës së rrezikut të ikjes së personit sipas kushtit të përcaktuar në shkronjën "b" të paragrafit 3 të nenit 228 të K.Pr.P.; iii) vetë personi i dyshuar ose një person tjetër ofrojnë një shumë monetare të përshtatshme si garanci për të vërtetuar se nuk do të largohet deri në përfundim të gjyqimit, duke kërkuar të hetohet në gjendje të lirë.

Referuar rastit konkret, nga ana e gjyqtarit nuk ka një arsyetim sipas kësaj dispozite, lidhur me provueshmërinë e kushtit se në rastin konkret ekziston vetëm shkak i ekzistencës së rrezikut të ikjes së personit që kushtëzon edhe vijimin e masës së sigurimit "arrest në burg" të vendosur ndaj personit nën hetim, si dhe me parashtrimin e faktit të ofrimit të një shume si garanci. Kështu lidhur me kushtin e rrezikut të ikjes, referuar nenit 228/3/b të K.pr.penale, në vendim nuk gjendet asnjë arsyetim. Asnjë arsyetim nuk gjendet edhe për kushtet e tjera të posaçme të parashikuar në këtë dispozitë. Po kështu lidhur me garancinë pasurore, është e vërtetë që kjo përmendet si kërkesë nga ana e mbrojtësit, si një nga llojet e masave krahas detyrimit për t'u paraqitur në policinë ose arrestit në shtëpi si alternativa të zëvendësimit të masës së sigurimit "arrest në burg", por gjyqtari nuk shprehet nëse ka një ofrim lidhur me këtë garanci dhe nëse po kush, dhe në cilën shumë. Pikërisht nisur nga sa më sipër, masa e sigurimit "garanci pasurore" është aplikuar në interpretim të gabuar të nenit 236 të K.Pr.Penale.

Për më tepër, që duhet theksuar se edhe përcaktimi i shumës si garanci është tërësisht e paqartë dhe në kundërshtim me atë se çfarë parashikon neni 236/3 i k.p.penal "3. Shuma e garancisë pasurore përcaktohet nga gjykata, pasi merr mendimin e palëve, bazuar në nevojat reale të sigurimit, rrethanat personale dhe familjare të të pandehurit, si dhe gjendjen e tij financiare".

Në vijim të parashikimeve procedurale lidhur me këtë masë sigurimi, vlerësohet se edhe mënyra sesi ka disponuar gjyqtari mbi ekzekutimin e kësaj garancie, është tërësisht në kundërshtim me parashikimet të të njëjtës dispozite. Kështu gjyqtari shprehet se shumën do ta depozitojë personi nën hetim, i cili tashmë ndodhet i paraburgosur, dhe duke i lënë për këtë një afat 48 orë, dhe në vazhdim nuk shprehet asgjë tjetër për mënyrën që parashikon neni 236 i K.Pr.Penale për të proceduarit me lirim të tij. neni 236 i K.Pr.Penale parashikon lidhur me këtë se: "4. *i pandehuri qëndron në masë sigurimi arrest në burg ose në shtëpi deri në depozitim të garancisë pasurore. Për depozitim njoftohet menjëherë prokurori. 5. Menjëherë pas njoftimit të depozitimit, në çdo rast jo më vonë se 24 orë nga njoftimi për depozitim të shumës së garancisë pasurore, prokurori verifikon dokumentacionin përkatës, duke urdhëruar, sipas rastit, lirim të menjëhershëm të të pandehurit ose konfirmimin e masës së sigurimit arrest në burg ose në shtëpi.*" Me mënyrën sesi ka arsyetuar gjyqtari, ky urdhërim është në pamundësi ekzekutimi.

III. Rasti i tretë lidhet me procedimin penal nr. 728/2021 i regjistruar më datë 27.05.2021 nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, dhe lidhet me ngjarjen e datës 26.05.2021, ku shtetasi K.Xh. ka goditur me armë zjarri pistoletë shtetasin E.G. në këmbë, dhe për këtë është ndaluar shtetasi K.Xh. për veprën penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit" dhe arrestuar në flagrancë shtetasi E.L. për veprën penale të "Moskallëzim të krimit".

Me kërkesën e datës 28.05.2021, prokurori me kërkesën për vleftësimin e ndalimit dhe të arrestimit në flagrancë, ka kërkuar caktimin ndaj shtetasit K.Xh. të masës së sigurimit "Arrest në burg" për veprën penale të parashikuar nga neni 278/1, 300 dhe 305/b i Kodit Penal, si dhe për shtetasin E.L. caktimin e masës së sigurimit "detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" për veprën penale të parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal.

Kërkesa e prokurorit është regjistruar në gjykatën e rrethit gjyqësor dhe brenda afatit ligjor, nga gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është caktuar shqyrtimi i çështjes në datën 28.05.2021. Në seancën e zhvilluar në datën 28.05.2021, prokurori ka mbajtur të njëjtin ëndrim si me shkrim, dhe nga ana e mbrojtjes i cili ka qenë i njëjti për të dy personat nën hetim, është kërkuar mospranimi i kërkesave të prokurorit për të dy të arrestuarit si lidhur me arrestimin/ndalimin ashtu edhe me masat e sigurimit të kërkuar dhe në alternativë për të ndaluarin K.Xh. një masë më të butë se masa e kërkuar nga ana e prokurorit.

Gjykata në përfundim të shqyrtimit të gjykimit, ka vendosur vleftësimin e ligjshëm të arrestimit/ndalimit për të dy personat e dyshuar dhe për shtetasin K.Xh. është caktuar masa e sigurimit "arrest në burg" parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale dhe për shtetasin E. L. *"Detyrim për paraqitje në polici gjyqësore", parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale.*

Në vazhdim, konstatohet se nga ana e kërkuarit K.Xh. është depozituar në Gjykatën e rrethit gjyqësor Vlorë, kërkesa për zëvendësimin e masës së sigurimit e cila është regjistruar më datë 07.06.2021 dhe është marrë për shqyrtim nga e njëjta gjyqtare që ka caktuar masën e sigurimit. Në këtë kërkesë, nga ana e kërkuarit dhe mbrojtësit të tij, i cili rezulton të jetë i njëjtë me atë që kishte në seancën e vleftësimin të ndalimit dhe caktimit të masës së sigurimit, bazuar në nenin 260/2 të Kodit të Procedurës Penale është kërkuar zëvendësimi i masës së sigurimit "arrest në burg" caktuar me vendimin nr. 142, datë 30.05.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me një masë tjetër sigurimi.

Lidhur me gjykimin e kësaj kërkesë nga ana e gjykatës, është caktuar zhvillimi i seancës në datën 11.06.2021, e cila nuk rezulton të jetë zhvilluar sipas shënimit të sekretares në procesverbal, për shkak se gjyqtari është thirrur në ILDKPI për në datën sipas shkresës së datës 08.06.2021. Sipas të njëjtit procesverbal seanca është shtyrë për në datën 17.06.2021.

Në seancën gjyqësore të datës 17.06.2021, është zhvilluar gjykimi në prani të prokurorit dhe të personit nën hetim/mbrojtësit. Nga ana e këtyre të fundit është mbajtur qëndrimi sipas kërkesës së paraqitur për zëvendësimin e masës së sigurimit dhe nga ana e prokurorit është mbajtur qëndrimi

për mundësi të zëvendësimi të masës së sigurimit personal duke arsyetuar për zbehje të dyshimit që i arrestuari të ketë mbajtur armë zjarri ditën e ngjarjes.

Gjykata në përfundim, sipas vendimit nr. 1418 datë 17.06.2021 ka vendosur: pranimin e kërkesës duke e zëvendësuar masën e sigurimit "arrest në burg" ndaj të dyshuarit K.Xh. me atë me masën e sigurimit personal "Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore" parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale."

Lidhur me proporcionalitetin e masës së propozuar nga ana e prokurorit, referuar parashikimeve të nenit 229/1, 2 dhe 230 të K.Pr.Penale, konstatohet se lidhur me caktimin e masës së sigurimit të shtetasave E.L dhe K. Xh. me rastin e kërkesës për vlefësim arresti dhe ndalimi, vlerësohet se ka një analizë të plotë referuar parimit të përshtatshmërisë dhe proporcionalitetit të masës së sigurimit për secilin prej tyre në mënyrë të veçantë. Ndaj shtetasit E.L. masa e sigurimit "detyrim për paraqitje" u propozua, për shkak të ekzistencës së kushtit të dyshimit të arsyeshëm se nga ana e tij është kryer vepra penale e parashikuar nga neni 300 i K. Penal. Dhe ndaj shtetasit K. Xh masa e sigurimit "arrest në burg", u propozua për shkak të ekzistencës së kushtit të dyshimit të arsyeshëm se nga ana e tij është kryer vepra penale e parashikuar nga neni 278/1, 300 dhe 305/b të K. Penal.

Kështu më konkretisht, konstatohet se prokurori në kërkesën e tij analizon ekzistencën e kushteve dhe kriterëve për caktimin e masave të sigurimit personal, për secilin shtetas të arrestuar duke e lidhur me ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm i bazuar në prova se të arrestuarit janë autor të veprës penale përkatëse e argumentuar kjo në unitet të provave të adminitruara deri në këtë fazë; me faktin se nuk ka shkaqe për moscaktimin e masës së sigurimit personal si ato të parashikuara në nenin 228/2 të K.Pr.penale për padënueshmërinë e personit ose të shuarjes së veprës penale; ekzistencën e kushteve të posaçme për vendosjen e masës së sigurimit si shkaqet që vënë në rrezik marrjen dhe vërtetësinë e provave të nevojshme për hetimet, ekzistencën e rrezikut për t'u larguar, të argumentuar për rastin konkret mbështetur në natyrën e veprës penale të cilat dyshohen këta shtetas, rëndësinë e fakti, sanksionin që parashikon vepra penale, rrethanat e faktit; me përshtatshmërinë e masës së sigurimit me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë për secilin person nën hetim, duke argumentuar mbi raportin e rëndësisë së fakti me sanksionin që parshkohet për veprën penale përkatëse, rrezikshmërinë që paraqet vepra penale përkatëse që i atribuohet secilit të arrestuar dhe rrezikshmërinë e vetë të arrestuarve në përputhje me provat përkatëse të adminitruara. Nga ana e prokurorit, në këtë analizë është vlerësuar në përfundim për secilën masë që do të kërkohet për të arrestuarit, edhe parashikimi ligjor që masa e sigurimit 'arrest në burg' mund të jepet vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të pandehurit. Kështu më konkretisht prokurori shprehet se: *"Në të tilla rrethana, jemi të mendimit që ekzistojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara nga nenet 228, 229 e 235 të Kodit të Procedurës penale për të marrë masa shtrënguese, për arsyt që më poshtë vijojnë: për shtetasin E. L., Për shtetasin e ndaluar K.Xh. së pari: në kuptim të nenit 228/1 të Kodit të Procedurës Penale, në ngarkim të shtetasit K.Xh. ekziston dyshimi i arsyeshëm për kryerjen prej të veprave penale, ... i bazuar ky dyshim në provat e adminitruar deri tani dhe*

të administruar në fashikull. Këto prova, në unitetin e tyre, tregojnë për ekzistencën e atyre elementëve të mjaftueshëm juridikë dhe të rrethanave të faktit që krijojnë bindjen në drejtëm të mundësisë që shtetasit K.Xh. të ketë kryer veprat penale për të cilat dyshohet. Së dyti: nuk ka shkaqe për moscaktimin e masës së sigurimit personal si ato të parashikuara në nenin 228/2 të K.pr.penale për padënueshmërinë e personit (pasi i arrestuari ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe nuk rezulton të jetë i papërgjegjshëm mendërisht) ose të shuarjes së veprës penale (pasi vepra penale sapo ka ndodhur). Së treti: si kushte të posaçme për vendosjen e masës së sigurimit, të parashikuara në nenin 228/3 të K.Pr.Penale, janë ato që kanë të bëjnë me rrezikun e largimit për t'ju shmangur hetimit, gjykimit apo ekzekutimit të vendimit të dënimit që mund të jepet, si dhe rrezikut për kryerje të krimeve të rënda apo të të njëjtit lloj prej tij, apo dhe shkaqe që vënë në rrezik marrjen dhe vërtetësinë e provave që nevojiten të merren në vijim të hetimeve. Në këtë konkluzion arrihet duke patur parasysh: - natyrën e veprave penale për të cilat dyshohet ky shtetas, rëndësinë e faktit, sanksionin e lartë të dënimit që parashikon një nga veprat penale, e cila dënohet vetëm me burgim dhe në maksimum shtatë vjet; - personalitetin e të ndaluarit, i cili paraqet rrezikshmëri të lartë, po të mbahet parasysh mënyra dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale, faktin që nuk ka treguar të vërtetën para organeve të hetimit apo dhe duke fshirë ose lejuar fshirjen e gjurmëve të veprës penale në lokalin e menaxhuar prej tij, etj. Së katërit: bazuar në nenin 229 të K.Pr.Penale, duke pasur parasysh përshtatshmërinë e masës së sigurimit që duhet të caktohet me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret, faktin që masa të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale, duke pasur parasysh se nuk kemi rrethana lehtësuese, Prokuroria çmon se, në përputhje me nenin 230/1 të K.Pr.Penale, e vetmja masë që duhet të caktohet ndaj të arrestuarit është ajo e "arrestit në burg", parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, pasi çdo masë tjetër do të ishte e papërshtatshme. kjo për shkak të rrezikshmërisë që paraqesin veprat penale për të cilat dyshohet i ndaluarit, e cila shprehet në sanksionin e parashikuar për këtë veprë penale, me burg gjer në shtatë; për shkak të mënyrës, rrethanave, kohës, të kryerjes së veprës penale; - për shkak të rrezikshmërisë së lartë të dyshuarit për kryerjen e veprave penale, e cila shprehet nga tërësia e rrethanave të veprimeve të tij të përshkruara më lartë. Sa më sipër, rezulton se ndaj shtetasit K.Xh. duhet të caktohet si masë sigurimi ajo e "arrestit në burg", parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale. Çdo masë tjetër, nuk u përgjigjet nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret. Masat e tjera të sigurimit nuk garantojnë rrezikun e largimit për t'ju shmangur hetimit, rrezikun e kryerjes së të njëjtës veprë penale përsëri, rrezikun për të helmuar provat. Në të kundërt, nuk do të arrihet qëllimi i zbatimit të ligjit penal dhe konkretisht parandalimi i përgjithshëm i këtyre lloj veprave penale dhe parandalimi i posaçëm i të ndaluarit."

Në përfundim, nga ana e prokurorit mbi arsyetimin sa më sipër, mbështetur në dispozitat përkatëse të shprehura 228, 229, 230/1, 234, 244/1, 251, 258 dhe 259/3 të Kodit të Procedurës Penale, është kërkuar para gjykatës, vleftësimi i ligjshëm i ndalimit dhe caktimi i masës së sigurimit "arrest në burg" të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale për shtetasin K. Xh. dhe vleftësimi i ligjshëm i arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit "detyrim për t'u paraqitur në policinë

gjqësore” për shtetasin E. L., duke përcaktuar për këtë të fundit edhe kohën e paraqitjes dhe zyrën përkatëse të oficerit të policisë gjyqësore.

Edhe nga ana e gjykatës bëhet një vlerësim dhe analizë e veçantë për secilin të dyshuar ndaj të cilit është kërkuar masa e sigurimit, duke argumentuar në drejtim të elementëve të përmendur prej saj si rëndësia e faktit, rrethanat e kryerjes së faktit të kundraligjshëm dhe sanksioni i veprës identifikon rrezikshmërinë e të arrestuarit dhe cili është niveli i kësaj rrezikshmërie; si dhe në mënyrë të veçantë lidhur me të dyshuarin ndaj të cilit kërkohet masa e sigurimit “arrest në burg” duke i dhënë përgjigje njëkohësisht edhe pretendimeve të mbrojtësit lidhur me kërkesën e tij për caktimin e një mase sigurimi më të butë nga ajo e kërkuar nga prokurori, referuar parashikimeve të nenit 245/ç të K.Pr.Penale.

Ndërsa lidhur me zëvendësimin e masës së sigurimit të shtetasit K.Xh. të dyshuar për kryerjen e veprës penale të mbajtjes pa leje të armës së zjarrit, konstatohet se nga ana e prokurorit si subjekti procedural i cili investon gjykatën lidhur me caktimin e një mase sigurimi personal, nuk mbahet një qëndrim konkret për masën e sigurimit që duhet të vendoset. Gjithashtu, përveç kësaj nga ana e prokurorit duhet të arsyetohej konkretisht në funksion të parashikimeve ligjore lidhur me faktin se cila është nevoja e sigurimit që është zbutur apo masa e zbatuar nuk i përgjigjet rëndësisë së faktit, duke patur në vëmendje parashikimet në nenet 228, 229 dhe 230 të K.Pr.Penale. Nënvizohet kjo, pasi ashtu siç është argumentuar, duket sikur në rastin konkret ka dyshime për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm se personi nën hetim ka kryer veprën penale për të cilën po kërkohet masa e sigurimit dhe si e tillë referuar nenit 260/1 i K.Pr.Penale, jemi para rasteve të revokimit të masës së sigurimit. Kështu sipas procesverbalit të seancës gjyqësore rezulton se prokurori është shprehur *“Çështja është ende në hetim dhe deri sa vijojn hetimet ende nuk mund të dalim në një konkluzion përfundimtar mbi ekzistencën apo jo të veprës penale. Edhe në këtë fazë të hetimit ekziston dyshimi i arsyeshëm i veprës penale poër të cilën është regjistruar kjo çështje penale, është e vërtetë që është kryer kontrolli i banesës dhe i vendit të punës për personin nën hetim K.XH. dhe nuk ka rezultuar ndonjë send i kundraligjshëm. Është pyetur shtetasi K.Xh.pas marrjes së masës së sigurimit dhe ai ka treguar një pjesë të së vërtetës por nuk e ka treguar gjithë të vërtetën e cila rezulton e evidentuar nga regjistrimet e kamerave të një biznesi aty pranë. Në këtë aspekt çmof se vepra penale e moskallëzimit të krimit në këtë fazë të hetimit nuk ka prova të mjaftueshme është më tepër se dyshim i arsyeshëm për ekzistencën e kësaj vepre penale. Janë zbuluar të dhënat që kishim në momentin e parë, duke çmuar këto të dhëna mund të caktohet një masë më e lehtë.”*

Edhe gjykata në vendimmarrjen e saj, argumenton se nga shqyrtimi i çështjes objekt gjykimi, ka rezultuar se nevojat e sigurimit lidhur me personin nën hetim janë zbutur si dhe masa e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit dhe për këtë analizon provat e administruara gjatë gjykimit të kërkesës, si prova këto të urdhëruara dhe të marra nga prokurori gjatë hetimit të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit K.Xh. Konkretisht nga ana e gjykatës arsyetohet se *“... është zbehur dyshimi se i arrestuari ka qenë posedues i një armë zjarri, dyshim i cili rezulton vetëm nga pamjet filmike por nuk është e shoqëruar me asnjë provë tjetër që të konfirmojë faktin që sendi i mbajtur*

në dorë nga i arrestuari (send që ngjan me armë zjarri) të jetë armë zjarri, përse kohë nuk është përdorur dhe nuk është gjetur fizikisht (kontrollet e urdhëruara nga gjykata me vendimin nr. 1387, datë 01.06.2021, nuk dhanë rezultat pozitiv në favor të akuzës). Në rrethana të tilla, duke pasur parasysh provat e administruara në gjykim dhe gjendjen në të cilën janë hetimet paraprake ndaj shtetasit K.Xh, përfshirë edhe deklarin e prokurorit, nuk është më e nevojshme masa e sigurimit "arrest në burg". Gjykata çmon se si masë sigurimi personal më e përshtatshme ndaj shtetasit K.Xh. duhet të caktohet ajo e "Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësor" parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, referuar kjo edhe rrethanave të kryerjes së veprave penale të cilat dyshohet se ai ka kryer dhe faktit që kërkuesi rezulton të jetë pa precedentë penale".

Nga rasti në fjalë, nisur nga qëndrimi i prokurorit dhe i gjykatës, konkludohet se në rastin konkret jemi para rastit të revokimit të masës së sigurimit parashikuar si e tillë në nenin 260/1 të K.Pr.Penale, që përcakton se "Masat shtrënguese dhe ndaluese revokohen menjëherë kur del se mungojnë kushtet dhe kriteret e zbatimit të tyre". Ndërsa në pikën 2 të nenit 260 të K.Pr.Penle është përcaktuar se: "... kur nevojat e sigurimit zbuten ose kur masa e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit ose dënimit që mund të caktohet, gjykata e zëvendëson atë me një më të lehtë...". Në vështrim të dispozitës së nenit 260, pika 2 të K.Pr.Penale, që nevojat e sigurimit të zbuten do të thotë që, pas vendimit të gjykatës me anën e të cilit është caktuar masa e sigurimit, të kenë ndodhur apo vërtetuar rrethana të reja prania e të cilave bën që nevojat e sigurimit të zbuten, rrethana të cilat vlerësohen në çdo rast konkret nga gjykata që shqyrton kërkesën.

Nga të dhënat e rastit konkret, rezulton se është argumentuar si zbutje të nevojave të sigurimit duke u mbështetur në zbehjen e dyshimit të arsyeshëm se shtetasi K.Xh.ka qenë poseduesi i një arme zjarri. Ky fakt, rezulton se është provuar nga provat e reja të marra pas dhënies së vendimit për caktimin e masës së sigurimit. Por ky fakt, lidhet me dyshimin e arsyeshëm të bazuar në prova, i parashikuar në nenin 228/1 të K.Pr.penale si kusht pa të cilin masat e sigurimit personal nuk mund të vendosen dhe si e tillë mungesa e tij nuk përbën zbutje të nevojave të sigurimit. Ky është qëndrimi që është mbajtur edhe nga Gjykata e Lartë në vendimin e saj me nr.61 datë 20.04.2011⁸⁹. Edhe në këtë rast vlen qëndrimi i mbajtur më sipër se nëse pranohet se egziston ende dyshimi, masa duhet të vijojë ajo që i përgjigjet rëndësisë së faktit, prandaj prokurori duhet të bëjë hetime të shpejta për të konkluduar mbi ekzistencën ose jo të dyshimit të arsyeshëm dhe jo zbehjen e tij.

⁸⁹ Gjykata është shprehur se: "Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e gjen të pabazuar në ligj argumentin si më sipër të përdorur nga Gjykata e Apelit dhe ajo e Shkallës së Parë Shkodër në vendimet e tyre se, mungesa e kushteve të përcaktuara nga ligjvënësi në pikën 3 të nenit 228 të K.Pr.Penale përbën zbutje të nevojave të sigurimit. Duke patur parasysh gjahë sa më sipër, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se Gjykata e Apelit Shkodër, ashtu dhe ajo e Shkallës së Parë Shkodër kanë zbatuar gabim ligjin procedural penal e konkretisht dispozitën e nenit 260, pika 2 të tij."

⇒ Nga inspektimi i kryer në 3 zyrat përkatëse të prokurorisë, është evidentuar edhe një rast me objekt kërkese për caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg" në përfundim të afatit të një mase sigurimi "arrest në burg" me afat e cila ishte vendosur jashtë periudhës së inspektimit.

Për rastin në fjalë, konstatohet se kërkesa e prokurorit nuk është pranuar nga gjykata, duke vendosur humbjen e fuqisë së paraburgimit dhe lirimim të personit. Ky vendim i gjykatës së rrethit gjyqësor rezulton të jetë lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Vlorë, e cila e ka shqyrtuar këtë çështje mbi bazën e ankimit të prokurorit.

Nisur nga këto konstatimeve vlerësohet të trajtohet si rast, duke sjellë të dhënat si më poshtë:

Rasti i përket zyrës së Prokurorisë Fier, lidhur me procedimin penal me nr. 1332 të vitit 2020, të regjistruar në ngarkim të shtetasit K. S, i dyshuar për veprat penale të "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit", parashikuar nga neni 278/3 i Kodit Penal, si dhe ndaj shtetasit I. T, i dyshuar për veprën penale të "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", parashikuar nga neni 283/2 i kodit penal.

Fakti penal lidhet me ngjarjen e datës 06.12.2020 ku punonjësit e policisë në vendin e quajtur "Kryqëzimi i Egnatias" Fier kanë ndaluar për kontroll automjetin e drejtuar nga shtetasi K. S. Gjatë kontrollit të mjetit, është gjetur një qese me pluhur e dyshuar si lëndë narkotike e llojit kokainë. Në vijim në lokalit të shtetasit K. S në fshatin Baltëz Fier janë gjetur pesë mbështjellje plastike të mbushura me pluhur të bardhë e dyshuar si lëndë narkotike e llojit kokainë, katër fishekë pistolete, si dhe një sasi lënde bimore e dyshuar si lëndë narkotike e llojit kokainë. Gjithashtu, shtetasit I. T gjatë kontrollit të banesës i është gjetur një sasi lënde e dyshuar si narkotike e llojit kanabis sativa.

Lidhur me këtë procedim penal, nga ana e prokurorisë është paraqitur para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, kërkesa për vlefësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg" ndaj shtetasve K. S dhe I. T, për të cilën nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me vendimin nr.62-2020-4760 (1552), datë 08.12.2020, orë ska (nga procesesverbali i seancës rezulton se është shpallur në orën 12.24) është vendosur:

"1. Vlefësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë të kryer nga policia gjyqësore në datën 06.12.2020, ora 23.10 ndaj personit nën hetim K. S, për kryerjen e veprave penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve," parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal dhe "Mbajtja pa leje e municionit", parashikuar nga neni 278/3 i Kodit Penal.

2. Caktimin ndaj personit nën hetim K. S si masë sigurimi atë të "arrest në burg me afat 30 ditë", parashikuar nga neni 238 dhe 245 të K. Pr. Penale

3. Vlefësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë të kryer nga policia gjyqësore në datën 06.12.2020, ora 22.30 ndaj personit nën hetim I. T, për kryerjen e veprave penale "Prodhimi dhe

shitja e narkotikëve, "parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal dhe "Mbajtja pa leje e municionit", parashikuar nga neni 278/3 i Kodit Penal.

4. Caktimin ndaj personit nën hetim I. T si masë sigurimi atë të "arrest në burg me afat 30 ditë", parashikuar nga neni 238 dhe 245 të K. Pr. Penale".

Ky vendim nuk është ankimuar nga palët, duke marrë formë të prerë.

Në seancën gjyqësore të zhvilluar për shqyrtimin e kërkesës në fjalë, rezulton se nuk është paraqitur prokurori i çështjes i cili kishte paraqitur edhe kërkesën, por është paraqitur me autorizim një prokuror tjetër, i cili rezulton të ketë mbajtur të njëjtin qëndrim si edhe prokurori i çështjes.

Në vazhdim, në datën 07.01.2021 ora 13.40 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier prokurori i çështjes ka depozituar kërkesën të titulluar "Për lënien në fuqi të caktimit të masës së sigurimit "arrest në burg" për të arrestuarit K. S dhe I. T", për faktin se nuk është administruar akti i ekspertimit kimik dhe toksikologjik dhe duke qene se ekzistojnë kushtet e përgjithshme e të veçanta të parashikuara nga neni 238 i K. PR. Penale, në fund disponon me kërkesën për caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg" ndaj këtyre personave.

Nga kërkesa në fjalë, **konstatohet se në drejtim të proporcionalitetit të masës së sigurimit të kërkuar më datë 07.01.2021**, ajo paraqitet e cunguar, pasi nuk konstatohet të ketë analizë në këtë drejtim. Kështu më konkretisht nga ana e prokurorit përshkruhen rrethanat e faktit, veprimet hetimore të kryera, si dhe pamundësinë e administrimit të dy akteve të ekspertimit për të cilat nga ana e gjykatës ishte lënë si detyre dhe mbi bazën e të cilave gjykata ishte bazuar në dhënien e masës së sigurisë me afat. Në vijim, prokurori konkludon pa një arsyetim se ekzistojnë kushtet e kriteret e përgjithshme e të veçanta, të parashikuar nga neni 238 të Kodit të Procedurës Penale për caktimin e masës së sigurimit personal "arrest në burg" për të dy personat nën hetim. Kështu me konkretisht nga ana e prokurorit, arsyetohet se: "Me vendimin nr. 1552 datë 08.12.2020 nga Gjykata e Shkallës së Parë Fier, është vendosur: Për personin nën hetim K. S. si masë sigurimi atë të "arrest në burg me afat 30 ditë", parashikuar nga neni 238 dhe 245 i K.Pr.Penale. Për personin nën hetim I.T. si masë sigurimi atë të "arrest në burg me afat 30 ditë", parashikuar nga neni 238 dhe 245 i K.Pr.Penale. Duke qenë para këtyre kushteve i kërkojmë gjykatës lënien në fuqi të masës së arrestit pasi deri në këto momente nuk është bërë e mundur administrimi i aktit të ekspertimit kimik dhe aktit toksikologjik. Pra, ekzistojnë kushtet dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta, të parashikuara nga neni 238, të Kodit të Procedurës Penale për caktimin e masës së sigurimit personal Arrest në burg për të dy personat nën hetim. Sa më sipër, bazuar në neni 228, 229, 230, 251/1 e 252, si dhe nenet 244/1 e 258/1 të Kodit të Procedurës Penale KËRKOJ: Caktimin e masës së sigurimit "Arrest në burg" pa afat, për personin nën hetim K.S. parashikuar nga neni 238 i K.Pr. Caktimin e masës së sigurimit

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, gjyqtari i caktuar, më datë 07.02.2021 ka urdhëruar caktimin e seancës gjyqësore për në datë 08.01.2021 ora 08.00, duke urdhëruar në vazhdim edhe njoftimin e prokurorit të çështjes dhe komisariatit e policisë për shoqërimin e të arrestuarve.

Seanca është zhvilluar më datë 08.01.2021, duke filluar në orën 09.00⁹⁰, në prani të prokurorisë të përfaqësuar me autorizim nga një prokuror tjetër i ndryshëm nga prokurori i çështjes dhe nga ai që ka përfaqësuar prokurorinë në seancën për caktimin e masës së sigurimit me afat, dhe mbrojtësit të personave nën hetim. Këta të fundit kanë lëshuar deklaratë ku shprehnin vullnetin për mosparaqitje dhe përfaqësimin e tyre nga mbrojtësi. Gjatë kësaj seance prokurori ka mbajtur të njëjtin qëndrim si prokurori me shkrim, ndërsa avokatët kanë kërkuar rrëzimi i kërkesës dhe shuarje të masës së sigurimit bazuar në nenin 261/ç të K.Pr.Penale dhe në alternativë njëri prej mbrojtësve kërkon caktimin e masës së sigurimit "detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore".

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata pasi është tërhequr në marrjen e vendimit në dhomë këshillimi dhe është rikthyer, në orën 10:08 ka vendosur konstatimin e humbjes së fuqisë së masës së sigurimit të caktuar me vendimin nr.62-2020-4760 (1552), datë 08.12.2020, për të dy personat nën hetim dhe ka caktuar ndaj tyre masën e sigurimit "arrest në shtëpi" të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale.

Gjykata ka vendosur konstatimin se masa e sigurisë e ka humbur fuqinë e saj në bazë të nenit 261/1, gërma ç), të K. Pr. Penale, duke arsyetuar se rezulton se ka një moment shkëputje nga data e dhënies së masës së sigurimit dhe momentit në të cilin është paraqitur para gjykatës kërkesa për lënien në fuqi të masës së sigurimit "arrest në burg". Sipas saj prokurori e ka paraqitur kërkesën për caktimin e masës së re në datën 07.01.2021, ora 13.40, pasi ka përfunduar afati 30 ditor i parashikuar në vendimin e gjykatës dhe sipas gjykatës rezulton se "zgjatja e afatit të masës" e kërkuar nga prokurori nuk mund të aplikohet. Dhe në vazhdim, duke e konsideruar kërkesë re, ka vlerësuar në interpretim të nenit 266 të K. Pr. Penale, caktimin e masës së sigurimit arrest në shtëpi për të dy personat nën hetim. Kështu më konkretisht lidhur me këtë, gjykata arsyeton se: "*Lidhur me kërkesën e mbrojtjes për shuarje të masës së sigurimit. Duke patur në konsideratë parashikimet e nenit 261/1, gërma "ç", i cili parashikon se: ..., rezulton se ka një moment 'shkëputje' nga data e dhënies së masës së sigurimit, dhe momentit në të cilin është paraqitur përpara gjykatës së rrethit gjyqësor Fier, kërkesa për lënien në fuqi të masës së sigurimit "arrest në burg". Neni 245 i K.Pr.Penale parashikon se: "1. Vendimi që cakton masën e sigurimit përmban, me pasojë pavlefshmëri: d) caktimi i kohëzgjatjes së masës, kur ajo është urdhëruar për të garantuar marrjen ose vërtetësinë e provës". Gjykata e rrethit gjyqësor Fier ka vlerësuar të ligjshëm arrestin në flagrancë të datës 06.12.2020 ora 23.10 ndaj personit nën hetim K.S. dhe gjithashtu ka vlerësuar të ligjshëm arrestin në flagrancë kryer nga policia gjyqësore, më 06.12.2020, ora 22.30 ndaj personit nën hetim I.T. Në kushtet kur prokurori e ka paraqitur kërkesën në datën 07.01.2021 ora 13.40 e ka kërkuar pasi ka përfunduar afati 30-ditor i parashikuar në vendimin e gjykatës, rezulton se "zgjatja e afatit të masës" e kërkuar nga prokurori nuk mund të aplikohet. Duke pasur në vëmendje konceptin e masës sipas nenit 245 të K.Pr.Penale, e cila caktohet me afat, vetëm atëherë kur ajo është urdhëruar për të garantuar marrjen ose vërtetësinë e provës, pretendimet e prokurorit për zgjatje, në skadim të një afati janë në kundërshtim me kuptimin e masës së sigurimit me kohëzgjatje të caktuar si më sipër.... Në kushtet kur nga mbrojtësit e të dyshuarve K.S. dhe I.T*

⁹⁰ Nga ana e gjykatës raportohet për fillimin me vonesë për shkak të ardhjes me vonesë të palëve

është kërkuar në seancë gjyqësore shuarja e masës së sigurimit, gjyqta për sa më sipër konstaton humbjen e fuqisë së saj. Neni 261/1 gërma ç) i K. Pr. Penale, parashikon se "1. Masat e sigurimit shihen: ç) kur pas mbarimit të afatit të parashikuar nga shkronja "d", e paragrafit 1, të nenit 245, të këtij Kodi, nuk është urdhëruar përsëritja, brenda kufijve të parashikuar nga nenet 264 dhe 267." Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se nëse përsëritja nuk është urdhëruar brenda afateve kur ajo është në fuqi, dhe sipas përcaktimeve të neneve 264 dhe 267, masa e sigurimit personal "Arrest në burg me afat" e vendosur ndaj të dyshuarit nuk mund të vazhdojë të ekzekutohet. ...Prokuroria duhet të kështë në vëmendje edhe parashikimin e nenit 257 të K.Pr.Penale, Rastet e lirimt të menjëhershëm të të arrestuarit ose të ndaluarit "...". Duke marrë në konsideratë argumentimin sa më sipër, si dhe nenin 250 të K.Pr.Penale, llogaritja e afateve të kohëzgjatjes së masave i cili parashikon se: "Efektet e paraburgimit fillojnë të ecin nga çasti i arrestimit ose i ndalimit. 2. Kur i pandehuri është paraburgosur për një vepër penale tjetër, efektet e masës fillojnë të ecin nga dita në të cilën është njoftuar vendimi. 3. Efektet e masave të tjera fillojnë të ecin nga çasti në të cilin vendimi është i njoftuar. 4. Kur ndaj një të pandehuri janë dhënë disa vendime që caktojnë të njëjtën masë për të njëjtin fakt, afatet fillojnë të ecin nga dita në të cilën është zbatuar ose njoftuar i pari". Si edhe neni 262 të K.Pr.Penale, pasojat e shuarjes së masave të sigurimit, i cili parashikon se: "1. Kur arrestimi e humbet fuqinë, gjykata vendos lrimin e menjëhershëm të personit ndaj të cilit është marrë masa"; në kushtet kur nuk është kërkuar përsëritja e masës brenda afatit të përcaktuar në vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor Fier, kjo gjykatë konstaton humbjen e fuqisë së masës së caktuar me vendimin nr. 62-2020-4760 (1552), datë 08.12.2020 për të dyshuarin K.S, si dhe humbjen e fuqisë së masës së caktuar me vendimin nr. 62-2020-4760 (1552), datë 08.12.2020 për të dyshuarin I.T.

ii. Lidhur me kërkesën e prokurorit për caktim mase sigurimi "arrest në burg". Prokurori në kërkesën e paraqitur konform neneve 228, 229, 244 e vijues të K.P.Penale ka kërkuar masën e sigurimit "arrest në burg". Nga ana e gjykatës kjo vlerësohet si një kërkesë e re, që organi i prokurorisë në kushtet dhe kriteret e përcaktuara në K.Pr.Penale, mund t'i drejtohet gjykatës me kërtime të tjera. ... sa më sipër Gjykata duke vlerësuar në kompleksitet rrethanat e mësipërme dhe në vështrim të nenit 261 dhe 266 të K.Pr.Penale, çmon se masa e sigurimit personal "arrest në shtëpi", ndaj personit nën hetim K.S., është në përputhje me nevojat e sigurimit, rrezikshmërinë e faktit dhe të personit nën hetim. Si rrjedhim, kërkesa e personit nën hetim me objekt shuarjen e masës së sigurimit arrest në burg, me afatë është e drejtë dhe duhet pranuar, dhe kërkesa e prokurorit për caktimin e një mase tjetër shtrënguese bazuar në nenin 266 të K.Pr.Penale, është e drejtë dhe duhet pranuar. ... Lidhur me të dyshuarin I.T... . Sa më sipër Gjykata duke vlerësuar në kompleksitet rrethanat e mësipërme dhe në vështrim të nenit 261 dhe 266 të K.Pr.Penale, çmon se masa e sigurimit personal "arrest në shtëpi", ndaj personit nën hetim K.S., është në përputhje me nevojat e sigurimit, rrezikshmërinë e faktit dhe të personit nën hetim. Si rrjedhim, kërkesa e personit nën hetim me objekt shuarjen e masës së sigurimit arrest në burg, me afatë është e drejtë dhe duhet pranuar, dhe kërkesa e prokurorit për caktimin e një mase tjetër shtrënguese bazuar në nenin 266 të K.Pr.Penale, është e drejtë dhe duhet pranuar."

Ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë, nga prokurori i çështjes. Kjo gjykatë me vendimin nr. 40, datë 09.02.2021 ka vendosur "Miratimin e vendimit nr.6 date 8.1.2021 të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier", duke arsyetuar: "... *Dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova, sipas pikes 1 të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, përbën standardin kryesor për kufizimin e lirisë.....Ky kusht, sikunder ka arsyetuar gjykata e shkallës së parë në vendimin e saj nr.1552 datë 8.12.2020, ka rezultuar i përmbushur dhe i provuar, për aq kohë sa ajo gjykatë ka vendosur masë sigurimi ndaj të dyshuarve. Por vendosja e masës së sigurimit "arrest në burg" me afat, deri në kryerjen e akteve të ekspertimit kimik dhe toksikologjik është në kundërshtim me përmbajtjen e nenit 228 të K. Pr. Penale të sipërcituar dhe me praktikën e konsoliduar gjyqësore, sipas të cilës, masa e sigurimit mund të vendoset me afat, jo për të pritur në vijim prova të tjera në lidhje me provueshmërinë e faktit penal. Kjo pasi, kushti mbi ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm duhet të analizohet dhe vlerësohet në raport me ato prova që paraqet prokurori në kërkesën për caktimin e masës së sigurimit. Ndryshimi i mëvonshëm i rrethanave, qofte edhe ato në lidhje me cilësimin juridik të veprës penale përbëjnë shkak për të kërkuar zëvendësimin e masës së sigurimit. Sipas dispozitës së sipërcituar, masa e sigurimit mund të vendoset me afat vetëm në ato raste kur, për marrjen e provës është e nevojshme marrja e një mase sigurimi për të parandaluar rrezikun që i dyshuari të ndikojë negativisht në marrjen e provës, por kurrësesi për të kërkuar thellimin e procesit të provueshmërisë mbi faktin penal.*

Për këtë qëndrim në kundërshtim me nenin 228 të K. Pr. Penale, vendimi nr.1552, datë 8.12.2020 i Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, është i gabuar dhe i tërhiqet vërejtja asaj gjykate në lidhje me këtë disponim.

Në vijim të shqyrtimit të kërkesës së prokurorit objekt gjykimi, rezulton se pa ndryshuar asnjë rrethane nga ato mbi të cilat është dhënë vendimi nr.1552, date 8.12.2020 i Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, është kërkuar në mënyrë jo të qartë fillimisht lenia në fuqi e këtij vendimi, ndërkohë që masa e sigurimit e vendosur ka qenë me afat dhe për rrjedhojë nuk mund të kërkohej të lihej në fuqi ajo masa, afati i të cilës, me të drejtë është konstatuar nga gjykata e shkallës së parë se ka përfunduar dhe për rrjedhojë, është shuar.

Në një situatë të tillë, duke mos reaguar me ankim ndaj vendimit nr.1552 date 8.12.2020 të Gjykatës së shkallës së parë Fier, pra duke qenë dakort me vendosjen e masës së sigurimit me afat, prokurori, në mungesë të akteve të ekspertimit kimik dhe toksikologjik, duhej të kërkonte zgjatjen e afatit të kësaj mase sigurimi.

Kërkimi i dytë i prokurorit, për të vendosur masën e sigurimit "arrest në burg" pa afat ndaj të dyshuarve, bazuar në të njëjtat prova dhe rrethana sikunder edhe ato mbi të cilat është dhënë vendimi nr.1552 date 8.12.2020 i Gjykatës së shkallës së parë Fier, jo vetëm që është në kontradiktë me qëndrimin e mëparshëm të prokurorit, të analizuar me lart, por çënon interesat e ligjshme të subjekteve nën hetim, ndaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë e ka çmuar atë të pabazuar në prova dhe në ligj.

Në rrethanat kur gjykata e shkallës së parë ka konstatuar shuarjen e masës së sigurimit "arrest në burg", të caktuar me afat me vendimin e saj nr.1552 date 8.12.2020, si dhe pabazueshmërinë në prova dhe në ligj të kërkesës së prokurorit për caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg"

pa afat, me të drejtë, bazuar në kërkesat e nenit 266 pika 1 të K.Pr.Penale, duke evidentuar se ekzistojnë ende arsyet për të cilat ishte vendosur paraburgimi, ka vendosur masën tjetër më të rëndë të sigurimit, pas asaj të "arrestit në burg", siç është ajo e "arrestit në shtëpi".

Ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë nuk rezulton të jetë ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë nga prokurori i Apelit.

Rasti në fjalë ka ngritur diskutime lidhur me përlogaritjen e afatit për humbjen e fuqisë së masës së sigurimit, si edhe në drejtim të konceptit të përsëritjes së kërkesës për masë sigurimi. Duke paratur në konsideratë elaborimin nga praktika gjyqësore, më poshtë është vlerësuar të paraqiten dy interpretime bazuar në rastin në fjalë. Për këtë rast në drejtim të ecurisë së tij procedurale, rezulton se ka marrë zgjidhje përfundimtare referuar vendimmarrjes nga Gjykata e Apelit e cila nuk rezulton të jetë rekursuar.

Vlen të theksohet se pavarësisht diskutimeve që mund të ngrihen para një rasti të tillë objekt i interpretimeve të ndryshme, në fokusin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është marrja e masave të duhura nga ana e magjistratëve për të garantuar nga njëra anë respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të tij, siç është edhe liria e personit dhe nga ana tjetër që personi ndaj të cilit ekzistojnë kushtet për caktimin e një mase sigurimi të vendoset nën një masë sigurimi në përputhje me kriteret për caktimin e masave të sigurimit personal.

Interpretimi i parë:

Duke qenë se kërkesa e prokurorisë për vlefësim arresti në flagrancë dhe caktim të masës së sigurimit është bërë në periudhën që nuk është objekt inspektimi, vlerësohet se kërkesa e prokurorit datë 07.01.2021 për caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i K.PR.Penale është në raport me shkallën e nevojave të sigurimit për personin që dyshohet për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 283/2 dhe 278/3 të Kodit Penal, rrezikshmërinë e veçantë të veprës penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve të kryer në bashkëpunim, rrezikshmërinë e veprës penale të mbajtjes pa leje të municionit, si dhe rrezikshmërinë e personit të dyshuar. Ditën e fundit të afatit 30 ditor në datën 07.01.2021 ora 13.40 nga prokurori është kërkuar masa e sigurimit "arrest në burg", bazuar në dyshimin e arsyeshëm të mbështetur në provat e grumbulluara, si dhe bazuar në kushtet dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta të nenit 230/1 të K. Pr. Penale.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr.62-2020-4760 (1552), datë 08.12.2020, ora 12.24, pasi ka vlefësuar të ligjshëm arrestimin në flagrancë për të dyshuarit K. S dhe I. T, ka vendosur caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg" me afat 30 ditë. Ky afat i caktuar në ditë përfundonte në datën 07.01.2021. Prokurori në datën 07.01.2021, ora 13.40 ka paraqitur në gjykatë kërkesën për caktim mase sigurimi "arrest në burg". Gjykata me vendimin nr.62-2021-14/6, datë

08.01.2021, ora 10.10 ka vendosur shuarjen e masës së sigurimit bazuar në nenin 261/1, pika ç) të K. Pr. Penale, pasi sipas saj, përsëritja nuk është urdhëruar brenda afateve kur ishte në fuqi masa e sigurimit "arrest në burg" me afat. Në konstatimin e humbjes së fuqisë së masës, gjykata i referohet nenit 263 të K. Pr. Penale, "Afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit".

Neni 261 i K. Pr. Penale ka parashikuar një rast specifik të shuarjes së masave të sigurimit, e karakterizuar, ashtu si në pikat e tjera të nenit 261, nga hipoteza e shuarjes automatike të masave të sigurimit, nëse brenda një periudhe të caktuar nuk urdhërohet përsëritja e masës (me vendim të gjykatës), brenda kufijve të parashikuar nga nenet 264 dhe 267 të K. Pr. Penale. Neni 245/1, gërma d) në përgjithësi është i zbatueshem për të gjitha masat e sigurimit të dhëna për qëllime të provës sipas kushtit të nenit 228, pika 3, shkronja a), vendosja e të cilës, duke u lidhur edhe me veprimtarinë e organeve të hetimit, në rastet e "arrestit në burg" ka nevojë për garanci të mëtjshme për të mos çuar në kufizime apo heqje arbitrare të lirisë personale të të akuzuarit. Nga dispozita kuptohet se përsëritja, e cila konsiston në një caktim të ri të masës së sigurimit, përmes një vendimi të ri, mund të kërkohet nga prokurori dhe të urdhërohet nga gjyqtari edhe më shumë se një herë, me kusht që kjo të jetë brenda kufijve të kohëzgjatjes maksimale të paraburgimit ose kohëzgjatjes së masave të tjera të sigurimit.

Neni 263 i K. Pr. Penale, të cilit i referohet gjykata parashikon rastet e humbjes së fuqisë së paraburgimit në faza të ndryshme të procedimit penal, hetime paraprake dhe gjykim. Nga interpretimi në harmoni me njëra tjetrën i dispozitave të K. Pr. Penale, rezulton se llogaritja e afatit të masës së sigurimit të caktuar me vendimin e gjykatës nr.1552, datë 08.12.2020 nga data e arrestimit ose ndalimit është në zbatim të gabuar të nenit 250 të K. Pr. Penale, i cili parashikon se "*Efektet e paraburgimit fillojnë të ecin nga çasti i arrestimit ose i ndalimit*". Kjo dispozitë i shërben llogaritjes për efekte të dispozitës së nenit 263 të K. Pr. Penale, e cila parashikon se "*Paraburgimi e humbet fuqinë në qoftëse nga fillimi i zbatimit të tij kanë kaluar afatet e mëposhtme...*", duke ju referuar me fillim të zbatimit të tij nenit 250 të K. Pr. Penale për llogaritjen e këtij afati dhe kohëzgjatjes tërësore të paraburgimit ose për efekte të llogaritjes së dënimit me burgim. Sipas kritereve të nenit 57 të Kodit Penal "*Koha e paraburgimit llogaritet në dënimin me burgim...*", neni 465 i K. Pr. Penale, parashikon se "*Në caktimin e kohës së dënimit me burgim, prokurori llogarit periudhën e paraburgimit të vuajtur për të njëjtën vepër penale....*" dhe efektet e kësaj llogaritje në bazë të nenit 250 të K. Pr. Penal merren nga çasti i arrestimit ose i ndalimit.

Fakti që afati i masës fillon nga data e vendimit të gjykatës që ka caktuar masën me afat kuptohet dhe nga interpretimi i dispozitave të neneve 251, 253, 257, 258 e 259 të K. Pr. Penale, ku gjykatës i paraqiten dy kërkesa, njëra për vlefësim arresti në flagrancë/ndalimi dhe tjetra sipas nenit 259, pika 3 të K. Pr. Penale, që kur ka kërkesë nga prokurori, gjykata mund të caktojë masë sigurimi. Deri në këtë moment ose fillimisht gjykata shqyrton kërkesën për vlefësimin e arrestit në flagrancë ose ndalimit dhe pas kësaj "seance" ku gjykata merr vendim për vlefësimin e tij, procedohet me caktimin e masës së sigurimit. Si rrjedhim, deri në këtë fazë nuk ka masë sigurimi, pasi ekziston vetëm masa paraprake e arrestit në flagrancë/ndalimit të marrë nga policia gjyqësore, ndërsa duke caktuar masën e sigurimit në këtë moment gjykata cakton edhe kohëzgjatjen e saj, kur ajo është

urdhëruar për të garantuar marrjen ose vërtetësinë e provës. Vetë dispozita e nenit 245 të K. Pr. Penale e parashikon këtë moment, duke sanksionuar se “vendimi që cakton masën e sigurimit përmban,: d) cakton kohëzgjatjen e masës, kur.....”. pra, Kodi i Procedurës Penale parashikon vendosjen e masave paraprake të kufizimit të lirisë, përkatësisht “arresti në flagrancë” dhe “ndalimi i të dyshuarit për një krim”. Këto masa paraprake kanë kohëzgjatje të kufizuar në kohë, deri sa gjykata të vendosë vlefhtësimin ose jo dhe caktim të masës së sigurimit personal të kërkuar nga prokuroria, si moment i fillimit të zbatimit të saj.

Për shkak se afati i masës caktohet në referim të nenit 228, pika 3/a të K. Pr. Penale, kur ajo është urdhëruar për shkaqe që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, kuptohet që ky afat i fillon organit procedues të hetimit nga momenti që gjykata e urdhëron një gjë të tillë, ku në pjesë të arsyetimit të saj të vendimit nr. 62-2021-14/6, datë 08.01.2021, edhe vetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, duket se i referohet datës së vendimit të caktimit të masës së sigurimit.

Sipas këtij interpretimi, neni 144 i K. Pr. Penale, parashikon se afatet procedurale caktohen në orë, në ditë, në muaj ose në vite, ndërsa në pikën 3, parashikohet se në afatin e caktuar nuk llogaritet ora ose dita në të cilën fillon të ecë afati, pra, kërkesa e prokurorit do të rezultonte brenda afatit. Në rastin konkret nuk mund të vihet barazim midis kohëzgjatjes së masës me afat me dispozita të tjera sepse për të parën nuk ka parashikim të shprehur, ndërsa për të tjerat psh sipas nenit 248 të K. Pr. Penale afati është i parashikuar dhe lidhet me mënyrën si e shpreh dispozita. Afati tek neni 248 është afat për veprimtarinë e gjyqtarit, i cili nëse nuk e zbaton ka për pasojë humbjen e fuqisë së arrestit (neni 261, pika 2 i K. Pr. Penale). Në këtë drejtim neni 248 i K. Pr. Penale ashtu si edhe neni 250 i K. Pr. Penale, si dhe arrestimi në flagrancë ose ndalimi, përcaktojnë çastin e arrestimit/zbatimit, dhe në fakt llogaritet si një afat në orë. Neni 245/1/d nuk përcakton çastin e arrestimit/ndalimit, por është dita nga e cila fillon të llogaritet afati i kohëzgjatjes së masës. Gjithashtu, neni 250 i K. Pr. Penale flet vetëm për çaste, pasi ka të bëjë me afatin tërësor të masave të sigurimit, prandaj edhe pse përdoret fjala “ditë”, sepse në një ditë mund të zbatohen disa vendime, për masën konkrete merret si fillim çasti.

Si rrjedhim, bazuar në nenin 261, pika ç) të K. Pr. Penale, ku parashikohet se masat e urdhëruara sipas nenit 228, pika 3, shkronja a) kur egzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, humbasin efektin e tyre menjëherë, nëse në mbarim të afatit të caktuar sipas nenit 245, pika 1, shkronja d) të K. Pr. Penale nuk urdhërohet përsëritja, rezulton se prokurori ka kërkuar “përsëritjen”, në këtë rast caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” brenda afatit të masës së caktuar nga gjykata, konkretisht ditën e fundit të afatit, gjykim i cili pastaj është zhvilluar në datën 08.01.2021, pasi kishte përfunduar ky afat.

Sipas dispozitës aktuale, prokurori mund të kërkojë caktimin e masës ose rinovimin e masës në bazë të vendimit të gjykatës që duhet të vlerësojë arsyet që penguan përfundimin e hetimeve për nevoja të të cilit ishte kërkuar masa, edhe më shumë se një herë, por në çdo rast brenda kufijve të përmendur në nenet 264 e 267 të K. Pr. Penale, pra, duke pasur parasysh të mos kalohen afatet e paraburgimit për efekte të të cilit llogaritja e afatit të tij fillon nga çasti i arrestimit/ndalimit, duke

marrë parasysh edhe zgjatjen e parashikuar nga neni 264/2 i K. Pr. Penale ose afatet e kohëzgjatjes maksimale të masave të tjera të sigurimit parashikuar në nenin 267 të K. Pr. Penale. Edhe në këtë dispozitë parashikohet se *“masat ndaluese e humbasin fuqinë kur kanë kaluar tre muaj nga fillimi i zbatimit të tyre. Kur ato janë marrë për arsye që të mos dëmtohen provat, gjykata mund të urdhërojë përsëritjen e tyre deri në kufijtë e parashikuar nga paragrafi 1”*, paragraf, i cili parashikon se *“masat shtrënguese, të ndryshme nga paraburgimi, e humbasin fuqinë kur nga fillimi i zbatimit të tyre ka kaluar një kohë një kohë e barabartë me dyfishin e afateve të parashikuara nga neni 263 i K. Pr. Penale.”*

Përcaktimi i kohëzgjatjes së një mase sigurimi personal të marrë për të garantuar marrjen ose vërtetësinë e provave, në zbatim të nenit 228, pika 3/a të K.PR. Penale, është e nevojshme vetëm kur masa zbatohet për të përmbushur këtë kusht, duke e qenë e panevojshme caktimi i afatit kur masa e sigurimit duhet të vazhdojë të zbatohet për të garantuar kushtet e tjera të nenit 228 të K. Pr. Penale.

Në këtë interpretim mund të vlerësohet i gabuar edhe qëndrimi i gjykatës në referim të nenit 266 të K. Pr. Penale, për caktimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi” si rrjedhojë të humbjes së fuqisë të masës së sigurimit “arrest në burg”. Në kërkesën e tij prokurori ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” në përfundim të afatit të masës së caktuar, kërkesë në bazë të të cilës është vënë në lëvizje edhe gjykata, të pasqyruar në vendimin e saj me objektin e kërkesës. Mbi bazën e kësaj kërkesë gjykata ka konstatuar humbjen e fuqisë së masës për shkak të kalimit të afatit dhe po mbi të njëjtën kërkesë gjykata ka vendosur caktimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi”. Disponimet në rastet e lirimit nga burgu parashikuar nga neni 266 i K. Pr. Penale, nuk mund të aplikohen për masën e sigurimit “arrest në burg”, të cilës i mbaron afati, pasi vjen në kundërshtim edhe me dispozitën e analizuar më sipër për nenin 245, pika 1, gërma d) të K. Pr. Penale. Praktikisht gjykata ka vendosur që ndaj të dyshuarve nuk mund të zbatohet më paraburgimi siç e ka kuptimin dispozita e nenit 266 të K. Pr. Penale, kur afatet e paraburgimit në hetim për veprën penale më të rëndë për të cilën dyshohen të arrestuarit “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penale, bazuar në nenin 263/1, pika c) të K.Pr. Penale janë 12 muaj. Në këtë mënyrë çënohet kjo dispozitë, për shkak se gjykata aplikon afatin e masës si afat paraburgimi, ndërkohë që Kodi nuk parashikon ndonjë pengesë që për shkak të humbjes së fuqisë të masës me afat, ndaj personit të mos kërkohet dhe të caktohet përsëri e njëjta masë sigurimi.

Konkretisht, neni 266 i K. Pr. Penale, parashikon shprehimisht aplikimin e tij në rastet e përfundimit të afateve të paraburgimit, në çdo fazë të procedimit, pasi *“ndaj të pandehurit të liruar nga burgu për shkak të mbarimit të afateve, gjykata, kur egzistojnë ende arsyet për të cilat ishte vendosur paraburgimi, cakton masa të tjera sigurimi në qoftëse janë kushtet e kërkuara”*. Gjithashtu, “arrestit në shtëpi” në këtë rast, i cili vjen si rrjedhojë e zbatimit në këtë mënyrë të kësaj dispozite, nuk rezulton të jetë masa e përshtatshme për rastin dhe vjen në kundërshtim edhe me vetë arsyetimin e gjykatës për rrezikshmërinë, pasi do të ishte ajo e “arrestit në burg”.

Nga ana tjetër, për çështjen në fjalë, vlerësohet se, përveçse në kundërshtim me parime themelore si ai i sigurisë juridike, neni 34 i Kushtetutës (ne bis in idem), pasi Gjykata e Apelit ka marrë në shqyrtim dhe vlerësuar një vendim të formës së prerë se është i gabuar, siç është vendimi nr.62-2020-4760 (1552), datë 08.12.2020 për vlefësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit ‘arrest në burg’ me afat për shtetasit K. S. dhe I. T, duke i tërhequr vërejtje asaj gjykate në lidhje me këtë vendim, edhe kjo Gjykatë, duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, ka mbajtur të njëjtin qëndrim përse i takon humbjes së fuqisë së masës së sigurimit ‘arrest në burg me afat’ dhe caktimit të masës së sigurimit ‘arrest në shtëpi’, duke bërë edhe vlerësime për vendimin e gjykatës së shkallës së parë, e cila nuk e ka çmuar kërkesën e prokurorit për caktim mase sigurimi ‘arrest në burg’ të pabazuar në prova dhe në ligj, siç arsyeton Gjykata e Apelit, por se prokurori e ka paraqitur kërkesën pasi ka përfunduar afati 30 ditor i masës. Përsëri Gjykata e Apelit vlerëson gabim se “prokurori, në mungesë të akteve të ekspertimit kimik dhe toksikologjik, duhej të kërkonte zgjatjen e afatit të kësaj mase sigurimi”, megjithëse edhe kjo del se është bërë si kërkim në kërkesën e prokurorit, pasi në vendimin e gjykatës së shkallës së parë, në përmbajtjen e tij dhe si objekt i kërkesës së prokurorit citohet: -Lënie në fuqi të masës së sigurimit “arrest në burg”/zgjatjen e afatit të masës së sigurimit “arrest në burg. –Caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i K. Pr. Penale; në pjesën në të cilën nga prokurori u kërkuar: “zgjatjen e masës së sigurimit personal “arrest në burg me afat 30 ditor” për shkak të mos ardhjes së rezultateve të akteve të ekspertimi për personin nën hetim”, por të shprehur edhe në vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë në pjesën “Kërkimi i dytë i prokurorit, për të vendosur masen e sigurimit “arrest në burg” pa afat ndaj të dyshuarve...”. Po kështu, ky kërkim i dytë i prokurorit nuk mund të jetë në kontradiktë me qëndrimin e mëparshëm të prokurorit apo të çënojë interesat e ligjshme të subjekteve nën hetim, pasi në të dyja rastet, masa e sigurimit e kërkuar nga prokurori është ajo e “arrest në burg”.

Megjithatë, duhet theksuar se në rastin e caktimit të masave të sigurimit, me afat, në përfundim të afati të caktuar, kodi nuk parashikon kërtime të tilla, as si “lënie në fuqi” e as si “zgjatje e afatit”, por vetëm përsëritjen, për të cilën u trajtua më lart, si kërkesë për caktimin e masës së sigurimit.

Interpretimi i dytë:

Nga trajtimi i rastit, referuar të dhënave që gjenden në dosjen gjyqësore vlerësohet se vendimi gjyqësor është i drejtë në faktin e konstatimit të humbjes së fuqisë së masës së sigurimit me afat të vendosur sipas vendimit të mëparshëm datë 08.12.2020, për të dy personat nën hetim, por mënyra sesi ka konkluduar në këtë konstatim nuk vlerësohet të jetë në përputhje me kuptimin e dispozitës të parashikuar në nenin 245/1/d të K.pr.penale dhe dispozitave të tjera lidhur me llogaritjen e afatit të paraburgimit, si neni 250 i K.Pr.Penale, si dhe të proceduarit nga prokurori me konstatimin e humbjes së fuqisë sipas nenit 257 të K.Pr.Penale.

Për arritjen e konkluzionit sa më sipër, është filluar me zgjidhjen e çështjes se kur fillon të llogaritet afati i masës së sigurimit me afat të vendosur nga gjykata, në bazë të nenit 245/1d të K.Pr.Penale.

Në Kodin e Procedurës Penale është parashikuar në nenin 245/1/d të K.Pr.Penale caktimi i masës së sigurimit me afat, me qëllim garantimin e marrjes apo vërtetësisë së provës, e lidhur me ekzistencën e kushtit të veçantë të parashikuar në nenin 228/3/a të K.P.Penale.

Në interpretim të nenit 261/1/ç të K.Pr.Penale, masa e sigurimit e caktuar me afat mund të përsëritet mbi kërkesën e prokurorit, brenda kufijve të parashikuar në nenet 264 dhe 267 të K.Pr.Penale. Kjo përsëritje është e kushtëzuar lidhur me një rivlerësim të ekzistencës së kushteve dhe kriterëve të caktimit të masës së sigurimit, bazuar në nenin 228, 229 të K.Pr.Penale, duke u vlerësuar se masa e mëparshme ishte kushtëzuar me afat për shkak të garantimit të marrjes e vërtetimit të provave e cila vihej në rrezik, nëse ndaj personit nuk do të vendosej masa e sigurimit. Dhe gjithashtu përsëritja e një mase sigurimi mund të kërkohej nëse nuk kanë kaluar afatet e parashikuar të masave të sigurimit, të përcaktuara në nenin 263 të K.Pr.Penale dhe 264/2 të K.Pr.Penale për masën e sigurimit "arrest në burg" dhe ato të përcaktuara në nenin 267 të K.Pr.Penale për masat e tjera të sigurimit. Në këtë kuptim, duke u nisur dhe nga qëllimi i zbatimit të afatit në nenin 245/1/d të K.Pr.Penale, ky afat nuk mundet të ketë fuqi prapavepruese duke e llogaritur nga dita e arrestimit/ndalimit. Duhet të theksojmë këtu qëndrimin që është mbajtur edhe nga praktika e gjykatës së lartë⁹¹, se arrestimi nuk është masë sigurimi, por veprime procedurale të cilat kufizojnë përkohësisht lirinë e personit. Përlllogaritja e efekteve të paraburgimit nga çasti i ndalimit/arrestimit, referuar nenit 250 të K.Pr.Penale aplikohet në rastet e përlllogaritjes së afateve tërësore të paraburgimit sipas parashikimeve të nenit 264 të K.Pr.Penale ose për efekte të llogaritjes së dënimit me burgim sipas kriterëve të nenit 57 të Kodit Penal "*Koha e paraburgimit llogaritet në dënimin me burgim...*", neni 465 i K. Pr. Penale, parashikon se "*Në caktimin e kohës së dënimit me burgim, prokurori llogarit periudhën e paraburgimit të vuajtur për të njëjtën vepër penale....*".

Në rastin e zyrës së Shkodër, lidhur me procedimin penal nr. 51 datë 12.01.2021, të trajtuar më sipër janë përmendur disa vendime gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të cilat kanë aplikuar përlllogaritjen e masës së sigurimit me afat, nga dita e vendimit të gjykatës për caktimin e masës së sigurimit me afat.

Referuar kuptimit sa më sipër, në vazhdim vlerësohet të trajtohet se si do të përlllogaritet në vazhdim koha nga dita e caktimit të masës së sigurimit, për të konkluduar se kur është dita kur masa e sigurimit humbet fuqinë, nëse nuk ka një kërkesë tjetër, sipas parashikimeve të nenit 261/1/ç të K.Pr.Penale.

Sipas kësaj dispozite, masa e sigurimit arrest në burg me afat shuhet në rast se nuk është urdhëruar përsëritja brenda kufijve të parashikuar nga neni 264 i K.Pr.Penal, si afati maksimal i kohës së paraburgimit e lidhur me mundësinë e zgjatjes së afatit të paraburgimit referuar përlllogaritjes në nenin 263 të K.Pr.Penale. Parashikimi i këtyre kufijve, ashtu siç është konkluduar edhe më sipër, nuk mund të interpretohet si fillimi i përlllogaritjes së afatit të masës së sigurimit të caktuar nga ana e gjykatës, sipas nenit 245/1/ç të K.Pr.Penale. Por mënyra sesi parashikohen përlllogaritja e këtyre afateve në raport me zbatimin e masës së sigurimit, të çon në interpretimin e kujdesshëm

⁹¹ Të përmendur në rastin e zyrës shkodër ndaj personit A.D.

që duhet t'i bëhet përllogaritjes së kohës lidhur me afatin e përcaktuar nga gjykata për kohëzgjatjen e masës së sigurimit me afat. Kështu, në dispozitat që parashikojnë përllogaritjen e afatit lidhur me zbatimin e masës së sigurimit, konstatohet se përllogaritja e tyre në përbushjen e një dite, merret duke marrë në konsideratë orën se kur fillon zbatimi i masës së sigurimit për të llogaritur përfundimin e 24 orëve, në llogaritjen e një dite. Kështu konstatohet në rastin e nenit 248/1 të K.Pr.Penale, kur afati tre ditor i zbatimit të masës së sigurimit "arrest në burg" apo i "arrestit në shtëpi" fillon të përllogaritet sipas rendit të përfundimit 1 ditë me përbushjen e 24 orëve nga ora që gjendet në procesverbalin e zbatimit të masës së sigurimit mbajtur nga oficeri/agjenti i policisë i ngarkuar me zbatimin e masës⁹². Po kështu të njëjtin kuptim, e gjejmë edhe në rastin e arrestimit/ndalimit kur afati megjithëse në këtë rast i përcaktuar me orë në dispozitat përkatëse rregulluese të këtyre veprimeve procedurale, lidhet domosdoshmërisht me përllogaritjen e fillimit nga ora e procesverbalit që pasqyron arrestimin/ndalimin, që në thelb përbën edhe çastin e privimit të lirisë së personit. Kjo është teknika legjislative që ka përdorur legjislatori në përllogaritjen e afateve lidhur me masat e sigurimit, në titullin V, dhe si të tilla nuk mundet të përdorim për përllogaritjen e tyre afatet e përgjigjshme që gjejmë përcaktim në nenin 144 të K.Pr.Penal, që mund të vlerësohen si afate të karakterit administrativ duke marrë në konsideratë mundësinë e shtyrjes në paragrafin 3. Afatet e masave të sigurimit nuk janë afate që mund të shtyhen. Në të njëjtën frymë, mund të interpretohet edhe terminologjia që ka zgjedhur të përdor legjislatori në nenin 250 të Kodit të Procedurës Penale, të lidhur me llogaritjen e afateve të kohëzgjatjes së masave në kuptimin e kohëzgjatjes tërësore të këtyre afateve. Kështu në paragrafët 1 dhe 3 shprehet për fillimin e efekteve duke iu referuar termit kohor "çasti", ndërsa në paragrafët 2 dhe 4, për fillimin e të njëjtave efekteve i referohet termit kohor "dita". Ndërkohë që nga praktika, është e gjithëpranuar që këto afate në funksionit të aplikimit sipas kuptimit përkatës, përllogariten duke iu referuar termit kohor "çasti" e cila lidhet me orën.

Për sa më sipër, nisur nga kuptimi i mësipërm, duke e lidhur me rastin konkret vlerësohet se nga ana e prokurorit të çështjes, kërkesa për caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg" në përfundim të afatit të përcaktuar nga ana e gjykatës, është bërë në tejkallim të afatit 30 ditor, duke filluar kjo ditë nga dita kur është shpallur vendimi gjyqësor i caktimit të masës së sigurimit me afat. Kështu rezulton se nga ana e gjykatës së rrethit gjyqësor ishte caktuar masa e sigurimit me afat në datën 08.12.2020, ora 12.24, ndërkohë që kërkesa e prokurorit është depozituar në gjykatë më datë 07.01.2021 ora 13.40. Duke përllogaritur këtë periudhë nga ora 12.24 e datës 08.12.2020, afati i fundit i përfundimit të afatit 30 ditor, do të ishte data 07.01.2021 ora 12.24.

⁹²Përmendim zbatimin e një rasti të tillë, sipas vendimit të Gjykatës së Lartë me nr. 16/3 datë 12.01.2017, me objekt verifikimi i kushteve të zbatimit të masës së sigurimit "arrest në burg", ku rezulton se zbatimi i masës është bërë sipas procesverbalit datë 09.01.2017, ora 22.44 dhe marrja në pyetje është bërë në seancën gjyqësore të datës 12.01.2017, ora 10.00. Lidhur me këtë gjykata shprehet se: "14. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, brenda afatit 3 (tre) ditor të parashikuar nga neni 248/1 i K.Pr.Penale, ka kryer veprimet procedurale dhe ka caktuar marrjen në pyetje të të pandehurit në seancën gjyqësore të datës 12.01.2017, ora 10.00, ndaj të cilit është kryer ekzekutimi i masës së sigurimit personal "arrest në burg", vendosur me vendimin nr. 16, datë 16.07.2016 të Gjykatës së Lartë."

Në këtë çështje vlerësohet të trajtohet edhe fakti i konstatuar i kryerjes së ankimit nga prokurori i çështjes, i cili rezulton vërtet prokuror i çështjes dhe ka paraqitur kërkesën me shkrim në gjykatë, por nuk është ai i cili ka përfaqësuar prokurorinë në seancë gjyqësore për caktimin e masës së sigurimit. Me ndryshimet kushtetuese dhe Kodit të Procedurës Penale me ligjin nr. 35/2017, neni 25 i K.Pr.Penale, prokurori i çështjes i ushtron funksionet e tij në mënyrë të pavarur, duke kryer veprime, parashtruar kërkesa dhe marrë vendime në mënyrë të pavarur, bazuar në parimet e ligjshmërisë, objektivitetit dhe paanshmërisë⁹³. Në kuptim të këtij funksioni, asnjë prokuror tjetër nuk mund të kryejë përkohësisht veprime në një çështje në vend të prokurorit të çështjes, siç është edhe rasti i përfaqësimit në seancë gjyqësore nga një prokuror tjetër. Legjislatori në Kodin e Procedurës Penale ka njohur institutin e heqjes dorë dhe të zëvendësimit të prokurorit sipas parashikimeve të neneve 26 dhe 27 të K.Pr.Penale, e cila do të passillte edhe ndryshimin e figurës së prokurorit të çështjes në vazhdimin e veprimeve hetimore. Referuar këtij intepetimi, vlerësohet se ankimi i prokurorit të çështjes, ndërkohë që ai nuk ka përfaqësuar çështjen në gjykim, nuk mbështetet në parashikimet ligjore të ushtrimit të funksioneve të prokurorit. Kjo mënyrë e të vepruarit është hasur edhe në një zyrë tjetër ku është shtrirë inspektimi dhe për këtë vlerësohet që t'i parashtrohet prokurorëve për t'a pasur në vëmendje, për shkak të pasojave që shkakton në vlefshmërinë e ankimit të paraqitur. Praktika e përfaqësimit të çështjes me autorizim nga një prokuror tjetër, është produkt i praktikës bazuar në organizimin e prokurorisë si organ i centralizuar, ku prokurori më i lartë, i njohur si i tillë edhe drejtuesi i prokurorisë për prokurorët e një zyre prokurorie kishte të drejtë të ushtronte kompetencat e prokurorit më të ulët⁹⁴, të jepte urdhëra dhe udhëzime të cilat ishin të detyrueshme për t'u zbatuar nga prokurori më i ulët, si dhe kishte të drejtë të ndryshonte apo të shfuqizonte vendimet e prokurorit më të ulët mbi bazën e ankimit apo kryesisht⁹⁵.

Sipas rregullimit konkret aktualisht në ligjin me nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë"⁹⁶, Prokurori mund të zëvendësohet në rastet dhe kushtet e parashikuara nga ligji procedural penal, si edhe edhe kur, për shkak të mungesës ose paafësisë së tij të përkohshme fizike për punë, nuk është në gjendje të ushtrorë funksionet apo të respektojë afatet ligjore. Ky zëvendësim kryhet me vendim me shkrim të drejtuesit të prokurorisë, i cili i dorëzohet prokurorit përkatës me qëllim tërheqjen e çështjes, si dhe i njoftohet edhe prokurorit të zëvendësuar i cili ka të dejtën e ankimit me shkrim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë ndaj vendimit të zëvendësimit të tij.

Një çështje tjetër që vlerësohet të trajtohet nisur nga intepetimi që ka bërë gjykata e rrethit gjyqësor, është edhe mënyra sesi në rastin e konstatimit të humbjes së fuqisë së një mase sigurimi, interpreton aplikimin e nenit 257 të K.Pr.Penale. Kjo dispozitë, ashtu siç edhe nga përmbajtja, por edhe nga vendi që zë në Kodin e Procedurës Penale, lidhet me rastet kur nuk është caktuar ende

⁹³ Neni 6 i ligjit për 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".

⁹⁴ Neni 25 i Kodit të Procedurës Penale përpara ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017

⁹⁵ Neni 24 i Kodit të Procedurës Penale përpara ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017.

⁹⁶ Neni 49 i këtij ligji.

një masë sigurimi, por jemi në rastet kur është vendosur arrestimi në flagrancë/ndalimi sipas neneve 251 dhe 253 të K.Pr.penale, dhe nga ana e prokurorit vlerësohet nëse ky arrest/ndalim është i ligjshëm, për t'u kaluar në hapin tjetër të paraqitjes në gjykatë të një kërkesë për vleftësim arrestimi/ndalimi apo për të proceduar me lirim të një personi. Interpretimi i gjyqtarës në rastin konkret, duke iu referuar nenit 257 të K.Pr.Penale, përbën ngatërrim nocionesh të arrestimit në flagrancë/ndalimit me masën e sigurimit. Ashtu siç është cituar më sipër, Gjykata e Lartë është shprehur në praktikën e saj tashmë të konsoliduar që këto dy nocione nuk janë të njëjta, dhe se arresti në flagrancë/ndalimi nuk janë masa sigurimi. Pavarësisht se nga qëllimet që ndjekin dhe pasojat që sjellin, arrestimi në flagrancë dhe ndalimi duken si masa sigurimi, pasi në të vërtetë nëpërmjet tyre realizohet kapja e të dyshuarit dhe izolimi i tyre, ato nuk mund të konsiderohen masa sigurimi, por veprime procedurale që diktohen nga rrethanat konkrete, të flagrancës apo të ikjes⁹⁷

Një çështje tjetër, gjithashtu që vlerësohet të trajtohet është edhe mënyra sesi e ka interpretuar gjyqtarja e rrethit gjyqësor Fier, në rastin konkret nenin 266 të K.P.Penale si të lidhur me pamundësinë e caktimit të të njëjtit lloj mase sigurie në përfundim të afatit të masës së sigurimit të vendosur nga gjykata sipas nenit 245/1/d të K.Pr.Penale dhe kur jemi në kushtet e përsëritjes sipas nenit 261/1/ç të K.Pr.Penale.

Ashtu siç u përmend edhe më sipër, në interpretim të nenit 261/1/ ç të K.Pr.Penale, masa e sigurimit e caktuar me afat mund të përsëritet mbi kërkesën e prokurorit, brenda kufijve të parashikuar në nenet 264 dhe 267 të K.Pr.Penale, dhe duke qenë e kushtëzuar me rivlerësim të ekzistencës së kushteve dhe kriterëve të caktimit të masës së sigurimit, bazuar në nenin 228, 229 të K.Pr.Penale. Ndrësa neni 266 i K.Pr.Penale, edhe për nga vendi që zë në kreun përkatës, që lidhet me shuarjen e masave të sigurimit, interpretohet se gjen zbatim në rastet kur për personin e paraburgosur janë ezauruar afatet tërësore të kohëzgjatjes së së paraburgimit në vështrim të parashikimeve të nenit 263 dhe 264 të K.Pr.Penale dhe në kushtet kur ekzistojnë sërish kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit arrest në burg. Ashtu siç është shprehur edhe Gjykata e Lartë në vendimin e saj unifikues me nr. 7/2011 *“Është thelbësore të mbahet parasysh se, në zbatim të drejtë të ligjit, në rastin e masave të sigurimit, vlera e gjësë së gjykuar ka natyrë relative, në kuptimin që ajo lidhet vetëm me parimin e garantimit të nevojave të sigurimit, rrjedhimisht me rrethanat e faktit e të ligjit, të cilat ekzistojnë në çastin e dhënies së vendimit gjyqësor për caktimin e masës së sigurimit. Nëse ndryshojnë nevojat e sigurimit, pra nëse rrethanat ndryshojnë, gjykata mund të revokojë ose ndryshojë masën e dhënë më parë (neni 260), apo të caktojë një masë të re nëse lind përsëri nevoja e sigurimit.”*

3.3. Veprimet procedurale të kryera nga ana e prokurorit për të identifikuar dyshimin e arsyeshëm të bazuar në prova;

⁹⁷ Arrestimi në flagrancë dhe ndalimi – Demokratizimi i legjislacionit penal nga Halim Islami, Shtëpia botuese “Luarasi”, 2000.

Nga rastet e kërkesave të prokurorit për caktimin e masës së sigurimit, për periudhën e inspektimit në tre zyrat e prokurorive konstatohet se në rastin kur procedohet me kërkesa për vlefësim arrestimi/ndalimi dhe kërkesë për caktim mase sigurimi, ato kryesisht bazohen në të dhënat që rezultojnë nga veprimtaria e oficerit të policisë gjyqësore.

Veprimet hetimore lidhur me mjetet e kërkimit të provës, mbi bazën e të cilat është krijuar dyshimi i arsyeshëm se shtetasi për të cilën kërkohet masa e sigurimit ka kryer veprën/at penale, pothuaj në të gjitha rastet në të tre zyrat, janë vlefësuar si të ligjshme nga prokurori me anë të veprimeve të tij procedurale, pas marrjes së informacionit për referim të veprës penale, bashkë me materialet hetimore. Kjo veprimtaria e prokurorit, është e detyrueshme referuar parashikimeve ligjore procedurale dhe me rastin e vlefësimit të ligjshmërisë së veprimeve të kryera në kushtet e urgjencës nga ana e policisë, i jep ligjshmëri provave mbi bazën e të cilave krijohet dyshimi i arsyeshëm mbi personin ndaj të cilit do të kërkohet masa e caktuar.

Në këto raste, është evidentuar se këto prova të marra nga ana e policisë kanë rezultuar të mjaftueshme për të krijuar dyshimin e arsyeshëm, pasi janë pranuar si të tilla edhe nga gjykatat, të cilat në të gjitha rastet objekt inspektimi kanë pranuar kërkesën e prokurorit për caktimin e një mase sigurimi personale të karakterit shtrëngues.

Më evidente veprimtaria e prokurorit është në rastet e kërkesave në bazë të nenit 244/1 të K.Pr.Penale, të cilat i japin mundësi dhe kohë prokurorit të grumbullojë provat e nevojshme për të paraqitur një kërkesë të bazuar dhe të arsyetuar para gjykatës, në drejtim të ekzistencës së kushteve dhe kriterëve të përgjithshme dhe të posacme për caktimin e një mase sigurimi personal.

Po kështu evidente veprimtaria e prokurorit është edhe në periudhën pas vendosjes së masës së sigurimit, e cila reflekton diligjencën e tij në këndvështrimin e ligjshmërisë së masës së sigurimit të vendosur, dhe vecanarisht të asaj të arrestit në burg⁹⁸, për të vlerësuar nëse motivet fillestare të caktimit të një mase janë akoma relevante dhe të mjaftueshme për vijimësinë e masës së sigurimit. Në rastet objekt inspektimi, në drejtim pikërisht të arsyetimit mbi dyshimin e arsyeshëm, është evidentuar në një çështje që nga ana e prokurorit është reaguuar nëpërmjet mjetit procedural kërkesës për revokim dhe në vazhdim për shuarje të masës së sigurimit⁹⁹.

Në këtë çështje nga ana e prokurorit është proceduar me kërkesën për revokim të masës së sigurimit "arrest në burg" të vendosur nga ana e gjykatës me afat. Në vendimin e gjykatës për caktimin e masës së sigurimit, ishte arsyetuar dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se shtetasi A.D. ishte autor i veprës penale të "Plagosjes së lehtë me dashje" dhe të "Mbajtjes pa leje të armëve luftarake", të parashikuar nga neni 89 dhe 278/1 i K.Penal. Në ditën e tetë të vendosjes së kësaj mase, dhe kur kishin mbetur edhe 22 ditë nga përfundimi i afatit të masës së sigurimit të vendosur nga ana e gjykatës, prokurori paraqet një kërkesë në gjykatë, duke kërkuar revokimin e masës së sigurimit në aplikim të nenit 260/1 të K.Pr.penale. Në këtë kërkesë nga ana e prokurorit, arsyetohet

⁹⁸ Vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë me nr. 1/2009.

⁹⁹ Rasti i procedimit penal nr 51, datë 12.01.2021 në ngarkim të shtetasit A.D. i zyrës së Prokurorisë Shkodër.

se ishin administruar aktet e pritura, si dhe personi ndaj të cilit është vendosur masa e sigurimit nuk e ka kryer veprën penale të plagosjes, dhe të mbajtjes së armës luftarake. Dhe për këtë nga ana e prokurorit, ishte disponuar me vendim për pushimin e çështjes lidhur me veprën penale të parashikuar nga neni 89 i K.Penal, ndërsa nuk ishte vepruar ende proceduralisht lidhur me veprën penale të parashikuar nga neni 278/1 i K.Penal. Konkluzioni i prokurorit mbi mosprovueshmërinë e kryerjes së veprave penale të parashikuar nga neni 89 e 278/1 i K.Penal, lidhen drejtëpërdrejtë me mungesën e dyshimit të arsyeshëm të parashikuar nga neni 228/1 i K.pr.penale si kusht i domosdoshëm pa të cilën nuk mundet që të caktohet një masë sigurimi.

Por gjithashtu, janë evidentuar edhe raste të qëndrimit të prokurorit në interpretim të gabuar të nocionit 'dyshim i arsyeshëm' si kusht i domosdoshëm pa të cilën, nuk mund të caktohet një masë sigurimi. Kështu në këto raste, megjithëse nga ana e prokurorit pranohet fakti i paprovueshmërisë së kryerjes së veprës penale nga personi ndaj të cilit kërkohet masa e sigurimit/apo dyshimit të ekzistencës së kësaj vepre penale, përsëri nga ana e prokurorit vlerësohet se ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova si kusht për caktimin e masës së sigurimit. Këto raste janë evidentuar si në momentin fillestar të kërkesës për caktimin e masës së sigurimit, ashtu edhe në vijim gjatë shqyrtimit të kërkesave për zëvendësim të masës së sigurimit.

Përmendim rastin¹⁰⁰ kur nga ana e prokurorit është kërkuar masa e sigurimit “**ndalimi për të dalë jashtë shtetit**” dhe “**detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore**”, ndaj shtetasit D.J. si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Plagosja e lehtë me dashje” dhe “Mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit” të parashikuar nga nenet 89 e 278/1 të K.Penal, duke argumentuar lidhur me faktin e paprovueshmërisë së kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 278/1 i K.penal, si dhe mungesën e ankimit lidhur me veprën penale të parashikuar nga neni 89 i K.penal. paprovueshmëria e kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 278/1 i K.penal, si dhe fakti i pamundësisë për të proceduar në mungesë të një ankimi të të dëmtuarit lidhur me veprën penale të parashikuar nga neni 89 i K.Penal, që në bazë të nenit 284 ndiqet vetëm mbi bazë ankimi, lidhen drejtëpërdrejtë me mungesën e dyshimit të arsyeshëm të parashikuar nga neni 228/1 i K.pr.penale si kusht i domosdoshëm pa të cilën nuk mundet që të caktohet një masë sigurimi.

Rasti tjetër¹⁰¹ kur gjatë shqyrtimit gjyqësor të kërkesës së të paraburgosurit për zëvendësim mase sigurimi, prokurori është shprehur për zëvendësim mase sigurimi në një masë më të butë, me arsyetimin se ndaj të dyshuarit për kryerjen e veprës penale “Mbajtja pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit” të parashikuar nga neni 278/1 i K.penal është zbehur dyshimi se i arrestuari të ketë mbajtur armë zjarri ditën e ngjarjes. Një argument i tillë lidhet drejtëpërdrejtë me mungesën tashmë të dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova për kryerjen e veprës penale nga personi ndaj të cilit caktohet masa e sigurimit, e parashikuar si e tillë

¹⁰⁰ procedimi penal nr. 218 datë 03.03.2021, në ngarkim të shtetasit D.J. i zyrës së Prokurorisë Shkoder.

¹⁰¹ Procedimi penal nr. 728/2021 në ngarkim të shtetasit K.Xh.i zyrës së Prokurorisë Vlorë

në nenin 228/1 i K.Pr.Penale dhe si e tillë, nuk mund të trajtohet si e dhënë e re që tregon se janë zbatuar nevojat e sigurimit sipas parashikimeve të nenit 260/1 të K.pr.penale.

Lidhur me provat mbi të cilat mbështetet kërkesa në funksion të ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm, konstatohet se nga ana e prokurorëve ndiqet një format i ndryshëm, disa i përmendin në parashtrësën e fakteve dhe disa të tjerë i përmendin në fund të kërkesës, dhe gjithashtu konstatohet se jo të gjithë ndjekin të njëjtën paraqitje të këtyre provave duke i cituar me të gjitha ekstremitetet për identifikimin e këtyre provave me datën përkatëse. Gjithsesi është për t'u nënvizuar fakti se të gjitha kërkesat e prokurorëve të zyrës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë nisen të shoqëruar me kopje të akteve të cilat listohen me anë të një inventari ku shënohen emërtimi i akteve dhe fletët përkatëse.

Gjithashtu është për t'u evidentuar fakti se në periudhën e inspektimit me përjashtim të një prokurori¹⁰², në aktet hetimore nuk evidentohet pyetje e të ndaluarit/arrestuarit nga ana e prokurorit, si një veprim hetimor i parashikuar në nenin 256 të K.pr.penale në kuadër të kohës që ka në dispozicion prokurori për të vlerësuar ligjshmërinë e këtij arrestimi/ndalimi të kryer nga ana e policisë gjyqësore dhe paraqitjes së kërkesës në gjykatë në rastet e ligjshmërisë.

Në nenin 256 të K.Pr.Penale është parashikuar se: *"1. Prokurori merr në pyetje të arrestuarit ose të ndaluarin në prani të mbrojtësit të zgjedhur ose të caktuar kryesisht. Ai i njofton të arrestuarin ose të ndaluarin faktin për të cilin procedohet dhe arsyet e marrjes në pyetje, duke i treguar të dhënat në ngarkim të tij dhe, kur nuk i shkaktohet dëm hetimeve, edhe burimet. 2. Prokurori fillimisht e pyet të arrestuarin ose të ndaluarin nëse e ka marrë letrën e të drejtave dhe sigurohet që ai i ka kuptuar të drejtat e tij. Kur i arrestuari ose i ndaluarit nuk e ka marrë letrën e të drejtave, prokurori ia jep atë përpara marrjes së parë në pyetje dhe i sqaron të drejtat e tij. 3. Deklarimet e bëra nga i arrestuari ose i ndaluarit përpara se të ketë marrë letrën e të drejtave ose përpara takimit me mbrojtësin e tij, nuk mund të përdoren"*

Kryerja nga prokurori, e veprimeve të përcaktuara në këtë dispozitë, është e detyrueshme, për çdo rast që personit i hiqet liria. Këto veprime kryhen domosdoshmërisht përpara se ndaj këtij personi të vlerësohet arrestimi në flagrancë apo ndalimi- pra në një afat që nuk i kalon në maksimum 4 ditë. Ajo që i bën të rëndësishme këto veprime të prokurorit në bazë të nenit 256 të K.Pr.Penale, përveç faktit të njohjes së të arrestuarit apo të ndaluarit me shkaqet e privimit të lirisë, është edhe fakti se prokurori duke marrë kontakt personalisht me të arrestuarin apo të ndaluarin është në gjendje të përmbush me efektivitet detyrën e tij për të kontrolluar paraprakisht nëse arrestimi apo ndalimi është i ligjshëm. Kështu sipas nenit 257 Prokurori ka për të detyrë që në rast se rezulton e qartë se arrestimi ose ndalimi është bërë për shkak se është ngatërruar personi ose nuk janë

¹⁰² Procedimi penal nr. 728/2021 në ngarkim të shtetasit K.Xh dhe E.L. i zyrës së Prokurorisë Vlorë, ku rezulton se nga ana e prokurorit është bërë pyetja e dy shtetasve të arrestuar/ndaluar në orën 21:20 dhe 21:45.

respektuar kërkesat e ligjit ose kur masa e arrestit ose e ndalimit e ka humbur fuqinë për shkak të shkeljes së afatit të kërkesës për vlefësimin e masës, të urdhërojë me vendim të motivuar lirimin menjëherë të të arrestuarit apo të ndaluarit.

Gjithashtu kontakti personalisht i prokurorit me të arrestuarin apo të ndaluarin përpara se ai të paraqitet përpara gjykatës, përbën veç sa më sipër, edhe një garanci përkundrejt abuzimeve që mund të pësojnë këta persona liria fizike e të cilëve iu është privuar. Janë të njohura rastet e keqtrajtimit që pësojnë të arrestuarit e të ndaluarit qoftë përpara se të futeshin në qeli ose gjatë kohës që mbahen aty¹⁰³. Por duhet të themi se ndonëse veprimet e kryera nga ana e prokurorit sipas nenit 256 të K.Pr.Penale janë kaq të rëndësishme në drejtim të sigurimit të garancive për individin të cilit i është privuar liria, dhe ndonëse janë të detyrueshme për t'u kryer, konstatohen se nuk është zbatuar për tre zyrat e inspektuara¹⁰⁴.

Lidhur me këtë detyrim të dispozitës në fjalë, në një rasi¹⁰⁵ është pretenduar nga mbrojtësi dhe konfirmuar nga prokurori se personi i arrestuar mund të ketë probleme të shëndetit mendor, duke i shfaqur dhe në seancë gjyqësore. Nga gjykata është caktuar masa e sigurimit "arrest në burg" dhe

¹⁰³ Këto të dhëna i gjejmë në dokumentet zyrtare të lidhur me monitorimin e këtyre raste, dhe të cilat pavarësisht se i përkasin shumë viteve më parë, sërisht vlerësohen të evidentohen në këtë raport për t'u patur në konsideratë në drejtim të rëndësishë që paraqet kjo dispozitë. Raporti i OSBE- Analizë e Sistemit të Drejtësisë Penale në Shqipëri, Raport i Programit për Zhvillimin e një Gjykimi të Drejtë. Viti 2005, Rekomandimi i Avokatit të Popullit-Nr. Dok. 201100537/2, korrik 2011- Rekomandohet denoncimi dhe hetimi i të gjitha rasteve të dhunes fizike që konstatohen tek personat e ndaluar apo arrestuar nga Policia e Shtetit. Raporti vjetor i Avokatit të Popullit viti 2010- Kufizime të lirisë së personit- ku ndër të tjera shprehet për keqtrajtme e paligjshme të arrestimeve të kryera nga ana e punonjësve të policisë së shtetit "Ne ankesën e shqyrtuar me nr.201000980, katër shtetas, përkatësisht B. K., M. K., J. T. dhe E. T. ankoreshin se, rreth orës 01.00, duke qenë në një lokal Internet-Kafe, që ndodhëj poshtë pallateve të tyre të banimit, ishin shoqëruar padrejtësisht nga patrulla e policisë në Komisarjatin e Policisë Nr. 4 Tiranë. Dy prej ankesve ishin keqtrajtuar nga punonjësit e policisë dhe, për shkak të dëmtimeve të pësuar, ishin dërguar në spital nga policia për ekzaminim e mjekim, ku njëri prej tyre, që ishte më rëndë, ishte shtruar. Ankesit pretendonin edhe për kallëzim të rremë, të bërë ndaj atyre nga punonjësit e policisë, sikur ata i kishin kundërshtuar me dhunë, fyer e kërcënuar policët. Si pasojë e këtij kallëzimi të rremë, shtetasit B. K. dhe J. T. ishin arrestuar padrejtësisht, ndërsa shtetasit M. K. dhe E. T. ndiqeshin penalisht në gjendje të lirë. Sipas ankesve, kallëzimin e rremë, punonjësit e policisë e kishin bërë për t'u mbrojtur nga ankimi që të afërmit e tyre, kishin bërë për veprimet e kundërligjshme të policies. Në përfundim të hetimit të kësaj anese dhe nga provat e administruara, si pyetja e të dëmtuarëve, e dëshmitarëve okularë L. B. dhe A. H., e punonjësve të policisë Alfred Thaçi, Armand Isufaj, Vladimir Gega dhe Rudin Baça, që ishin autorë të këtyre veprimeve, nga kqyrja e dokumentave në Komisarjatin e Policisë Nr. 4 Tiranë dhe në dy spitalet ku ishin ekzaminuar e mjekuar të dëmtuarit, si dhe aktet e ekzaminimit mjeko-ligjor të dy të dëmtuarëve, arritëm në konkluzionin se, pretendimet e ankesve për keqtrajtim fizik, për shoqërim të paligjshëm në polici dhe për kallëzim të rremë ndaj tyre, nga punonjësit e policisë, ishin të vërteta.

¹⁰⁴ Moshatimi i kësaj dispozite, në kushtet aktuale nga ana jonë vlerësohet se mund të ndodhë për shkak të ngarkesës dhe dinamikës ditore të panës së prokurorit.

¹⁰⁵ Procedimi penal me nr. 364, datë 26.04.2021, i zyrës së Prokurorisë Fier, i regjistruar për veprat penale të "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit", "Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta" dhe "Prishja e qetësisë publike" të parashikuara nga nenet 278/1, 279/2 dhe 274 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit M. P.

në vijim të hetimeve është lënë detyrë të bëhet akt ekspertimi. Gjithashtu në një rast tjetër¹⁰⁶ është vlerësuar se në kuadër të veprimeve të para të mundshme nga ana e prokurores, ndër të cilat edhe ky veprim në bazë të nenit 256 të K.Pr.Penale, do të ndikonte në vlerësimin e prokurores në drejtim të përshtatshmërisë dhe proporcionalitetit të masës së sigurimit të propozuar, duke qenë se informacioni/të dhënat rreth faktit penal e personalitetit, gjëndjes familjare apo shëndetësore të vetë të arrestuarit do të ishin më të plota dhe si i tillë do të mund të evitonte ndryshimin e qëndrimit e saj në seancë (ku ajo është njohur me të dhëna të tjera sipas relatimit të saj dhe që janë bërë shkak më tej për ndryshimin e qëndrimit). Për me tepër, që është detyra e prokurorit, në rast se vihet në dijeni për të dhëna të cilat lidhen me nevojat e sigurimit, të veprojë për të mundësuar marrjen e tyre dhe kryerjen e një analize të plotë dhe të argumentuar.

Pikërisht në këtë kontekst duhet të bëhen propozimet përkatëse drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, i cili me anë të mekanizmave të tij administrativ dhe procedural të mund të ndërgjegjësojë prokurorët për këtë detyrim që kanë ndaj të gjithë personave të arrestuar/ndaluar e veçanërisht kur këto i përkasin kategorisë së të miturve në konflikt me ligjin. Në lidhje me këtë të fundit, nga ana e Prokurorit të Përgjithshëm është nxjerrë udhëzimi i Përgjithshëm me nr. 8 datë 15.11.2021 “Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale me të mitur në konflikt me ligjin, viktimë dhe/ose dëshmitar”, në të cilën është parashikuar në mënyrë specifike garantimin e të drejtës për t’u informuar përkundrejt të miturit në konflikt, si dhe të të drejtën për t’u dëgjuar dhe marrë në pyetje, detyrim ky që i është ngarkuar prokurorit dhe oficerit të policisë gjyqësore¹⁰⁷.

3.4. Niveli i arsytimit të bërë nga ana e prokurorit për t’i siguruar gjykatës se ekzistojnë së bashku ose veçmas kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit me karakter personal.

Në të gjitha rastet e kërkesave me objekt “Vlefësim i arrestimit/ndalimit dhe caktimit të masës së sigurimit” dhe “caktim të masës së sigurimit”, nga ana e prokurorëve në përgjithësi nuk ka një arsyetim të plotë dhe shterues lidhur me kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit me karakter personal. Prokurorët në përgjithësi në arsyetimin e tyre, mjaftohen me një analizë të përgjithshme të kushteve dhe kriterëve të masës së sigurimit, por pa u ndalur konkretisht në secilin prej kushteve të parashikuar në nenin 228 të K.Pr.Penale dhe në elementët që përcaktojnë kriteret e një mase sigurimi referuar nenit 229 të K.Pr.Penale. Gjithashtu, ky lloj arsyetimi evidentohet edhe në kriteret e veçanta të parashikuar në nenin 230 të K.Pr.Penale.

Mungesa e analizës në kërkesat e prokurorit lidhur me kushtet, më konkretisht konstatohet në drejtim të analizës së provave për të identifikuar dyshimin e arsyeshëm; të analizës së ekzistencës së kushteve të parashikuar posaçërisht në nenin 228/3 të K.Pr.Penale, të cilat shpesh rezultojnë të

¹⁰⁶ Procedimi penal 839/2021 i regjistruar më datë 15.06.2021 nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për veprat penale të “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit” të parashikuar nga neni 278/1 i K.Penale, në ngarkim të shtetasit E.B.

¹⁰⁷ Shih nenin 4 dhe 7 të udhëzimit

jenë të paraqitur në mënyrë abstrakte dhe stereotipe. Referuar këtyre kushteve, prokurorët në kërkesat e tyre, mjaftohen përgjithësisht me konstatimin e tyre, por jo me analizën me rastin konkret.

Lidhur me kriteret e përgjithshme, dhe ato të veçanta, mungesa e analizës konstatohet në drejtim të faktit se megjithëse prokurorët përmendin elementët që përfshihen në kriteret që parashikon dispozita, nuk ndalen për të analizuar sesi identifikohen këto nga provat në rastin konkret dhe si reflektohen këto në treguesin e përshtatshmërisë dhe proporcionalitetit të masës së sigurimit.

Mungesa e kësaj analize, në dy raste ka bërë që gjyqtari të mbështetet në konstatimin e ekzistencës së një kushti “rrezikut që ai të largohet” për përshtatshmërinë e një lloji mase sigurimi të ndryshëm nga ajo e kërkuar nga ana e prokurorit dhe për një nga këto masa sigurimi nuk është ushtruar ankim nga ana e prokurorit, megjithëse nga ana e këtij të fundit kërkesa mbështetej edhe në ekzistencën e kushteve të tjera të parashikuara në nenin 228/3,a, c të K.Pr.Penale.

i.) Në rastin e parë, prokurori ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” lidhur me faktin penal të mbajtjes së armës së zjarrit në ambiente publike, e parashikuar nga neni 278/1 i K.Penal. Prokurori në kërkesën e tij lidhur me caktimin e masës së sigurimit arsyeton se: *“Fakti penal i mësipërm ka dyshime për veprën penale të “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal. Për shkak të dyshimit të krijuar nga policia gjyësore në datën 26.03.2021, në orën 20.00, është bërë “Arrestimi në flagrancë” i shtetasit S.S... i datëlindjes 13.03.1987, lindur e banues në fshain Armen – Vlorë, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal. Nisur nga sa më sipër, ekzistojnë të gjitha kushtet ligjore të parashikuara nga neni 251 i Kodit të Procedurës Penale që përlligjin këtë masë sigurimi dhe lënia në fuqi e saj i shërben interesave të hetimit të çështjes penale. Gjithashtu, duke qenë se ekzistojnë kushtet për caktimin e masës së sigurimit siç është ekzistenca e një dyshimi të arsyeshëm të bazuar në prova, mundësia e shmangies nga hetimet, duke patur parasysh shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale e të autorit, sanksionet që parashikohen për veprën penale të cilën ai dyshohet të ketë kryer, si dhe kriteret ligjore për caktimin e masës së sigurimit, bazuar në nenet 258/1 e 244/1 të Kodit të Procedurës Penale, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i paraqes këtë KËRKESË ...¹⁰⁸”* Për këtë rast nga ana e gjykatës, është pranuar kërkesa për caktimin e masës së sigurimit, por duke e zëvendësuar me masën e “garancisë pasurore” të parashikuar nga neni 236 i K.Pr.Penale. Ndaj këtij është ushtruar ankim nga ana e prokurorit dhe Gjykata e Apelit, ka ndryshuar vendimin duke caktuar masën e sigurimit të propozuar nga ana e prokurorit.

¹⁰⁸ Kërkesë për vlefësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit ndaj shtetasit S.S. të dyshuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 278/1 të K.Penal, për nevoja të procedimit penal nr. 378 të vitit 2021, të zyrës së prokurorisë Vlorë.

ii) Në rastin e dytë, prokurori ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” lidhur me faktin penal të gjetjes gjatë një kontrolli të policisë, në banesën e shtetasit Sh.I. të municionit luftarak i llojit fishekë të ndara në dy qeska në sasinë 136 copë+60, lëndë narkotike kanabis sativa në peshën 356.6 gram, 9150 fara bimore si ato të Canabis Sativa. Prokurori në kërkesën e tij lidhur me caktimin e masës së sigurimit arsyeton se: *“Në këtë rast ekzistojnë kushtet e përgjithshme për caktimin e masave të sigurimit personal pasi: - konkretisht ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se i arrestuari është autor i veprës penale të parashikuar nga neni 283/1 të K.Penal. ky dyshim bazohet nga veprimet hetimore të kryera deri në këtë fazë dhe që aktet përkatëse ia kemi bashkëlidhur kësaj kërkesë. Duke patur parasysh të gjitha provat që i kemi paraqitur gjykatës, ekziston dyshimi i arsyeshëm se i arrestuari është autor i veprës penale të parashikuar nga neni 283/1 dhe 278/3 të K.Penal. – Fakti përbën veprë penale që parashikohet si e tillë nga neni 283/1 dhe 278/3 të K.Penal. – Nuk ekzistojnë shkaqe padëmueshmërie apo shkaqe të shuarjes së veprës penale për të arrestuarin. Do mbajmë parasysh sanksionin që parashikon vepra penale. Qëndrimin që ka mbajtur i arrestuari para policisë gjyqësore. Për shkak të rrethanave të faktit, personalitetit, veprimeve konkrete të kryera dhe qëndrimit që ka mbajtur, çojmë se rrezikshmëria e autorit në këtë rast është e lartë. Ekziston rreziku që ai të kryejë krime më të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet. ...Përfundimisht bazuar në nenet 228, 229, 230, 251, 252, 258 dhe 259 të Kodit të Procedurës penale i paraqesim Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë këtë: KËRKESË: ...¹⁰⁹”* Për këtë rast nga ana e gjykatës, është pranuar kërkesa për caktimin e masës së sigurimit, por duke e zëvendësuar me masën e “garancisë pasurore” të parashikuar nga neni 236 i K.Pr.Penale. Ndaj këtij vendimi nga ana e prokurorit nuk është ushtruar ankim, duke marrë formë të prerë.

Për këto dy raste, rezulton se ka qenë i njëjti gjyqtar që ka shqyrtuar kërkesat e prokurorëve, i cili për aplikimin e nenit 236 të K.pr.penale ka arritur në konkluzionin e ekzistencës vetëm të kushtit të rrezikut të ikjes, duke mos identifikuar konkretisht të dhënat në rastin konkret që mbështesin këtë konkluzion. Për njërin nga rastet, e cila i është nënshtruar ankimi nga ana e prokurorit, Gjykata e Apelit e ka konsideruar vendimin e gjykatës për caktimin e masës së sigurimit, jo të marrë në përputhje me ligjin, duke arsyetuar se: *“Masa e sigurimit nuk është e përshtatshme për arsye se ka rrezik për marrjen ose vërtetësinë e provës, ekziston rreziku që të dyshuarit të largohen dhe ka rrezik që ky i dyshuar të kryejë një veprë tjetër penale. Për më tepër që i arrestuari është dyshuar për një veprë penale me rrezikshmëri shoqërore siç është ajo e mbajtjes pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyes dhe i municionit”* parashikuar nga nenet 278/1 i Kodit Penal. Të gjitha këto edhe për faktin se mbi bazën e fakteve të konstatuara dhe të pasqyruara në proceverbalet përkatëse nga punonjësit e policisë del se ky i arrestuar u kap me armë zjarri pa leje në ambiente publike,

¹⁰⁹ Kërkesë për vlefësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit ndaj shtetasit J.A., të dyshuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283/1 e 278/3 të K.Penal, për nevoja të procedimit penal nr. 290 të vitit 2021, të zyrës së prokurorisë Vlorë.

çka e bënë këtë ngjarje me rrezikshmëri të lartë shoqërore si fakt dhe si subjekt i veprës penale dhe ka nevojë të hetohet nën masën e sigurimit dhe me përshatshmja është ajo e arrestit në burg.”

Nga rastet ku evidentohet se nuk ka një arsyetim të plotë dhe shterues, përmendim edhe raste kur në kërkesat e prokurorëve përveç mungesës së arsytimit të kushteve dhe kritereve konkrete, nuk gjejmë në pjesën arsyetuese as citim të kushteve dhe kritereve sipas dispozitave përkatëse të neneve 228 dhe 229 të K.Pr.Penale. Përmendim këtu rastet e disa çështjeve:

i) Pasi përshkruhet fakti penal, kërkesa vazhdon: *“Për të dyshuarin H.N. i cili është arrestuar në flagrancë janë respektuar kërkesat e nenit 251 dhe 252 mbi gjendjen e flagrancës dhe ka dyshime pasi: Ekzistojnë dyshime të arsyeshme dhe të bazuara në ligj për faktin e ndodhur, fakt i cili parashikohet si veprë penale në kodin penal shqiptar. Ekzistojnë dyshime të arsyeshme dhe të bazuara në ligj se shtetasi H.N. ka kryer këtë veprë penale. Dispozita për këtë veprë parashikon dënim 5 deri në 7 vjet burgim. Për këto arsye ndaj të dyshuarit duhet të caktohet masa e sigurimit arrest në shtëpi dhe garanci pasurore, prandaj në bazë të neneve 228, 229, 244, 258, 237, 236 të K.Pr.Penale KËRKOJ: ...¹¹⁰”*

ii) *“B. Në lidhje me kushtet për caktimin e masës së sigurimit dhe faktorët që mbahen parasysh. Në caktimin e llojit dhe të masës së sigurimit gjykata duhet të ketë parasysh: - Kryerja e veprave penale të tjera; - përhapjen e kryerjes së veprave penale të “Armbëmbajtjes pa leje” të parashikuar nga neni 278 (paragrafi i parë) i Kodit Penal në Rrethin Gjyqësor Vlorë; - sanksionin e parashikuar nga legjislatori për këto lloj veprash penale që është vetëm ai me burgim; - moshën e personit të arrestuar dhe rrethanave personale të tij. Në ngarkim të personit nën hetim E.B. ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova, për këto arsye ndaj tij duhet të caktohet masa e sigurimit “Arrest në burg” të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, PËR KËTË ARSYE në bazë të neneve 228, 229, 238, 258 dhe 259 të K.Pr.Penale, KËRKOJ: ...¹¹¹”*

iii) *“Për caktimin e masave të sigurimit personal duhet të ekzistojnë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta si dhe të respektohen kriteret për caktimin e tyre. Në rastin konkret: Ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova (të dhënat hetimore të marrë nga burimet përkatëse të proves) të cilat në unitetin e tyre tregojnë se vepra penale është kryer dhe se është kryer nga personi që dyshohet, nuk ka shkaqe padënueshmërie ose të shuarjes së veprës penale. Për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të dyshuarve, pasi ka rrezik që ai të shmanget hetimit, gjykimin dhe vuajtjes së dënimit është e nevojshme që ndaj tyre të caktohet një masë sigurimi me karakter shtrengues. Përsa i përket kritereve për caktimin e masave të sigurimit: Masa e sigurimit që do të*

¹¹⁰ Kërkesë për vlefësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit ndaj shtetasit H.N. të dyshuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 278/1 të K.Penal, për nevoja të procedimit penal nr. 524 të vitit 2021, të zyrës së prokurorisë Shkodër.

¹¹¹ Kërkesë për vlefësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit ndaj shtetasit E.B. të dyshuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 278/1 të K.Penal, për nevoja të procedimit penal nr. 839 të vitit 2021, të zyrës së prokurorisë Vlorë.

kërkojmë është e përshtatshme për shkallën e nevojave të sigurimit që ekzistojnë në ratën konkret. Ekziston një raport i drejtë midis rëndësisë së faktit dhe sanksionit që parashikohet për veprën penale konkrete me llojin e masës së sigurimit. Në ngarkim të personit nën hetim ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova, për këto arsye ndaj tyre, duhet të caktohet masa e sigurimit "detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore", parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale"¹¹²

iv) "Fakti penal i mësipërm ka dyshime për veprën penale të "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit", parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal. Për shkak të dyshimit të krijuar nga policia gjyqësore në datën 26.03.2021, në orën 20.00, është bërë "Arrestimi në flagrancë" i shtetasit J.A., ..., i datëlindjes 31.07.1995, lindur e banues në Vlorë, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit", parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal. Nisur nga sa më sipër, ekzistojnë të gjitha kushtet ligjore të parashikuara nga neni 251 i Kodit të Procedurës Penale që përligjin këtë masë sigurimi dhe lënia në fuqi e saj i shërben interesave të hetimit të çështjes penale. Gjithashtu, duke qenë se ekzistojnë kushtet për caktimin e masës së sigurimit siç është ekzistenca e një dyshimi të arsyeshëm të bazuar në prova, mundësia e shmangies nga hetimet, duke patur parasysh shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale e të autorit, sanksionet që parashikohen për veprën penale të cilën ai dyshohet të ketë kryer, si dhe kriteret ligjore për caktimin e masës së sigurimit, bazuar në nenet 258/1 e 244/1 të Kodit të Procedurës Penale, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i paraqes këtë KËRKESË ..."¹¹³

vi) "Në këto rrethana ekzistojnë kushtet dhe kriteret ligjore për caktimin e masave të sigurimit personal me karakter shtrëngues, të parashikuara nga nenet 228, 229 e 230 të K.Pr.Penale. Konkretisht ekziston dyshimi i arsyeshëm se shtetasi R.M. në bashkëpunim me persona të tjerë ka kryer veprën penale të vrasjes me paramendim, me mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 78/1, 22, 25 të K.Penal, dyshim ky që bazohet në aktet bashkëlidhur kërkesës për caktimin e masës së sigurimit. Nuk ka shkaqe padënueshmërie apo shuarje të veprës penale si dhe i dyshuari është i larguar, duke ju fshetur hetimit të çështjes. Në lidhje me llojin e masës së sigurimit kërkojmë që nga ana e Gjykatës të caktohet ajo e arrestit në burg, e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, pasi kjo është masa e përshtatshme në lidhje me nevojat e sigurimit, rrezikshmërinë e veprës dhe

¹¹² Kërkesë për vlefësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit ndaj shtetasit R.L. të dyshuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283/1, 278/3 dhe 279/2 të K.Penal, për nevoja të procedimit penal nr. 52 të vitit 2021, të zyrës së prokurorisë Shkodër.

¹¹³ Kërkesë për vlefësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit ndaj shtetasit J.A. të dyshuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 278/1 të K.Penal, për nevoja të procedimit penal nr. 379 të vitit 2021, të zyrës së prokurorisë Vlorë.

të autorit në rastin konkret. Nisur sa më sipër, në bazë të nenit 244/1 të K.Pr.Penale KËRKOJ:
...¹¹⁴

vii) "Pra, ekzistojnë kushtet dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta, të parashikuar nga nenet 228, 229, 237 të Kodit të Procedurës Penale për caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues ndaj të arrestuarit I.H., për arsye se: "1. Nga hetimet e kryera rezulton se ka dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se shtetasi I.H., ka konsumuar elementët e veprës penale "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municioneve" parashikuar nga nenet 278/1/2 të K.Penal. 2. Nga hetimet e kryera rezulton se ka dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se shtetasi I.H. ka konsumuar elementët e veprës penale të parashikuar nga nenet 278/1/2 të K.Penal. 3. Ekziston nevoja e kryerjes së veprimeve të tjera hetimore administrimi i akteve të ekspertimit etj. Pra, ekzistojnë kushtet dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta, të parashikuara nga nenet 228, 229, 237 të Kodit të Procedurës Penale për caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues ndaj të arrestuarit I.H. për arsye se: Sa më sipër, bazar në nenet 228, 229, 230, 251/1 e 252, si dhe nenet 244/1 e 258/1 të Kodit të Procedurës Penale, KËRKOJ: ..."¹¹⁵

Nga rastet sa më sipër, evidentohet gjithashtu edhe raste kur në çështjet me kërkesë me objekt "vlefësimin e arrestimit/ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit ndaj dy ose më shumë personave, mungesa e arsytimit, konstatohet në mosbërjen e asnjë lloji dallimi mbi përshtatshmërinë e proporcionalitetin e masës së kërkuar për secilin person për të cilin kërkohet masa. Përmendim këtu rastet si më poshtë:

i) "Nisur nga sa më sipër është e nevojshme që në ngarkim të të ndaluarve duhet të caktohet një masë sigurimi shtrënguese për vazhdimin e mëtejshëm të hetimeve të këtij procedimi penal pasi: Përveç sa më sipër çmujmë se ekzistojnë kushtet dhe kriteret ligjore të parashikuara në nenet 228 e 229, 230 të K.Pr.Penale që ndaj të pandehurit të caktohet një masë sigurimi me karakter shtrëngues. ... Në kërkesën lidhur me llojin e masës së sigurimit që kërkohet të caktohet mbahet parasysh proporcionaliteti dhe përshtatshmëria specifike e nevojave të sigurimit në rastin konkret me llojin e masës së sigurimit. Në caktimin e masës së sigurimit duhet të kihet parasysh raporti me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Duke qenë se ndalimi i shtetasit është bërë konform rregullave procedurale duke ju bërë të qartë të drejtat

¹¹⁴Kërkesë për caktimin e masës së sigurimit ndaj shtetasit R.M. të dyshuar për kryerjen e veprave penale të parashikuar nga neni 78/1, 22, 25 (vrasje me armë zjarri), të K.Penal. për nevoja të procedimit penal nr. 578 të vitit 2021, të zyrës së prokurorisë Fier.

¹¹⁵ Kërkesë për vlefësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit ndaj shtetasit I.H., të dyshuar për kryerjen e veprave penale të parashikuar nga neni 278/1/2, të K.Penal. M. për nevoja të procedimit penal nr. 3 të vitit 2021, të zyrës së prokurorisë Fier.

dhe detyrimet ligjore në përputhje me nenet 253 dhe 258/1 të K.Pr.Penale si dhe bazuar në nent 228, 229 e 230, 245, 254, 259 të K.Pr.Penale.¹¹⁶

ii) "Përveç sa më sipër çojmë se ekzistojnë kushtet dhe kriteret ligjore të parashikuara në nenet 228 e 229, 230 të K.Pr.Penale që ndaj të pandehurit të caktohet një masë sigurimi me karakter shtrëngues. Konkretisht ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në provaNë kërkesën lidhur me llojin e masës së sigurimit që kërkohet të caktohet mbahet parasysh proporcionaliteti dhe përshtatshmëria specifike e nevojave të sigurimit në rastin konkret me llojin e masës së sigurimit. Në caktimin e masës së sigurimit duhet të kihet parasysh raporti me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Duke qenë se ndalimi i shtetasit është bërë konform rregullave procedurjale duke ju bërë të qartë të drejtat dhe detyrimet ligjore në përputhje me nenet 251, 252, 253 dhe 258/1 të K.Pr.Penale si dhe bazuar në nenet 228, 229 e 230, 245, 254, 259 të K.Pr.Penale KERKOJME: ...¹¹⁷

iii) "Në këto rrethana ekzistojnë kushtet dhe kriteret ligjore për caktimin e masave të sigurimit personal me karakter shtrëngues, të parashikuara nga nenet 228, 229 e 230 të K.Pr.Penale. Konkretisht ekziston dyshimi i arsyeshëm se shtetasi A.Z., E.T, E.Xh. dhe R.C. në bashkëpunim me njëri tjetrin kanë kryer veprën penale të vrasjes me paramendim, me mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 78/1, 25 të K.Penal. dyshim ky që bazohet në aktet bashkëlidhur kërkesës për caktimin e masës së sigurimit. Nuk ka shkaqe padënueshmërie apo shuarje të veprës penale si dhe duke vlerësuar rrethanat e faktit dhe personalitetin e të dyshuarit ekziston rreziku që i dyshuari të kryejë vepra të të njëjtit lloj, si dhe është i larguar. Në lidhje me llojin e masës së sigurimit kërkohet që nga ana e Gjykatës të caktohet ajo e arrestit në burg, e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, pasi kjo është masa e përshtatshme në lidhje me nevojat e sigurimit, rrezikshmërinë e veprës dhe të autorit në rastin konkret. Nisur sa më sipër, në bazë të nenit 244/1 të K.Pr.Penale KERKOJ: ...¹¹⁸

Në kërkesat lidhur me vlefhtësimin e arrestimit/ndalimit dhe caktimit të masave të sigurimit përkundrejt të miturve, jo në të gjitha aktet si tek kërkesa e prokurorit dhe vendimi i gjykatës, ka

¹¹⁶ Kërkesë për vlefhtësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit ndaj shtetasit K.K të dyshuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga neni 79/c, 22, 278/1 të K.Penal dhe Xh.M. të dyshuar për kryerjen e veprës penale penale të parashikuara nga neni 130/a/4 të Kodit Penal, për nevoja të procedimit penal nr. 1 të vitit 2021, të zyrës së prokurorisë Vlorë.

¹¹⁷ Kërkesë për vlefhtësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit ndaj kërkuar ndaj të dyshuarit të miturit në konflikt me ligjin, V.M. bazuar në ekzistencën e dyshimit për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga neni 84, 274, 278 e 25 i K.Penal dhe D.LI për veprën penale të parashikuara nga neni 278/1, 25 i K.penal, për nevoja të procedimit penal nr. nr. 352 datë 19.03.202.

¹¹⁸ Kërkesë për caktimin e masës së sigurimit ndaj shtetasve A.Z., E.T, E.Xh. dhe R.C të dyshuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga neni 78/1, 25 (vrasje me armë zjarri), të K.Penal, për nevoja të procedimit penal nr.103 të vitit 2021, të zyrës së prokurorisë Fier.

një pasqyrim të dispozitave përkatëse të ligjit me nr.37/2017 Kodi i Drejtësisë Penale për të miturit. Kjo e fundit parashikon kushte dhe kritere të veçanta lidhur me këtë kategori personash, për shkak të vulnerabilitetit të tyre, duke i kushtuar rëndësi mbajtjes në konsideratë interesit më të lartë të fëmijës. Përmendim rastet e mëposhtëme:

i) Rasti i zyrës së Prokurorisë Fier, lidhur me procedimin penal me nr. 396, datë 02.05.2021, për të cilën nga ana e prokurorit është kërkuar "Vendosje nën mbikqyrje" e të miturit në konflikt me ligjin, N.S., si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit", parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal. Në kërkesën e tij lidhur me llojin e masës së sigurimit, prokurori shprehet se: *"Në caktimin e llojit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues ndaj të dyshuarit duhet të merren parasysh dhe kriteret ligjore të caktimit të masës të parashikuar nga neni 229 që janë: përshtatshmëria e masës së sigurimit me nevojën e sigurimit; ruajtja e një raporti të drejtë midis rëndësisë së faktit dhe sanksionit që parashikohet për veprën penale konkrete me llojin e masës së sigurimit; si dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale. Për të gjitha arsyet e lartpërmendura, masa e sigurimit është më e përshtatshme në raport me masat e tjera të sigurimit personal me karakter shtrëngues. Kjo masë diktohet nga rrethanat e kryerjes së veprës penale, nga rrezikshmëria e veprës penale dhe e personit nën hetim. Gjithashtu, duke iu referuar përshtatshmërisë së masës së sigurimit me shkallën e nevojave të sigurimit, në raport me rëndësinë e faktit, kjo masë sigurimi, i përmbush nevojat e sigurimit për hetimet që po zhvillohen në ngarkim të të dyshuarit. Për sa më sipër, bazuar në nenin 228, 229, 238, 258 dhe 259 të Kodit të Procedurës Penale, KËRKOJMË:"*

ii) Rasti i zyrës së prokurorisë Vlorë, lidhur me procedimin penal me nr. 352 datë 19.03.2021 për të cilën nga ana e prokurorit është kërkuar masa e sigurimit "arrest në shtëpi", ndaj të dyshuarit të miturit në konflikt me ligjin, V.M. bazuar në ekzistencën e dyshimit për kryerjen e veprave penale të parashikuar nga neni 84, 274, 278 e 25 i K.Penal. Në kërkesën e tij lidhur me llojin e masës së sigurimit, prokurori shprehet se: *"Në kërkesën lidhur me llojin e masës së sigurimit që kërkohet të caktohet mbahet parasysh proporcionaliteti dhe përshtatshmëria specifike e nevojave të sigurimit në rastin konkret me llojin e masës së sigurimit. Në caktimin e masës së sigurimit duhet të kihet parasysh raporti me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Duke qenë se ndalimi i shtetasit është bërë konform rregullave procedurjale duke ju bër të qartë të drejtat dhe detyrimet ligjore në përputhje me nenet 251, 252, 253 dhe 258/1 të K.Pr.Penale si dhe bazuar në nenet 228, 229 e 230, 245, 254, 259 të K.Pr.Penale KËRKOJMË: ..."*

iii) Rasti i zyrës së Prokurorisë Shkodër, lidhur me procedimin penal nr. 415 datë 07.05.2021, ku nga ana e prokurorit është kërkuar caktimi i masës së sigurimit "arrest në shtëpi" ndaj të miturit në konflikt të dyshuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga nenet 274, 278/1 dhe 293/b të K.Penal. Në kërkesën me shkrim, lidhur me llojin e masës së sigurimit, nuk ka asnjë analizë lidhur me dispozitat konkrete të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur të cilat rregullojnë në mënyrë të veçantë edhe rastet e masës së sigurimit. Nga ana e prokurorit, përmendet thjesht si bazë ligjore

neni 86 i Kodit Penal për të të Miturit në momentin kur duhet të konkludoj, prokurori shprehet se: *“Në caktimin e llojit të masës së sigurimit me karakter shtrëngues ndaj të ndaluarit duhet të merren parasysh dhe kriteret ligjore të caktimit të masës së sigurimit të parashikuara nga enni 229 i K.Pr.Penale që janë: a) Përshtatshmëria e masës së sigurimit, me shkallën e nevojave të sigurimit; b) Ruajtja e një raporti midis rëndësisë së faktit me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete; c) Rrethanat e kryerjes së veprës penale si ato lehtësuese dhe rënduese. Duke mbajtur parasysh: përshtatshmërinë e masës së sigurimit në raport me shkallën e nevojave të sigurimit; përshtatshmërinë e masës së sigurimit në raport me rëndësinë e faktit; sanksioni që parashikohet për këto vepra penale; personalitetin e personit nën hetim, rrethanat familjare të të arrestuarit, faktin që i arrestuari është i mitur dhe nxënës shkolle, në rastin konkret masa e sigurimit personal “arrest në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 të K.Pr.penale plotësojnë nevojat e sigurimit. Bazuar në nenet 228, 229, 237, 258 dhe 259 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenin 86 të Kodit Penal për të Miturit, KËRKOJ:”*

3.5. Aspekte të tjera të evidentuara gjatë inspektimit tematik

Përveç sa më sipër, gjatë studimit lidhur me rastet në fjalë të fokusuar në drejtimit sa më sipër, është konstatuar se:

i) Lidhur me nenin 244/1 të K.Pr.Penale ku parashikohet se: *“1. Masat e sigurimit vendosen me kërkesën e prokurorit, i cili i paraqet gjykatës kompetente arsyet ku bazohet kërkesa. Vendimi merret në dhomë këshillimi dhe jepet i arsyetuar”,* vlerësohet se ka vend për të ndryshuar lidhur me fjalinë e dytë. Kjo e fundit është shtuar me ligjin me nr. 35/2017 dhe sipas relacionit ndryshimi ka ndodhur me këtë arsyetim: *“Në paragrafin 1 të nenit 244 është shtuar parashikimi që gjykata vendos mbi kërkesën e prokurorit për caktimin e masës së sigurimit në dhomë këshillimi, duke i dhënë kështu kuptim parashikimit aktual të nenit 248 mbi marrjen në pyetje të personit të arrestuar, parashikim i cili është keqkuptuar dhe zbatuar gabim në praktikë, duke u konsideruar kjo seancë thjesht si seancë verifikimi e identitetit të personit të arrestuar. Në të kundërt nga aplikimi në praktikë, ligji ka si synim caktimin e masës së sigurimit arrest në burg në mungesë në rastet e ngutshmërisë dhe seanca e marrjes në pyetje të të pandehurit është një seancë reale, në të cilën gjykata duhet t'i nënshtrojë debatit gjyqësor ekzistencën e kushteve dhe kriterëve për caktimin e masës së sigurimit, duke marrë edhe provat eventuale të mbrojtjes.”*

Qëllimi i ndryshimit sipas këtij arsytimi të përdorur, nuk është reflektuar në ndryshimin e bërë.

Në Kodin e Procedurës Penale në titullin V “Masat e Sigurimit”, Kreu i “Masat e Sigurimit Personal” janë parashikuar ndër të tjera edhe rregullat për caktimin e zbatimin e masave të sigurimit, e lidhur me subjektet procedurale që kërkojnë dhe vendosin një masë sigurimi, përcaktimin e caktimit nga gjykata kompetente dhe rregullimin përkatës në rast të deklarimit të moskompetencës, si dhe rregullimin e raportit midis masës së kërkuar dhe asaj që do të vendoset. Ky parashikim gjën pasqyrim në nenin 244 të K.Pr.Penale, e cila gjendet në Pjesën e Parë, Titullin V, Kreu II, dhe si e tillë jo vetëm nga vendi ku gjendet në Kodin e Procedurës Penale (përpara

Titujve mbi fazën e hetimit paraprak dhe atij të gjykimit), por edhe nga përmbajtja e saj, kjo dispozitë thjesht evidenton se duhet respektuar parimi procedural i disponimit nga organi që procedon, në respektim të ushtrimit të funksioneve procedurale nga prokurori dhe gjykata. Referuar këtij parashikimi, një masë sigurimi mund të vendoset vetëm nga gjykata kompetente dhe vetëm mbi bazën e një kërkesë të prokurorit¹¹⁹, dhe se gjithashtu gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori. Në këtë kuptim, kjo dispozitë lidhur me kërkesën dhe vendimmarrjen e masave të sigurimit, në vijim edhe përmbajtjen e vendimit të gjykatës sipas parashikimeve të nenit 245 të K.Pr.Penale, janë dispozita të cilat duhet të zbatohen për të dy mënyrat që Kodi i Procedurës Penale ka parashikuar për caktimin e masave të sigurimit personal, si për rastin kur masa e sigurimit vendoset në mungesë të të dyshuarit dhe për rastin kur masa e sigurimit vendoset në rastet e arrestimit në flagrancë/ndalimit të personit të dyshuar. Në rastin e parë, gjykata procedon me shqyrtimin e kërkesës, bazuar vetëm në aktet e paraqitur nga prokurori, në dhomë këshillimi dhe vendos pranimin/mospranimin e kërkesës së prokurorit. Ndërsa në rastin e dytë, gjykata procedon me shqyrtimin e kërkesës për caktimin e masës së sigurimit, në seancë gjyqësore në prani të të dyshuarit, mbrojtësit dhe të prokurorit, të cilët kanë të drejtë të paraqesin prova.

Referuar nenit 112 të K.Pr.Penale, ku parashikohen format e disponimit të gjykatës, për vendimin e gjykatës në pikën 4 të kësaj dispozite është parashikuar se: *"Vendimi merret në dhomën e këshillimit, pa praninë e sekretarit dhe të palëve"*. Pra, sipas këtij parashikimi, ashtu siç është pranuar tashmë nga praktika e hershme gjyqësore kombëtare dhe ndërkombëtare, Gjykata vendimet i merr gjithmonë në dhomën e këshillimit.

Pikërisht nisur nga sa më sipër lidhur me kuptimin e vendimmarrjes në dhomë këshillimi dhe kuptimit të zbatimit të nenit 244 të K.Pr.Penale për të dy mënyrat që njihen për caktimin e një mase sigurimit, vlerësohet se parashikimi në fjalinë e dytë në nenin 244/1 të K.pr.Penale, nuk reflekton qëllimin për ndryshimin e këtij paragrafi. Dhe për këtë vlerësohet që dispozita duke qenë se nuk paraqet keqkuptim në praktikë tashmë prej shumë vitesh, të hiqet kjo fjali që është shtuar me ligjin nr. 35/2017 ose nëse do të gjendet një riformulim në përshtatje të qëllimit të relacionit, mund të ndryshohet e tillë si vendosja e një afati me orë ose me ditë, të cilën dispozita në këto raste nuk e parashikon, brenda të cilit duhet të merret vendimi i gjykatës.

ii) Nga gjykatat e rretheve gjyqësore Vlorë, Fier, Shkodër konstatohet se në dispozitivin e shumicës së vendimeve për vlefësimin e arrestimit në flagrancë/ndalimin dhe caktim mase sigurimi, si edhe të vendimeve për caktim mase sigurimi në mungesë, shprehen *për të drejtën e ushtrimit të ankimit brenda 5 ditëve nga e nesërmeja e shpalljes së vendimit*.

Përcaktimi i fillimit të këtij afati për ushtrimin e të drejtës së ankimit në këto vendime, konstatohet se nuk është në përputhje me parashikimin e nenit 249 të K.Pr.Penale që rregullon ankimin ndaj masave të sigurimit, dhe ku gjen rregullim edhe ankimi ndaj vendimeve të caktimit të masave të

¹¹⁹ Kjo është praktikë tashmë e konsoliduar, konfirmuar edhe me vendimin Unifikues të Gjykatës së Lartë me nr. 7-2011.

sigurimit me persona të arrestuar/ndaluar, sipas nenit 259/3 të K.p.penale. Kjo dispozitë përcakton se: "3. Kur del se arrestimi në flagrancë ose ndalimi janë bërë në mënyrë të ligjshme, gjykata merr vendim për vleftësimin e tij. Kur ka kërkesë nga prokurori, gjykata mund të caktojë masë sigurimi. Kundër vendimit të gjykatës lejohet ankim sipas nenit 249 të këtij Kodi".

Në nenin 249 të K.Pr.Penale parashikohet se:

1. Kundër vendimit të gjykatës për caktimin e masës së sigurimit, sipas nenit 244 të këtij Kodi, lejohet ankim brenda pesë ditëve nga njoftimi i vendimit të gjykatës.

1/1. Kundër vendimit të gjykatës për vazhdimin, revokimin ose zëvendësimin e masës së sigurimit, sipas nenit 248 të këtij Kodi, prokurori, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij mund të bëjnë ankim brenda pesë ditëve.

2. Per të pandehurin e ikur afati fillon të ecë nga data e njoftimit të bërë sipas nenit 141"

Nga përmbajtja e dispozitës, rezulton e qartë se në rastet e caktimit të masës së sigurimit të vendosur në mungesë, afati i fillimit të të drejtës së ankimit fillon nga dita e njoftimit të vendimit të gjykatës.

Edhe në rastet e masës së sigurimit me persona të arrestuar në flagrancë/ndaluar, për përlogaritjen e afatit sërish referimi duhet të bëhet tek paragrafi i parë i nenit 249 të K.Pr.Penale. Kjo pasi neni 244 i K.Pr.Penale i parashikuar në këtë paragraf, ashtu siç është interpretuar më sipër, lidhur me kërkesën dhe vendimarrjen e masave të sigurimit është një dispozitë e cila duhet të zbatohet për të dy mënyrat që Kodi i Procedurës Penale ka parashikuar për caktimin e masave të sigurimit personal, si për rastin kur masa e sigurimit vendoset në mungesë të të dyshuarit dhe për rastin kur masa e sigurimit vendoset në rastet e arrestimit në flagrancë/ndalimit të personit të dyshuar.

Në vijim të këtij interpretimi lidhur me konstatimin nga vendimet e gjykatave për rastet objekt inspektimit, vlerësohet të evidentohet edhe fakti se paragrafi 1/1 i shtuar me ligjin nr. 35/2017, ku parashikohet e drejta e ankimit ndaj vendimeve të gjykatës me rastin e aplikimit të nenit 248 të K.Pr.Penale, nuk është i qartë në drejtim të fillimit të afatit të ankimit.

Gjithashtu një moment tjetër i rëndësishëm që evidentohet lidhur me ankimin mbi masat e sigurimit, është edhe mungesa e parashikimit shprehimisht të të drejtës së ankimit për vendimet e marra në aplikim të nenit 260 të K.Pr.Penale. Është e nevojshme që edhe për këto vendime në këto raste, të parashikohet shprehimisht e drejta e ankimit, për të mbuluar kështu të gjitha rastet, ose duke qenë se titulli në nenin 249 i referohet ankimit kundër masave të sigurimit (pa përcaktuar rast konkret) mendoj që kështu në një fjali të përfshihen të gjitha rastet e ankimit. Kjo nuk do të krijonte paqartësi lidhur me zbatimin e cilës dispozitë ligjore do të duhej t'i referohemi për llogaritjen e afatit të fillimit të lejimit të ankimit.

Në relacionin e paraqitur në kuvend, që ka shoqëruar ligjin me nr. 35/2017 nuk ka sqarime lidhur me ndryshimin lidhur me nenin 249 të K.Pr.Penale.

4. Konkluzione

Nga të dhënat e marra nga 3 zyrat e prokurorive subjekt i këtij inspektimi, është konstatuar se lidhur me veprën penale të "Mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyes dhe municionit", nga ana e prokurorit janë propozuar masa sigurimi personal shtrengues. Këto masa sigurimi janë propozuar ndaj personave të cilët kanë qenë të arrestuar në flagrancë apo të ndaluar, ashtu edhe ndaj personave të cilët nuk kanë qenë në këto kushte. Gjithashtu masat e sigurimit personal janë propozuar nga ana e prokurorit, si ndaj personave të cilët kanë qenë të dyshuar vetëm për kryerjen e veprës penale të "Mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyes dhe municionit" ashtu edhe ndaj personave të cilët kanë qenë të dyshuar për kryerjen e veprës penale të "Mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyes dhe municionit", të shoqëruar edhe me vepra të tjera.

Masat e sigurimit personal të kërkuar nga ana e prokurorit në të tre zyrat e prokurorive subjekte të inspektimit, kanë qenë në masën më të madhe "arrestit në burg" të parashikuar në nenin 238 i K.Pr.Penal dhe nuk janë aplikuar në asnjë rast ndaj personave të mitur në konflikt me ligjin. Masa të tjera të aplikuara kanë qenë "arrest në shtëpi" dhe "garanci pasurore", ndërsa për të miturit në konflikt me ligjin janë aplikuar masat e sigurimit "arrest në shtëpi", "detyrim për t'u paraqitur" dhe "Vendosja e të miturit nën mbikëqyrje".

Masat e sigurimit personal të kërkuar nga ana e prokurorit në të tre zyrat e prokurorive subjekte të inspektimit, kanë qenë në përgjithësi proporcionale në raport me shkallën e nevojave të sigurimit për rastet konkrete, rëndësinë e faktit dhe sanksionin që parashikohet për veprën penale të parashikuar nga neni 278/1 i K. Penal, dhe me rrethanat që lidhen me autorin e dyshuar, deri në fazën e kërkuar.

Në të tre zyrat e prokurorive subjekte të inspektimit, për personat e dyshuar për kryerjen e vetëm të veprës penale të "Mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyes dhe municionit", apo të shoqëruar edhe me vepra të tjera, qëndrimi i prokurorëve për llojin e masës së sigurimit që kërkohet është i njëjtë referuar rrethanave të faktit penal. Kështu në rastet kur fakti penal lidhet me mbajtjen e armës në mjedise të hapura, publike, përdorimit të armës, kërkesa e prokurorit në të gjitha rastet në të gjitha zyrat ka qenë masa e sigurimit "arrest në burg". Ndërsa lidhur me gjetjen e municionit luftarak, e cila përbën kundravajtje, në të gjitha zyrat konstatohet se masa e sigurimit që është kërkuar në këto raste, ka qenë e lidhur me veprën tjetër shoqëruese e cila ka patur sanksionin më të rëndë dhe ka patur edhe rrezikshmëri të lartë shoqërore, të tilla si "Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike" që përbën edhe numrin më të madh të rasteve.

Në të tre zyrat e prokurorive subjekte të këtij inspektimi, janë konstatuar raste të aplikimit të masës së sigurimit "garanci pasurore" në të cilat janë vërejtur problematika në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të dispozitës procedurale, neni 236 të K.Pr.Penale. Kjo dispozitë ka pësuar ndryshime me ligjin me nr. 35/2017, duke u riformuluar për t'a bërë më konkrete zbatimin e garancisë pasurore.

Nga të dhënt e administruara nga të tre zyrat e prokurorive subjekte të këtij inspektimi, mbi qëndrimin e prokurorit dhe gjyqtarit për masat e sigurimit ndaj të miturve, vlerësohet se trajtimi i këtyre çështjeve, në rastet kur duhet të vendoset arrestimi në flagrancë/ndalimi dhe të kërkohet të caktohet një masë sigurimi proporcionale ndaj një të mituri, paraqet ende problematika në drejtim të vlerësimit të drejtë të këtyre kërkesave të ligjit dhe interpretime të ndryshme në praktikë të dispozitave, në mënyrë që prokurori në kërkesë dhe gjykata të mbajnë parasysh dhe të arsyetojnë interesin më të lartë të të miturit, nevojat specifike të tij dhe kërkesën për të mos ndërprere proceset edukative, të mirërritjes dhe zhvillimit normal të një të mituri.

Gjatë trajtimit të çështjeve objekt i këtij inspektimi gjatë shqyrtimit të kërkesave për zëvendësim mase apo revokim mase sigurimi, janë konstatuar qëndrime të prokurorit në interpretim të gabuar të dispozitave që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale, në drejtim të ndryshimit të kualifikimit të faktit penal e cila konsiderohet si një nga argumentet mbi të cilat mund të bëhet një vlerësim ndryshe të proporcionalitetit të masës së sigurimit të vendosur. Vlerësohet se nëse nga ana e prokurorit çmohet se nga provat e grumbulluar gjatë hetimit faktit penal duhet t'i jepet një kualifikim tjetër, ai, duhet të procedojë me një ndryshim të kualifikimit përkatës me akt përkatës të arsyetuar sipas parashikimeve të nenit 287/2¹²⁰ të K.P.Penale nëse personi është në cilësinë e personit nën hetim dhe me ndryshim akuze sipas nenit 34/1 të K.Pr.Penale nëse personi është në cilësinë e të pandehurit. Kjo është mënyra procedurale e parashikuar lidhur me dhënien e një kualifikimi ligjor të veprës penale për faktin penal të atribuar personit nën hetim dhe ndaj të cilit vlerësohet propozimi i një mase sigurimi. Kjo kompetencë i është dhënë vetëm prokurorit në fazën e hetimeve paraprake dhe si i tillë ai është i detyruar ta respektojë. Ajo që vihet re është se prokurorët kërkojnë zëvendësimin e masës pa i formalizuar në këtë mënyrë procedurale këto ndryshime.

Gjatë trajtimit të çështjeve me objekt caktim i masave të sigurimit me afat, në të tre zyrat e prokurorive janë vërejtur interpretime jo të bazuara në kuptimin e nenit 245/1/d të K.Pr.Penale për dhënien e një mase sigurimi me afat. Ka patur raste kur vetë prokurori ka kërkuar afat për masën e sigurimit, ndërkohë që nuk arsyetohej lidhur me rrezikun e marrjes së provës apo vërtetësinë e saj, si kusht i domosdoshëm për aplikimin e afatit. Dhe po kështu janë evidentuar raste kur në të njëjta vërejtje mbi zbatimin e gabuar të dispozitës për përcaktimin e afatit, këto masa janë caktuar nga vetë gjykata, ndërkohë që nga ana e prokurorit është propozuar e njëjta masë sigurimi pa afat. Qëndrime të tilla si të prokurorit dhe të gjykatës, në përfundim të afatit të masës së sigurimit, kanë pasqyruar situata procedurale në të cilat janë shfaqur interpretime të gabuara si në drejtim të formës së aktit procedural, ashtu edhe në drejtim të zgjidhjes së thelbit të çështjes lidhur me caktimin/zëvendësimin apo revokimin e masës së sigurimit.

Në 6 raste që i përkasin dy zyrave të prokurorive subjekt i këtij inspektimi është evidentuar vendim i ndryshëm i gjykatës nga kërkesa e prokurorit. Në këto raste konstatohet mosushtrim i ankimit i

¹²⁰ 2. Kur gjatë hetimeve paraprake ndryshon cilësimi juridik ose ndonjë rrethanë e kryerjes së veprës penale, prokurori urdhëron pasqyrimin e tyre në shënimet e bëra sipas paragrafit 1 të këtij neni.

pashoqëruar me një qëndrim me shkrim lidhur me këtë. Referuar ndryshimeve kushtetuese dhe të Kodit të Procedurës Penale, e më konkretisht nenit 408 të K.pr.penale, sipas të cilit ankimin mund t'a ushtrojë vetëm prokurori i çështjes, është e nevojshme që në rastet kur prokurori vlerëson të mos ushtrojë ankimin ndaj vendimit të gjykatës për caktimin e masës së sigurimit sipas nenit 249 të K.Pr.penale, t'i paraqes arsyet me shkrim lidhur me këtë vlerësim dhe t'ia paraqes Drejtuesit të Prokurorisë i cili mund t'a vlerësojë në kuadër të të drejtës së tij për të nxjerrë udhëzim jo të detyrueshëm, sipas Udhëzimit të Përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm me nr. 12/2020 i ndryshuar¹²¹.

Në rastet e zbatimit të një mase sigurimi të caktuar në mungesë nga ana e gjykatës, sipas parashikimeve të nenit 244/1 të K.pr.penale, konstatohet se ka praktika të ndryshme ndërmjet zyrave të prokurorisë subjekte inspektimi mbi mënyrën e të proceduarit për njoftimin e gjykatës, në kuadër të zbatimit të nenit 248 të K.pr.penale. Kështu në rastet e zyrave Shkodër dhe Vlorë, konstatohet se prokurori vepron me një shkresë përcjellëse duke njoftuar gjykatën për zbatimin e masës së sigurimit dhe të shoqëruar me dokumentacionit përkatës të mbajtur nga ana e oficerit të policisë gjyqësore me këtë rast. Ndërsa në zyrën e prokurorisë Fier, konstatohet se nga ana e prokurorit është vepruar me anë të aktit procedural të titulluar "për verifikimin e zbatimit të masës së sigurimit".

Në Kodin e Procedurës Penale, nuk ka asnjë parashikim ligjor lidhur me këtë mënyrë të të proceduarit nga ana e prokurorit për vënien në lëvizje të gjykatës, në kuadër të zbatimit të nenit 248 të K.Pr.Penale, megjithëse kjo është një praktikë e zbatueshme në të gjitha zyrat e prokurorive në Republikën e Shqipërisë. Sipas parashikimeve të nenit 246/1 të K.Pr.Penale është oficeri ose agjenti i policisë që bën zbatimin e masës së arrestit, që ka detyrimin e njoftimit në radhë të parë gjykatës si organi që ka dhënë vendimin dhe të prokurorit që është ngarkuar me ekzekutimin e vendimit të gjykatës. Pas këtij njoftimi, gjykatës i lind detyrimi për të marrë masat, që brenda afatit 3 ditor, personi të paraqitet para saj dhe nëpërmjet marrjes në pyetje në seancë gjyqësore, në prani të prokurorit dhe mbrojtësit, të verifikojë kushtet e kriteret të caktimit të masës së sigurimit dhe nevojat e sigurimit.

Nga rastet e kërkesave të prokurorit për caktimin e masës së sigurimit, për periudhën e inspektimit në tre zyrat e prokurorive konstatohet se në rastin kur procedohet me kërkesa për vlefësim arrestimi/ndalimi dhe kërkesë për caktim mase sigurimi, ato kryesisht bazohen në të dhënat që rezultojnë nga veprimtaria e oficerit të policisë gjyqësore.

Nga të gjitha rastet e marra në trajtim në të tre zyrat, vetëm në një çështje është evidentuar zbatimi nga ana e prokurorit e detyrimit ligjor të parashikuar nga neni 256 i K.Pr.Penale mbi pyetjen e të

¹²¹ Në nenin 13 të këtij udhëzimi është parashikuar mundësia e Drejtuesit të Prokurorit për të nxjerrë udhëzim jo të detyrueshëm lidhur me masat e sigurimit, por nuk është rregulluar konkretisht ky moment lidhur me ankimin ndaj vendimit të gjykatës për masat e sigurimit.

arrestuarit dhe të ndaluarit. Është e nevojshme që në zbatim të nenit 256 të K.Pr.Penale, nga ana e prokurorëve të procedohet me marrjen në pyetje të të arrestuarve ose të ndaluarve. Dhe kjo me qëllim që të garantohen të gjitha të drejtat e të të arrestuarit/ndaluarit. Sipas parashikimeve të kësaj dispozite, prokurori njofton të arrestuarin/të ndaluarin për faktet për të cilat procedohet dhe arsyet e marrjes në pyetje, duke i treguar të dhënat në ngarkim të tij dhe, kur nuk i shkaktohet dëm hetimeve, edhe burimet. Gjithashtu gjatë këtij procesi, prokurori sigurohet nëse i arrestuari/i ndaluarit është njohur me letrat e të drejtave, duke patur në vëmendje këtu rëndësinë procedurale të deklarimeve në këtë fazë hetimore. Këto deklarime, nuk mund të përdoren nëse më parë se të merreshin i arrestuari/i ndaluarit nuk është njohur me letrën e të drejtave apo nuk është takuar me mbrojtësin e tij.

Lidhur me provat mbi të cilat mbështetet kërkesa në funksion të ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm, konstatohet se nga ana e prokurorëve ndiqet një format i ndryshëm, disa i përmendin në parashitësën e fakteve dhe disa të tjerë i përmendin në fund të kërkesës, dhe gjithashtu konstatohet se jo të gjithë ndjekin të njëjtën paraqitje të këtyre provave duke i cituar me të gjitha ekstremitetet për identifikimin e këtyre provave me datën përkatëse. Gjithsesi është për t'u nënvizuar fakti se të gjitha kërkesat e prokurorëve të zyrës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë nisen të shoqëruar me kopje të akteve të cilat listohen me anë të një inventari ku shënohen emërtimi i akteve dhe fletët përkatëse.

Në të gjitha rastet e kërkesave me objekt "Vleftësim i arrestimit/ndalimit dhe caktimit të masës së sigurimit" dhe "caktim të masës së sigurimit", nga ana e prokurorëve në përgjithësi nuk ka një arsyetim të plotë dhe shterues lidhur me kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit me karakter personal. Prokurorët në përgjithësi në arsyetimin e tyre, mjaftohen me një analizë të përgjithshme të kushteve dhe kriterëve të masës së sigurimit, por pa u ndalur konkretisht në secilin prej kushteve të parashikuar në nenin 228 të K.Pr.Penale dhe në elementët që përcaktojnë kriteret e një mase sigurimi referuar nenit 229 të K.Pr.Penale. Gjithashtu, ky lloj arsyetimi evidentohet edhe në kriteret e veçanta të parashikuar në nenin 230 të K.Pr.Penale. Ndërsa gjejmë një analizë më të mirë tek vendimet gjyqësore, kryesisht në drejtëm të përshtatshmërisë së llojit të masës që do caktohet dhe dallimit të përshtatshmërisë së kësaj mase në rastet e caktimit të masës ndaj dy ose më shumë personave.

Në të gjitha zyrat e prokurorive subjekt i këtij inspektimi është evidentuar se informacioni i referimit të veprës penale, i oficerit të policisë gjyqësore së bashku me aktet e veprimeve hetimore të kryera prej tyre, ku përfshihet edhe procesverbali i arrestimit në flagrancë apo i ndalimit, regjistrohet në prokurori vetëm më datë dhe jo me orë. Kjo e fundit është e rëndësishme për t'u vlerësuar mundësia e prokurorit për të proceduar me detyrimin ligjor të pyetjes së të arrestuarit/të ndaluarit në respektim të nenit 256 të K.Pr.Penale, si dhe të vlerësimit efektiv duke patur kohë mjaftueshëm për të vlerësuar në mënyrë të përshtatshme të dhënat në kuadër nenit 257 të K.Pr.Penale dhe paraqitjes së një kërkesë të mirëarsyetuar para gjykatës, në kuadër të nenit 258 të K.Pr.Penale.

1. Për prokuroritë subjekte të inspektimit:

Raporti i inspektimit t'i njoftohet të gjitha prokurorive të inspektura në zbatim të parimit të transparencës së veprimtarisë inspektuese, me qëllim njohjen me praktikatat më të mira të identifikuara dhe problematikat e konstatuara në respektimin e kushteve dhe kritereve të caktimit të masave shtrënguese, si dhe të tjera në zbatimin e ligjit, për shmangien e tyre.

Gjithashtu, t'u kërkohet Drejtuesve të prokurorive të inspektuara, që në zbatim të nenit 42/d të ligjit me nr.97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar të diskutojnë me të gjithë prokurorët e zyrës gjetjet e konstatuara në këtë inspektim, me qëllim përmirësimin në veprimtarinë e tyre të mëtejshme. Veçanërisht kërkohet që:

Prokurorët pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore në kërkesat për caktimin e masës së sigurimit personal shtrëngues, duhet të analizojnë në raport me të dhënat e rastit konkret për të konkluduar sesi identifikohen secili prej tyre në tregues të provueshmërisë së ekzistencës së kushteve dhe kritereve për caktimin e masës së sigurimit, në përputhje me parashikimet e neneve 228, 229 të K.Pr.Penale, dhe për rastet e kërkesave të masës së sigurimit "arrest me burg" edhe të kritereve sipas parashikimeve të nenit 230 të K.Pr.Penale.

Në rastet e caktimit të masave të sigurimit ndaj personave të mitur, prokurori duhet përfshijë në analizën e mësipërme, edhe dispozitat konkrete të Kodit të Drejtësisë për të Mitur.

Me rastin e kërkesave për zëvendësim/revokim mase sigurimi, prokurori duhet të jetë me një qëndrim konkret dhe joevaziv përkundrejt masës së sigurimit që duhet t'i caktohet personit nën hetim. Është prokurori ai që me kërkesën e tij, ka iniciuar caktimin nga gjykata të masës së sigurimit që po kërkohet të zëvendësohet, si një atribut që i është dhënë vetëm atij nga ligji dhe pikërisht në kuadër të këtij funksioni është sërish prokurori ai i cili ka detyrimin për t'u shprehur lidhur me masën e sigurimit me të cilën duhet të vazhdojë tashmë personi për të cilën bëhet kërkesa.

Drejtuesit e prokurorive të inspektuar u kërkohet që në kuadrin e kompetencave administrative, sipas parashikimeve në nenin 42/a)¹²², dhe 52/1, 3¹²³ të Ligjit me nr. 97/2016 "Për Organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", të marrin masa për evidentimin e orës dhe datës së hyrjes në prokurori të materialeve hetimore të cilat përmbajnë procesverbal të arrestimit në flagrancë/ndalimit me iniciativë nga oficeri i policisë gjyqësore. Kjo me qëllim që të

¹²² Neni 42, në shkronjën a) parashikon se: "Drejtuesi i prokurorisë ushron këto detyra: a) organizon punën dhe merr masat e nevojshme për mirëfunksionimin e prokurorisë"

¹²³ Në nenin 52 parashikohet se: "1. Drejtuesi i prokurorisë është përgjegjës për mbarëvajtjen e punës dhe marrjen e masave dhe veprimeve për të siguruar efikasitetin dhe ligjshmërinë e veprimtarisë së prokurorisë që drejton. ... 3. Drejtuesi i prokurorisë merr masa për të garantuar përmbushjen e funksioneve administrative të prokurorisë, përfshirë mbajtjen e regjistrave dhe raporteve, mbajtjen e protokollit dhe arkivit, administrimin financiar dhe material, menaxhimin informatik, ndarjen e brendshme e detyrave, shqyrtimin e ankesave dhe detyra të tjera që lidhen me veprimtarinë e prokurorisë.

mund të vlerësohet në drejtim të arsytimit lidhur me veprimtarinë e të proceduarit të prokurorit, në këto raste, referuar zbatimit të nenit 256 dhe nenit 258 të K.Pr.Penale.

2. Për gjykatat e rretheve gjyqësore pranë të cilëve ushtrojnë funksionin prokuroritë subjekte të inspektimit:

Raporti i këtij inspektimi t'i njoftohet edhe Kryetarëve të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore në territorin e të cilave funksionojnë prokuroritë e inspektuara, me qëllim diskutimin e tyre në mbledhjet e përgjithshme të gjyqtarëve:

- i. në kuadër të koordinimit dhe organizimit të veprimtarisë së tyre në raport me administratën gjyqësore, me qëllim respektimin e afatit detyrues ligjor të parashikuar në nenin 249/3 të K.Pr.Penale të dërgimit të akteve përkatëse në gjykatën që do të shqyrtojë ankimin. Ky afat, edhe pse jo me pasojë pavlefshmërie, gjithsesi është një afat i detyrueshëm për t'u zbatuar nga gjykatat dhe sekretaritë e tyre. Çdo moszbatim i tyre, pavaresisht nga pasoja në vetvete, është shkelje e ligjit dhe urdhërimeve të tij.
- ii. në kuadër të rritjes së cilësisë së vendimmarrjeve të gjyqtarëve në drejtim të respektimit të kushteve dhe kriterëve të caktimit të masave të sigurimit, sipas parashikimeve në nenet 228, 229, 230 dhe 245 të K.Pr.Penale, si edhe në drejtim të formës lidhur me dispozitivin e vendimit për përcaktimin qartë të llojit të masës së sigurimit, mënyrës së zbatimit të tyre, afatit të vendosur për masat e sigurimit me afat dhe disponimit të saktë lidhur me afatin e ushtrimit të të drejtës së ankimit.
- iii. në kuadër të respektimit të afatit ligjor të parashikuar në nenin 260/3 të K.Pr.Penale, për shqyrtimin e kërkesave të prokurorit ose të të pandehurit për revokimin, zëvendësimin ose bashkimin e masave të sigurimit.

Rekomandimi nxirret bazuar në parimin e qasjes proaktive në zhvillimin e inspektimeve.

3. Për Prokurorin e Përgjithshëm:

Raporti i këtij inspektimi t'i njoftohet Prokurorit të Përgjithshëm, si autoriteti që ka përgjegjësi për punën e prokurorëve pranë gjykatave me juridiksion të përgjithshëm, pjesë e të cilave ishin subjektet e këtij inspektimi, dhe ka në kompetencën e tij nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme për të siguruar zbatimin e njëjtë të ligjit dhe ndjekjes penale.

4. Për shkollën e Magjistraturës:

Raporti i këtij inspektimi t'i njoftohet Shkollës së Magjistraturës, me qëllim që të bëhen pjesë e curriculave të trajnimit vazhdues të prokurorëve dhe gjyqtarëve. Më konkretisht, kërkohet që të përfshihen në temat e trajnimit:

- i. çështjet e interpretimit dhe zbatimit në praktikë të nenit 236 të K.Pr.Penale "Garancia pasurore", në drejtim të përputhshmërisë së garancisë së parashikuar në nenin 5.3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, "Lirimi i parashikuar në pritje të gjyqimit".

Raste të trajtimit të saj nga GJEDNJ, si dhe raste të praktikave më të mira të parashikimit dhe zbatimit të kësaj garancie në legjislacionet kombëtare të vendeve që kanë ngjashmëri me legjislacionin në këtë lloj mase sigurimi.

- ii. çështjet e interpretimit dhe zbatimit në praktikë të dispozitave në Kodin e Drejtësisë Penale me të Mitur, lidhur me masën e sigurimit ndaj personave të mitur në konflikt me ligjin.
- iii. çështjet e interpretimit ligjor mbi kushtet lidhur me caktimin e masës së sigurimit "me afat". Koha e fillimit të përlllogaritjes së afatit. Roli i prokurorit në arsyetimin e kërkesës së tij, në lidhje me këto masa dhe kompetencat e gjyqtarit të hetimeve paraprake në caktimin e tyre. Mundësia e përsëritjes së tyre, dhe procedura përkatëse sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale, në drejtim të formës së kërkesës së prokurorit dhe vendimmarrjes së gjykatës.
- iv. çështje lidhur me teknikën e shkrimit dhe të hartimit të kërkesave nga ana e prokurorëve dhe të vendimeve nga ana e gjyqtarëve, që lidhen me masat e sigurimit.

6. Për Këshillin e Lartë të Prokurorisë

Raporti i këtij inspektimi t'i njoftohet Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për t'u patur në konsideratë veprimtaria e prokurorëve, gjatë vlerësimit të punës së tyre sipas parashikimeve të ligjit me nr. 96/2016 në drejtim të cilësisë së hartimit të kërkesave për masat e sigurimit.

7. Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Raporti i këtij inspektimi t'i njoftohet Këshillit të Lartë Gjyqësor, për t'u patur në konsideratë veprimtaria e gjyqtarëve gjatë vlerësimit të punës së tyre sipas parashikimeve të ligjit me nr. 96/2016 në drejtim të cilësisë së hartimit të vendimmarrjeve për masat e sigurimit.

8. Për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë:

- Të vlerësohet për propozime për ndryshime ligjore referuar parashikimeve të nenit 244 të K.Pr.Penale dhe nenit 249 të K.Pr.Penale.
- Të kryhet inspektim tematik pranë gjykatave me juridiksion të përgjithshëm për periudhën 01.01.2020 – 01.01.2022, lidhur me zbatimin e nenit 236 të K.Pr.Penale, me qëllim evidentimin e mënyrës së interpretimit të kësaj dispozite referuar respektimit të kushteve dhe kritereve të caktimit të masës së sigurimit.
- Referuar gjetjeve në këtë raport, vlerësohet se ka të dhëna lidhur me fakte që nëse provohen përbëjnë shkelje disiplinore të parashikuar sipas ligjit me nr. 96/2016. Për këto raste¹²⁴, sipas një raporti të veçantë të përgatitur nga inspektorët ku trajtohet hollësisht secili rast në kuadër të evidentimit të shkeljes disiplinore konkrete, është sugjeruar:

¹²⁴ Fakte sipas terminologjisë së përdorur në nenin 120/1/b të ligjit me nr. 96/2016.

- o fillimi i verifikimeve në kuadër të ligjit me nr. 97/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, për të konstatuar nëse ka fakte të mjaftueshme për fillimin e hetimit disiplinor për një magjistrat prokuror të zyrës së Prokurorisë Vlorë, për një magjistrat prokuror të zyrës së Prokurorisë Shkodër, për një magjistrat prokuror të zyrës së Prokurorisë Fier, për një magjistrat gjyqtar të zyrës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për një magjistrat gjyqtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe për një magjistrat gjyqtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Propozime

Bazuar në nenin 147/d, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenin 194, pika 4 dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar,

PROPOZOJMË:

1. Përfundimin e inspektimit tematik datë 02.11.2022 të Prokurorive të Juridiksionit të Përgjithshëm me objekt: *Respektimi i kushteve dhe kritereve për caktimin e masave të sigurimit personal, për veprën penale të "Mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyes dhe municionit"*.
2. Caktimin e periudhës nga 01.01.2023 deri në datën 01.07.2023, si periudhë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.
3. Të njoftohet Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, për përfundimin e inspektimit tematik, duke iu dërguar edhe një kopje të Raportit të Inspektimit.
4. Të njoftohet Prokurori i Përgjithshëm, Shkolla e Magjistraturës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor me Raportin e Inspektimit, duke iu dërguar një kopje të këtij raporti

INSPEKTORËT

Elena Pelushi



Julian Zonja



Alma Tafani



Lindita Ziguri



Besnik Maho



166

NJËSIA E INSPEKTORËVE – INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË